Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 101 / 2012

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XLI nr. 101 - 2012

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Korrektor:
Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 101 / 2012

Prishtinë
2012

Qemajl Morina

SHQIPËRIA – 100 VJET PAS PAVARËSISË

Nuk ka dyshim se njëqindvjetori i pavarësisë së Shqipërisë është ndër festat më të dashura të shqiptarëve, qofshin ata brenda Shqipërisë londineze apo jashtë saj. Edhe pse njëqind vjet për popujt e vjetër nuk paraqesin ndonjë periudhë të gjatë kohore, por kjo për një popull të vogël si ne shqiptarët do të thotë shumë. Për këtë edhe i tërë viti u shpallë vit i pavarësisë së Shqipërisë apo siç njihet ndryshe festa e ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar në Vlorën historike më 28 nëntor 1912, nga babai i kombit, Ismail Qemal bej (Vlora) dhe shokët e tij.

Në përvjetorë të këtillë është mirë që jo vetëm të përkujtojmë ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, por edhe të bëjmë analiza se si janë zhvilluar ato dhe mësimet, të cilat mund të nxirren prej tyre që të mos na përsëriten gabimet e njëjta në të ardhmen. Vetëm në këtë mënyrë e kaluara mund të na sjellë dobi ta ndërtojmë të tashmen dhe të ardhmen tonë.

Gjatë këtij viti jubilar u organizuan konferenca shkencore, u botuan libra të rinj, u shkruan artikuj të shumtë, të cilët objekt trajtimi kishin pavarësinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, duke bërë ana-

liza të ndryshme për rrethanat të cilat bënë që populli shqiptar të ngritet dhe të kërkojë heqjen e zgjedhës së huaj.

Kështu shohim historianin Oliver Jens Schmitt[1], në artikullin e tij të botuar me titull: "Njëqind vjet Shqipëri"[2], përveç tjerash shkruan: "Njëqindvjetori i ekzistimit të shtetit shqiptar është rast për kremtime në Shqipëri, në trevat e banuara me shqiptarë në Evropën Juglindore dhe në diasporën e madhe shqiptare në Evropë dhe përtej oqeanit. Aktualisht po shënohet vetë ekzistenca e shtetit të parë kombëtar shqiptar në histori. Si i tillë, shteti i Shqipërisë ka shënuar epokën në historinë shqiptare dhe atë evropiane. Po kremtohet ekzistenca e shtetit, por me pak ngjarjet historike, të cilat kanë karakterizuar shekullin e fundit. Po kremtohet shteti si ideal, si qëllim final i historisë shqiptare, si entitet abstrakt. Një kremtim i tillë është një lloj ftese për të bërë bilanc. Në Shqipëri shumë zëra janë duke u deklaruar mbi këtë temë. Këta zëra theksojnë para së gjithash bilancin pozitiv. Në fakt, në njëqind vitet e fundit u ndërtuan ato institucione të cilat sot e karakterizojnë Shqipërinë: administrata, shkollat, shkenca, policia, ushtria si dhe shumë institucione tjera".

Me një formë të ngjashme shohim shprehet edhe Sami Repishti[3] në artikullin e tij me titull: "Të falem Shqipëri, dheu i im i të parëve!"[4], ku përveç tjerash shkruan: "Prej Tivarit deri në Prevezë, kushdo që bukën e quen bukë dhe besën e mban besë, ashtë shqiptar dhe shqiptare, ashtë vëlla e motër gjuhe dhe gjaku të përbashkët, është arbënor, ashtë arbënore.

Për ju të gjithë arbënorë, urimet tona ma të përzemërta me rastin e festimit të Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar në Vlorën historike më 28 Nandor 1912, nga babai i kombit, Ismail Qemal bej (Vlora) dhe shokët e tij.

---

[1] Historian i Evropës Juglindore në Univesitetin e Vjenës dhe autor i disa librave mbi shqiptarët.

[2] www.panarama.com.al/28.11.2012.

[3] Ish i burgosuri politik 1946-1956 dhe profesor i City University of New York.

[4] www.panarama.com.al/28.11.2012.

Shqipëria e juej dhe e jona ashtë sot nji shtet shekullor, jo krijesë e rastit, as edhe dhuratë e "Shën Adriatikut". Sot, Shqipëria ashtë nji shtet i lirë për hir të tokës që mbrojti me gjak, të gjuhës që ruejti me kambëngulje, për hir të interesave dhe aspiratave të përbashkëta të fisit arbënor."

Me këto fjalë, intelektuali i njohur shqiptar, Sami Repshti iu drejtua nga Amerika e largët, ku siç thotë ai "jetojnë sot afër nji gjysmë miljon shqiptar, mendja dhe zemra e jonë janë me të gjithë ju, dhjetë miljonë vëllazën dhe motra shqiptare që banoni në hapësinën shqiptare të Ballkanit ose të shpërndamë në të gjitha kontinentet; me ju gegë e toskë, kosovarë e çamë, me ju arbëreshë të Italisë, arvanitas të Greqisë dhe arnautë të Turqisë".

Sami Repishti, pastaj i bënë një vështrim të shkurtër, por përmbajtësor gjendjes nëpër të cilën kaluan shqiptarët në periudhën një shekullore të shpalljes së pavarësisë: "Nji shekull ka kalue me invazione të hueja, lufta mbrojtje, grindje të brendshme, diktatura ekstreme, regjime autoritare; dhe sot kalohet nëpër rrugën e vështirë të "tranzicionit" nga diktatura e egër e proletariatit – çmenduria monstruoze e shekullit 20 – në demokracinë e brishtë, në nji periudhë historike që do të kujtohet për të kaluemen dështake që refuzon me vdekë dhe për të renë premtuese që nuk ka fuqi me lindë."

Për të arritur në etapën më të mirë dhe më premtuese të Shqipërisë dhe kombit shqiptar për tu integruar në rrjedhat euro-atlantike , pas krajatave nëpër të cilat kaloi kombi ynë në të kaluarën disa shekullore: "Asnjiherë në të kaluemen tonë 25 herë shekullore, vendi i shqiptarit nuk ka qenë ma i lirë dhe ma i sigurt se sot. Shqiptarët gëzojnë nji Shqipëri të lirë, të pavarun, të etshme për demokratizim, dhe me shpresë bashkimi shpirtënor të të gjithë shqiptarëve. Shqipëria ashtë anëtare e NATO-s, garancia e pavarësisë dhe integritetit tokësor të vendit. Shqipëria po i afrohet Bashkimit Europian, garancia e nji zhvillimi ekonomik të studjuem dhe kultural të vendit në nji atmosferë që lejon dhe thith me etje të pashueme ajrin e pastër e frymëdhanës të ideve iluministe dhe humaniste të Europës së qytetnueme që duhet të përqafojmë. Në Kosove gëzojmë sot lindjen e Republikës së Kosovës,

e lirë, e pavarun, demokratike dhe me perspektiva europiane. Në Maqedoni kemi nji popullsi shtet-formuese e angazhueme në sigurimin e të drejtave që meritojnë. Në Kosovën Lindore (Lugina e Preshevës) dhe në Mal të Zi, vëllaznit e motrat shqiptare janë ngritë në nivelin e duhun për kërkim dhe afirmim të të drejtave të tyne. Por Shqipëria sot vajton fatin tragjik të Çamërisë së masakrueme, popullsinë e saj pa plang, pa shtëpi."

Intelektuali i njohur shqiptar, Sami Repishti periudhën e tanishme e qan më prosperuese për shqiptarët. Meqenëse Evropa u ndërgjegjësua më në fund: " Shqipëria për të parën herë që në periudhën e lavdishme të herojt tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, hynë plotësisht në histori si pjesë përbamëse e kontinentit dhe bashkohet në marshimin drejt lirisë së plotë të njeriut, të çdo njeriu, pa përjashtim. Europa nuk ashtë thjesht nji shprehje gjeografike, as edhe nji ishull begatie. Europa ashtë nji koncept lirie dhe humanizmi, vlera themeltare të qytetnimit, që shqiptarët duhet të përvetësojnë".

Ish i burgosuri politik, Sami Repishti, periudhën e tranzicionit në Shqipëri e quan periudhë të ndërgjegjësimit: "Për Shqipërinë kjo gjendje tranzicioni sot ashtë faza e ndërgjegjësimit dhe ringjalljes mbas kohës së humbun në errësinën 50-vjeçare të pushtimeve të hueja e diktaturës hermetike komuniste. Ditët e vështira të frikësimeve, arrestimeve, ekzekutimeve, vrasjeve, vjedhjes së votave, gjyqeve të paligjëshme, eliminimit të opozitës politike, të shteteve njipartiake dhe qeverive kukëll në shërbim të qendrave jashtë-shqiptare ka kalue njiherë e përgjithmonë. Kanë perëndue kohët e nji sistemi politik, qëllimi i të cilit ka qenë me krijue "njeriun e ri", që nuk ndien shtypjen dhe as nevojën e revoltimit kundër sistemit që e detyron me shërbye si kafshë pune. Kanë kalue ditët kur kultura, arti, letërsia dhe sportet ishin të detyruem me i dhanë "nji fëtyrë njerëzore" çnjerëzimit të plotë komunist".

Intelektuali shqiptar nga Amerika e largët e përfundon artikullin e tij, duke e quajtur shekullin e dytë të pavarësisë si një orientim i respektimit i dinjitetit njerëzor,si vlerën më të lartë të këtij shekulli: "Me hymjen në shekullin e dytë të pavarësisë dhe në historinë euro-

piane, na duhet të orientohemi nga qëllimi kryesor: respektimi i jetës së njeriut dhe jetës me dinjitet. Me gjuhën shqipe: qytetarë liridashës me nder, besë e burrëni, për çdo burrë dhe grue shqiptare, pa asnji dallim. Na duhet të shikojmë çdonjenin nga ne si nji "person" individ me liri dhe të drejta të plota. Na duhet të pyesim çdo qytetar, duhet të njohim "andrrën" e tij, dhe nga të gjitha këto të nxjerrim përfundimet tona. Duhet të grumbullohemi rreth nji klase të ndërgjegjshme që nuk pranon uniformitetin vdekjeprurës që përqafon diversitetin dhe që ngren frymën e solidaritetit shoqënor si dëshirë e përbashkët me ec përpara. Duhet nji grupim vullnetar mendimesh të ngjashme – jo uniforme – dhe nji udhëheqje që përfaqëson esencën e mendimit të përbashkët".

Roli i ulemasë dhe pavarësia e Shqipërisë

Dijetarët mysliman, në përpjekjet dhe luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar kanë marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Në rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin Shqipërisë e të shqiptarëve, padyshim gjen edhe ata, dijetarë të nderuar të besimit mysliman, prania e të cilëve është e pashmangshme. Që nga eruditi Hoxha Hasan Tahsini, e më tej Daut efendi Boriçi (në Lidhjen e Prizrenit më 1878), Hafiz Ibrahim Shkupi (në Kongresin e Manastirit më 1908), me Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin (në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit), Hafiz Ali Korçën dhe Ismail efendi Ndroçin (në Kongresin e Durrësit më 1918), Mutesim Këllçin (në Kongresin e vitit 1920), Hafiz Ibrahim Dalliun në Tiranë e shumë të tjerë.

Për këtë ishte shumë domethënëse organizimi i Konferencës shkencore nga Bashkësitë Islame të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë me temën bosht: "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", e cila i zhvilloi punimet e saj në Tiranë më 28-29 shtator 2012, ku u paraqiten kumtesa me rëndësi, të cilat edhe një herë në mënyrë të argumentuar vërtetuan kontributin e

ulemave në rrjedhat kombëtare në të gjitha periudhat kohore nëpër të cilat kaloi kombi shqiptar.

Vlem të përmendim me këtë rast se ishte shumë me interes publikimi i "Enciklopedisë 100 personalitete shqiptare të kulturës islame", të cilët jetuan dhe vepruan gjatë shekujve XIX dhe XX-të. Andaj, me të drejt,në ballinën e librit konstatohet se kjo enciklopedi, e cila vjen për herë të parë, përbëhet nga 100 personalitete të shquara shqiptare të kulturës islame, të cilët i kanë shërbyer kombit dhe atdheut po me aq zell sa ç'i kanë shërbyer edhe fesë. Enciklopedia i shërben çdo personi për t'u njohur me këta patriotë, atdhetarë e fetarë të lartë, por vlen gjithashtu edhe për studiuesit e shumtë të figurave dhe personaliteteve shqiptare të kulturës islame.

Ky botim ka ardhur gjithashtu në kuadër të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, për të cilën bashkësitë islame shqiptare të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë kanë organizuar edhe një konferencë ndërkombëtare me temë "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar", mbajtur në Tiranë në dt. 28-29 shtator 2012.

Andaj, pas tërë kësaj që u tha, mund të përfundojmë se shqiptarët pas një shekulli të pavarësisë së Shqipërisë janë më mirë se që ishin një shekull më parë, por shumë larg asaj që ata në realitet duhet të jenë. Për të arritur këtë duhet shumë mund, angazhim dhe punë e përbashkët në nivele të ndryshme, si në aspektin intelektual, kulturor, fetar, kombëtar, politik etj. Për çka u mbetet gjeneratave të tashme dhe atyre që do të vijnë pas nesh të punojnë shumë.

Qemajl Morina

ALBANIA – 100 YEARS OF INDEPENDENCE

(Summary)

There is no doubt that the 100th anniversary of the independence of Albania is a very special day to all Albanians, be they Albanians who live within the borders of the Albanian state as defined by the London Treaty or outside them. 100 years is not a very long period of time, yet, for a small nation as are we the Albanians it means a lot. Consequently, in 2012, there was a year long celebration of the 100th anniversary of the independence of Albania, or the Flag Day, which was hoisted in Vlora, by Ismail Qemali, the father of our nation, on November 28, 1912.

كمال مورينا

ألبانيا - ١٠٠ سنة بعد الاستقلال

(خلاصة البحث)

لا شك أن الذكرى المئوية لاستقلال ألبانيا هي واحدة من الاعياد المحبة للألبان سواء داخل أو خارج ألبانيا اللندنية. و على الرغم من أن مئة سنة لشعوب كبيرة لا تشكل فترة طويلة من الزمن ولكن هذه المدة بالنسبة لشعب صغير مثل الألبان تعني الكثير. و لهذا تم اعلان العام الكامل كعام لاستقلال البانيا أو المعروف باسم عيد رفع العلم الوطني الألباني في فلورا التاريخية يوم ٢٨ نوفمبر ١٩١٢ من قبلÈÃ الأمة الالبانية اسماعيل كمال بك (فلورا) و المشاركون معه.

Mr. Ejup Haziri

SHITBLERJA NË JURISPRUDENCËN ISLAME

Hyrje

Feja islame nuk është fe askete që privon besimtarët nga të shijuarit e të mirave të kësaj dynjaje, përkundrazi thërret besimtarët që t'i shijojnë të mirat, që Zoti u ka dhënë atyre.

Njeriu është krijuar dhe është udhëzuar nga Krijuesi, se si duhet të jetojë në këtë jetë dhe çfarë ai duhet të bëjë. Ai është qenie shoqërore që s'mund të jetojë i vetëm, i ndarë, i izoluar dhe i braktisur, por duhet të jetojë me shoqërinë dhe për shoqërinë. Ai duhet t'u përgjigjet kërkesave të jetës, në mënyrë që ta jetojë jetën ashtu siç duhet.

Islami, i lejoi njeriut shitblerjen, sipas konceptit dhe frymës që ka paraparë Krijuesi dhe i Dërguari, ngase për shitblerjen ka rregulla, norma dhe dispozita të caktuara. Shitblerja është një gjë e domosdoshme për njeriun, pa të cilën njeriu do të jetë i privuar, ngase ajo promovon dhe ndihmon mirëqenien njerëzore. Nga ana tjetër, Islami ka ndaluar kërkimin e lëmoshës, pasi që ajo si një dukuri është në kundërshtim me parimet hyjnore. Së këndejmi, njerëzit duhet të punojnë e të angazhohen për këtë jetë, ngase Islami nuk na porosit që t'i largohemi tërësisht kësaj jete e t'i përkushtohemi tjetrës. Përmes kësaj jete, fitohet

bota tjetër, jo duke iu shmangur kësaj, por duke e kuptuar realitetin e kësaj jete dhe të botës tjetër.

Secili njeri duhet të përpiqet, të angazhohet dhe të punojë për të pasur një mirëqenie të mirë, ku s'do të ketë nevojë për ndihmën e tjetrit, madje formën e të jetuarit si parazit në kurriz të të tjerëve, islami e ka ndaluar, me përjashtim të disa rasteve, si gjatë sëmundjes e të ngjashme.

Njëra nga format e lejuara që arrihet mirëqenia dhe një jetë e rehatshme, është shitblerja, por ajo duhet të jetë sipas konceptit të lejuar, ngase jo çdo shitblerje është e lejuar, e për të cilën do të flasim në vijim.

PËRKUFIZIMI I SHITBLERJES

Sa i përket përkufizimit të shitblerjes, juristët myslimanë kanë dhënë definicione dhe përkufizime të ndryshme, por që nuk kanë ndonjë dallim të theksuar mes tyre, andaj një përkufizim do të mjaftonte për të, e ne do ta cekim atë përkufizim që pothuajse është më i pranuari dhe më i përhapuri.

تَعْرِيفِ الْبَيْعِ: مُبَادَلَةُ الْمَالِ بِالْمَالِ

Shitblerje nënkupton: "Këmbimi i mallit me mall."

Në këtë kontekst ka ardhur në Kur'an:

ÇËÈ ... ¸Šr%èB Nü°'Š <§ ¢2 ¤Æ JVÎ ¤ÇŽŸr

"Dhe e shitën atë** (Jusufin) **për një çmim të vogël, për disa dirhemë** (masë argjendi) **të numëruar..."[1]

Pra, nënkupton transferimin, gjegjësisht ndërrimin e mallit nga një person te tjetri, me mirëkuptim.[2]

---

[1] Kur'an, Jusuf: 20.

[2] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. El-Mektebetul Asrijetu, bot. I-rë, 1422h-2002m, Sajda-Bejrut, vëll. I, fq. 14.

Në kuptim të përgjithshëm, shitblerja nënkupton ndërrimin (këmbimin) e mallit me mall, në bazë të pëlqimit të dyanshëm, apo bartja e pronës (pasurisë) me kompensim në mënyrë të lejuar.[3]

DISPOZITA E SHITBLERJES

Shitblerja në parim është e lejuar. Njeriu në këtë jetë do të obligohet domosdoshmërish të ushqehet, e për këtë i nevojitet atij shitblerja[4] për të ruajtur veten në rend të parë, e më pas edhe ata që janë përreth tij.

Në Kur'anin Famëlartë dhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut ekzistojnë shumë argumente që tregojnë se shitblerja është e lejuar brenda suazave që Krijuesi e lejoi atë.

I Madhërishmi thotë:

ÇïÎÈ... ¢q/Ì0$PS§mr ì ø7ø¢ª! $'@m&r

"...Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën..."[5]

ÇïÑÈ ... ÔÊè/$6? #ŒÎ) ÿ‰ÎgŒ&r

"...Por, kur bëni shitblerje, dëshmojeni..."[6]

ç•»gÏ šc qà? b& w) @Ü»ø¢ø Mà6 Y•/ Nà9ºqÞ& ¢hè2 Ù? Ÿw ¢qŠB#ä šú ï‰Œ$$gƒ'»ƒ

ÇïÈ ... Nà7Ï ‹Ú#•? `ã

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete..."[7]

Në këto ajete kuranore qartazi precizohet lejimi i pakontestueshëm i shitblerjes, ndërsa në shumë hadithe i jepet edhe rëndësi e posaçme shitblerjes, dhe i ndalohet njeriut që të pret furnizimin nga lartë duke e

---

[3] Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, bot.i II-të, 1419h-1999m, dare l-fet'h, Kairo-Egjipt, vëll. IV, fq. 26.

[4] Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, El-Mektebu-th-Thekafij, el-Ez'her-Kajro, vëll. II, fq. 119.

[5] Kur'an, Bekare: 275.

[6] Kur'an, Bekare: 282.

[7] Kur'an, Nisa: 29.

braktisur punën apo duke pritur mëshirën e ndokujt. Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut thotë: “

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَأَنْ يَأْخُذَ أَحَدُكُمْ حَبْلَهُ فَيَحْتَطِبَ عَلَى ظَهْرِهِ خَيْرٌ لَهُ مِنْ أَنْ يَأْتِيَ رَجُلًا فَيَسْأَلَهُ أَعْطَاهُ أَوْ مَنَعَهُ

Nga Ebu Hurejre transmetohet se i Dërguari i Allahut kishte thënë: *“Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, më mirë është që ndonjëri nga ju të marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru sesa të vijë e të kërkojë (lëmoshë) nga ndokush, i jep apo jo.”*[8]

Pra, shumë më mirë dhe më ndershëm do të ishte sikur njeriu ta merrte litarin e tij e të tërhiqte me të drunj, sesa t’ua shtrijë dorën njerëzve, për të pritur mëshirën e tyre.

LIGJSHMËRIA E SAJ

Shitblerja është e lejuar me porosi kuranore, profetike dhe me konsensus (ixhma) të dijetarëve.

Nga Kur’ani

Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë:

ÇÈÎÈ... #4/Ì$PS mr ì ø7ø$ª! $@m&r

“...Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën...”[9]

ÇÈÑÈ ... Ôçè/$6? #Œ) ÿ%ÎÔ&r

“...Por, kur bëni shitblerje, dëshmojeni...”[10]

ÇÈÑÈ... Ñà6 ÎÈ `Ï WÒù (qáGÿ b& ÎY$Yã Ñà6 øã §ø

[8] Sahihul Buhari, nr. i hadithit 1377, El-Muvetta, nr. i hadithit 1588.
[9] Kur’an, Bekare: 275.
[10] Kur’an, Bekare: 282.

***"Nuk është mëkat për ju të kërkoni begati nga Zoti juaj** (të bëni tregti gjatë haxhit)..."*[11]

Nga Sunneti

سُئِلَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَيُّ الْكَسْبِ أَطْيَبُ أَوْ أَفْضَلُ ؟ قَالَ: " عَمَلُ الرَّجُلِ بِيَدِهِ وَكُلُّ بَيْعٍ مَبْرُورٍ

I Dërguari i Allahut është pyetur se cili fitim është më i miri? Fitimi më i mirë është ai që arrihet nga puna e dorës së tij, si dhe çdo shitblerje e drejtë (e mirë)[12]*-ishte përgjigja e tij.*

Në një hadith tjetër thuhet:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ : " الْبَيِّعَانِ بِالْخِيَارِ مَا لَمْ يَتَفَرَّقَا ، فَإِنْ صَدَقَا وَبَيَّنَا بُورِكَ لَهُمَا فِي بَيْعِهِمَا ، وَإِنْ كَتَمَا وَكَذَبَا مُحِقَتْ بَرَكَةُ بَيْعِهِمَا ".

"I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Shitblerësit*[13] *mund të zgjedhin përderisa nuk janë ndarë nga njëri-tjetri, nëse e thonë të vërtetën dhe e shfaqin atë, do t'iu jepet atyre begati (bereqet) në shitblerjen e tyre, e nëse e fshehin të vërtetën dhe gënjejnë, atëherë s'do të ketë begati në shitblerjen e tyre."*[14]

Muhamedi [paqja e Allahut qoftë mbi të] u dërgua Profet e njerëzit shitnin e blinin, ai nuk e mohoi veprimin e tyre, përkundrazi e miratoi atë[15], ndaj miratimi i tij konsiderohet vepër legjitime.

---

[11] Kur'an, Bekare: 198.

[12] Ahmedi në Musnedin e tij, nr. i hadithit 16628.

[13] البيعان Bejjiani, është për qëllim shitësi dhe blerësi, gjegjësisht dy kontraktuesit.

[14] Taberaniu në el-Mu'xhemul Kebir, nr. i hadithit 3045.

[15] Vehebeh Zuhejli, El-*Fikhul Islami ve Edil-letuhu*, bot.i IV-të, 1422h-2002m, dar el-fikr, Damask-Siri, vëll. V, fq. 3306.

Ixhmai-Konsensusi

Dijetarët me konsensus të plotë (pa përjashtime), thonë se shitblerja është e lejuar,[16] dhe që nga i Dërguari i Allahut deri në kohën tonë nuk njihet askush që ta ketë kundërshtuar shitblerjen.[17]

VLERA E SHITBLERJES

Shitblerja e lejuar ka vlerë të madhe dhe të rëndësishme. Allahu e ka lejuar atë për interesa të njerëzve. Ajo është domosdoshmëri e secilës gjeneratë dhe në secilën kohë. Myslimanit nuk i lejohet të presë ndihmë apo mëshirë nga ndokush tjetër, e vetë të mos punojë e të mos angazhohet, kur ka mundësi për një gjë të tillë. Fitimi më i mirë është ai që fitohet me djersë, mund dhe angazhim personal. E në këtë kontekst i Dërguari i Allahut thoshte:

"Nuk do të hajë ushqim më të mirë askush sesa ai i cili fiton me dorën e vet, Pejgamberi i Zotit, Davudi a.s., ka ngrënë vetëm nga ajo që ka fituar me dorën e vet."[18]

Njeriu nuk duhet bërë jetë parazite, të presë gjithnjë nga të tjerët, por ai duhet shfrytëzuar metoda të ndryshme të përfitimit. Më i vlefshëm është fitimi që e bën njeriu vetë sesa kur kërkon lëmoshën nga të tjerët:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَأَنْ يَأْخُذَ أَحَدُكُمْ حَبْلَهُ فَيَحْتَطِبَ عَلَى ظَهْرِهِ خَيْرٌ لَهُ مِنْ أَنْ يَأْتِيَ رَجُلًا فَيَسْأَلَهُ أَعْطَاهُ أَوْ مَنَعَهُ

Nga Ebu Hurejre transmetohet se i Dërguari i Allahut kishte thënë: *"Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, më mirë është që ndo-*

[16] AbdulAdhim Bedevij, *El-Vexhiz*, bot.I-rë, 1421h-2001m, dar ibn Rexheb, El-Mensura, Kajro, fq. 335.
[17] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. El-Mektebetul Asrijetu, bot. I-rë, 1422h-2002m, Sajda-Bejrut, vëll. I, fq. 15; Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, vëll. IV, fq. 26.
[18] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2072.

njëri nga ju të marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru sesa të vijë e të kërkojë (lëmoshë) nga ndokush, i jep apo jo."[19]

E rëndësishme është që fitimi të jetë në suaza të hallallit, e të mos jetë fitim haram, ngase nuk lejohet një gjë e tillë.

Nga Ebu Hurejre përcillet se i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Njerëzve do t'ju vijë një kohë që nuk do të kenë kujdes (nuk do të mërziten) se a është marrë fitimi prej hallallit (formës së lejuar) apo prej haramit (formës së ndaluar)."*[20]

URTËSIA E SHITBLERJES

Urtësia nga lejimi i shitblerjes qëndron në faktin se njeriu për t'i kryer nevojat e tij të domosdoshme, si ushqimi, pirjet, barnat dhe gjërat tjera, duhet të blejë dhe të shesë gjërat që ai ka nevojë për to, me fjalë tjera duhet ta praktikojë shitblerjen.[21]

Prej qëllimeve të pastra të Islamit është edhe plotësimi i nevojave të individit dhe lehtësimi për ta jetuar jetën në formën më të mirë si dhe për ta realizuar qëllimin primar e sublim, atë të adhurimit ndaj Krijuesit të tij.

Njeriu në këtë jetë nuk do të jetë në gjendje që të mbjellë e prodhojë gjithë atë që i duhet gjatë jetës së tij, andaj është e detyrueshme që të shkëmbejë raporte me të tjerët, e si rrjedhojë nga shkëmbimet rrjedh edhe blerja dhe shitja, këto dy komponentë tepër të rëndësishëm për njeriun dhe jetën e tij, mirëpo për të arritur një shitblerje të suksesshme duhet të arrihet pajtimi-pëlqimi mes shitësit dhe blerësit, e kur të arrihet pëlqimi, atëherë kemi të bëjmë me *akd-ul-bej'* kontratën e shitblerjes.

Përveç kësaj, prej natyrës së njeriut është vrapimi pas fitimit, e blerja dhe shitja janë rrugët e shëndosha për realizimin e fitimit.

---

[19] Sahihul Buhari, nr. i hadithit 1377, El-Muvetta, nr. i hadithit 1588.
[20] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2070.
[21] Op, cit: vëll. I, fq. 16.

EDUKATA NË SHITBLERJE - آداب البيع

Është mirë që të zbatohen disa masa edukative gjatë shitblerjes, prej tyre veçojmë:

1. **Të mos tentohet fitim i tepërt në shitblerje**: Prej edukatës në shitblerje është edhe fakti që të mendohen dy palët kontraktuese, e të mos mendojë vetëm te çmimi i tij, duke tentuar në një fitim të tepërt. Disa dijetarë mendojnë se fitimi duhet të jetë brenda kufijve të së tretës së pasurisë (⅓),[22] por megjithatë Ligjvënësi nuk ka caktuar limite për fitim.
2. **Trajtimi i sinqertë**: Kur përshkruan mallin me një paraqitje dhe përshkrim të drejtë e të sinqertë,[23] duke mos gënjyer e as fshehur gjë. I Dërguari i Allahut thoshte:

   إِنَّ التُّجَّارَ يُبْعَثُونَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فُجَّارًا إِلَّا مَنْ اتَّقَى اللَّهَ وَبَرَّ وَصَدَقَ

   "Me të vërtetë, tregtarët do të ringjallen në ditën e Gjykimit mëkatarë (keqbërës) përpos kush iu frikësua Zotit, pati trajtim të mirë dhe e thoshte të vërtetën."[24]

3. **Toleranca**: Kur shitësi nuk ngul këmbë vetëm në çmimin e parë, por toleron dhe zbret pak nga çmimi i tij. Preferohet që edhe blerësi të mos ngutet, mirëpo të mundohet t'ia zbresë çmimin shitësit, e në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut kishte thënë:

   نَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ رَحِمَ اللَّهُ رَجُلًا سَمْحًا إِذَا بَاعَ وَإِذَا اشْتَرَى

   "Allahu e mëshiroftë atë njeri tolerant kur shet dhe blen..."[25]

4. **Largimi nga betimi, edhe nëse tregtari është i sinqertë**: Në parim është i preferuar largimi nga betimi në shitblerje, madje edhe atëherë kur personi është i drejtë dhe i sinqertë. Megjithatë, personi mund të betohet nëse këtë e kërkon nevoja.

---

[22] Të këtij mendimi janë Malikitë, të cilët mendojnë se duhet të caktohet një e treta në fitim.
[23] Vehebeh Ez-Zuhejli, *El-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3308.
[24] Ibnu Maxheh në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2137.
[25] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 1934.

I Dërguari i Allahut thotë:

إِنَّ أَبَا هُرَيْرَةَ قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ الْحَلِفُ مَنْفَقَةٌ لِلسِّلْعَةِ مَمْحَقَةٌ لِلْبَرَكَةِ

"Ebu Hurejre transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: "Betimi e shet mallin por e zhduk bereqetin-mirësinë."[26]

5. **Të shpeshtojë lëmoshën (sadakanë):** Preferohet për tregtarin që të japë lëmoshë sa më tepër, ngase ajo ia fshin mëkatet e tij në betim, mashtrim, fshehje të ndonjë të mete, ngritje në çmim, e të ngjashme me të.[27] I Dërguari i Allahut kishte potencuar:

إِنَّ الشَّيْطَانَ وَالإِثْمَ يَحْضُرَانِ الْبَيْعَ، فَشُوبُوا بَيْعَكُمْ بِصَدَقَةٍ

"Me të vërtetë djalli dhe mëkati prezantojnë gjatë shitblerjes, andaj përzieni shitblerjen tuaj me lëmoshë."[28]

6. **Shkrimi i borxhit dhe dëshmitarët**: Preferohet shkrimi i kontratës, sasia e çmimit dhe dëshmitarët në shitblerje.[29] Në lidhje me këtë i Madhërishmi thotë:

... ¤ç¤ÇÇõ2 $ß ‘ ¼v¡ B @ _ & #<Î Á¼‰Î LêZƒ#‰? #ŒÎ ¢þŽB#ä šú ï‰Ö$$ $gƒ'»ƒ

ÇÑËÈ **...** ß¼à6 Ø‰ ` Ñ ` B È¤Ø‰<Í - ¢rßÎâFÖ‰$

"O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë...Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi juaj..."[30]

PËRCAKTIMI I ÇMIMIT - حكم التسعير

[26] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 1945; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2897.
[27] Vehebeh Ez-Zuhejli, *El-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3308.
[28] Transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1129.
[29] Vehebeh Ez-Zuhejli, *El-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3308.
[30] Kur'an, Bekare: 282.

Përcaktimi i çmimit në treg është e drejtë tregtare, ngase shitblerja duhet të kryhet me pëlqim të dyanshëm mes shitësit dhe blerësit, ashtu siç e ka potencuar i Madhërishmi:

ç•»gË šc qa? b& wÎ) @Ü»6 Mà6 ¥•/ Na%qB& (hè2 Ù? Ÿw (qB#ä šú ï‰Ÿ$gƒ'¯7

ÇÚÈ … NaZË <Ú#•? `ã

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete..."[31]

Ndërsa, ndërhyrja në përcaktimin e çmimit e kundërshton lirinë tregtare, ndaj Islami e ka trajtuar këtë çështje me kujdes të madh.

Kjo çështje është lënë në kompetencat e tregut dhe tregtarëve, ata kanë ekskluzivitetin e përcaktimit të çmimit, gjithnjë sipas vlerës së llojit, sasisë dhe cilësisë.

Në kohën e të Dërguarit të Allahut u ngritën çmimet, e disa njerëz kërkuan nga i Dërguari i Allahut që të ndërhynte në këtë çështje, duke përcaktuar çmimet sipas vlerës së mallit, por ai kundërshtoi dhe i ndaloi nga një gjë e tillë.[32]

عَنْ أَنَسٍ قَالَ غَلَا السِّعْرُ عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالُوا يَا رَسُولَ اللَّهِ سَعِّرْ لَنَا فَقَالَ إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمُسَعِّرُ الْقَابِضُ الْبَاسِطُ الرَّزَّاقُ وَإِنِّي لَأَرْجُو أَنْ أَلْقَى رَبِّي وَلَيْسَ أَحَدٌ مِنْكُمْ يَطْلُبُنِي بِمَظْلِمَةٍ فِي دَمٍ وَلَا مَالٍ

Nga Enesi transmetohet të ketë thënë: *"U ngritën çmimet në kohën e të Dërguarit të Allahut, e njerëzit thanë: "O i Dërguar i Allahut, çmimet u ngritën, ndaj përcakto çmimet për ne." I Dërguari i Allahut u tha: "Allahu është Ai që gjykon në çështjen e çmimeve, Ai është Shtrënguesi, Dhënësi, Furnizuesi, e unë shpresoj ta takoj Zotin tim e askush prej jush të mos kërkojë nga unë ndonjë padrejtësi (që ka të bëjë me) në gjak (jetë) e as në pasuri."*[33]

Juristët myslimanë nga ky hadith kanë nxjerrë konkluza se nuk lejohet ndërhyrja e autoriteteve përgjegjëse në përcaktimin e çmimit

[31] Kur'an, Nisa: 29.
[32] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. III, fq. 146.
[33] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1235; Ibni Maxheh në Sunenin e tij, nr. 2191; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 2994. Tirmidhiu thotë se hadithi është hasen-sahih.

të mallrave të ndryshme, ngase vetë fjala e të Dërguarit të Allahut "askush prej jush të kërkojë nga unë për ndonjë padrejtësi", nënkupton se kjo vepër është padrejtësi, e që nuk duhet të aplikohet nga askush, ngase njerëzit janë të lirë në shkëmbimet e tyre financiare, e ndërhyrja e cenon lirinë dhe të drejtën e tyre.

Por mund të ndodhë që ndërhyrja në çmim të ndikojë në fshehjen e artikullit në treg, e më pas në ngritjen e çmimeve, e kjo për shtresën e varfër do të ishte një barrë shumë e rëndë.

PËRCAKTIMI I ÇMIMIT GJATË NEVOJËS ËSHTË OBLIGIM (VAXHIB)

Më herët elaboruam se ndërhyrja në përcaktimin e çmimit është padrejtësi dhe se ky është rregull i përgjithshëm, por në rast se tregtarët pa të drejtë luajnë me çmimet e tregut, duke i tejkaluar edhe normat dhe kufijtë e drejtësisë dhe mirësisë, të prirë nga lakmia e cila i kaplon shpirtrat e dobët dhe u shkaktojnë të tjerëve padrejtësi, atëherë për udhëheqësin apo gjykatësin është e domosdoshme të ndërhyjë dhe t'i përcaktojë çmimet, në këtë mënyrë do të ruheshin të drejtat e njerëzve dhe do të evitoheshin padrejtësitë.

Në këtë mënyrë do të vendosej një rregull për ata që i tejkalojnë kufijtë, ndërsa përcaktimi i çmimit nuk bëhet ndryshe vetëm se pas një konsultimi të gjatë me personat kompetentë, me ekspertët e fushave përkatëse, të cilët i njohin rrethanat dhe gjendjen e njerëzve më së miri, e të cilët do të jenë të paanshëm dhe të drejtë, duke mos i bërë padrejtësi askujt. Kur ata japin mendimin e tyre të bazuar në fakte dhe argumente, atëherë gjykatësi sjell verdiktin përfundimtar për përcaktimet e çmimit, e kur ky verdikt të publikohet, atëherë askujt nuk i lejohet ta ndryshojë apo kundërshtojë vendimin për çmimin që ka paraparë gjykatësi.[34]

PJESËT PËRBËRËSE NË SHITBLERJE - أركان البيع

[34] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. III, fq. 149-150.

Te hanefitë në shitblerje ekziston vetëm një rukn/shtyllë, kurse te medhhebet tjera ekzistojnë katër rukne:

Oferta dhe pranimi[35] - **الإيجاب والقبول** : Oferta dhe pranimi që ndryshe quhet Formula e kontratës - **صيغة العقد** , janë shprehjet që tregojnë për këmbim (ndërrim) në bazë të pëlqimit të dyanshëm.[36]

Kontrata lidhet me pajtimin e vullnetshëm të palëve kontraktuese lidhur me elementet thelbësorë të kontratës.

Oferta mund të jetë edhe nga shitësi por edhe nga blerësi, varësisht se cili fillon së pari. Oferta mund të jetë nga shitësi, si p.sh.: Po ta shes këtë gjë për dhjetë euro, në këtë rast shitësi është ofertues, e nga blerësi pritet pranimi me fjalët: po e blej, pranova, apo të ngjashme me të. Por ndodh që oferta të vijë nga blerësi, si p.sh.: Po e blej këtë gjë për dhjetë euro, e në këtë rast blerësi është vetë ofertues, e nga shitësi pritet pranimi me fjalët: po e shes, pranova, apo të ngjashme me të.[37]

Por ndodh që shitblerja të kryhet edhe pa formulën e kontratës (ofertën dhe pranimin), siç është e njohur shitblerja në fikh-jurisprudencë me emrin el-bej'u bil-muatat (**البيع بالمعاطاة**) që nënkupton marrjen e sendit nga blerësi dhe parasë nga shitësi, duke mos shprehur asnjë fjalë të vetme, e që është mjaft e përhapur.

Te hanefitë, malikitë dhe hanbelitë, lejohet kjo shitblerje, kurdo që veprimet e dy kontraktuesve tregojnë për pëlqimin e tyre, e dihet se shitblerja është e vlefshme përderisa kryhet në bazë të pëlqimit të dyanshëm.[38]

Njerëzit blejnë e shesin, sidomos në treg, vendosin çmimin pranë sendit, konsumatorët marrin sendin e nevojitur dhe i japin paratë, pa ofertë e pa pranim, mirëpo akti i tyre konsiderohet i vlefshëm, ngase është bërë në bazë të pajtimit dhe pëlqimit.

Tradita dhe zakoni tregojnë se ky lloj është mjaft i përhapur dhe i popullarizuar sidomos në kohën tonë moderne, ku në dyqane e super-

---

[35] Kjo është rukni i vetëm tek hanefitë.

[36] Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. II, fq. 120.

[37] Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. II, fq. 121.

[38] El-Kasani, *El-Bedai'i*, bot.i I-rë, pa vit botimi, vëll.V, fq. 134; Kemaludin Muhamed ibn AbdulVahid, *Fet'hul Kadir*, matbeatu Mustafa Muhamed, Kajro-Egjipt, vëll. V, fq. 77; Ibnu Rushd, *Bidajetul Muxhtehid ve Nihajetul Muktesid*, matbeatul Istikameti, Kajro-Egjipt, vëll. II, fq. 161; Ibni Kudame, *El-Mugni*, bot. i III-të, dar el-menareh, Kajro-Egjipt, vëll. III, fq. 561.

markete dhe vende tjera, pothuajse në krejt mallrat janë të vendosura çmimet, konsumatori merr mallin dhe bën pagesën, pa ofertë dhe pa pranim.

Ndërsa te shafitë, ky lloj i shitblerjes nuk është i vlefshëm, qoftë në gjëra të vlefshme apo të thjeshta, por patjetër në shitblerje duhet të ketë ofertë dhe pranim, ngase i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *"Shitblerja duhet të jetë nga pëlqimi i dyanshëm."*[39]

Mirëpo, disa dijetarë të mëvonshëm nga medhhebi shafi'i, e lejojnë këtë lloj shitblerje, prej tyre është imam Neveviu, Begaviu, etj.[40] në sendet-gjërat që janë të imta e jo të shtrenjta, siç është buka, orizi, gjërat e vogla e të thjeshta, kurse kur në pyetje është diçka tjetër (p.sh. blerja e shtëpisë, tokës, etj.), e ndalojnë.[41]

Kontrata e shitblerjes lidhet me kërkesën (ofertën-ixhabin) dhe pranimin (kabulin). Nga kjo përjashtohet malli i pavlerë, në të cilin këto dy elemente s'janë të domosdoshëm, por mjafton të jepet dorë më dorë e të njihet vetëm çmimi. Kjo gjë i lihet në dorë traditës dhe adeteve të njerëzve.[42] Në kërkesë dhe pranim nuk detyrohen shprehje të caktuara, sepse në konsideratë te kontratat merren qëllimet dhe kuptimet e jo fjalët dhe ndërtimet e tyre.[43]

Shitësi dhe blerësi – البائع والمشتري : Si shitësi ashtu edhe blerësi duhet të jenë të shëndoshë mendërisht, të mos jenë të trashë nga mendja-budalla (*sefih*),[44] as të çmendur,[45] ngase i çmenduri mund ta shesë edhe shtëpinë për gjëra të vogla e të thjeshta,[46] e as të dehur gjatë procesit të shitblerjes.[47] Të kenë maturi e pjekuri në shitblerje.[48] Shitësi të

---

[39] Ibni Maxheh në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2176. Hadithi transmetohet nga Ebu Seid el-Hudrij.

[40] Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, matbeatul babi el-halebij, Kajro-Egjipt, vëll. II. Fq. 3.

[41] Shih më tepër: Zekerija ibn Muhamed ibn Ahmed ibn Zekerija el-Ensari, *Esna-l Metalib fi Sherhi Revdi-t-Talibi*, vëll. VII, fq. 372.

[42] Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, Mileniumi i Ri, Tiranë, 2007, vëll. III, fq. 197.

[43] Op, cit: vëll. II, fq. 197.

[44] Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, el-Mektebetu et-Tevfikijetu, bot.i IV-të, fq. 281.

[45] Ahmed Isa Ashur, *el-Fikhul Mujesser*, dar-ul hajr, bot.i III-të, 1423h-2003m, fq, 241.

[46] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 29.

[47] Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, vëll. IV, fq. 28.

[48] Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 280.

jetë zotërues i asaj që e shet, apo eventualisht i autorizuar nga dikush për shitjen e asaj gjëje. Të jenë në moshën madhore, me përjashtim të hanefive, të cilët nuk e kushtëzojnë moshën madhore në shitblerje, por sipas tyre lejohen veprimet e fëmijëve të mençur, që ende s'e kanë arritur moshën e pjekurisë, e të cilët kanë mbushur shtatë vjet.[49]

Dijetarët e lejojnë edhe shitblerjen e memecit, nëse ajo kryhet me gjeste (isharete) të kuptueshme, ngase gjestet e tij janë sikurse të folurit me gjuhë, ashtu sikurse lejohet për të që kontratën e shitblerjes ta bëjë me shkrim, në vend të gjesteve. Nëse lejohet bej'u bi-l-Muatat, ku merret malli dhe paguhet çmimi, që është i lejuar sipas xhumhurit (pjesës dërrmuese të dijetarëve), lejohet edhe shitblerja e memecit po në të njëjtën mënyrë, ngase del në pah elementi i pajtimit reciprok.[50]

Shitblerësi që është i imponuar (bej'ul-mukrehi), nëse bën shitblerje në atë gjendje imponuese, shitblerja e tij konsiderohet e pavlefshme, ngase imponimi e zhduk elementin e pëlqimit, e që është kusht për vlefshmërinë në kontratë.[51] Në lidhje me këtë Kur'ani thotë:

ç•»gB šc qa? b& tW) @Ü»6 M à6 ¥•/ Na9qB& (pè2 Ù? Ww (qB#ä šú ï‰ $g'»7

ÇÈ ... Na7B <Ú#•? `ã

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete..."[52]

Edhe shitja (blerja) e detyruar (bej'ul-mudtarri) kur detyrohet shitësi të shet diçka nga malli i tij, si p.sh. gjykatësi detyron një person ta shesë mallin e tij në mënyrë që t'i shlyejë borxhin atij. Te hanefitë konsiderohet shitblerje e pavlefshme, kurse te disa të tjerë lejohet në rast nevoje.[53]

Duhet theksuar se në kontrata të tilla, duhet të ketë frymë lirie, e jo imponim, ngase njerëzit janë krijuar të lirë e këtë liri nuk mund t'ua heqë askush, s'ka të drejtë askush që t'ia imponojë tjetrit. Nuk është e

[49] Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3317.
[50] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 37.
[51] Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3323.
[52] Kur'an, Nisa: 29.
[53] Ibn Kudame, *El-Mugni*, vëll. IV, fq. 214; Hashijetu ibni Abidin, vëll. IV, fq. 111.

kushtëzuar sipas hanefive, malikive dhe shtatë dijetarëve të Medinës,[54] që blerësi dhe shitësi të jenë në një vend, ngase ata mund të jenë larg njëri-tjetrit, dhe lejohet shitblerja e tyre edhe me shkrim, dërgesa, apo me ndonjë mjet tjetër, me kusht që të arrihet pëlqimi (pajtueshmëria) mes tyre.[55] P.sh. blerësi qëndron në një qytet të largët nga shitësi, i pari dërgon ndokënd apo ndonjë shkresë tek ai, nëse pajtohen arrihet edhe shitblerja. Por, mund të ndodh shitblerja edhe nëpërmjet telefonit, faksit dhe internetit në kohën tonë me përparimin e teknologjisë, e nuk kushtëzohet prezenca e blerësit në vendin e shitësit.[56]

Sendi që shitet - المبيع: Sendi që shitet duhet të jetë prezent, ngase shitja e një sendi mosekzistent (inekzistent) konsiderohet shitblerje e pavlerë, sikurse shitja e frutave në kopsht gjersa ende s'janë shfaqur frutat e tij.[57] Shitblerja e gjërave mosekzistente mund të jetë shkak në grindje dhe konflikte.[58]

عَنْ حَكِيمِ بْنِ حِزَامٍ قَالَ يَا رَسُولَ اللَّهِ يَأْتِينِي الرَّجُلُ فَيُرِيدُ مِنِّي الْبَيْعَ لَيْسَ عِنْدِي أَفَأَبْتَاعُهُ لَهُ مِنْ السُّوقِ فَقَالَ لَا تَبِعْ مَا لَيْسَ عِنْدَكَ

Nga Hakim ibn Hizami transmetohet të ketë thënë: *"O i Dërguar i Allahut, më vjen ndonjë njeri dhe dëshiron nga unë t'i shes atë që nuk është në pronësinë time. A ta blej unë në treg dhe t'ia shes atij[59]?. I Dërguari i Allahut i tha: "Mos shit atë që nuk është në pronësinë tënde."[60]*

Në një hadith tjetër thuhet:

---

[54] Shtatë juristët (dijetarët) e Medinës janë: Seid ibn Musejjeb, Urvetu ibn Zubejr, El-Kasim ibn Muhamed, Ebu Bekr ibn Abdurrahman ibnul Harith ibn Hisham, Ubejdullah ibn Utbetu ibn Mes'ud, Sulejman ibn Jesar dhe Harixheh ibn Zejd ibn Thabit.

[55] Shih më tepër: Kasani, *El-Beda'i*, vëll. V, fq. 134; Fet'hul Kadir, vëll. V, fq. 78.

[56] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 37.

[57] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 33.

[58] Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. II, fq. 128.

[59] Sipas shpjeguesve të hadithit, është për qëllim kur shitësi shet atë që nuk është pranë tij, pastaj atë e blen në treg dhe ia ofron blerësit. Shih: *Tuhfetul Ahvedhij Sherh Sunen Tirmidhi*, vëll. III, fq. 331.

[60] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1153.

عَنْ ابْنِ عُمَرَ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَهَى عَنْ بَيْعِ الثِّمَارِ حَتَّى يَبْدُوَ صَلَاحُهَا نَهَى الْبَائِعَ وَالْمُشْتَرِيَ

"Nga Ibni Omeri transmetohet se i Dërguari i Allahut ka ndaluar shitjen e frutave para se të shihet pjekuria e tyre, e ka ndaluar shitësin dhe blerësin."[61]

Sendi që shitet duhet të jetë i gatshëm për dorëzim,[62] e nuk lejohet shitja e zogjve në ajër, peshqve në ujë, e të ngjashme me të.[63] Gjithashtu sendi që shitet duhet të jetë i ditur nga sasia, e nuk lejohet ta shesë askush hisen (pjesën) e tij trashëguese, e cila ende nuk është ndarë nga trashëgimtarët, mirëpo duhet të jetë e njohur sasia.[64]

Duhet të jetë i pastër[65] dhe brenda kornizave të lejuara në pikëpamje fetare, e të mos jetë prej atyre gjërave që i Madhërishmi i ka ndaluar, siç janë shitja e alkoolit, mishi i derrit, apo të ngjashme. I Dërguari i Allahut thotë:

إِنَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ حَرَّمَ بَيْعَ الْخَمْرِ وَالْمَيْتَةِ وَالْخِنْزِيرِ وَالْأَصْنَامِ

"Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar shitjen e alkoolit, ngordhësirës, derrit dhe idhujve..."[66]

Të jetë prej gjërave që ka dobi në to, e të mos jetë prej atyre që s'ka dobi, siç është shitja e insekteve, gjarprit[67], miut, etj.[68] Lejohet shitja e maces, bletëve, luanit, tigrit, çka nevojitet për gjueti, apo në përdorim të lëkurës, lejohet shitja e elefantit. Shitja apo blerja e qenit

[61] Maliku në Muvetta, nr. i hadithit 1127.
[62] Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, vëll. II, fq. 126.
[63] Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3322.
[64] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 33.
[65] Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, vëll. IV, fq. 29.
[66] Ibni Maxheh në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2158. Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1218.
[67] Tek disa nga hanefitë lejohet shitja e gjarprit.
[68] Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, vëll. IV, fq. 31.

nuk lejohet[69], me përjashtim të qenit të mësuar, ruajtës dhe për gjueti.[70]

Gjithashtu duhet të jetë sendi i njohur për nga përshkrimi. [71]

Pëlqimi i dyanshëm –التراضي: Nuk lejohet shitblerja pa pëlqimin e të dy kontraktuesve, bazuar në thënien e të Dërguarit të Allahut i cili thotë[72]:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِنَّمَا الْبَيْعُ عَنْ تَرَاضٍ

"*Shitblerja duhet të jetë me pëlqimin e dyanshëm."*[73]

Pëlqimi i dyanshëm në shitblerje e bën atë valide, si dhe përjashton shitblerjet tjera që nuk kryhen nën elementin e pajtueshmërisë, si shitblerja e imponuar apo e detyruar.

LLOJET E SHITBLERJES

Janë katër lloje kryesore të shitblerjes:

Bej'u-l-Mukajedah - **بيع المقايضة** Shitblerja e mallit me mall

Bej'u-l-mal bil mal (Es-Sarf) - **بيع المال بالمال (الصرف)** Shitblerja e valutës me valutë

El-Bej'u bin-nukudi ved-derahimi - **البيع بالنقود والدراهم** Shitblerja e gjërave me valuta

Bej'us-Selem - **بيع السلم** Blerja e gjërave më vonë me çmim të menjëhershëm (paradhënia)

---

[69] Ebu Hanife mendon se shitja e qenit është e lejuar, ndërsa imam Jusufi e thotë të kundërtën.

[70] Op. cit: vëll. IV, fq.31.

[71] Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 281.

[72] Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, fq. 281.

[73] Ibni Maxheh në Sunenin e tij, nr. i hadithit 2176. Hadithi transmetohet nga Ebu Seid el-Hudrij.

Bej'u-l-Mukajedah - بيع المقايضة

Bej'u-l-Mukajedah - **بيع المقايضة** është shitblerja e mallit me mall[74], apo këmbimi i një lloji të mallit me një lloj tjetër, si shitja e grurit për rrush, hurmave për elb, vajit për gjalpë, shitja e kalit (veturës) për shtëpi, rrobës për dele, gjalpës për mjaltë, e të ngjashme me të.[75]

Në të kaluarën ky lloj i shitblerjes ka dominuar në shitblerjet e tyre, për shkak se paratë (dërhemi dhe dinari) në atë kohë kanë qenë të pakta në përdorim, ndaj ka dominuar ndërrimi i mallit me një mall tjetër. Është quajtur *bej'ul mukajedah* për shkak të këmbimit (ndërrimit) mallit me mall, e që nuk përdoren paratë, por përdoret vetëm malli.[76]

Ky lloj i shitblerjes lejohet në Islam, bazuar në hadithin që transmeton Ebu Katadeh, në të cilin thuhet:

عَنْ أَبِي قَتَادَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ خَرَجْنَا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَامَ حُنَيْنٍ فَأَعْطَاهُ يَعْنِي دِرْعًا فَبِعْتُ الدِّرْعَ فَابْتَعْتُ بِهِ مَخْرَفًا فِي بَنِي سَلِمَةَ فَإِنَّهُ لَأَوَّلُ مَالٍ تَأَثَّلْتُهُ فِي الْإِسْلَامِ

"Dolëm me të Dërguarin e Allahut në vitin e Hunejnit dhe i dha një parzmore. Unë e shita parzmoren time e me të bleva një vend-kopsht (prej hurmeve) në (fisin) Benu Selemeh, e ky ishte malli i parë që mora në Islam."[77]

Bej'u-l-mal bil mal (Es-Sarf) - بيع المال بالمال (الصرف)

Bej'u-l-mal bil mal është shitblerja e çmimit me çmim, valutës me valutë, e që te juristët islamë ndryshe quhet *Bej'us-Sarf*-ndërrim pa-

[74] Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3600.
[75] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 18.
[76] Op. cit: vëll. I, fq. 18.
[77] Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 1958,

rash, si shitja e monedhës së argjendit me të arit[78], dërhemit me dinarit, sterlinave me dollar,[79] eurove në funta, dhe të ngjashme me to.

Në këtë shitblerje si te blerësi ashtu edhe te shitësi, ka vetëm çmim apo vlerë, e jo mall, si në grupin e parë.

Edhe ky lloj i shitblerjes është i lejuar me konsensus të dijetarëve, për shkak të nevojave të mëdha të njerëzve gjatë shitblerjes dhe shkëmbimit, e sidomos në kohën tonë, saqë nëse shkon në ndonjë vend ku nuk këmbehet me valutën tënde, atëherë të duhet shkëmbimi i valutës sate në valutën e atij vendi, e kjo është një domosdoshmëri e kohës.

El-Bej'u bin-nukudi ved-derahimi - البيع بالنقود والدراهم

El-Bej'u bin-nukudi ved-derahimi është lloji i tretë që nënkupton shitblerjen e gjërave me valuta[80], e që është më i përhapuri mes njerëzve, sidomos në kohën tonë, ku pothuajse të gjitha gjërat blihen me para-valuta, si blerja e gjërave ushqimore, shtëpisë, veturës, tokës, e gjërave tjera.

Edhe ky lloj i shitblerjes është i lejuar, me kusht që të jetë kryer shitblerja me pajtueshmëri e jo me imponim dhe detyrim.[81] Në lidhje me këtë i Madhërishmi thotë:

ç•»gË šc qa? b& w) @Ü»6 Mà6 Y•/ Na9qB& (hè2 Ù? Ww (qB#ä šú ï%$gƒ'»ƒ

ÇÈ ... NaZË <Ú#•? `ã

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete..."[82]

Bej'us-Selem - بيع السلم

Bej'us-Selem është lloji i katërt që nënkupton marrjen e sendit të blerë më vonë me çmim të menjëhershëm -paradhënie (avancë)-, si-

[78] Monedha të dikurshme që ishin në përdorim
[79] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 19.
[80] Vehebeh Zuhejli, *el-Fikhul Islamij ve Edil-letuhu*, vëll. V, fq. 3600.
[81] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 20.
[82] Kur'an, Nisa: 29.

kurse ndokush blen nga bujku grurë, rrush, perime, apo diçka tjetër, e çmimin (vlerën) ia jep menjëherë, e mallin e merr pas një kohe, pas korrjes apo vjeljes, ku që të dytë pajtohen për këtë gjë.[83]

Në parim duket se ky lloj i shitblerjes ndalohet për shkak se blerja nuk është prezente, e i Dërguari i Allahut ka thënë: ***"Mos shit atë që nuk është në pronësinë tënde."***[84] Mirëpo Ligjvënësi e lejoi edhe këtë lloj për shkak se është për nevojën e njerëzve, sidomos bujqve dhe fermerëve. Prandaj praktikimi i *bej'us-selem* është i legalizuar si një rast përjashtues dhe në kundërshtim me analogjinë (e rregullit të përgjithshëm), që në fakt do të thotë se kjo ligjshmëri nuk mund të bëhet shembull për analogji të mëtutjeshme.[85]

Islami i kushton vëmendje të posaçme interesave të njerëzve, ndaj ai edhe erdhi për t'i realizuar të mirat dhe interesat e tyre, e në këtë rast ndihmon bujqit dhe fermerët duke ua plotësuar kërkesat e tyre financiare, me shuma paraprake për një periudhë nga një vit deri në tre, ashtu siç do të aludojë hadithi në vijim. Ndaj, në një farë forme, avanci (paradhënia) në këtë rast është edhe produktiv dhe se ato para mund të plotësojnë kërkesat e kultivuesve.

Edhe pse analogjia e ndalon këtë shitblerje, për faktin se malli nuk është prezent gjatë shitjes, mirëpo është i lejuar për nevojën e njerëzve.[86] Imam Kuduriu thotë: "...ky lloj i shitblerjes është bërë legjitim në kundërshtim me analogjinë, për faktin se po bëhet blerja që nuk është prezente gjatë kontratës së shitblerjes, mirëpo në këtë rast e lëmë analogjinë duke vepruar me Kur'an, sunet dhe konsensus të dijetarëve.

Nga Kur'ani

Argument për lejimin e kësaj shitblerje është ajeti kuranor:

---

[83] Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. vëll. I, fq. 21.

[84] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. i hadithit 1153.

[85] Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*. Boton Fjala e Bukur, Prishtinë, 2008, fq. 257.

[86] Vizaretul Evkaf vesh-Shuun el-Islamijeh, *el-Mevsuat-ul-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, bot. I-rë, 1427, matba' darus-Safvetu, Kajro-Egjipt, vëll. XXXI, fq. 158.

ÇïÈ… ¤¤¤

atë që transmetohet nga Ibni Abbasi, se i Dërguari i Allahut ndaloi *bej'us-selem* në shtazë. Përderisa tre medhhebet tjera e lejojnë, bazuar në analogji që lejohet huaja në shtazë. Sa i përket mishit, Ebu Hanifja e ndalon, ndërsa Ebu Jusufi, Imam Muhamedi dhe tre medhhebet tjera e lejojnë atë. Gjithashtu këtë lloj të shitblerjes Ebu Hanifja e ndalon edhe në rroba[91], gjersa medhhebet tjera e lejojnë.[92]

Polemikat mes shkollave juridike qëndron në faktin se disa gjëra nuk mund të jenë në masë dhe peshë të caktuar e të prerë, që Ebu Hanifja e konsideron kusht parësor në këtë lloj shitblerje.

Prandaj, në *bej'us selem* mund të shiten vetëm ata artikuj që mund të përkufizohen në mënyrë precize në kuptim të cilësisë dhe të sasisë.

Ata të cilët e lejojnë këtë lloj shitblerje në kafshë dhe në mish, nisin nga parimi se është e mundshme që t'i definojnë kafshët dhe mishin e tyre në mënyrë cilësore dhe sasiore, gjithashtu edhe ata të cilët e lejojnë *bej'us selem* në vezë, nisin nga parimi i peshës e jo nga numërimi, për shkak se po të pajtohen me numërimin, mund të krijohen polemika për masën e vezës në kohën e dorëzimit.

Sidoqoftë, ky është lloji i vetëm që lejohet kur malli nuk është prezent,[93] por malli duhet të jetë në dispozicion në treg apo të jetë i gatshëm në kohën për të cilën ka marrëveshje për dorëzim, e mallrat që janë objekt i këtij lloji duhet të përcaktohen në kuptim të cilësisë dhe të sasisë.

Dallimi mes shitjes *selem* dhe shitjes së zakonshme

Ekzistojnë disa pika ndryshimi ndërmjet shitjes së zakonshme dhe *bej'us selem*:

---

[91] Nuk lejohet për shkak të dallimit të madh në mes rrobave, e kjo mund të shpie deri tek grindjet, kurse disa prej medhhebit hanefij e lejojnë nëse përshkruhen në detaje rrobat; ngjyra, materiali dhe përshkrimet tjera.

[92] Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 107.

[93] Ibni Rushd, *Bidajetul Muxhtehid*, vëll. II, fq. 199; Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, vëll. II, fq. 102; Ibn Hemmam, *Fet'hul Kadir*, vëll. V, fq. 323.

a. Në shitjen *selem* është e domosdoshme të caktohet një periudhë fikse për dorëzimin e mallit; në shitjen e zakonshme nuk është e domosdoshme:
b. Në shitjen *selem*, një artikull që nuk është në posedim të shitësit mund të shitet; në shitjen e zakonshme nuk mund të shitet;
c. Në shitjen *selem*, ata artikuj të cilët mund të përcaktohen në mënyrë precize në kuptim të cilësisë dhe të sasisë mund të shiten; në shitjen e zakonshme çdo gjë që mund të zotërohet mund të shitet, vetëm nëse Kur'ani dhe Hadithi e ndalojnë atë:
d. Një shitje *selem* nuk mund të ndodhë ndërmjet mallrave identike, për shembull gruri për grurë, ose patatja për patate; në shitjet e zakonshme kjo është e lejuar;
e. Në shitjen *selem* pagesa duhet të bëhet para kohës së dorëzimit të mallrave dhe në kohën e kontratës; në shitjet e zakonshme pagesa mund të shtyhet ose të bëhet në kohën e dorëzimit të mallrave.[94]

Përfundim

Ndonëse tematika e shitblerjes është mjaft e gjerë dhe assesi ajo nuk mund të shpjegohet brenda një punimi të tillë, për shkak se shumë gjëra mbesin jashtë shpjegimit, madje edhe jashtë referimit, siç janë edhe shitblerjet e ndaluara, për të cilat ne nuk kemi shpjeguar, me shpresë se ndonjëherë tjetër, do ta trajtojmë temë të veçantë, për shkak të rëndësisë së madhe që ka ajo tematikë.

Sidoqoftë, në këtë punim modest u munduam ta pasqyrojmë tematikën e shitblerjes sipas konceptit të përgjithshëm, ku janë përmendur elementet kryesore të shitblerjes, pa të cilat nuk mund të kuptohet e as të aplikohet shitblerja. Shpresoj se këto informacione janë të dobishme për lexuesit.

[94] Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame.* fq. 258.

Literatura e konsultuar:

- Kur'ani i Madhërishëm.
- El-Kasani, *Bedaius-Sanaiu fi Tertibish Sherai'*, bot.i I-rë, pa vit dhe vend botimi.
- Kemaludin Muhamed ibn AbdulVahid ibn Hemmam, *Fet'hul Kadir*, matbeatu Mustafa Muhamed, Kajro-Egjipt.
- Ibn Rushd, *Bidajetul Muxhtehid ve Nihajetul Muktesid*, matbeatul Istikameti, Kajro-Egjipt.
- Ibni Kudame, *El-Mugni*, bot. i III-të, dar el-menareh, Kajro-Egjipt.
- Sherbini, *Mugni el-Muhtaxh*, matbeatul babi el-halebij, Kajro-Egjipt.
- Zekerija ibn Muhamed ibn Ahmed ibn Zekerija el-Ensari, *Esna-l Metalib fi Sherhi Revdi-t-Talibi*.
- Ebu Beker el-Xhezairi, *Minhaxhul Muslim*, el-Mektebetu et-Tevfikijetu.
- Ahmed Isa Ashur, *el-Fikhul Mujesser*, dar-ul hajr, bot.i III-të.
- Muhamed Ali Sabuni, *Fikhul Muamelat*. El-Mektebetul Asrijetu, bot. I-rë, 1422h-2002m, Sajda-Bejrut.
- Es-Sejid Sabik, *Fikhu-s-Sunneti*, bot.i II-të, 1419h-1999m, dare l-fet'h, Kajro-Egjipt.
- Abdurrahman el-Xhuzejri, *El-Fikhu Alel Medhahibi-l Erbeati*, El-Mektebu-th-Thekafij, el-Ez'her-Kajro.
- Vehebeh Zuhejli, El-*Fikhul Islami ve Edil-letuhu*, bot.i IV-të, 1422h-2002m, dar el-fikr, Damask-Siri.
- Vizaretul Evkaf vesh-Shuun el-Islamijeh, *el-Mevsuat-ul-Fikhijetu el-Kuvejti-jetu*, bot. I-rë, 1427, matba' darus-Safvetu, Kajro-Egjipt.
- AbdulAdhim Bedevij, *El-Vexhiz*, bot.I-rë, 1421h-2001m, dar ibn Rexheb, El-Mensura, Kajro.
- Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*, Mileniumi i Ri, Tiranë, 2007.
- Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*. Boton Fjala e Bukur, Prishtinë, 2008.

Mr. Ejup Haziri

TRANSACTIONS IN ISLAMIC JURISPRUDENCE

(Summary)

Introduction

Islam is not an ascetic religion, which deprives its followers from enjoying the goods of this life; on the contrary it calls upon them to enjoy the goods that God has provided to them.

Humans were fashioned and are guided by the Creator on how to live their lives. Humans are social beings, who can not live in solitude and isolation. They must live in the company of other humans. They must face the difficulties of life in order to live their lives properly.

أيوب حزيري

البيع و الشراء في الفقه الاسلامي

(خلاصة البحث)

مقدمة

الإسلام ليس دين التقشف الذ Í يحرم المؤمنين من ذوق متاع هذه الدنيا و لكن بالعكس يدعو المؤمنين في التمتع بالطيبات التى سخرالله للناس. الله جل

و على هو الذى خلق الإنسان وهداه عن كيفية العيش في هذه الحياة و عن واجباته و هو الكائن الاجتماعي الذي لا يستطيع العيش وحده منفصولاæ منعزولا ولكن بجب عليه ان يعيش فى المجتمعæ للمجتمعæ لا بد له من الاستجابة لمتطلبات الحياة من أجل أن يعيش الحياة على الوجه الصحيح.

Nexhat Ibrahimi

KOMPLEKSIVITETI IDEOLOGJIK I LËVIZJEVE ISLAME NË BOTËN ARABO-ISLAME NË SHEKUJT XX-XXI (Shkaqet e paraqitjes, rëndësia politike dhe temat më të rëndësishme)

Shqyrtime paraprake

Deri në "pranverën e vonuar" arabe, që ndodhi në pranverë të vitit 2011, të cilat në vijën e sistemit domino u zgjeruan në shumicën e vendeve arabe, rajonin arabo-islam e bënte disi të paprekur, rezistent ndaj çdo ndryshimi politik, ekonomik, kulturor etj. Tunizia, e cila e para e filloi këtë pranverë të vonuar, ende nuk ka vizion dhe perspektivë të shëndoshë, sepse i tërë angazhimi momental i opozitës është në ndëshkimin e krimeve dhe kriminelëve, e jo në gjetjen e një rruge më të favorshme për vendin, duke i marrë parasysh të gjitha komponentët: fetare, kulturore, politike, ekonomike etj. Edhe pranvera e vonuar egjiptiane përveç që e rrëzoi njërën nga diktaturat më autokrate në botë, nuk ofron shpresë reale për një të ardhme premtuese.

Një ndër faktorët e kësaj gjendjeje në Egjipt, është mungesa e një opozite demokratike dhe homogjene. Kurse ajo opozitë që ekziston, e

personifikuar në Lëvizjen e Vëllezërve Myslimanë nuk gëzon shumicën e popullatës së vendit dhe nuk gëzon përkrahjen e botës perëndimore. Është mendimi se kjo lëvizje do të ndikojë që politika egjiptiane do të jetë nën ndikimin fetar.

1. Islami politik, si lëvizje bashkëkohore fetare-politike

Nëse gjysmën e dytë të shekullit XX e karakterizoi ideologjia revolucionare e nacionalizmit arab (e imponuar si zëvendësim për Islamin), tre dekadat e fundit të shekullit XX i karakterizoi zgjimi i alternativës myslimane. Ky është realitet si në Egjiptin properëndimor, si në regjimet socialiste bathiste në Irak e Siri, si islame (vehabiste) proamerikane në Arabinë Saudite, si në shekullarizmin turk, tunizian e algjerian.

Duhet theksuar rilindjen islame nuk e përdorën vetëm lëvizjet opozitare por edhe vete qeveritë, pastaj grupimet më të vogla shoqërore dhe organizatat e shumta joqeveritare, me qëllimin final të arritjes së pushtetit politik. Kjo gjendje bën që Islami të bëhet apologji për ta ruajtur *status-quo*-në në formën e Islamit "zyrtar" apo si instrument i ndryshimit politik në formën e asaj që në zhargonin aktual e quajmë Islami "luftarak".

Perceptimi aktual i fesë islame ndër myslimanët është *din we dewleh* (fe dhe shtet), sipas disave sistem totalitar i besimit dhe ideve, të cilat janë ngushtë të lidhura nëpërmjet sistemit gjithëpërfshirës të moralit. Edhe pse ky sistem është dominues, megjithatë, gjatë historisë ka qenë i shpërfillur nga myslimanët. Qysh herët në historinë të shtetit islam do të gjejmë *halifatin* (manifestim i unitetit shpirtëror të myslimanëve) dhe *sulltanatin* (manifestimin politiko-ushtarak). Formën e plotë të ndarjes së fesë nga politika e hasim në fillim të halifatit abasit, në gjykatat e ashtuquajtura *medhalim* dhe *shurta*, në kompetencë të halifit. Në kohën e Perandorisë osmane këto gjykata do të quhen divane.

Përkundër rrëshqitjeve historike pohimi mbi lidhshmërinë e ngushtë ndërmjet fesë dhe politikës, megjithatë, është thellë i mbëltuar në natyrën e islamit dhe rikthimi i këtij komponenti paraqet ringjallje të monoteizmit ibrahimian dhe tërë ciklit pejgamberik.

Aktivizimi fetar dhe kërkesa për ringjallje fetare dhe shoqërore në frymën e Kur'anit gjatë historisë islame janë të pranishme. Por, atëherë kur dominonte pushteti botëror juristët dhe dijetarët islamë me përjashtim të Ibn Tejmijes kanë kërkuar nënshtrim sunduesit politik, në emër të qetësisë së shtetit islam. Kjo klimë e kuientizmit, pak a shumë, ka dominuar deri në fund të shekullit XIX.

Lëvizjet bashkëkohore myslimane, edhe pse proklamonin pastërti fetare, formatimin e tyre politik e bënin nën ndikimin e shteteve moderne të Lindjes së Mesme, që forconin autoritetin e shtetit dhe thyenin qendrat alternative të fuqive. Më tej, konsolidimi i shtetit shkonte në drejtim të nacionalizmit shekullar dhe në drejtim të kufizimit të fesë në fushë të moralit individual. Mirëpo, në vitet e shtatëdhjeta të shekullit XX, lëvizjet islame filluan të preokupohen me probleme politike, shoqërore, dhe me qëllim të riorganizimit të shtetit dhe shoqërisë në bazë të parimeve islame.

2. Shkaqet e Islamit politik

Rilindja bashkëkohore islame është fenomen i ndërlikuar dhe shumëdimensional, i cili nuk ka mundësi të shpjegohet vetëm nëpërmjet një vije. Mirëpo, si shkak i parë mund të merret kriza strukturore që pësoi bota arabo (myslimane) pas humbjes nga Izraeli më 1967. Kjo humbje ishte kapaku i dështimeve të dy shekujve të fundit. Kriza e fundit ka disa karakteristika të veçanta:

1. Kriza është më gjithëpërfshirëse se çdoherë më parë;
2. Kriza është shumëdimensionale: shpirtërore, politike, kulturore dhe socio-ekonomike dhe;
3. Kriza kumulative e cila paraqet kulmin e pritjeve të dështuara dhe mossuksesit në fushën e ndërtimit të shtetit, mbrojtjes ushtarake

dhe zhvillimit socio-ekonomik.[1] Kjo ishte faza e fundit të shpresave të rrejshme për imitim të euro-perëndimit. Kjo ishte periudha e kthesave, sepse bota arabe-myslimane filloi t'i kthehet Islamit, si garantues të vetëm drejt një identiteti pa mashtrim.

2.1. Kriza socio-ekonomike, lufta e tretë arabe-izraelite dhe humbja e legjitimitetit të regjimeve shekullare arabe

Edhe pse çdo shtet ka specifikat e tij, megjithatë, fondamentet e këtyre lëvizjeve nuk dallojnë shumë. Rritja e lartë demografike, migrimi i lartë fshat-qytet, mosgjetja punë e kuadrove me shkollim të lartë prodhoi gjendje të palakmueshme shoqërore. Nëse këtyre faktorëve ia shtojmë se elita intelektuale, nacionalistët dhe e majta arabe qenë kompromet uar duke bashkëpunuar me regjimet autoritare dhe qenë bërë pjesë e korrupsionit dhe tiranisë, bëhet e qartë se synimet e tyre për një mirëqenie materiale, për një pavarësim nga Perëndimi dhe çlirimit të Palestinës, qenë të pasuksesshme.

Aktivizimi politik i motivuar fetarisht fitoi në motiv sidomos pas luftës së tretë arabe-izraelite më 1967, kur ndërtesa nacionaliste shekullariste nuk ofroi atë që iu mungonte arabëve myslimanë. Madje, ky import shihej si i imponuar nga Perëndimi, si mjet perfid për përçarjen dhe nënshtrimin e botës arabe-myslimane kundrejt Perëndimit.

2.2. Hulumtimi i autentikes dhe reaksioni kundrejt Perëndimit

Shpjegimi socio-ekonomik i aktivizimit politik të Islamit nuk mjafton. Këtij duhet shtuar edhe faktin se rilindja islame paraqet reaksion ndaj ndjenjës së pafuqisë, absurdit dhe përçmimit kundrejt kulturimit dhe imperializmit perëndimor. Tani, Islami funksionon si variant i nacionalizmit kulturor i cili plotëson nevojën psikologjike për identitet autentik dhe vetëmjaftueshmëri.

[1] Dekmeijan, 1995: 30-31, sipas: Davorka Matić, Islamski pokret u arapskom svijetu: uzroci, teme i politički značaj. (Teksti ynë në masë është interpolim i tekstit të mësipërm).

Tërë kjo çoi në pyetjet, sikur: Cilat janë shkaqet e rrënimit të shoqërisë myslimane, cilat janë shkaqet e fuqisë dhe superioritetit evropian, si të kthehet lavdia dhe fuqia e humbur?

Myslimanët këtë rënie e shihnin në largimin nga Islami (Kur'ani dhe Suneti), të cilin e shihnin si relevant në botën moderne.[2] Së këndejmi, përgjigjja e parë ideologjike e myslimanëve kundër dominimit perëndimor nuk ishte refuzimi i të gjitha të arriturave perëndimore, nuk ishte lufta "e shenjtë" kundër të huajve dhe aprovimi fatalist i botës, por që me përpjekje të shtuara t'u përgjigjen imperialistëve me modernizimin e institucioneve politike, juridike, sociale të shoqërisë myslimane.

Islamistët bashkëkohorë zhvilluan një retorikë të fuqishme antiperëndimore, duke refuzuar të gjitha vlerat perëndimore, me përjashtim të shkencave natyrore dhe teknologjisë. Perëndimi shihej si "tjetri", shpesh edhe si "armik", kurse huazimet nga ata si të "huaja dhe të rrezikshme", që ishte reflektim tipik i diskursit postkolonialist.

2.3. Faktorët e brendshëm për fuqizimin e aktivizmit islam:

Revolucioni iranian dhe roli i Arabisë Saudite

Lëvizjet myslimane krahas faktorëve të tjerë u ndikuan edhe nga faktori i Revolucionit Iranian më 1979. Jo vetëm që u ringjallen shiitët myslimanë por edhe sunitët. Sunitët në revolucionin e tyre panë fitoren e të shkelurve dhe modelin e luftës kundër regjimeve diktatoriale vendore dhe hegjemonisë perëndimore. Islamistët u fuqizuan sepse Revolucioni tregoi se dëshirat e tyre nuk ishin utopi e thjeshtë por fakt real. Nga ana tjetër, rënia e prestigjit të regjimeve revolucionare u dha hapësirë forcave konservative si asaj të Arabisë, e cila e bazuar në

[2] Më shumë për modernizmin islam shih: Enes Karic, Tumacenje Kur'ana i ideologije XX stoljeca, Sarajevë, 2002, fq. + 646. Po ashtu: Enes Karic, Kur'an u savremenom dobu, II, Sarajevë, 2000, fq. 335-507.

pasurinë përrallore të naftës filloi promovimin e vlerave të tyre puritane dhe shtrirjen e ndikimit në masat arabe.

3. Burimet intelektuale të lëvizjeve islamiste

3.1. Burimet paramoderne: harixhinjtë dhe i Ibn Tajmije

Burimi më i vjetër i frymëzimit për doktrinën e Islamit politik paraqet sekti ekstrem mysliman i **harixhinjve,** i cili u paraqit në shekullin VII[3]. Pjesëtarët e këtij sekti shquheshin për fanatizëm dhe dhunë. Në serinë e atentateve viktimë ishte edhe Aliu r.a., halifi i katërt mysliman. Viktima të tyre ishin shpesh edhe gratë dhe fëmijët. Të gjithë ata që nuk silleshin në pajtim me interpretimin e tyre selektiv të Islamit i konsideronin kafirë (jobesimtarë)[4] dhe shenjtër legjitime e vrasjes fetare.

Edhe harixhinjtë bashkëkohorë, ata më militantët, përvetësuan nga harixhinjtë e vjetër pesë koncepte:

1. Sovraniteti dhe pushteti i përket Allahut (*el-hakimijje li'l-llah)*,
2. Bashkësia myslimane (umeti) paraqet burimin e pushtetit, respektivisht umeti e zgjedh sunduesin.
3. Shpallja për jobesimtarë dhe në bazë të kësaj ekskomunikimin nga bashkësia (*takfir*) jo vetëm heretikët por edhe mëkuaratët e zakonshëm.
4. Mosbesimin duhet ndëshkuar me vrasje dhe
5. Është detyrë e besimtarit të ngrihet kundër halifit, i cili shkel urdhrat e Zotit. Kjo pozitë i takon më të mirit ndër myslimanët, "qoftë ai edhe robi abisinas.

[3] Nexhat Ibrahimi, Vepra, vëllimi 3, Logos-A, Shkup, 2009, fq. 292-301.

[4] Viktima e tyre më e njohur ka qenë Ali ibn Ebi Talibi, halifi i fundit besimdrejt, i cili sundoi prej vitit 656 deri më 661. Vdekja e tij e dhunshme merret si fundi i periudhës së artë.

Burimi vijues i frymëzimit për doktrinën e Islamit politik paraqitet në doktrinën e Ibn Tejmijes[5]. Ai ishte juristi i parë mysliman i cili e lejoi mundësinë e rebelimit kundër halifit, që shkel urdhrat e Allahut.

Ai përpiqej që autoritetin politik t'ia nënshtrojë autoritetit fetar të ulemasë, meqë funksioni i halifit është detyrë fetare. Sunduesi e ka për detyrë t'iu drejtohet dijetarëve për këshilla. Ibn Tejmije synon bashkësinë ideale myslimane dhe nuk bazohet në precedentë historikë.

3.2. Burimet moderne të konceptit politik në Islam: Hasan El-Benna, El-Mewdudi, Sejjid El-Kutbi dhe Homeini

Përkundër rëndësisë së ndikimeve të hershme, lëvizjet bashkëkohore islame frymëzimin e tyre e gjejnë sidomos në idetë dhe konceptet e themeluesit të Lëvizjes së Vëllezërve Myslimanë, Hasan El-Bennës (1906-1949), pastaj të mendimtarit indo-pakistanez Ebu A'la El-Mewdudit (1903-1979) dhe egjiptianit Sejjid El-Kutbit (1906-1966). Mendimi politik shiit islam i paraqitur në idetë e Imam Homeinit, edhe pse ka mjaft pika prekëse me sunizmin, megjithatë, posedon specifikat e tij.

Hasan El-Benna[6] ofroi formulimin e parë bashkëkohor të konceptit të Islamit politik në botën arabe. Idetë e tij u zhvilluan gjatë luftës egjiptiane për pavarësi dhe nën ndikimin e fuqishëm të qeverisë shekullariste nacionaliste. Këto ide në rrafshin politik rezultuan në formimin e një grupi shoqëror fetar me emrin Vëllezëria Myslimane (*El-Ihwan el-Muslimun*, i cili së shpejti do të bëhet organizata më e rëndësishme islame, e cila Islamin do ta paraqesë si mënyrë gjithëpër-

[5] Ahmed ibn Tejmije (1263-1328) ka qenë dijetar mesjetar i cili kërkonte kthimin në mësimin burimor të Kur'anit dhe pastrimin nga risitë (bid'atet) të cilat sipas tij ishin në kundërshtim me praktikën e bashkësisë së hershme myslimane. Ibn Temije u ndesh me shumicën e medhhebeve të deriatëhershme dhe merret si nismëtar i jomedhhebizmit. Edhe pse gjatë jetës së tij nuk arriti ndonjë sukses, doktrina e tij gjeti në të shumtën vend në doktrinën e Muhammed ibn Abdulvehabit, i njohur më vonë si vehabizëm.

[6] Enes Karic, Tumacenje Kur'ana i ideologije XX stoljeca, Sarajevë, 2002, fq. 123-162.

fshirëse e jetës islame, me ç'gjë do të dallojë dukshëm nga ulemaja tradicionaliste dhe shoqëritë ekzistuese islame.

Vëllazërinë Myslimane El-Benna e përkufizoi si *"lëvizje selefiste, rrugë besimdrejtë ..."*, kurse metoda e tij e komunikimit bëhej në formë ligjëratash, ku bëhej thirrje kundër kolonializmit, hedhja poshtë e ndikimeve kulturore perëndimore, kthimi rrënjëve islame, respektimi rigoroz i ritualeve fetare dhe rol më të madh të Islamit në jetën publike. Metoda e tij nisej nga poshtë, duke e nxitur shtetin që Islamin ta pranojë si pjesë integrale të jetës publike dhe të bëhet instrument për përhapjen e fesë ndër masat. Synimi final i tij ishte vendosja e rendit islam (nidham'ul-islamij) dhe vetë shteti islam. Kjo mund të kuptohet lehtë nga slogani i tyre: "Zoti është synimi ynë, Pejgamberi është udhëheqësi ynë, Kur'ani është kushtetuta jonë, lufta është rruga jonë, kurse vdekja në shërbim të Zotit është synimi më i lartë i synimeve tona." (cit. sipas Mitchell, 1969:193-194).

Ebu'l-A'la El-Mewdudi[7] është personaliteti i dytë që ndikoi dukshëm në formulimin e botëkuptimit islam. Ka vepruar në nënkontinentin indo-pakistanez, por ndikimi i tij është shtrirë edhe në botën arabe dhe në vendet tjera myslimane. Në ditët e hershme rinore ka bashkëpunuar me lëvizjet nacionaliste dhe antikolonialiste, por me kalimin e kohës hetoi se është vështirë të bëhej një pajtim ndërmjet nacionalizmit dhe Islamit. Në dekadën e tretë të shekullit XX, ai shfaqte bindjen se rrënimi i qytetërimit islam ishte pasojë e përvetësimit të zakoneve joislame, risive (bid'ateve) dhe stagnimi i shkencës juridike islame. Si pasojë e kësaj gjendjeje kemi korrupsionin e Islamit burimor, të Muhammedit a.s. dhe bashkësisë së parë myslimane.

Për shkak të mospajtimeve me Partinë e Kongresit, në vitin 1942, e formoi Partinë islame (*Jamaat-e-Islami) e* cila pas ndarjes nga India do të bëhet ndër faktorët me rëndësi në skenën politike të Pakistanit. Koncepcioni i rendit islam të shtetit sipas tij, mbështetej në sovranitetin absolut të Zotit, kurse njeriu ka për detyrë ekskluzivisht aplikimin e urdhrave të Zotit. Sipas tij, sunduesi, mbreti, sulltani apo kryetari

[7] Enes Karic, Kur'an u savremenom dobu, po aty, fq. 169-196.

është përgjegjës jo vetëm para Zotit por edhe para njerëzve, me ç'gjë tentoi të demonstronte një sistem demokratik islam, të cilin sistem kushtimisht do të mund ta quanim teodemokratik, ku pushteti politik në islam është njëkohësisht edhe hyjnor edhe demokratik.

Sejjid Kutbi[8] është personaliteti i tretë në shqyrtimin tonë, i cili erdhi si rezultat i ndryshimeve politike në Egjipt, në vitet e pesëdhjeta të shekullit XX. Angazhimi i Oficerëve të Rinj në Egjipt me ndihmën direkte të Vëllazërisë Myslimane në rrëzimin e mbretit Farukut, nënkuptonte që në shtetin e ri do të participonte edhe Vëllazëria Myslimane. Por, shumë shpejt u bë e qartë se Naseri, jo që nuk mendonte ta bëjë një gjë të tillë, por madje mori masa rigoroze kundër anëtarëve të Vëllazërisë. Ndër të arrestuarit, pastaj edhe i ekzekutuari, ishte edhe Sejjid Kutbi, sigurisht ideologu më i rëndësishëm i krahut radikal të Lëvizjes. Ky do të bëhet shembull i aktivistit mysliman, jo vetëm në Egjipt, por edhe në tërë botën myslimane.

Konceptet e tij do të radikalizohen në vazhdimësi, sikur në veprën e tij nga viti 1964, me titull *Shenjat në rrugë* (*Mealem fi't-tarik*). Idetë e tij në të ardhmen ndikuan në grupe të caktuara, të cilat qeverive të ndryshme do t'u shpallin luftë si regjime jobesimtare, çfarë kemi te grupi Xhihad, Xhemaah islamijje, Lëvizja islame në Algjeri, Al-Kaida etj.

Personaliteti i katërt është nga provenienca shiite, i njohur si **Imam Homeini**[9]. Ai iku nga doktrina klasike shiite e cila karakterizohej me kuientizëm, me pranimin e pushtetit botëror dhe me insistimin e sigurimit të autonomisë në fushën fetare dhe me teorinë e tij që e vuri në praktikë (wilajat-e fakih = sundimin e prijësit fetar).

Mund të përfundohet se përkundër dallimeve këta ideologë kanë edhe pikat e përbashkëta: ekzistenca njerëzore e fiton kuptimin e tij vetëm nëse i nënshtrohet vullnetit të Zotit. Ata mendojnë se islami nuk është vetëm sistem i bindjeve dhe ritualeve fetare, por sistem i

[8] Enes Karic, Tumacenje Kur'ana, po aty, fq. 163-340.
[9] Enes Karic, Kur'an u savremenom dobu, po aty, fq. 223-252.

plotë i jetës, në të cilin feja dhe politika nuk janë të ndara nga fusha e jetës, por thellë të gërshetuara që përbëjnë unitet të pandarë.

Duhet kuptuar se idetë e tyre janë lindur dhe përpunuar në kohën e rrethanave të modernizimit të pasuksesshëm, shekullarizimit në rritje dhe represionit politik.

4. TEMAT KARAKTERISTIKE TË IDEOLOGJISË ISLAME

Trajtimi i ekspozesë është i ndërlikuar dhe nuk mund të perceptohet njëtrajtshëm. Domeni i diskursit dhe aktivizmit është i gjerë dhe lëviz nga pluralizmi dhe pozicioni prodemokratik deri te radikalizmi ekstrem dhe unitarizmi totalitar. Historikisht ka kaluar nëpër disa faza zhvillimore kurse konceptet e tij kanë evoluar, ndërkaq metodat e punës u janë përshtatur rrethanave përkatëse.

4.1. Sovraniteti absolut i Zotit (hakimijje)

Tema kyçe e diskursit islamist është sovraniteti suprem, absolut i Zotit. Ai është sunduesi dhe ligjvënësi i vetëm. Domethënia e jetës njerëzore përbëhet nga nënshtrimi vullnetit të Tij. Sunduesit janë mëkëmbës të Zotit në tokë, pushteti politik i të cilëve është i limituar me sheriat. Qëllimi i pushtetit është aplikimi i ligjit të Zotit, kurse legjitimiteti i sunduesit varet nga gatishmëria e tij që të udhëhiqet me dispozitat sheriatike. Ligji i Zotit është universal, i përkryer, i amshueshëm, i cili mbulon të gjitha fushat njerëzore dhe nuk u nënshtrohet ndryshimeve. Ndër synimet e sheriatit sipas islamistëve, është luftë kundër të gjitha regjimeve që nuk i nënshtrohen sovranitetit të Zotit dhe sheriatit.

4.2. Kthimi në "rrugën e drejtë" (sirat'ul-mustakim)

Është bindje e të gjithë besimtarëve myslimanë se periudha e Muhammedit a.s. dhe e halifëve besimdrejtë (hulefai rashidun) paraqet kohën normative, shembullore të historisë islame. Në këtë periudhë Allahu e kompletoi shpalljen dhe e konstituoi bashkësinë / shtetin (ummetin) islam. Po ashtu, u vendos kalendari islam, u redaktua Kur'ani, u vendosën raportet Islami dhe fetë tjera e shumë gjera të tjera.

Çdo rënie e vendeve myslimane është pasojë e neglizhimit të burimeve islame, prandaj çdo ngritje duhet të bazohet në burimet islame dhe në pararendësit e mirë (selef'us-salih). Duke ndjekur fillimet e mira të ummetit ideal dhe mjaftueshmërisë së Kur'anit, ata i janë shmangur kufizimeve të traditës ndërmjetësuese historike. Sipas Oliver Royit, ky trend ngjason me reformacionin protestant, i cili gjithashtu ftoi në fondamentet kristiane dhe u bë katalizator i ndryshimeve shoqërore. (Roy, 1996:20-21).

4.3. Rendi islam (nidham'ul-islami)

Sipas islamistëve, Islami është rend total e jo vetëm përmbledhje dogmash, bindjesh dhe praktikash. Ligji i Zotit rregullon ritualet religjioze, karakterin, moralin dhe shprehitë personale, raportet familjare, shoqërore dhe ekonomike, mënyrën e udhëheqjes së luftës dhe lidhjes së paqes etj. (Mewdudi, 1960:53). Islami është fe (*din*), mënyrë e jetës (*dunya*) dhe shtet (*dawla*).

4.4. Universalizmi unitar (et-tewhid)

Në paradigmën islamiste vend me rëndësi zë koncepti teologjik o unitetit të Zotit (tewhidit), sipas të cilit, Zoti është transcendent, një dhe i vetmi. Shoqëria duhet të jetë manifestim i konceptit të tewhidit. Ky koncept është universalist sepse pohon vlefshmërinë e sheriatit në të gjitha vendet dhe hapësirat, është unitarist sepse refuzon të gjitha

partikularizmit të kombit, klasës, etnive dhe nuk pranon ndarjen e fushës fetare nga fusha e së drejtës dhe politikës.

4.5. Ideja qendrore e shtetit islam (dewle el-islamijje)

Ajo që e ndan islamin politik nga format e mëhershme revivaliste islame është theksi i tij politik në shtetin islam. Grupimet aktuale islame shtetin e vendosin në qendër të vëmendjes, sepse nëpërmjet shtetit bëhet implementimi i sheriatit dhe sigurohet rendi islam. Prandaj, edhe kemi orientimin e tyre drejt marrjes së shtetit dhe qendrave të ndikimit, qoftë nëpërmjet institucioneve ekzistuese qoftë dhunshëm nëpërmjet luftës revolucionare. Të tillët diskrepancën ndërmjet islamit ideal dhe atij historik e kërkojnë jo në mossendërtimin e idealit, por në dobësinë e karakterit njerëzor dhe në dinakërinë dhe intrigat e jobesimtarëve, sidomos Perëndimit.

Në këtë çështje duhet theksuar një veçori mjaft të kontestueshme në Perëndim, atë të xhihadit, e cila konsiston në detyrën aktive të myslimanit në ndërtimin e bashkësisë ideale. Në interpretimin radikal të xhihadit, ai më nuk është vetëm angazhim moral dhe intelektual, por edhe angazhim luftarak, vdekjen dhe rënien dëshmor, si shkallën më të lartë të një besimtari.

Përfundimi

Lëvizja islame është bërë pjesë përbërëse e strukturave politike dhe sociale të vendeve arabe, kurse ndikimi i saj është i dukshëm në rrafshin kulturor, qytetërues, social dhe politik. Intelektuali Dekmeijani e ka klasifikuar si gjithëpërfshirës, policentrik dhe rezistent. *Gjithëpërfshirës* sepse është i pranishëm në të gjitha vendet pa marrë parasysh madhësinë, atmosferën politike, ekonomike apo kulturore; *policentrik* sepse nuk posedon një udhëheqje dhe në gjirin e saj ka shumë organizata dhe grupime të ndryshme; *rezistent* sepse ka treguar

qëndrueshmëri të lartë me pirje ciklike që të merr pjesë në formësimin e hapësirës socio-politike.[10]

Ndërmjet këtyre grupeve ka dallime cilësore. Disa prej tyre kanë pranuar sistemet e caktuara dhe brenda tyre përpiqen të ofrojnë alternativën e tyre, sikurse janë: Vëllezërit Myslimanë në Egjipt, Partia e drejtësisë dhe zhvillimit në Marok, Fronti Islam në Jordani etj. Por, disa të tjera kanë zgjedhur rrugën e dhunës dhe luftës së armatosur si mjet për sendërtimin e synimeve të tyre. Mirëpo, përkundër dallimeve, ato kanë të përbashkët islamizimin e shoqërisë myslimane dhe vendosjen e qeverisë myslimane.

Reaksion i të gjitha lëvizjeve ishte qasja e Perëndimit ndaj lirisë, drejtësisë dhe fesë. Me ndryshimin e rrethanave shoqërore politike nuk do të thotë që ndikimi islam i këtyre lëvizjeve do të ndryshojë ose do të bjerë. Këtë më së miri e treguan ndryshimet e fundit në pranverë të vitit 2011. Mbetet të kalojë sadopak kohë e të bëhet një analizë më e qëndrueshme dhe më reale.

Literatura:

1. Matić, Davorka, Islamski pokret u arapskom svijetu: uzroci, teme i politički značaj.
2. Karic, Enes, Tumacenje Kur'ana i ideologije XX stoljeca, Sarajevë, 2002.
3. Karic, Enes, Kur'an u savremenom dobu, II, Sarajevë, 2000.
4. Ibrahimi, Nexhat, Vepra, vëllimi 3, Logos-A, Shkup, 2009.

[10] Dekmeijan, 1995:3-4, sipas: Davorka Matić, po aty.

Nexhat Ibrahimi

THE IDEOLOGICAL COMPLEXITY OF ISLAMIC MOVEMENTS IN THE ISLAMIC WORLD IN THE XX-XXI CENTURY

(Summary)

Emergence, political importance and most important topics

Until the dramatic unfolding of events during the “late Arab spring”, which occurred in 2011, and which had a domino effect on most Arab countries, the region had largely been unaffected by any political, economic or cultural changes. Tunisia, where the Arab spring began, still has no vision for the future. All the efforts are focused in punishing the crimes from the past rather than on treading a new road, which would be more favorable for the country, taking into consideration all components: religious, cultural, political, economic, etc. Similarly, the Egyptian spring, which brought down one of the most autocratic dictatorships in the world, does not give real hope of a prosperous future.

نجات ابراهيمي

التعقيد الأيديولوجي للحركات الإسلامية في العالم العربيæ الإسلامي في القرنين ٢٠-٢١

(أسباب الظهور، الأهمية السياسية وأهم المواضيع)

(خلاصة البحث)

مناقشات تمهيدية

حتى "الربيع العربي المتأخر" الذي وقع في ربيع عام ٢٠١١ و الذي توسع في خط نظام الدومينو في معظم الدول العربية جعل المنطقة العربيةæ الإسلامية إلى حد ما سليمة ومقاومة لأ Í تغيير سياسي و اقتصاديæ ثقافي إلخ. و تونس التي بدأ هذا الربيع المتأخر ما زال لا يوجد لديها رؤية و منظور صحيح بسبب الالتزام الحالي للمعارضة في معاقبة الجرائم والمجرمين بدلا من إيجاد وسيلة أكثر ملاءمة للبلاد مع الأخذ في الاعتبار جميع العناصر الدينية والثقافية والسياسية والاقتصادية وما إلى ذلك. و أيضا الربيع المتأخر المصريمع أنه أطاح بواحد من أكثر الأنظمة الديكتاتورية الاستبدادية في العالم فإنه لا يقدم أملا حقيقيا لمستقبل واعد.

Mr. Jahja Hondozi

KONTRIBUTI SHKENCOR I PROF. DR. HASAN KALESHIT NË PERIODIKUN SHKENCOR NË KOSOVË[1]

Për jetën dhe veprën e dr. Hasan Kaleshit, deri më sot janë botuar disa shkrime, madje edhe një monografi e tërë.[2]

Thënë të vërtetën, të shkruhet për një figurë aq të shquar siç ishte dr. Kaleshi, nuk është aspak punë e lehtë, kur të kihet parasysh dimensioni dhe vëllimi i jashtëzakonshëm i kontributit të tij.

Dr. Hasan Kaleshi ka qenë një studiues i mirëfilltë, i cili ka dhënë kontribut shumë të çmuar në afirmimin e shkencës shqiptare dhe prezentimin e saj në rajon e gjetiu.

Janë të njohura pjesëmarrjet e tij në konferenca e simpoziume shkencore në Gjermani, Turqi, Bullgari, Itali, Greqi e vende të tjera, ku me profesionalizmin e një shkencëtari ofronte gjithnjë të arriturat më të reja nga fushat e ndryshme shkencore.

---

[1] Kumtesë e lexuar në Akademinë përkujtimore me rastin e 90-vjetorit të vdekjes së prof. dr. Hasan Kaleshit, e cila u mbajt në Kërçovë, më 14.07.2012.

[2] Shih: Riza Sadiku, *Hasan Kaleshi – Jeta dhe vepra*, Kërçovë, 1996.

Opusi i tij krijues mjaft i pasur, ndonëse për nga aspekti kohor jo fort i gjatë, shtrihej në disa disiplina, si: linguistikë, histori, letërsi, kulturologji, po edhe islamistikë.

Gjatë periudhës kohore 1949-1976 kur edhe ndërron jetë, dr. Kaleshi ka shkruar një numër të madh punimesh të publikuara në periodikun shkencor të kohës. Janë gjithsej 373 punime të cilat dr. Kaleshi ia ofroi opinionit shqiptar dhe atij botëror.

Këtu përfshihen punime origjinale të autorit si edhe shumë përkthime nga gjuhët e huaja, e kjo falë zotërimit të tij të gjuhëve kryesore evropiane: gjermanishtes, anglishtes, frëngjistes e italishtes, përfshirë këtu edhe gjuhët ballkanike dhe atyre orientale: arabishtes, osmanishtes e turqishtes.

Objekti i vështrimit tonë do të jetë kontributi shkencor i dr. Hasan Kaleshit në periodikun shkencor në Kosovë.

Për herë të parë, para opinionit shqiptar, dr. Kaleshi është paraqitur në vitin 1949, me një studim të publikuar në revistën "Jeta e Re". Studimi titullohej: *"Disa vërejtje mbi gjuhën në shtypin tonë"*.[3]

Po në këtë revistë, gjatë vitit 1951, prof. Kaleshi do të botojë edhe pesë punime të tjera, kryesisht nga fusha e gjuhës dhe letërsisë. Ato janë: *"Përkthimet dhe problemi gjuhësuer"*,[4] *"Poezija për fëmijë e Zmajit në përkthimin e Anton Çetës"*,[5] *"Kundër plagijateve"*,[6] *"Nji punim shkencuer jo kritik i Glisha Elezoviqit (me Kadri Halimin)"*[7] dhe *"Interesimi i Vuk Karaxhiqit për poezin popullore shqiptare"*.[8]

Po në këtë vit, në gazetën *"Rilindja"*, prof. Kaleshi do të botojë një vështrim me titull: *"Edhe nji herë mbi punimin e Glisha Elezoviqit, "Glasne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline"*.[9]

Në vitin vijues, 1952, autori ynë, në revistën e lartpërmendur do të botojë edhe gjashtë studime (dy prej të cilave si bashkautor me Hilmi

[3] Jeta e re, nr. 2/1949, f. 109-114.
[4] Jeta e re, nr. 4/1951, f. 224-234.
[5] Jeta e re, nr. 4/1951, f. 261-267.
[6] Jeta e re, nr. 5/1951, f. 289-297.
[7] Jeta e re, nr. 5/1951, f. 309-320.
[8] Jeta e re, nr. 6/1951, f. 369-385.
[9] Rilindja, 9.XII.1951, Prishtinë.

Thaçin). Le t'i përmendim radhazi: *"Pak fjalë mbi botimet tona"*,[10] "Dr. Henrik Barić, *Mbi origjinën e gjuhës shqipe*", (me H. Thaçin)[11] *"Fjaluer serbokroatisht-shqip"*,[12] "Henrik Barić, *Ilyrico-Albanica*",[13] *"Me rastin e përkthimit të Kunorës së maleve"*[14] dhe "Dr. Henrik Barić, *Bolla Hysein aga*" (me H. Thaçin)[15].

Në vitin 1953 dr. Kaleshi boton tri punime (dy prej tyre si bashkautor me Hilmi Thaçin): *"Ivo Andrić i njegova dela, predgovor zbrici pripovedaka"* (me H. Thaçin),[16] *"Ivo Andrić, Tregime të zgjedhuna"* (me H. Thaçin)[17] dhe *"I mjeri Nasradin"*.[18]

Në vitin tjetër në shtypin kosovar, dr. Kaleshi do të botojë pesë artikuj, një në revistën *"Jeta e re"*, një në *"Jedinstvo"* dhe tri në gazetën *"Rilindja"*. Ja edhe titujt e tyre: *"Përgjegje nji kritike insolente"* (bashkautor me H. Thaçin)[19], *"Savremena turska književnost"*,[20] *"Albanologija - Albanistika"* (bashkautor me H. Thaçin),[21] *"Çështja gjuhësore"*[22] dhe *"Ylberi"*,[23] një përkthim nga shkrimtari turk, Omer Seyfedin.

Viti 1955 në periodikun kosovar regjistron gjashtë punime të prof. Kaleshit (dy prej tyre si bashkautor me H. Thaçin). Këto janë: *"Gramatika shqipe e Fadil Tiranasit"*,[24] *"Quod licet Jovi, non licet Jovi"* (me H. Thaçin)[25] *"Neki problemi časopisa "Jeta e re"*,[26] *"Ivo Andriqi*

[10] Jeta e re, nr. 1/1952, f. 30-33.
[11] Jeta e re, nr. 3/1952, f. 205-211.
[12] Jeta e re, nr. 3/1952, f. 227-232.
[13] Jeta e re, nr. 4/1952, f. 273-278.
[14] Jeta e re, nr. 5-6/1952, f. 337-352.
[15] Jeta e re, nr. 5-6/1952, f. 384-388.
[16] "Mustafa Bakija", Prishtinë, 1953.
[17] "Mustafa Bakija", Prishtinë, 1953.
[18] Jeta e re, nr. 4/1953, f. 298-306.
[19] Jeta e re, nr. 1/1954, f. 48-57.
[20] Jedinstvo, 13, 20, 27 dhe 28. VII. 1954, Prishtinë.
[21] Rilindja, 21. III. 1954, Prishtinë.
[22] Rilindja, 8 dhe 15. VIII. 1954, Prishtinë.
[23] Rilindja, 2. XI. 1954, Prishtinë.
[24] Përparimi, 5/1955, f. 270-273.
[25] Jeta e re, nr. 1-2/1955, f. 48-55.
[26] Jedinstvo, 7. IV. 1955

dhe veprat e tij" (parathënie me Hilmi Thaçin),[27] "Dr. Henrik Barić, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe"*[28] dhe *"Kosova e Metohija në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebis"*.[29]

Në këtë punim të fundit, mjaft të çmuar, prof. Kaleshi fillimisht ofron të dhëna historike mbi jetën e E. Çelebiut dhe disa shënime mbi veprën e tij, Siyahatname.

Këtu, ai përmend se E. Çelebiu e pati vizituar Kosovën dy herë. Herën e parë, në vitin 1660, kur vjen prej Novi Pazarit dhe përshkruan Novo Bërdon, Mitrovicën, Vushtrrinë, Prishtinën dhe Kaçanikun. Ndërkaq, herën e dytë në vitin 1662, kur vjen prej Shkodër në Dukagjin, e prej andej në Gjakovë.

Përveç të dhënave të pasura mbi këto vende, ku përfshihen kalatë, kasabatë, xhamitë, hamamet, popullsia etj, prof. Kaleshi e pasuroi këtë punim edhe me sqarime të shumta nga terminologjia administrative e kohës, siç janë fjalët: ejalet, rumeli, sanxhak, akçe, serdar, muhtesib, imaret, kaza, nahi, dizdar etj. Për më tepër, ai vende-vende bën edhe lexim kritik të veprës, gjë që tregon për njohuritë e thella të prof. Kaleshit në fushën e historisë.

Në periudhën mes viteve 1956-1965 prof. Kaleshi boton nga një punim në vit. Arsyeja e numrit të kufizuar të punimeve rrjedh me gjasë nga angazhimet e tij të shumta për pjesëmarrje nëpër konferenca e simpoziume shkencore nëpër qendrat më të njohura evropiane. Gjithashtu, kjo ishte periudha kur ai punonte intensivisht në projektin e tij jetësor, tezën e tij të doktoratës,[30] të cilën e mbrojti me sukses në Beograd në vitin 1960.

T'u kthehemi tani punimeve të tij gjatë kësaj periudhe duke i përmendur sipas kronologjisë. Në vitin 1956, ai boton një punim në gjuhën serbokroate: *"Savremena egipatska književnost"*.[31] Artikulli është

[27] "Mustafa Bakija", Prishtinë, f. 5-20, 1955.
[28] Prishtinë, 1955.
[29] Përparimi, 7-8/1955, f. 422-434.
[30] Ajo titullohet "Najstariji vakufski dokumenti iz Jugoslavije na arapskom jeziku".
[31] Jedinstvo, 1. V. 1956, Prishtinë.

një kontribut i çmuar i autorit tonë, ku ai i ofron opinionit të asaj kohe disa të dhëna dobiprurëse mbi letërsinë bashkëkohore egjiptiane.

Në vitin 1957 autori boton një tjetër punim mjaft të çmuar në gjuhën serbokroate, i cili mban titullin: *"Jedna prizrenska i dve vučitrnske kanunname"*.[32]

Në këtë punim autori ofron përkthimin e një kanunname të Prizrenit dhe dy kanunnameve të Vushtrrisë. Këto kanuname na sjellin një varg shënimesh mbi gjendjen ekonomike në sanxhakun e Vushtrrisë, mbi mallrat që prodhoheshin dhe me të cilat bëhej tregti, mbi tatimet që paguante raja, mbi organizimin e doganës, mbi inspektimin e tregut etj. Këto kanunname paraqesin materialin themelor për studimin e sistemit feudal të Perandorisë Osmane. Autori vë në pah se këto kanunname shërbejnë për ndriçimin e disa çështjeve deri tani jo dhe aq të qarta lidhur me disa nahije dhe kadillëqe. Në shënimet, në fund të punimit, autori ka dhënë sqarimet e duhura për një varg termesh të domosdoshme për kuptimin e tekstit si dhe ka dhënë një varg shënimesh të reja për kadillëqe të ndryshme. Autori thekson se origjinalet e të trija kanunnameve gjenden në Arkivën e Kryesisë së Qeverisë turke në Stamboll. Kanunnameja e Prizrenit daton nga viti 1570, kurse ato të Vushtrrisë – prej viteve 1525 dhe 1530.

Në vitin 1960 dr. Kaleshi boton një punim me titull: *"Nji prizrenas që ka shkrue në gjuhën arabishte"*.[33]

Në vitin 1961, në revistën *"Përparimi"* autori boton një vështrim të vlefshëm historik që mban titullin: *"Shënime nga e kalumja e Prizrenit gjatë periodës turke"*.[34]

Autori, në këtë punim të tij, fillimisht ofron të dhëna historike për çlirimin e Prizrenit, ku si datë definitive jep 21 qershorin 1455. Duke u bazuar në vakufname dhe sallname të ndryshme, autori ofron shënime të shumta mbi Sanxhakun e Prizrenit, mbi ekonominë, tregtinë, zejet si dhe popullsinë që banonte në atë trevë. Edhe këtë punim,

[32] Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, knjiga II, Prishtinë, 1957, str. 289-300.
[33] Zani i rinisë, gusht, 1960, Prishtinë.
[34] Përparimi, nr. 7-8, Prishtinë, 1961, f. 497-510.

autori e pasuroi me sqarime të duhura për një varg termesh që janë të domodoshme për kuptimin e tekstit në tërësi.

Në vitin 1962, dr. Kaleshi paraqitet para opinionit të kohës me një tjetër kontribut, me titull: *"Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda"* (Prizreni si qendër kulturore gjatë periudhës së Perandorisë Osmane).[35]

Në këtë punim të tij, autori vë në pah faktin se Prizreni, pos që ishte i njohur si 'djep i poetëve', ka qenë gjithashtu edhe një qendër e rëndësishme kulturore gjatë pothuaj tërë periudhës së Perandorisë Osmane, pra rreth 450 vjet.

Autori këtu thekson se që nga viti 1455 e deri më 1912, Prizreni ishte një qendër e rëndësishme administrative, qendër e sanxhakbeut, e një herë madje edhe qendër e vilajetit (1868-1875). Autori përshkruan trashëgiminë kulturore-historike dhe atë fetare të Prizrenit, si: xhamitë, medresetë, bibliotekat, teqetë, hanet, mejtepet dhe institucionet tjera kulturore.

Autori vë në pah se edhe në Prizren, si në tërë Turqinë, të gjitha ndihmat sociale, shërbimet publike, institucionet kulturore-historike janë themeluar e mirëmbajtur falë sistemit të vakëfit. Këtu përfshiheshin: shkollat, xhamitë, rrugët, krojet, kanalizimet, ujësjellësit, godinat bamirëse dhe shumë institucione të tjera.

Si formë e veçantë e veprimtarisë kulturore e cila kultivohej asokohe në Prizren, autori përmend edhe përshkrimin e veprave të ndryshme: arabe, persiane e turke, me tematikë fetare, shkencore e letrare. Librat përshkruheshin nëpër xhamitë, medresetë, teqetë, por kishte edhe njerëz të cilët këtë e kishin profesion të vetëm. Kështu, në Prizren zhvillohej një aktivitet mjaft i gjallë kulturor. Në fund të punimit, autori ofron edhe disa shënime mbi disa letrarë të Prizrenit, siç ishin: Suzi, Nehari, Suxhudi, Ashik Çelebi etj.

[35] Gjurmime albanologjike, nr. I, Prishtinë, 1962, f. 91-118 (rezyme në frengjisht).

Në vitin 1964, bashkë me Hilmi Thaçin, autori boton një shkrim në gazetën "Rilindja", me titull: *"Për gjuhën e popullit kundër gjuhës individualiste"*.[36]

Në vitin 1965, dr. Kaleshi i ofron opinionit shkencor një punim me titull: *"Veliki vezir Kodža Sinan Paša, njegove zadužbine i njegova vakufnama"*.[37]

Në vitin 1967, autori boton katër punime. Ato janë: *"Legjendat shqiptare për Sari Salltukun"*,[38] *"Vilajeti i Prizrenit"* (bashkautor me dr. Hans Jürgen),[39] *Letër prej RAB, Kajro në një atmosferë paralufte"*[40] dhe *"Njiqind shqiptarë – shkrimtarë të njoftun në letërsinë turke"*.[41]

Punimi *"Legjendat shqiptare për Sari Salltukun"* ishte fillimisht referat i mbajtur në gjuhën gjermane në Kongresin për Ballkanologji, mbajtur në Sofje, më 1. IX. 1966. Këtu, autori përpiqet të ndriçojë figurën e Sari Salltukut, një personalitet i shek. XIII, siç thotë edhe vetë sa historik, aq më tepër edhe legjendar. Ai ofron teza të ndryshme lidhur me këtë figurë, duke përmendur një nga një edhe legjendat shqiptare, të cilat populli i ka kultivuar gjatë shekujve. Disa nga teoritë e shtruara në këtë punim e paraqesin atë si një dervish endacak, misionar i fesë islame, por edhe asket i krishterë.

Në punimin tjetër, në bashkautorësi me dr. Hans Jürgen, autori ofron të dhëna mbi vilajetin e Prizrenit, bazuar në dy sallnamet që datojnë nga vitet 1873 dhe 1874. Këtu përfshihen informata të përgjithshme për secilën njësi administrative të vilajetit, pastaj për komunikacionin, për arsimin e shkollat etj. Autorët, këtë punim të tyre e pasuruan edhe me disa shënime shtesë për t'i ndriçuar disa çështje të cilat nuk janë edhe aq të njohura.

---

[36] Rilindja, 9. V. 1964, Prishtinë.
[37] Gjurmime albanologjike, nr. II, Prishtinë, 1962, f. 105-144 (rezyme në anglisht).
[38] Përparimi, nr. 1, f. 85-103, 1967, Prishtinë.
[39] Përparimi, nr. 2, f. 165-193 dhe Përparimi, nr. 3, f. 274-310, 1967, Prishtinë.
[40] Rilindja, nr. 2937, 4. VI. 1967, Prishtinë.
[41] Rilindja, 1. VIII. 1967, Prishtinë.

Vitet 1968-69 shënojnë vlugun e veprimtarisë së dr. Hasan Kaleshit. Gjatë këtyre dy viteve, ai botoi vetëm në periodikun shqiptar gjithsej 28 artikuj, ku përfshihen: punime origjinale, përkthime, recensione etj.

T'i përmendim radhazi: *"Lufta shqiptaro-turke në shek XIV-XV sipas tri kronikave turke",*[42] *"Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëllimi II, shek. XIV-XV, Tiranë 1962, 410 f. in 8",*[43] *"Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IX, 1964 – Prishtinë",*[44] *"Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965",*[45] *"Stavri N. Naçi, Pashallëku nën sundimin e Bushatlive në gjysmën e dytë të shek. XVIII/1757-1796",*[46] *"Gerhard Grim, Johan Georg von Han (1811-1869), Wiesbaden, Otto Harrasovitz 1966, 385 f. in 8° (Albanischen Forschungen)",*[47] *"Südost-Forschungen, Band XXVI, 9 Oldanburg, München 1967",*[48] *"Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke",*[49] *"Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi i III, shek. XVI-XIX (1506-1839), Universiteti Shtetnor i Tiranës, Tiranë 1962, 366 fq.",*[50] *"Kutbu d-din Muhammad Ahmad, od Dahrawaili al Makki Gazawat al Garakisa-wa-l-Atrak fi Geni übi l-Gazire, Menshurat dal' al-Jamama li l-bahth wa t-targama wa n'nashr 1967, ar Rijad, al Mamlaka al Arabija as Su'udija 69+542 f. in 8°",*[51] *"Zeitschrift Für Balkanologie, Jahrgang, Heft – I, Otto Harrasovitz, Wiesbaden 1967",*[52] *"Dr. Franc Babinger, In memoriam",*[53] *"Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII, Tiranë 1965, 525 f",*[54]

---

42 Përparimi, nr. 2, 1968, f. 267-303, Prishtinë.
43 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 254, Prishtinë.
44 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 285-288, Prishtinë.
45 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 273-275, Prishtinë.
46 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 260, Prishtinë.
47 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 261-264, Prishtinë.
48 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 290-291, Prishtinë.
49 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 33-116, Prishtinë (rezyme në frengjisht).
50 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 254-255, Prishtinë.
51 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 256-257, Prishtinë.
52 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 288-290, Prishtinë.
53 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1968, f. 255-257, Prishtinë.
54 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1968, f. 273-275, Prishtinë.

"Vostočnije istočniki po istorii narodov jugo-vostočni centralnoi Evropi, Moskva, 1964",[55] *"Jedna zabluda o bogorodici Leviškoj",*[56] *"Veprat filologjike dhe dialektologjike të Sami Frashërit",*[57] *"Rezistenca e shqiptarëve në epokën e Skënderbeut",*[58] *"Peter Bartl, Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unobhongigkcitsbe wegung 1878-1912, Wiesbaden, 1968, p. 208",*[59] *"Körnrumpf – Hans Jürgen: Ahmed Xhevat pasha në Shqipërinë veriore dhe Mal të Zi (përktheu H. Kaleshi)",*[60] *"Mahmud Tejmur, Me terrin e natës (fragment)",*[61] *"Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll",*[62] *"Çfar të dhënash na japin kronikat osmane mbi luftat shqiptaro-turke në shek. XV",*[63] *"Mahmud Tejmur, Abu Arab",*[64] *"Selami Pulaha, Luftat shqiptaro-turke në shek. XV, burime osmane, Tiranë 1968, 426 fq",*[65] *"Agah Sirri Levend, Şemsettin Sami, TDK yayinlari 287, Ankara 1969",*[66] *"Georges T. Petrovitsch, Scanderbeg (Georges Castriota), Essai de bibliograpfie, Raisonne, Paris 1881, rishtypur nga Rudolf Trofenik, München 1967, parathanja nga Franc Babingeri",*[67] *"Studia Albanica monacensia, In memoriam Georgii Castrioti Scanderbegi 1468-1968, München, 1968, pp. 175",*[68] *"Univerzitet u Prištini treba da bude motor i regulator naučne aktivnosti na Kosovu".*[69]

Në punimin *"Lufta shqiptaro-turke në shek XIV-XV sipas tri kronikave turke"* autori fillimisht vë në pah rëndësinë e kronikave të vjetra turke për historinë e Perandorisë Osmane. Këtu, ai ofron të dhëna

---

55 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1968, f. 270-273, Prishtinë.
56 Jedinstvo, 1. 1. 1968, Prishtinë.
57 Fjala, 7 shtator 1968, Prishtinë.
58 Rilindja, 16-19 janar 1968, Prishtinë
59 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1968, f. 275-276, Prishtinë.
60 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1969, f. 185-217, Prishtinë.
61 Rilindja, 19. VI. 1969, Prishtinë.
62 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1969, f. 77-117, Prishtinë.
63 Simpozijumi për Skënderbeun, 9-12 maj 1968, Prishtinë, 1969, f. 171-180.
64 Rilindja, 16. I. 1969, f. 11, Prishtinë.
65 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1969, f. 298-300, Prishtinë.
66 Gjurmime albanologjike, nr. I, 1969, f. 300-303, Prishtinë.
67 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1969, f. 222-223, Prishtinë.
68 Gjurmime albanologjike, nr. II, 1969, f. 227-230, Prishtinë.
69 Jedinstvo, 13 novembar 1969, Prishtinë.

mbi luftat shqiptaro-turke sipas tre kronistëve turq. I pari është Shukrullah, me kronikën e tij *Behxhetu-t-tevarih* (Bukuria e kronikave), mandej Ashikpashazade, me kronikën e tij *Tevarih-i Al-i Osman* dhe Hoxha Sa'duddin, me kronikën e tij *Taxhu-t-tevarih* (Kurora e kronikave).

Dr. Kaleshi thekson se Perëndimi ka shprehur interesim të veçantë për këto kronika qysh në shek. XVII. Kështu, ai përmend se në vitin 1649 në Vjenë është botuar përkthimi italisht i pjesës së parë të kronikës së Hoxha Sa'duddinit, pastaj përkthimi i pjesës së dytë në Madrid më 1652, më pas një pjesë anglisht në Londër më 1652, e një pjesë frengjisht më 1710. Autori ofron përkthime të pjesshme nga të trija kronikat, duke vënë në pah njëherësh edhe veçoritë e secilës prej tyre.

Punimi i dr. Hasan Kaleshit *"Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke"* është mbase njëri ndër kontributet më të çmuara dhe më voluminoze në mesin e shkrimeve të autorit, të botuara në gjuhën shqipe. Punimi shtrihet në gjithsej 80 faqe, me një rezime katër faqesh në gjuhën frenge. Në këtë punim studioz, dr. Kaleshi me penën e tij mjeshtërore e përshkruan në hollësi veprimtarinë krijuese të kësaj figure të dalluar të kombit shqiptar. Në të, autori ofron të dhëna të hollësishme mbi krijimtarinë e Samiut, duke i përmendur e përshkruar një nga një romanet e tij, dramat, anekdotat dhe maksimat, antologjitë, përkthimet, mandej veprat e tij filologjike dhe dialektologjike të Samiut, veprat leksikografike dhe enciklopedike të tij, në mesin e të cilave veprën e tij monumentale Kamusu-l-a'lam, më pas veprat nga fusha e islamistikës dhe arabistikës, abetaret dhe gramatikat e turqishtes dhe të arabishtes, e krejt në fund, autori përmend edhe veprimtarinë e tij në fushën e gazetarisë.

Duke e përmbledhur këtë punim të tij, dr. Kaleshi thekson se Samiu shkroi më se 50 vepra, nga të cilat disa me shumë vëllime. Ai me plot të drejtë pohon se një punë të tillë sot e bën një institut për vite me radhë, kurse Samiu e kishte bërë vetë pa bashkëpunëtorë, pa administratë e pa ndihmës, punë e cila me të vërtetë meriton çdo lëvdatë e admirim.

Në vitin 1970 prof. Kaleshi i ofroi opinionit të kohës disa punime mjaft të çmuara shkencore.

Le t'i përmendim ato: *"Dokumente të Arkivit të Vjenës mbi mësimet e shqipes në Arbnesh të Zarës",*[70] *"Četrnaest turskih fermana manastira Dečana"*[71] (bashkautor me Ismail Erenin), *"Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit",*[72] *"Dr. Jašar Redžepagić, Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918 godine, Priština, 1968",*[73] *"Beitrage zur Südosteuropa – Forschung. Anlasslich des II Internacionalen Balkanologenkongres in Athen, München 1970, 210",*[74] *"Turski uticaji u tvorbi reči u Albanskom jeziku",*[75] *"Nji shoqeri e panjohur e shqiptarëve e Stambollit",*[76] *"Profesor dr. Alois Schmaus",*[77] *"Arkivi i Wienës dhe rëndësia e tij për historinë shqiptare".*[78]

Në punimin *"Dokumente të Arkivit të Vjenës mbi mësimet e shqipes në Arbnesh të Zarës"* autori ofron të dhëna mbi dy kuti dokumentesh që gjenden në arkivin shtetëror të Vjenës. Ai tregon se kjo përmbledhje e cila përfshin rreth 300 dokumente përbëhet prej letrave origjinale të mësuesve shqiptarë të cilët kanë punuar atje, raporteve të konzullit austriak në Shkodër, pastaj në mesin e tyre janë çertifikata origjinale, udhëzime të ndryshme të cilat ua dërgon qeveria nga Vjena organeve më të ulta etj. Autori thekson se këto dokumente janë në gjermanisht, italisht dhe serbokroatisht. Nga numri i madh i dokumenteve kushtuar kësaj çështjeje, autori ka përzgjedhur dymbëdhjetë sish të cilat i boton këtu në origjinal dhe me përkthim shqip.

Tjetër kontribut i tij të cilin po e paraqesim këtu është *"Četrnaest turskih fermana manastira Dečana"*. Në të, ai pohon se në manastirin

[70] Vjetari i Arkivit të Kosovës II-III, f. 151-208, 1970, Prishtinë.
[71] Glasnik Muzeja Kosova i Metohije X, str. 305-344, 1970, Prishtinë.
[72] Gjurmime albanologjike, nr. 1-2, f. 143-153, 1970, Prishtinë.
[73] Gjurmime albanologjike, nr. 1-2, f. 326-333, 1970, Prishtinë.
[74] Gjurmime albanologjike, nr. 1-2, f. 347-349, 1970, Prishtinë.
[75] Zbornik Filozofskog Fakulteta, str. 165-199, 1970, Prishtinë.
[76] Rilindja, 31 dhjetor 1969 - 1, 2 janar 1970, Prishtinë.
[77] Glasnik Muzeja Kosova i Metohije X, str. 489-492, 1970, Prishtinë.
[78] Rilindja, 12. 02. 1970, Prishtinë.

e Deçanit në Kosovë është ruajtur një numër i madh dokumentesh turke, ku bëjnë pjesë: fermane, berate, huxhete, teskere, temesuqe, bujurulldi, fetva, tapi etj. Midis këtyre dokumenteve, autorët kanë zgjedhur dhe botuar 13 fermane dhe një berat. Autorët theksojnë se dokumenti më i vjetër (nr. 1) është lëshuar në korrik të vitit 1506, ndërsa ai i fundit (nr. 14) rrjedh nga viti 1649. Në punim, pas hyrjes, është dhënë përkthimi i këtyre dokumenteve, pastaj teksti i deshifruar, shtypur me alfabetin arab në makinë shkrimi si dhe faksimilet e një numri të tyre. Në fund, është dhënë edhe fjalorthi i termave që përmenden më shpesh në këto dokumente.

Një punim tjetër gjithashtu mjaft i vlefshëm të cilin do ta prezentojmë këtu është *"Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit"*. Autori thekson se gjatë punës së tij gjurmuese në Stamboll, përveç veprës Tehayyulat, e cila përmendet si vepra e parë e shkruar e Naimit, kishte gjetur edhe katër vepra të tjera të tij të botuara, shkruar turqisht.

Ai përmend këtu se kishte shfrytëzuar veprën e Bursali Mehmed Tahirit: *Osmanlı müellifleri* (*Shkrimtarët osmanë*) dhe pohon se vepra e parë e botuar e Naimit është *Gramatika e persishtes sipas metodës së re*, botuar në Stamboll më 1871. Për këtë vepër, autori ofron edhe disa shënime të shkurtra. Në vazhdim, jep të dhëna edhe për vepra të tjera të Naimit: *Ihtiraat ve keşfiyyat* (*Shpikjet dhe zbulimet*), botuar në Stamboll më 1881. Në të njëjtin vit, dr. Kaleshi thotë se Naimi boton veprën tjetër me titull *Fusul-i erbe'a* (*Katër stinët*) dhe *Tehayyulat* (*Ëndërrime*). Këtë të fundit, autori e ka paraqitur me tituj të vjershave, ashtu si e ka dhënë edhe vetë Naimi. Dr. Kaleshi thekson se ndër të gjitha veprat e Naimit, të shkruara turqisht dhe persisht, kjo është më e rëndësishmja. Një tjetër vepër turqisht të Naimit të cilën autori e përmend në këtë punim është *Përkthimi i kapitullit të parë të Iliadës* (*Ilyada Eser-i Homer*). Në fund të punimit, autori përmend edhe një vepër tjetër të Naimit, që mban titullin persisht *Sahanan-i ber güzide*. Kaleshi thotë se megjithë përpjekjet nuk kishte arritur ta gjente këtë vepër duke shtuar se edhe titulli i veprës është i pakuptimtë.

Rëndësi të veçantë ka po ashtu edhe studimi i autorit me titull *"Turski uticaji u tvorbi reči u albanskom jeziku"*. Këtë punim të tij

autori e nis me konstatimin se në fund të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV, turqit, duke depërtuar gradualisht në Ballkan, aty sjellin një fe të re, një sistem të ri social e shtetëror, institucione të reja, një kulturë të re orientale dhe gjithashtu një gjuhë të re. Autori thekson se jeta gati pesëqindvjeçare e popujve ballkanikë nën qeverisjen osmane ka lënë një gjurmë të dukshme në të gjitha fushat e jetës të popujve ballkanikë. Por askund, pohon autori, ai ndikim nuk ishte aq i madh sa ishte në gjuhë. Për këtë arsye, thotë autori, studimi i turcizmave në gjuhët ballkanike nuk është me rëndësi primare vetëm për nga aspekti filologjik, por edhe në aspektin kulturoro-historik dhe atë sociologjik. Në hyrje të punimit të tij, autori jep një pasqyrë mbi punimet shkencore në këtë fushë, duke filluar me F. Mikloshiç-in e tutje. Kaleshi thekson se shumë kërkime janë bërë në gjuhën serbokroate, veçanërisht pas shfaqjes së dy fjalorëve të turçizmave, nga A. Škaljić dhe Knežević. Për meritat e tyre në këtë fushë, autori nuk i lë pa i përmendur edhe A. Xhuvanin dhe E. Çabejin. Duke u marrë me vite me grumbullimin e turcizmave nga letërsia popullore dhe ajo e shkruar dhe duke i regjistruar ato nga gjuha popullore, autori kishte mbledhur material të pasur të cilin do ta shtrojë në një punim të madh. Ai thotë se punimi nuk do të jetë thjesht një fjalor turcizmash, por edhe trajtimi i tyre shkencor: fonetik, morfologjik, semantik, kronologjik, stilistik, e veçanërisht etimologjik. Në këtë punim, autori është përpjekur të trajtojë ndikimin e gjuhës turke në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe.

Punimi, pas hyrjes, ndahet në katër pjesë. Pjesa e parë trajton ndikimin e gjuhës turke në formimin e emrave, nëpërmjet prapashtesës së shumësit -ler/-lar, prapashtesës së deminutivit -xhik, si dhe me anë të prapashtesave: -li, xhi/çi, -llëk, pastaj nëpërmjet prapashtesave të persishtes: -hâne, -dâr, (i)stân, -dân, -vân (bân).

Pjesa e dytë trajton formimin e mbiemrave në mënyra vijuese: disa mbiemra të turqishtes përdoren në gjuhën shqipe pa kurrfarë prapashtesash, pastaj formimi i mbiemrave, të derivuara nga emrat e gjuhës turke, duke ua shtuar prapashtesat e shqipes: -shëm, -të, -ur, -un; prapashtesa mohuese e turqishtes -sëz, formimi i mbiemrave me anë të shtimit të prapashtesave të persishtes -kâr dhe -man/-men, prapashte-

sës turke -li, dhe krejt në fund kompozitat, të formuara nga një fjalë turke dhe një tjetër shqipe.

Pjesa e tretë flet për formimin e foljeve në forma vijuese: foljet denominale, të derivuara nga emrat e gjuhës turke me prapashtesën e shqipes -ue, formimi i foljeve me formantin grek -is(ë), formimi i foljeve me formante -os(ë), -it(ë) dhe me formantin e përbashkët të turqishtes e greqishtes –dis(ë) (-di+isa). Në fund të kësaj pjese, autori jep edhe disa kompozita, të formuara nga masdari i arabishtes apo participi (pjesorja) aktiv dhe pasiv duke i shtuar foljen ndihmëse të gjuhës shqipe "me ba", "me u ba" dhe "me qenë", siç haset në gjuhën turke "lanet etmek", në shqip "me ba lanet", "hazır olmak" - "me u ba hazër".

Pjesa e katërt trajton formimin e ndajfoljeve. Fillimisht, vihen në dukje ndajfoljet e gjuhës turke të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe dhe përdoren pa ndonjë prapashtesë, pastaj ndajfoljet e derivuara me anë të prapashtesave të shqipes: -të, -thi, -isht, -shëm dhe në fund ndajfoljet me prapashtesën turke -çe, e cila, thekson autori, u bë shumë produktive në gjuhën shqipe. Në fund të punimit, autori jep disa sqarime dhe përfundime.

Në vitin 1971 prof. Kaleshi boton katër punime të reja: *"Profesor. dr. Alois Schmaus"*,[79] *"Dokumenta nga arkivi i Vjenës mbi Lidhjen e Pejës* (bashkautor me Ismet Dermakun)",[80] *"Burimet lidhur me studimin e Sami Frashërit"*[81] dhe *"Nji burim turk mbi kryengritjen e shqiptarëve më 1909-1912"*.[82]

Në punimin *"Dokumenta nga arkivi i Vjenës mbi Lidhjen e Pejës"* autori fillimisht pohon faktin historik se pas Lidhjes së Prizrenit manifestimi më i rëndësishëm politik i shqiptarëve të Kosovës dhe përpjekja më e madhe për krijimin e një organizate tëë gjerë politike e ushtarake për mbrojtjen nga aspiratat e vendeve fqinje ishte Lidhja e Pejës, e mbajtur nga 26-30 janar 1899. Autori thekson se megjithëse

[79] Gjurmime albanologjike, nr. 1, f. 87-89, 1971, Prishtinë.
[80] Vjetari i Arkivit të Kosovës IV-V, f. 149-206, 1971, Prishtinë.
[81] Buletini i Fakultetit Filozofik, VIII, f. 35-52, 1971, Prishtinë.
[82] Gjurmime albanologjike (seria e shkencave historike), nr. 1, f.197-234, 1971, Prishtinë.

kjo ngjarje e rëndësishme ka pasur jehonë të madhe në shtypin e vendeve ballkanike dhe evropiane, asaj deri më sot i është kushtuar shumë pak hapësirë në historiografinë shqiptare. Autori, midis tjerash, këtë e arsyeton me mungesë të materialeve të botuara arkivore. Këtu, ai ofron përkthimin e një numri dokumentesh nga Arkivi i Vjenës në lidhje me ngjarjen në fjalë.

Në vitin 1972 autori boton gjashtë punime në periodikun e kohës. Ato janë: *"Ndikimet orientale në tregimet popullore shqiptare"*,[83] *"Dr. Ivan Božić, Doba Balšića, Zeta u despotovini Vladina Crnojevića"*,[84] *"Türk folklor ve etnografya bibliografyasi"*,[85] *"Prizrenac Mahmud Paşa Rotul, njegova zadužbina i vakufname* (në bashkautorësi me Ismail Erenin)",[86] *"Andrej Andrejević, Aladža Džamija u Foči"*[87] dhe *"Osmanlı imperatorluğunda sosyalist basımın başlangıçları"*.[88]

Në vitin 1973 dr. Kaleshi boton dy punime në periodikun shqiptar. Ato janë: *"Pertev Nail Baratev, Türk folkloru"*[89] dhe *"Rreth artikullit tim "Kosova nën pushtimin turk", që u botua në monografinë "Kosova"*.[90]

Në vitin 1974 janë botuar katër punime të dr. Kaleshit, që të gjitha në gjuhën turke: *"Şemsettin Sami Fraşerinin siyasi görüşleri"*,[91] *"Arnavutçada Osmanlıca-Türkçenin ekleri"*,[92] *"Türkler gelişmiş bir uygarlığı zenginliktir"*[93] dhe *"Arnavut öykülerinde doğunun etkileri"*.[94]

Në vitin 1976, vit kur edhe ndërroi jetë dr. Hasan Kaleshi, janë botuar gjashtë punime të tij. Le t'i përmendim radhazi: *"O strukturi*

---

[83] Buletini i Muzeut të Kosovës X, f. 9-51, 1972, Prishtinë (rezyme në gjuhën angleze).
[84] Glasnik Muzeja Kosova i Metohije XI, str. 364-366, 1972, Prishtinë.
[85] Glasnik Muzeja Kosova i Metohije XI, str. 382-384, 1972, Prishtinë.
[86] Starine Kosova VI-VII, str. 23-65, 1972/73, Prishtinë (rezyme në gjuhën frenge).
[87] Starine Kosova VI-VII, str. 261-263, 1972/73, Prishtinë.
[88] Tan, nr. 123-133 (dt. 24. 2. 1972 – 24. 4. 1972), f. 7, 1972, Prishtinë.
[89] Çevren, 1973, Prishtinë.
[90] Rilindja, 14. IV. 1973, f. 11.
[91] Çevren, no. 2, 1974, Prishtinë, s. 14-22.
[92] Çevren, no. 4, 1974, Prishtinë, s. 26-32.
[93] Tan 27, 4, 1974, Prishtinë, s. 11.
[94] Çevren, no. 3, 1974, Prishtinë, s. 10-25.

stanovništva Kosovskog vilajeta u drugoj polovini XIX veka”,[95] *“O seobama Srba sa Kosova krajem XVII i početkom XVIII veka, etničkim promenama i nekim drugim pitanjima iz istorije Kosova”*,[96] *“XV Asırda, XVII, Asrın Nihayetine kadar Yugoslav topraklarında şark Medeniyeti”*,[97] *“Roli i shqiptarëve në letërsitë orientale”*,[98] *“Të përpiqemi për një afirmim sa më të madh të shkencës kosovare”* (intervistë me Q. Mehmedin)[99] dhe *“Islamkundliche Abhandlungen – Hans Joakim Kissling zum 60. Geburtstag Gevidmet Von Seinen Schülem, Dr. Rudolf Trofenik, München, 1974”*.[100]

Pas vdekjes së dr. Hasan Kaleshit, janë botuar edhe disa punime të tij. Në vitin 1980/81 është botuar një punim i tij shumë i çmuar që mban titullin *“Kur’ani kryevepër e letërsisë arabe”*.[101]

Në vitin 1995 botohet punimi i tij *“Faik Konica dhe marrëdhëniet e tij me Austro-Hungarinë”*, ndërsa në vitin 2003 botohen edhe katër punime të tij, të përkthyera në gjuhën shqipe. Ato janë: *“Dorëshkrimet arabe në Jugosllavi”*,[102] *“Gjendja e monumenteve islame të Kosovës në vitet e pesëdhjeta të shekullit njëzet”*,[103] *“Mahmud Pasha Rrotulla nga Prizreni, përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”*[104] dhe *“Veziri i madh Koxha Sinan Pasha - përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”*.[105]

---

95 Obeležja III, 1976, Prishtinë, str. 108-132.

96 Obeležja IV, 1976, Prishtinë, str. 193-216.

97 Çevren, no. 9, s. 13-36, no. 10, s. 23-41, 1976, Prishtinë.

98 Seminari i kulturës shqiptare për të huaj, 2/1976, Prishtinë (boton Fakulteti Filozofik).

99 Bota e re, nr. 5-6 (prill), 1976, f. 7, Prishtinë.

100 Çevren, no. 2, 1976, Prishtinë, s. 147-151.

101 Ky studim mjaft i gjerë dhe shumë i vlefshëm është botuar fillimisht në revistën Edukata islame dhe atë në katër vazhdime. Shih: Edukata islame, 27/1980, Prishtinë, f. 64-75; Edukata islame, 28-29/1980, Prishtinë, f. 27-35; Edukata islame, 30/1981, Prishtinë, f. 66-72 dhe Edukata islame, 31/1981, Prishtinë, f. 49-55. Më vonë, ky punim është botuar në tërësi edhe në monografinë *Kur’ani kryevepër* nga dr. Feti Mehdiu. Shih: Dr. Feti Mehdiu, *Kur’ani kryevepër*, Prishtinë, 1992, f. 77-125.

102 Edukata islame, 70/2003, Prishtinë, f. 55-72 (përktheu Q. Morina).

103 Edukata islame, 76/2005, Prishtinë, f. 75-90 (përktheu Q. Morina).

104 Edukata islame, 81/2006, Prishtinë, f. 151-190 (përkthyen: Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti).

105 Edukata islame, 82/2007, Prishtinë, f. 95-140 (përkthyen: Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti).

Në këtë shkrim tonin kemi dhënë një prezentim të mbi njëqind punimeve të dr. Hasen Kaleshit, të botuara në periodikun shkencor në Kosovë, duke i paraqitur disa prej tyre në formë përmbledhëse.

Siç u pa më lart, punimet e dr. Kaleshit janë mjaft të larmishme, të shkruara në disa gjuhë: shqip, serbisht e turqisht. Ato trajtojnë tema nga më të ndryshmet: historike, gjuhësore, letrare etj.

Së fundi, dëshirojmë të theksojmë se opusi krijues i dr. Kaleshit meriton një qasje gjithëpërfshirëse, e pa dyshim se shënimi i 90-vjetorit të lindjes për nder të profesorit të ndjerë është një nismë mjaft e qëlluar për t'i dalë hakut këtij orientalisti të shquar shqiptar të shekullit të kaluar.

Mr. Jahja Hondozi

THE CONTRIBUTION OF PROF. DR. HASAN KALESHI TO SCIENCE IN KOSOVA

(Summary)

Much has been written about the life and work of Hasan Kaleshi, including a whole monograph. As a matter of fact, writing about such a distinguished figure, as was dr. Kaleshi, is not an easy thing to do, taking into consideration the volume of his work. Dr. Kaleshi was a true scholar, who contributed to the affirmation of Albanian science and its presentation in the region and further.

يحيى هوندوزي

المساهمة العلمية للاستاذ الدكتور حسن كالشي في الدوريات العلمية في كوسوفا

(خلاصة البحث)

قد نشر حتى الآن عن حياة وأعمال الدكتور حسن كالشي العديد من المقالاتæ حتى دراسة كاملة و في الحقيقة الكتابة عن شخصية بارزة كما كان الدكتور كالشي ليست مهمة سهلة مع الأخذ في الاعتبار أبعاد وحجم مساهمته العلمية .

و كان د. حسن كالشي عالما حقيقيا الذي ساهم مساهمة ثمينة في تعزيز العلوم الألبانية وعرضها في المنطقة وأماكن أخرى.

Dr. Islam Hasani

INVESTIMET NË PARTNERITET SIPAS PARIMEVE ISLAME

Sistemi ekonomik Islam është i njohur për investimet në partneritet me pjesëmarrje në rrezik dhe fitim. Ndër konceptet më të njohura të kësaj natyre janë: *"Mudaraba"* dhe *"Musharaka"*, të cilat do të diskutohen në vijim.

Mudaraba

"Mudaraba" është një kontratë e definuar si ndarje e humbjes dhe fitimit PLS "Profit and Loss Sharing", e cila përdoret nga individë, kompani dhe bankat Islame për investime në partneritet. Është një kontratë shumë e rekomanduar për financime, por një gjë është e ditur se implementimi i saj kërkon konsolidim të përpjekjeve dhe besueshmëri në partneritet për të pasur suksesin e dëshiruar. Termi *"Mudaraba"* rrjedh nga fjala "*El-Darb fil-erd*" e përdorur në Kur'an, që do të thotë të bësh një udhëtim. Quhet kështu sepse në shumicën e rasteve punë-

torit i kërkohet të bëjë udhëtime, si pjesë e punës së tij për ta realizuar qëllimin dhe plotësimin e projektit biznesor.[1]

"... udhëtojnë përmes tokës dhe detit duke kërkuar të mirat e Allahut." *(el-Muzemmil: 20)*

Është e qartë se fjala "*daraba"* është përdorur për të treguar udhëtim prej një vendi në tjetrin, apo për të bërë një udhëtim për qëllime tregtie, duke kërkuar të mirat e Allahut.

Fjala tjetër që përdoret për qëllim të njëjtë si "*Mudaraba"* është "*El-Kirad*" apo "*El-Mukarada*". Fjala "*kard"* dhe "*mukarada"* burojnë nga fjala "*karada"* që do të thotë për të ndarë apo shkëputur. Quhet kështu për arsye se në praktikë për të formuar këtë kontratë, ai që siguron kapitalin e ndan një pjesë të kapitalit të tij për të përdorur nga mudaribi (ndërmarrësi) në projektin biznesor me qëllim të gjenerimit të fitimit për t'u ndarë mes tyre. Të dy këto terme janë përdorur për qëllimin e njëjtë, dallimet në përdorim janë varur prej vendit dhe rajonit. "*Mudaraba"* është përdorur nga populli i Irakut, kurse "*Mukarada"* është përdor nga populli i Hixhazit.[2]

Përshkrimi i "*Mudaraba*" sipas *medhhebeve* (shkollave juridike)

Për nga përshkrimi se çka përmban në vete kjo kontratë, dijetarë të ndryshëm që u përkasin të katër "*medhhebeve"* (shkollave juridike) kanë dhënë definimet e tyre që nuk kanë dallime përmbajtësore. [3]

- **Malikijët: "**mudaraba" është një agjenci për tregti duke dhënë paranë e gatshme për një pjesë të fitimit.

[1] M. Fahim Khan, *Comparative Economics of Some Islamic Financing Techniques* (Jeddah: Islamic Research and Trainign Institute, 1991), 19-20.

[2] Joni Tamkin Borhan & Che Zarrina Sa'ari, "The Agent-manager's Conduct of Mudarabah Contract in Islamic Transactions", Brenda Librit, *Islamic Finance: The Challenges Ahead*, editor: Nafis Alam & Bala Shanmungam, (Serdang: University Putra Malaysia Press, 2007), f. 59.

[3] INCEIF, *Shariah Rules in Financial Transactions* (Kuala Lumpur: INCEIF, 2009), f. 275

- **Shafiijët:** "Mudaraba" është një marrëveshje në të cilën një pronar i jep kapitalin një punëtori që tregton më të dhe në fund ndahet fitimi.
- **Hanbelijët:** "Mudaraba" është një kontratë në të cilën një person e jep kapitalin e tij te një ndërmarrës, në mënyrë që të ndahet fitimi sipas marrëveshjes së tyre paraprake.
- **Hanefijët:** "Mudaraba" është një partneritet me pjesëmarrje në profit, në të cilën kapitali është i siguruar nga njëra palë kurse puna apo ekspertiza nga pala tjetër duke ndarë fitimin sipas marrëveshjes paraprake.

Edhe pse përshkrimi i "mudaraba"-s nga katër shkollat juridike është pak i ndryshëm, të gjitha e drejtojnë te e njëjta çështje. Mendimi apo përshkrimi nga Hanefijët është marrë si definicion më gjithëpërfshirës krahasuar me mendimet tjera dhe përdoret për përshkrimin e kësaj kontrate në shumicën e vendeve, ku praktikohet bankimi Islam.

Ekzistojnë shënime se në fund të shekullit të 8-të, bota Islame ka poseduar modele shumë të sofistikuara të financimit duke i kombinuar kapitalin dhe eksperiencën. Prandaj, kapitali i të pasurve nga radhët e myslimanëve ishte transferuar te ndërmarrësit në mënyrën më efikase. Në shekullin e 10-të, evropianët e kanë huazuar këtë formë të partneritetit nga bota Islame atëherë kur ata filluan të bëjnë tregti me vendet e botës Islame dhe ishte koha kur edhe Spanja ishte nën udhëheqjen e myslimanëve. Koncepti mbeti i njëjtë por është quajtur me emra të ndryshëm që kishin kuptim të njëjtë sikurse "*mudaraba"* në origjinal. Në Itali është quajtur "*accomendatio"*, në Angli "*sleeping partnership"*, në Gjermani "*wederlegginge"*, etj.[4]

[4] Murat Cizakca, *Acomparative Evolution of Business Partnerships: The Islamic World and Europe with Special Reference to Ottoman Archives* (Leiden: E.J. Brill, 1996), 19.

Legjitimiteti i "Mudaraba"-së

Legjitimiteti i "*Mudaraba"-së* mbështetet në Kur'an, Sunnet dhe në konsensusin e dijetarëve.

Edhe pse nuk ka ndonjë ajet Kur'anor, i cili flet drejtpërdrejt për lejimin e "mudaraba"-së, ekzistojnë ajete që në mënyrë indirekte tregojnë për lejimin e "mudaraba"-së. Për shembull, "Të tjerët udhëtojnë në tokë duke kërkuar mirësitë e Zotit...." . Disa komentues të Kur'anit e interpretojnë këtë ajet në kuptimin, "ata të cilët udhëtojnë për qëllim tregtie duke synuar fitime të lejuara, përfshirë edhe ata që punojnë me kapital të të tjerëve duke ndarë fitimin e bërë" që përshtatet me konceptin praktik të "mudaraba"-së.

Mbështetja e kësaj kontrate nga sunneti mund të ndahet në dy kategori. E para, ekziston evidencë që Pejgamberi a.s. ka punuar në konceptin e kësaj kontrate para dhe pas ardhjes së shpalljes. Dhe kategoria e dytë janë thëniet e Pejgamberit a.s. në lidhje me këtë kontratë, po ashtu edhe pëlqimet e tij rreth praktikimit të kësaj forme të biznesit. Shokët e Pejgamberit a.s. e kanë përdorur këtë formë të koftraktimit ndërmjet vete për financim të projekteve tregtare dhe Pejgamberi a.s. e ka miratuar këtë formë kontraktimi.

Konsensusi i juristëve myslimanë është se "Mudaraba" është e lejuar dhe nuk ka ndonjë kundërshtim rreth legjitimitetit të saj. Kjo kontratë është njëra ndër kontratat më të rekomanduara nga dijetarët për t'u përdorur nga bankat Islame për investime kapitale në partneritet dhe financime të projekteve të ndryshme, por përdorimi i saj mbetet i paktë për arsye të ndryshme që do të përmenden në vijim.[5]

[5] Ibid

Elementet dhe kushtet e "Mudaraba"-së[6]

Elementet e "Mudaraba"-së sipas shumicës së juristëve myslimanë janë:

1. Palët e kontratës – (Rabul mal & Mudarib);
2. Përmbajtja e kontratës – (kapitali, puna dhe profiti) dhe
3. Forma (oferta dhe pranimi)

Kushtet e "Mudaraba"-së

Pasi që "mudaraba" duhet t'i plotësojë kushtet në aspektin ligjor, ka edhe kushte tjera për të filluar implementimi i "mudaraba"-së. Në "mudaraba" kapitali i financimit duhet patjetër të jetë në para të gatshme për fillimin e projektit që mund të jetë në fusha të ndryshme, investime kapitale, tregti, bujqësi, etj, dhe në fund të projektit prapë llogaritet në para të gatshme dhe ndahet përqindja e caktuar në fillim të kontratës. Por, ka raste kur edhe një pasuri e patundshme apo e tundshme (vlerë jo-monetare) mund të konsiderohet si kapital për "mudaraba".

AAOIFI ka pranuar mendimin se edhe kapitali jo-monetar mund të konsiderohet si kapital financues nëse merret çmimi i tregut për vlerësimin e pasurisë. Vetë pasuria duhet të jetë pjesë e projektit. **Një shembull:** Nëse një person A i ka 15 vetura për shitje, ai i ofrohet personit B dhe i ofron një kontratë që nëse arrin t'i shesë këto vetura margjina e fitimit ndahet në 50:50. Në këtë rast kapitali i projektit është kapital jo-monetar.

Ky standard është më gjeneral dhe nuk i përkrah disa mendime që nuk lejojnë kapital tjetër përveç parasë si kapital investues.

[6] Islamic Shari'ah Research Academy for Islamic Finance, *Islamic Financial System: Principles and Operations*, (Kuala Lumpur: Pearson Custom Publishing, 2012), f. 250.

Llojet e "Mudaraba"-së

"Mudaraba" e palimituar

"Mudaraba", në të cilën kapitali i dorëzohet udhëheqësit të projektit pa i caktuar se në çfarë biznesi, vendi, metode, kohe dhe mënyre të investohet.

Investitori nuk ka të drejtë të ndërhyjë në menaxhim të projektit, por ka të drejtë që të informohet për mbarëvajtjen e projektit dhe nëse dyshon se nuk punohet sipas projekt propozimit të bërë në fillim nga ndërmarrësi atëherë investitori ka të drejtë të kërkojë verifikimin e gjërave dhe nëse vërtetohet devijimi i projektit nga marrëveshja e bërë në fillim atëherë mund të kërkojë ndërprerjen e punës dhe kompensim të dëmeve të shkaktuara.

"Mudaribi" (ndërmarrësi i projektit) ka të drejtë të praktikojë çdo gjë për realizimin e projektit të rënë dakord mes tyre si dy partnerë përveç hyrjes në borxh për zotërinë pa lejen e tij.

Kjo lloj kontrate zakonisht bëhet mes bankës dhe klientëve, të cilët hapin llogaritë e tyre në banka Islame. Sipas kësaj marrëveshjeje, klienti është investitori ndërsa banka është ndërmarrës i projektit dhe klienti e autorizon bankën që të punojë në projekte që i vlerëson rentabile pa i kushtëzuar se ku të investohet.[7]

"Mudaraba" e limituar

Sipas standardeve të AAOIFI, "Kontrata në të cilën furnizuesi i kapitalit i limiton veprimet e udhëheqësit të projektit në një vend të caktuar apo të ndonjë lloj i veçantë i investimeve por nuk mundet t'i ndërhyjë në mënyrën e udhëheqjes dhe operacionet e projektit. Në këtë kategori koha dhe shuma e mjeteve për investime duhet të caktohet në fillim, ndërkaq ndërprerja e parakohshme nuk lejohet. Në këtë kategori bëhet marrëveshje mes bankës dhe klientit, banka si investitor, ndërsa klienti si ndërmarrës i projektit, ku dihet shuma e investimit dhe koha e implementimit të projektit. Por, mund të bëhet edhe në

[7] Ibid, 251.

anën tjetër klienti si financues (depozitor) për një projekt të caktuar, ku dihet shuma dhe koha për investim. Kjo llogari në bankat Islame quhet "Llogari specifike për investime".[8]

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Mudaribit (ndërmarrësit)

- Ndërmarrësi i projektit është person i besuar të "Rabul-mal" (investitori) dhe është përgjegjës të ndërmerr projektin në mënyrën më të mirë.
- Sipas AAOIFI (**Accounting Auditing Of Islamic Finance Issue**):
- Investimi në të gjitha fushat të cilat janë të lejuara, profitabile dhe të realizueshme.
- Kryerja e punëve nga ai personalisht apo caktimi i dikujt nëse është e nevojshme.
- Zgjedhja e vendit për investim që janë me rrezikshmëri më të vogël.
- Ruajtja e fondeve apo depozitimi i tyre nëse e kërkon nevoja për shkak të sigurisë.

Çështjet në implementim

- Kontrata hyn në fuqi menjëherë pas marrëveshjes dhe nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët
- Kjo kontratë është jo-detyruese, mund të ndërpritet në mënyrë unilaterale (të njëanshme) nga secila palë përderisa nuk ka filluar implementimi i saj.
- Nëse puna ka filluar atëherë kjo kontratë bëhet detyruese për të dyja palët dhe asnjëra nuk mund të tërhiqet para kohës së rënë dakord në fillim.
- Gjithashtu koha e implementimit duhet të specifikohet dhe nuk mund të ndërpritet.

[8] Muhammad Imran Ashraf Usmani, *Meezan Bank's Guide to Islamic Banking*, (Karachi: Darul-Ishaat, 2002),f.98.

Musharaka

Definimi i fjalës "Musharaka"

Në aspektin gjuhësor fjala "Musharaka" rrjedh prej rrënjës së foljes "*shereke"* që do të thotë për të ndarë. Nganjëherë kjo fjalë përdoret edhe si synonim i termit "*el-shirka"*. Kjo e fundit, "*el-shirka"* bazuar në literaturën klasike ka kuptim më të gjerë sesa "*musharaka"*. "*El-shirka"* përfshin në vete "*Shirkatul mulk"* që do të thotë pronësi e përbashkët e një pasurie të caktuar dhe "*shirkatul akd"* që ka kuptimin e partneritetit në biznes si rrjedhojë e një kontrate të përbashkët. Porse, termi "*Musharaka"* ashtu siç përdoret në financat moderne ka kuptimin e partneritetit në biznes dhe i takon një partneriteti kontraktues.[9]

Juristët kanë dhënë disa shpjegime rreth kuptimit terminologjik për "Musharaka"[10].

Hanefijet: "Musharaka" është një kontratë partneriteti mes partnerëve në kapital dhe në fitim.

Shafiijet: "Musharaka" është një konfirmim i të drejtave të dy apo më shumë njerëzve rreth një pasurie të caktuar.

Hanbelijet: "Musharaka" është shkrirja e të drejtave dhe liria për të përdorur, që nënkupton, disa partnerë i shkrijnë të drejtat e tyre dhe disa autorizohen për të përdorur pasurinë e njëri-tjetrit.

Malikijet: Lejimi apo autorizimi i njërit partner për të bërë transaksione me pasurinë në partneritet dhe në të njëjtën kohë mban të drejtën për të bërë transaksione me të njëjtën pasuri.

Nga shpjegimet e përmendura rreth domethënies së "musharaka" është e qartë se shumica e dijetarëve e definojnë atë në kuptimin më të gjerë të "shirka". Shpjegimi i dijetarëve që i takojnë shkollës juridike Hanefite janë më të afërta me llojin e kontratave të një partneriteti modern. Ky shpjegim i përshtatet më shumë konceptit të "musharaka" të aplikuar në kohën e tashme, ku fitimet ndahen në përqindje sipas

[9] Razali Hj Nawawi, *Islamic Law on Commercial Transactions,* (Kuala Lumpur: CT Publications, 1999), f156-157.

[10] Zainal Azam Abdul Rahman ed, "Shariah Rules in Financial Transactions" (text book for students), (Kuala Lumpur: INCEIF, 2009), f. 310-312.

marrëveshjes paraprake, ndërsa humbja ndahet në proporcion me kapitalin e investuar. Në "musharaka" të gjithë partnerët kontribuojnë me kapital dhe kanë të drejtën e përfshirjes në menaxhim por nuk janë të obliguar. Dijetarët mund të kenë ndonjë dallim rreth formës, kushteve të aplikimit dhe detajeve të ndryshme, por të gjithë pajtohen për ligjshmërinë e saj.[11]

Ligjshmëria e "musharaka"-së

Ligjshmëria e "musharaka"-së si një kontratë partneriteti ka mbështetje në Kur'an, sunnet dhe në konsensusin e juristëve myslimanë.

Janë disa ajete Kur'anore që citohen për mbështetje të konceptit të "Musharaka"-së, njëri prej tyre është ajeti Kur'anor, që inkurajon ndihmën e njëri-tjetrit dhe bashkimi i aktiviteteve për qëllim të mirë:

"Ndihmoni njeri-tjetrin në drejtësi dhe devotshmëri". *(El-maida 2)*

"... me të vërtetë ka partner në biznes që e mashtrojnë njëri-tjetrin, përveç atyre që kanë besuar dhe punojnë punë të mira, por të tillë janë pak... *(Sad: 24)*

Për mbështetje nga sunneti, transmetohet nga Ebu Hurejra se Pejgamberi a.s. ka thënë në një *"hadith kudsi":*

"Unë jam i treti në partneritet përderisa nuk ka mashtrime, nëse njeri prej partnerëve e mashtron tjetrin unë tërhiqem nga ai partneritet."

Pejgamberi a.s. në shumë raste ka aprovuar praktikimin e "musharaka"-së dhe në një rast ka thënë: *"Dora e Zotit është me ata dy partnerë përderisa ata nuk e mashtrojnë njëri-tjetrin".*

Kushtet dhe elementet e "Musharaka"-së

Elementet e "Musharaka"-së përfshijnë: renditjen e fjalive (ofertën dhe pranimin), palët kontraktuese (dy apo më shumë palë në kontraktim) dhe lënda e kontratës (kapitali dhe puna). Kontraktimi konsiderohet i plotë nëse palët kanë shprehur qëllimin e partneritetit, palët

[11] Saad Abdul Sattar Al Harran, *Islamic Finance: Partnership Financing*, (Kuala Lumpur: Pelanduk Publications, 1993), f. 75.

kontraktuese duhet të jenë persona kompetentë apo duhet të jenë të autorizuar për veprim. Lënda e kontratës që është kapitali duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Kapitali për pjesëmarrje duhet të jetë në para të gatshme, ari, argjend apo kundërvlera e tyre, në këtë aspekt nuk ka mospajtime mes dijetarëve.
- Kapitali mund të përbëhet nga mallra të tregtisë, pasuri, pajisje, etj. Gjithashtu mund të jetë edhe në formë të pasurive të paprekshme, siç janë, patente, të drejtat për biznes apo prodhim dhe të ngjashme duke i vlerësuar ato në kundërvlerë me para të gatshme sipas asaj që partnerët pajtohen.

Llojet e "musharaka"-së

Ekzistojnë disa klasifikime të *"musharaka"-së* të bëra nga juristët duke u bazuar në qëllime të ndryshme. Bazuar në kushtet e partneritetit duke pasur parasysh të drejtat dhe obligimet e partnerëve, se a kanë apo nuk kanë ata të drejta të barabarta në shfrytëzimin e kapitalit dhe ndarjen e fitimit *"musharaka"* ndahet në dy lloje: *"inan"* (partneritet me aksione të pabarabarta) dhe *"mufavada"* (partneritet me aksione të barabarta). Detajet e këtyre dy llojeve të *"musharaka"-së* janë si në vijim:

***A. Inan* (partneritet me aksione të pabarabarta)**

Kjo kontratë do të thotë dy apo më shumë persona janë të përkushtuar për të paguar aksione të caktuara në kapital, e cila do të përdoret në tregti dhe fitimi do të ndahet mes tyre sipas përqindjes së caktuar për të cilën janë pajtuar. Kjo nuk kërkon barazi në investime dhe secili nga partnerët mund të jenë pronarë të aksioneve të ndryshme dhe të pabarabarta në partneritet. Gjithashtu nuk është e kushtëzuar barazia e statusit personal apo shpërndarjes së fitimit dhe përgjegjësive mes partnerëve.

Në këtë lloj të *"musharaka"*, secili nga partnerët konsiderohet agjent apo përfaqësues i tjetrit në veprime që kanë të bëjnë me kapitalin dhe transaksionet e kompanisë. Edhe një karakteristikë e partne-

ritetit në këtë kategori është se partnerët në biznes mund të veprojnë si agjent apo përfaqësues të të drejtave të njëri-tjetrit por jo edhe si garantues. Kjo do të thotë se asnjëri prej partnerëve nuk mund të garantojë detyrimet e partnerit tjetër, dhe nuk mund të futet si garantues edhe me kapitalin e partnerëve.

***B. Mufawada* (Partneritet me aksione të barabarta)**

Në këtë lloj të "*musharaka"*, secili partner ka aksione të barabarta me ato të partnerëve të tij në kapital, profit dhe liri të veprimit. Barazia në investim, status personal dhe ndarja e profitit dhe detyrimeve është kusht i kësaj kategorie. Ekzistojnë mendime dhe shpjegime të ndryshme nga dijetarë të ndryshëm lidhur me kompetencat dhe detyrimet e partnerëve, dhe përderisa kërkohet barazi në të gjitha aspektet është pak e komplikuar dhe jo shumë praktike për t'u aplikuar në transaksionet moderne.

Bazuar në lëndën e kontratës, "*musharaka"* ndahet në tri lloje[12]:

a) Nëse lënda e kontratës (investimi) është në formë të parave të gatshme ajo quhet "*shirkatul emwal"*, ku të gjithë partnerët investojnë një shumë të parave në një ndërmarrësi komerciale.
b) Nëse lënda e kontratës (investimi) është në formë të kontributit me punë fizike ajo quhet "*shirkatul amal"*, ku të gjithë partnerët ndërmarrin të punojnë në një projekt apo shërbim klientëve dhe të gjitha të ardhurat e gjeneruara ndahen mes tyre sipas përqindjes së rënë dakord pa marrë parasysh sa ka kontribuar secili partner.
c) Nëse lënda e kontratës (investimi) është reputacion dhe besueshmëri, ky partneritet quhet "*shirkatul vuxhuh"*, në të cilën palët blejnë produktet me pagesë të shtyrë dhe i shesin ato me pagesë të menjëhershme. Fitimi i bërë ndahet sipas marrëveshjes paraprake.

[12] Nabil A. Salih, *Unlawful Gain and Legitimate Profit in Islamic Law*, second edition (London: Graham & Trotman, 1992), f. 113.

Rregullat bazike të *"Musharaka"-së*

"Musharaka" është një marrëdhënie e themeluar mes dy palëve përmes një kontrate të përbashkët. Prandaj, të gjitha elementet kryesore të një kontrate të rregullt duhet të plotësohen, ndërkaq përveç tyre ekzistojnë kushte të cilat vlejnë vetëm për *"musharaka"*, siç janë: ndarja e fitimit, pjesëmarrja në humbje, menaxhimi në partneritet dhe ndërprerja e kontratës para përfundimit të biznesit.

Ndarja e fitimit

Për përqindjen e ndarjes së fitimit mes partnerëve duhet të dihet në fillim të marrëveshjes para se të hyjë në fuqi kontrata, nëse nuk është caktuar kjo përqindje atëherë kontrata nuk është e plotë sipas rregullave të *Sheriatit*. Përqindja e fitimit për secilin partner duhet të ndahet në proporcion me akumulimin e fitimit, nuk është patjetër të ndahet sipas përqindjes së kapitalit të investuar.[13] Dijetarët e shkollave juridike kanë dhënë mendime rreth përqindjes për ndarjen e fitimit, Shafiijet dhe Malikijet janë të mendimit se përqindja e ndarjes së fitimit duhet të jetë përqindje e shumës se investuar, ndërsa Hanefijet dhe Hanbelijet janë të mendimit se përqindja e ndarjes së fitimit mund të jetë e ndryshme nga përqindja e investimit duke u bazuar se njëra palë mund të kontribuojë edhe me eksperiencë edhe në menaxhim. Dhe ky i fundit është mendim më i përshtatshëm dhe më bashkëkohor, me të cilin edhe punohet në ditët e sotme.

Një gjë është shumë me rëndësi rreth ndarjes së fitimit, nuk duhet të jetë shumë e caktuar si pagesë në një kohë të caktuar për asnjërin partner duke u bazuar me shumën fillestare të investimit. Për shembull, nëse personi A dhe Personi B kanë hyrë në partneritet dhe janë pajtuar që personi A duhet të marrë 1000 euro si pagesë mujore apo tremujore në emër të aksioneve të tij në biznes ndërsa shuma tjetër i

[13] Abbas Mirakhor & Iqbal Zaidi, "Profit and Loss Sharing Contracts in Islamic Finance", ins. *Handbook of Islamic Banking* eds. M. Kabir Hassan & Mervyn K. Lewis (Massachusetts: Edward Elgar, 2007), f.51.

takon personit B, ky partneritet nuk i plotëson kushtet e partneritetit sipas rregullave të "musharaka"-së dhe është i paligjshëm. Ngjashëm me këtë, nëse ata janë pajtuar që personi A të marrë 10 për qind të vlerës së kapitalit të tij të investuar, kontrata është e pavlerë. Baza e ligjshme për ndarjen e fitimit është ndarja e një përqindje të paracaktuar e fitimit të realizuar në biznes.

Pjesëmarrja në humbje

Ndërmarrësia në biznes nuk është çdoherë fitim por ndodh edhe të ketë humbje. Në rast të përfundimit të projektit me humbje të gjithë dijetarët janë të pajtimit se secili partner duhet të bartë humbje në bazë të përqindjes së investuar. Nëse njëri partner ka investuat 30 për qind, patjetër të bartë humbje 30 për qind, as më shumë e as më pak, çdo marrëveshje ndryshe nga kjo kontratë sipas kritereve që ka "musharaka" është e paligjshme.

Menaxhimi në "musharaka"

Në këtë ndërmarrësi biznesi të gjithë partnerët kanë të drejtë të marrin pjesë në menaxhim dhe të punojnë në projekt pasi që të gjithë kanë kontribuar me kapital për këtë biznes. Ekziston mundësia që partnerët të pajtohen që vetëm njëri prej tyre të udhëheqë menaxhimin dhe asnjëri prej tyre nuk merr pjesë në udhëheqje. Në këtë rast, partnerët pasivë kanë të drejtën në fitim dhe përqindja e fitimit që kanë të drejtë ta marrin nuk mund ta kalojë përqindjen e investimit në projekt pasi që ata nuk janë aktivë në biznes por mund të jetë më e vogël sesa përqindja e investimit.

Ndërprerja kontratës në "*musharaka*"

Fillimisht biznesi i filluar në konceptin e *"musharaka"-së* supozohet të zgjasë aq sa janë pajtuar në fillim të gjithë partnerët, por ekzistojnë situata kur njëri dëshiron ta ndërpresë partneritetin për arsye të ndryshme. Nëse njëri prej partnerëve dëshiron ndërprerjen ndërsa par-

tnerët tjerë dëshirojnë të vazhdojnë me biznes kjo duhet të rregullohet me marrëveshje të dyanshme. Partnerët që dëshirojnë të vazhdojnë me projekt i blejnë aksionet e personit i cili dëshiron ndërprerjen e punës, sepse ndërprerja apo dalja e njërit partner nga biznesi nuk i obligon edhe tjerët ta ndërpresin partneritetin e filluar mes tyre. Partneriteti sipas konceptit të "*musharaka*"*-së* mund të ndërpritet para kohe në ndonjërën prej këtyre rasteve.

A. Secili partner ka të drejtë ta ndërpresë partneritetin në çdo kohë pasi t'i ketë informuar partnerët për këtë vendim. Në këtë situatë, nëse asetet e partneritetit janë në para të gatshme ato ndahen ndërmjet partnerëve, ku secili merr përqindjen e rënë dakord para fillimit të partneritetit. Por, nëse asetet nuk janë në para të gatshme partnerët mund të pajtohen në shndërrimin e tyre në para të gatshme, duke i shitur ato apo duke i ndarë asetet ndërmjet vete. Nëse ka mospajtim ndërmjet partnerëve se si të veprohet me asetet, të shndërrohen në para të gatshme duke i shitur ato apo të ndahen ashtu si janë, atëherë përparësi do të ketë ndarja e aseteve sepse pas ndërprerjes së partneritetit në "musharaka" të gjitha asetet janë në pronësi të përbashkët dhe bashkëpronari ka të drejtë të kërkojë ndarjen e tyre dhe askush nuk mund ta detyrojë partnerin t'i shes ato. Porse, nëse asetet nuk mund të ndahen, siç janë makineritë e ndryshme atëherë ato duhet të shiten dhe të ardhurat nga shitja ndahen mes tyre.

B. Nëse ndonjëri prej partnerëve vdes, kontrata e partneritetit e bërë me të duhet të ndërpritet. Trashëgimtarët e tij në këtë rast kanë të drejtën e tërheqjes së aksioneve nga biznesi apo të vazhdojnë me kontratë të re në konceptin dhe kushtet e njëjta.

C. Nëse ndonjëri prej partnereve bëhet i paaftë për veprim, qoftë paaftësi psikike apo fizike që e ndalon atë të veprojë në transaksione komerciale atëherë kontrata me të llogaritet e përfunduar.

"Musharaka" si një produkt financiar

"Musharaka" është e aplikueshme në modele të ndryshme të financimit, disa prej tyre janë si në vijim.

Financimi i projekteve

"Musharaka" është njëra prej modeleve që mund të përdoret për financim të projekteve të ndryshme, me theks të veçantë kur investimi vjen nga palë të ndryshme. Rregullat dhe kriteret për financimin e këtij grupi të projekteve janë ato që u diskutuan në nëntitullin e ndërprerjes së kontratës.

Financimi i një transaksioni të vetëm

Koncepti i financimit sipas "musharaka"-së mund të përdoret për financimin e një transaksioni të vetëm. Ky instrument mund të përdoret për financim të importit dhe eksportit. Një importues bën një kërkesë nga financuesi apo banka për të financuar importin e dëshiruar në një transaksion të vetëm bazuar në këtë koncept. Atëherë, hapet një LC (Letter of Credit) letër-kredi me një margjinë fitimi duke përdorur formën e "musharaka"-së, pasi që produktet e importuara të dalin nga porti, procedohet me shitjen e tyre duke ndarë në fund fitimin e arritur sipas përqindjes së rënë dakord në fillim të marrëveshjes. Në këtë rast, financuesi apo banka ka në pronësi përqindjen e financuar të mallrave të importuara. Ky transaksion ka një kohëzgjatje të caktuar dhe nëse mallrat e importuara nuk janë shitur deri në kohën e caktuar atëherë importuesi mund ta blejë përqindjen e pronësisë nga financuesi duke u bërë pronar i vetëm i tyre. Shitja e tyre duhet të bëhet me çmim të tregut apo çmim të rënë dakord mes palëve në ditën e shitjes, kurrsesi nuk duhet të ketë çmim të paracaktuar në kohën e marrëveshjes para se të futen në kontratën e musharaka.[14]

[14] Abdul Rahman, 2009. f. 313.

Ngjashëm me këtë, ky koncept i financimit mund të përdoret edhe për financimin e eksportit. Një eksportues ka një kërkesë eksporti çmimi i të cilit është i ditur paraprakisht dhe mund të bëhet një llogari fitimi që është një gjë e lehtë për kalkulim edhe për financuesin-bankën dhe fitimi duhet të ndahet bazuar në përqindjen paraprakisht të rënë dakord. Financuesi për të siguruar veten nga ndonjë neglizhencë e klientit-eksportuesit duhet të vendosë kushte që eksporti duhet të bëhet nga eksportuesi sipas marrëveshjes dhe nëse ka ndonjë neglizhencë përgjegjësinë për këtë duhet ta bartë eksportuesi. Nëse ndodhin humbje për shkak të neglizhencës apo keqpërdorimit të eksportuesit humbjet i bart vetë eksportuesi, por nëse ndodhin humbje për arsye tjera jo të neglizhencës apo keqpërdorimit të eksportuesit atëherë edhe financieri merr pjesë në humbje sepse koncepti i bashkëpunimit është koncept partneriteti.

Financimi i kapitalit punues

Ky koncept i financimit mund të përdoret edhe për financimin e kapitalit punues të ndonjë biznesi, i cili është në veprim dhe kjo mund të bëhet në këtë mënyrë. Pasi që financimi në "musharaka" mund të jetë edhe diçka tjetër përveç parave të gatshme, ky rregull duhet të merret në konsideratë në këtë veprim. Kapitali i biznesit duhet të vlerësohet në pajtueshmëri të dy palëve, ndërkaq vlera e biznesit trajtohet si kapital investues për palën që kërkon financim, ndërsa shuma e investuar nga financuesi-banka si kapital investues për pjesën e mbetur. Marrëveshja e këtij partneriteti bëhet për një kohë të limituar si për shembull disa muaj apo një vit. Të dy palët pajtohen për përqindjen që i takon financuesit, e cila nuk e kalon përqindjen e investimit sepse financuesi nuk punon për këtë biznes. Në përfundim të kohës, të gjitha asetet e biznesit, likuide dhe jo-likuide vlerësohen përsëri dhe fitimi ndahet në përqindjen e rënë dakord në fillim. Edhe pse ka mendime se fitimi nuk mund të caktohet përveç nëse të gjitha asetet janë shndërruar në para të gatshme, në aspektin e sheriatit nuk ka ndonjë ndalesë specifike nëse vlera e aseteve është caktuar në pajtueshmëri me të dyja palët.

Dr. Islam Hasani

INVESTMENT PARTNERSHIPS ACCORDING TO ISLAMIC PRINCIPLES

(Summary)

The Islamic economic system is well-known for investment partnerships based on the principle of profit and loss sharing. Mudaraba and Musharaka are among the most distinguished concepts of this nature.

Mudaraba

Mudaraba is a contract based on the principle of profit and loss sharing. It is used by individuals, companies and Islamic banks for investment partnerships. It is a contract, which is highly recommended for financing, but its implementation requires consolidated efforts and trust in the partnership.

The word “mudaraba” is derived from the Arabic term darb fi al-ard, which means those “who journey through the Earth seeking the bounty of Allah”. It is called so because the mudarib is requested to travel as part of his job (in order to realize his objectives and implement the business project).

د. إسلام حسن

الاستثمار بالشراكة على مبادئ إسلامية

(خلاصة البحث)

ومن المعروف النظام الاقتصادي الإسلامي مشهور بالاستثمار في الشراكة مع المشاركة في المخاطر والأرباح و من بين المفاهيم الأكثر شعبية من هذا النوع هي "المضاربة" و " المشاركة" التي سيتم مناقشتها أدناه.

المضاربة

"المضاربة" هو عقد يعرف بأنه تقاسم الربح والخسارة والذي يستخدم من قبل الأفراد والشركات والمصارف الإسلامية على الشراكة للاستثمار و هو عقد مفضل لتمويل و من المعروف أن تنفيذه يتطلب توحيد الجهود والثقة في الشراكة لتحقيق النجاح المنشود æ مصطلح "المضاربة" مشتق من كلمة "الضرب في الأرض" المستخدمة في القرآن ما يعني القيام برحلةæ يسمى هكذا لأنه في معظم الحالات يتتطلب من الموظف السفر كجزء من عمله لتحقيق الهدف و اتمام المشروع.

ABDU-RR-RRAHMAN BEDEVĪ* - FILOZOF

Abdu-rr-Rrahman Bedevī-u, duke e prezantuar kolosin e orientalistikës Carl Brockelamnn-in në "Fjalorin Enciklopedik të Orientalistëve", pyeste kush është ai që ia del mbanë pa veprën "Historia e letërsisë arabe" në pesë vëllime, kurse ne tani pyesim kush është ai që ia del mbanë në Lindje të studiojë filozofinë perëndimore, më saktësisht ekzistencializmin, e të mos shërbehet me veprat e Bedevī-ut, apo cili është ai që dëshiron të dijë rreth orientalistikës dhe orientalistëve e të mos shërbehet me "Fjalorin Enciklopedik të Orientalistëve", dhe athua ka studiues në Orient që merret me studimin e tesavufit e të mos e konsultojë veprën "Historia e tesavufit" të Bedevī-ut.

Abdu-rr-Rrahman Bedevī-u (1917-2002) konsiderohet ndër profesorët egjiptianë më të shquar dhe më produktivë të shekullit XX. Lirisht

* Shkrimi i emrave arab dhe i titujve të veprave në arabisht është bërë duke u bazuar në transkriptimin e alfabetit arab sipas një pasqyre, e cila do të prezantohet menjëherë pas parathënies.

mund të thuhet se ka qenë një personalitet enciklopedik. Veprat autoriale dhe përkthimet e Bedevī-ut kalojnë numrin njëqind e pesëdhjetë. Nga disa studiues të filozofisë arabe konsiderohet filozofi i parë ekzistencialist egjiptian. Ishte i ndikuar nga disa ekzistencialistë evropianë e sidomos nga filozofi gjerman, Martin Hiedegger.

Bedevī-u shkollën fillore e kreu në vendlindje në Farskur, kurse të mesmen në Giza. Në vitin 1934 përfundoi nivelin e dytë në Shkollën as-Se'idijjeţ, një ndër shkollat më të njohura të sistemit bashkëkohor të Egjiptit. Në Universitetin e Kajros u regjistrua në 1934 në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Filozofisë. Gjatë studimeve ishte bursist në Gjermani dhe Austri. Në Kajro u kthye në vitin 1937. U diplomua në vitin 1938 në Departamentin e Filozofisë.

Pas diplomimit Bedevī-u zgjidhet asistent dhe në të njëjtën kohë vazhdoi studimet pasuniversitare e më pas edhe ato të doktoraturës në Universitetin e Kajros, atëkohë quhej Universiteti Mbreti Fuād. Bedevī-u për tezë doktorate pati Epokën ekzistencialiste, të cilën e mbrojti më 29 maj 1944. Gjatë mbrojtjes së tezës shkrimtari i njohur egjiptian Taha Husejn thotë: "Për herë të parë po shoh një filozof egjiptian".

Bedevī-u karshi gjuhës arabe fliste frëngjishten, gjermanishten, italishten, latinishten, greqishten dhe spanjishten. Pra, ishte një intelektual me plot kuptimin e fjalës.

Karriera akademike e Bedevī-ut:

Në vitin 1945, menjëherë pas mbrojtjes së doktoratës zgjidhet profesor asistent në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Kajros. Në vitin 1950 kalon në Universitetin Ajnu Shems (dikur Universiteti Ibrahim Pasha), në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Filozofisë. Në vitin 1959 zgjidhet profesor i rregullt. Nga viti 1956 e deri në vitin 1958 ishte këshilltar për kulturë dhe drejtor për arsim në Legatën egjiptiane në Bern të Zvicrës.

Pas Revolucionit të 23 korrikut të vitit 1962, familjes së Bedevī-ut iu mor e gjithë prona dhe detyrohet të migrojë në Francë. Nga viti 1947 deri në vitin 1949, Bedevī-u punoi profesor në Universitetet e Libanit.

Nga shkurti e deri në maj të vitit 1967, punoi në Institutin për Studime Islame në Sorbonë, Universiteti i Parisit. Prej vitit 1967 e deri në vitin 1973 në Universitetin e Bengazit në Libi. Nga viti 1973 e deri në vitin 1974 në Universitetin e Teheranit në Fakultetin për Studime Islame. Në vitin 1974 u transferua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Teheranit. Aty ligjëroi lëndët, filozofi bashkëkohore, logjikë dhe tesavufin. Punoi edhe në Universitetin e Kuvajtit. Më në fund karrierën e tij akademike e përfundoi në Paris.

Aktivitetet politike të Bedevī-ut:

Bedevī-u nga viti 1938-1940 ishte anëtar i Partisë së Rinisë së Egjiptit. Prej vitit 1944-1952 anëtar i Këshillit të Lartë i Partisë së Re kombëtare dhe u zgjodh në mesin e pesëdhjetë anëtarëve të këshillit kushtetues. Në vitin 1953 ky këshill u autorizua për të hartuar kushtetutën e re të Egjiptit. Ky projekt përfundoi në gusht të vitit 1954. Por, kjo kushtetutë u la pas dore dhe u zëvendësua me Kushtetutën e vitit 1956.

Në vitin 2000 Bedevī-u botoi kujtimet e tij në një vepër autobiografike voluminoze në dy vëllime me rreth 768 faqe. Botimi i kësaj vepre pati jehonë në qarqet intelektuale egjiptiane. Përkundër faktit që Bedevī-u qe akuzuar mjaft shumë, megjithatë shumë intelektualë e konsideronin simbol të inteligjencies egjiptiane. Ai e pati sulmuar ashpër regjimin e Egjiptit, sidomos Xhemal Abdu-n-Naser-in. Bedevī-u gjatë një ligjërate e pati komentuar varrimin e Naserit, duke thënë se kjo është diç e natyrshme dhe se pjesëmarrja në një masë aq të madhe në përcjelljen e xhenazes së Naserit, është më tepër një rutinë e masës, sesa një dashuri që kanë pasur ndaj Naserit.

Rreth asaj se, a ishte Bedevī-u në armiqësi me revolucionarët apo jo, al-Levendi thotë se, ai në fillim ishte caktuar këshilltar për kulturë në Legatën e Egjiptit në Zvicër. Konflikti i tij me revolucionarët erdhi pikërisht kur u fillua me shpifjet kundër intelektualëve.

Akuza të regjimit për të shpallur personalitet e shkencës si elementë të huaj në Egjipt, atëkohë ishte dukuri e zakonshme. Kështu ndodhi edhe me Sa'd Zaglulin, të cilin e shpallën bashkëpunëtor të britanikëve, kurse

simbolin e letërsisë bashkëkohore arabe Taha Husnin e shpallën shërbëtor të agjenturave të huaja, ndërsa studentët akuzonin njëri-tjetrin për spiun.

Dr. Se'īd al-Levendī në parathënien e monografisë kushtuar Abdu-rr-Rrahman Bedevī-ut thotë se, ai zgjodhi të jetojë i vetmuar larg vendlindjes në Paris. Jetoi në hotelin e njohur "Lutetia", në po të njëjtin hotel ku më parë pati banuar profesori i tij Taha Husejni. Sipas al-Levendī-t, Bedeviu për tetëmbëdhjetë vjet rresht, nga viti 1980 deri në fillim të vitit 1998, jetoi i vetmuar në Paris. Pikëpamjet ekzistencialiste evropiane patën ndikuar thellë në personalitetin e Bedevī-ut, në lirinë individuale larg ndikimeve hyjnore. Al-Levendī pohon se Bedevī-u ndërkohë u korrigjua dhe se pati marrë për obligim mbrojtjen e Islamit karshi të pafeve, si fe e vërtetë, Islamin fe të kësaj bote dhe të ahiretit.

Një ditë, shkruan Al-Levendi, Bedevī-u i dëshpëruar më thotë se në Perëndim gjithkush i jep të drejtë vetes të flasë për Islamin dhe të përkthejë Kur'anin. Ai vazhdon duke shtuar se e pyeta profesor Bedevī-un se a mos frikësohet Perëndimi nga Islami? Ai, pa hezituar m'u përgjigj: natyrisht se frikësohet edhe atë shumë, duke më thënë, nëse dëshiron argument për këtë, më rekomandoi që t'ua hedh një vështrim librarive përreth dhe më tha se në to do të gjesh me dhjetëra mos edhe me qindra vepra që hedhin helm kundër Islamit. Al-Levendi thotë se Bedevī-u ishte jashtëzakonisht i shqetësuar rreth disa veprave që fyenin islamin, duke përmendur përkthimin e Kur'anit nga kryebashkiaku i Jerusalemit André Chouraqui. Bedevī-u për këtë përkthim thoshte se është turpi i përkthimit dhe i përkthyesve i të gjitha kohëve dhe se ai përkthim është sulm flagrant karshi tekstit të shenjtë të Kur'anit.

Shumë intelektualë arabë habiten, thotë al-Levendi, se si Bedevī-u vazhdoi të mbrojë idenë e ekzistencializmit në njërën anë dhe në anën tjetër të mbrojë Kur'anin dhe Pejgamberin a.s. Bedevī-u për këta kishte këtë përgjigje: vërtet unë që në fillim të karrierës sime intelektuale kam luftuar në dy fronte: kam mbrojtur filozofinë e përgjithshme duke përfshirë këtu edhe filozofinë ekzistencialiste dhe islamin dhe se kam mbrojtur tezën se filozofia ekzistencialiste nuk bie ndesh me Islamin, të paktën në fushën e hulumtimit dhe në historinë e të menduarit të lirë.

Një studiues tjetër i cili është marrë me jetën dhe veprën e Bedevī-ut është edhe Abdu-l-Ḳādir Bin Muhammed al-Gāmidī. Kjo monografi kushtuar Bedevī-ut është mjaft voluminoze dhe është e ndarë në disa kapituj. Autori i kësaj monografie karshi jetës së Bedevī-ut, kryesisht përqendrohet në prezantimin e kontributeve shkencore të Bedevī-ut, duke prezantuar pikëpamjet e tij rreth filozofisë ekzistoncialiste dhe filozofisë në përgjithësi.

Ndër shumë kapituj të kësaj monografie po veçojmë vetëm disa, që sipas mendimit tonë janë më me interes me këtë rast.

Në një kapitull autori i monografisë përqendrohet në mendimin e Bedevī-ut rreth etikës dhe fesë. Një kapitull të veçantë ia kushton pikëpamjeve të Bedevī-ut rreth lirisë, duke vazhduar me një artikull tjetër të titulluar se çfarë kuptojmë me lirinë dhe rruga se si të arrihet deri te ajo. Sipas autorit të monografisë, Bedevī-u lirinë e percepton në të gjitha sferat e jetës, në besim, në qeverisje, në politikë, në legjislacion, lirinë e femrës etj. Në këtë monografi kapitull të veçantë zënë metodat në studimet e doktrinave filozofike. Përcaktimi i Bedevī-ut rreth Ehli Synetit gjithashtu zë një kaptinë të veçantë në këtë monografi. Autori i monografisë prezanton edhe pikëpamjet e Bedevī-ut rreth sektit mu'tezle dhe esh'arite. Një kapitull tjetër u kushton edhe raporteve të Bedevī-ut me tesavufin dhe sufizmin. Ai në këtë kapitull prezantoi pikëpamjet e Bedevī-ut rreth konvergjencave mes misticizmit dhe ekzistencializmit. Pra, është një monografi gjithëpërfshirëse e pikëpamjeve filozofike të Bedevī-ut në pika të shkurtra.

Nga hulumtimet e bëra nëpër literaturë nuk kam hasur në ndonjë studim që është marrë me kontributet e Bedevī-ut rreth prezantimit të filozofisë perëndimore në arabisht dhe kontributeve tjera të shumta të Bedevī-ut.

Në intervistën e Bedevī-ut dhënë revistës "al-Hirs-l-vaṭanijj" të datës 1-10.2002, një muaj para, vdekjes ndër të tjera deklaron: "... heq dorë nga e gjithë ajo që kam shkruar më parë e që në një farë mënyre bie ndesh me besimin dhe me sheriatin". Ajo që bie në sy në këtë intervistë është bindja e Bedevī-ut rreth gjuhës arabe karshi gjuhëve evropiane. Ai lidhur me këtë thotë: "... vërtet unë kam lexuar letërsitë perëndimore

dhe filozofinë perëndimore në anglisht, frëngjisht, latinisht, gjermanisht dhe italisht dhe me plot kompetencë e them se asnjëra nga këto gjuhë nuk të ofron atë që të ofron arabishtja."

Në këtë intervistë Bedev-ïu polemizon me Sartrin, rreth asaj se çfarë është ekzistencializmi. Sipas Bedev-ïut, ekzistencializmi i Sartrit nuk është asgjë tjetër pos një revolucion negativ i dëshpëruar, i cili nuk ia del dot të diagnostifikojë sëmundjen aq më tepër edhe kur ia ofron barnat. Sinqerisht mund t'ju them se gjithë atë që kam prezantuar rreth ekzistencializmit karshi njerëzimit është t'i paraqesim disa aspekte të tragjedisë njerëzore, tragjedi e shprehur me një fjali të vetme: hulumtimi në Zotin.

Bedevï-ut në Fjalorin Enciklopedik të Filozofisë thotë se Sartri në filozofi përdori termin ekzistencializëm por pa filozofi ekzistencialiste.

Bedevï-u intervistën e tij e përfundon me ajetet kur'anore: "Nga unë do t'ju vijë gjithsesi udhëzimi dhe ai që e pason udhëzimin tim nuk do të devijojë dhe nuk do të jetë i pafat. Por, kushdo që i kthen shpinën udhëzimit (Librit tim), do të ketë jetë të mjeruar dhe ne në ditën e kiametit do ta ringjallim të verbër. Ai do të pyes: O Zoti im po pse më ke ringjallur të verbër kur unë i kisha sytë?! (Allahu) i përgjigjet: ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t'i ofruam, ashtu edhe ti je i harruar sot. Kështu Ne e shpërblejmë atë që e tepron në mëkate dhe nuk i beson argumenteve të Zotit të tij, kurse dënimi në botën tjetër do të jetë më i ashpër dhe i përjetshëm". Sureja 20, ajeti 123-126.

Këtë prezantim modest për pikëpamjet e Bedevï-ut po e përmbyllim me një pjesë të shkëputur nga intervista e tij: "Nuk mund ta shpreh atë që është brenda meje nga ndjenja e thellë e pendimit. I jam kthyer Islamit dhe trashëgimisë arabe para më shumë se katër dekadave. Tani e ndiej se kam nevojë për dikë që do të më pastrojë me ujë të pastër që shkëlqen dhe me këtë të rikthehem si mysliman i vërtetë. Vërtet jam penduar te Perëndia dhe ndiej keqardhje për veprat e mia. Kam ndërmend që posa të shërohem, me vullnetin e All-llahut, do të jem një ushtar i denjë në mbrojtje të mendimit islam, në mbrojtje të civilizimit që e ngritën baballarët dhe gjyshërit tanë, civilizim i cili me shekuj shndriti në Lindje dhe në Perëndim. Bedevï-u i sëmurë në shtrat lutet: "Uroj që All-llahu të më japë jetë që të jem në shërbim të Islamit ...".

Sa i përket civilizimit islam, Bedevī-u pohon se është shumë i bindur se civilizimi islam është shpikja më e mirë që ka shpikur mendja njerëzore për shekuj me radhë.

Nga lista e veprave të publikuara në arabisht dhe gjuhë të tjera evropiane, shihet se Bedevī-iu ka kontribuar në shumë fusha, si në historinë e shkencës, në filozofi, në letërsi etj. Bedevī-u vërtetë ishte një enciklopedist i vërtetë andaj edhe hartoi tri enciklopedi. Fjalori Enciklopedik i Civilizimit arab dhe islam, Fjalori Enciklopedik i Filozofisë dhe Fjalori Enciklopedi i Orientalistëve. [1]

Bedevī-iu vdiq në spitalin Naser në Kajro, në mëngjes të datës 25 korrik të vitit 2002, në moshën 85-vjeçare.

Veprimtaria shkencore e Abdu-rr-Rrahman Bedevī-ut

Sipas Mahmūd Emīn al-'Alem, numri i veprave të Bedevī-ut arrin rreth dyqind sosh. Njëri nga botuesit e Bedevī-ut pohon se veprat e Bedevī-ut nga botimi i veprës së parë kushtuar Niçes, e cila është botuar në vitin 1939, kalon numrin 150. Këtë numër të veprave të Bedevī-ut e vërteton edhe nipi i tij Muhsin Bedevī. Muhsini në portalin e tij thotë se numri i veprave të Bedevī-ut nga veprat e botuara dhe të pabotuara janë rreth 150 sosh. Në këtë listë të veprave të Bedevī-ut, përveç veprave të botuara në arabisht, janë përfshirë edhe të gjitha veprat e Bedevī-ut të botuara në frëngjisht, spanjisht, gjermanisht dhe anglisht.

Çfarë është shkruar për Bedevī-un?

1. Monografia: Studime arabe kushtuar Abdu-rr-*Rrahman Bedvī*-un, autor Ahmed Abdu-l-Halīm 'Aṭijjeþ, 2002;
2. Abdu-rr-*Rrahman Bedvī*-u, Doktrina e tij filozofike dhe metodat rreth studimeve të doktrinave të interpretimit dhe kritikës, autor Abdu-l-Ḳādir Bin Muhammed al-Gāmedī, biblioteka arr-Rrushd, Rijāḍ, 2008;

[1] Kjo biobibliografi është pjesë e botimit në shqip e këtij Fjalori Enciklopedik të Orien-talistëve.

3. Bedevī-u filozof ekzistencialist i arratisur në islam, Dr. Se'īd al-Levendī;
4. Gazeta spanjolle 'Almond', artikull kushtuar Bedevī-ut.

Lista e punimeve shkencore të Abdu-rr-Rrahman Bedvī-ut:[2]

a. Lista e publikimeve të Bedevī-ut në arabisht:[3]

- 1939, Nietzsche;
- 1940, at-Turāthu-l-junānijjeţu fī-l-ḥḍāreţi-l-islāmijjeţi: dirāt[un] likibāri-l-musteshriḳine;
- 1942, Schopenhauer;
- 1943, Eflāṭūn;
- 1943, Rebī'u-l-fikri-l-jūnānijji;
- 1944, Aresṭū;
- 1944, Esfāru Childe Harold, Bernë;
- 1944, ad-Dīvānu-sh-sherḳijju lilmuellifi-l-grabijji, Gete;
- 1944, Endīn Fūkijjeţu;
- 1944, Min hajāţi bair: Ashendorf;[4]
- 1945, al-Insābu-l-muḥtāreţ: Gete;
- 1945, az-Zemānu-l-vuxhūhijju;
- 1945, al-Mevtu ve-l-'abḳarijjeţu;
- 1945, Min tārīḫi-l-ilhād fī-lislāmi;
- 1946, Harīfu-l-fikri-l-junānijj;
- 1946, Sheḥṣijāt[un] ḳalaḳaţ[un] fī-l-islāmi;
- 1946, Mirāţu nefsī;
- 1947, Aresṭū 'inde-l-'arabi: dirāseţ[un] ve niṣūṣ gajru menshūreţ[un];
- 1947, al-Muthulu al-aḳlijjeţu al-aflāṭūnijjeţu;
- 1948, Sheǧīdeţu-l-ashḳi-l-Ilāǧī: Rābi'aţ al'Udvijjeţ;

[2] Duke marrë parasysh se veprimtaria e Bedevī-ut është e kozmopolite andaj edhe renditjen e veprave të e kam bërë sipas viteve të botimit pa tentuar të ndajë nëpër fusha. Pos që i kam veçuar ato vepra që janë botuar në arabisht dhe në gjuhë tjera evropiane.

[3] Këtë listë e kam shfletuar në një faqe intreneti e cila përfshinë pjesën dërmuese të veprave të Bedevī-ut, por ndërkohë kam hasur në një informatë se vepra e Bedevī-ut Défense du Coran Contre ses critiques e botuar në frëngjisht në vitin 1997 është përkthyer edhe në arabisht me titullin *Difā*[un] *'ani-l-Ḳurʾāni ḍ* idda munteḳ adejḥ i.

[4] Ashendorf është poet dhe historian i letërsisë gjermane si dhe kritik letrar.

- 1949, Sheṯhātu-ṣ-ṣūfijjeṯi: Ebū Jezid al-Busṯāmī;
- 1950, al-Ishārātu-l-Ilāḫijjeṯu li Ebī Hajān at-Tevhīdī;
- 1950, al-Insānu-l-kāmilu fī-l-islāmi;
- 1952, al-Hikmeṯu al-ḥālideṯu: Muskevejḫ;[5]
- 1952, al-Hūru ve-n-nūru;
- 1953, Aristoteli: Fennu-sh-shi'ri me'a-t-terxhemeṯi-l-'arabijjeṯi-l-ḳadīmeṯi ve ash-shrūhi al-Fārābī ve Ibn Sīnā ve Ibn Rushd;
- 1953, Ḫel jumkinu ḳijāmu aḥlāḳi vuxhudijeṯ;
- 1954, al-Uṣūlu al-junānijjeṯu li-n-neḏrijāti-s-sijāsijjeṯi fī-lislāmi;
- 1954, al-Burḫānu min kitābi-sh-shifāi li Ibn Sīnā;
- 1954, 'Ujūnu-l-hikmeṯi: Ibn Sīnā;
- 1954, Fī-n-nefsi li Arisṭūṭālīs;
- 1955, Eflāṭūn 'inde-l-'arabi;
- 1955, Eflāṭūnijjeṯu al-muhaddetheṯu 'inde-l-'arabi;
- 1958, al-Ḥavārixhe ve-sh-shī'aṯu (ahzābu-l-mu'āreḍeṯu ad-dīnijjeṯu as-sijāsijjeṯu fī ṣadri-l-islāmi) Wellhausen; [6]
- 1958, Muḥterātu-l-hikemi ve-l-mehāsinu-l-kelimi li Ebī al-Vefā al-Mubeshshir bin Fātik;
- 1959, al-Ḥiṭābeṯu, Aristoteli;
- 1959, Meḥṭūṭātu Aresṭū fī-l-'arabijjeṯi;
- 1960, Telḥīṣu-l-ḥaṭābeṯu li Ibn Rushd;
- 1961, Hāzimu-l-Ḳarṭāxhenâ ve neḏerijātu Aresṭū fī-l-blāgaṯi ,e-sh-shi'ri;
- 1961, Dirāsāt[un] fī-l-felsefeṯi-l-vuxhūdijjeṯi;
- 1961, Muel-lefātu al-azālī;
- 1961, Mesrehijjeṯu 'ulemāi-ṭ-ṭabī'aṯi: Friedrich Dürrenmatt;[7]
- 1962, al-Menṭiḳu aṣ-ṣūrâ ve-rr-rrijāḍijj;
- 1962, Festschrift me rastin e shtatëdhjetëvetorit të Taha Husejnit, përgatitur nga studentët e tij nën përkujdesjen e Abd-rr-Rrahman Bedevī;
- 1962, Felsefeṯu-l-'uṣūli-l-vusṭâ;

---

[5] Për më shumë rreth Miskevejḫ-it shih Fjalori enciklopedik i orientalistëve f.?

[6] Për më shumë rreth Julius Wellhausen-it, shih shënimin nr.? në Fjalorin enciklopedik të orientalistëve.

[7] Friedrich Dürrenmatt (1921-1990) njëri ndër dramaturgët më të njohur zviceran i shek, XX. Famën e arriti me dramën e tij Der Besuch der alten Dame (Vizitë zonjës së moshuar), 1956.

- 1963, an-Neḳdu at-tāriḥijju;
- 1963, Felsefeţ-l-haḍareţi: Albert Schweitzer;[8]
- 1963, Fī-sh-shi'ri-lurūbijji;
- 1963, Menāẖixhe-l-behthi-l-'alemijji;
- 1964, Feḍāihu-l-bāṭinjjeţi li Ebī Hāmid al-Gazālī;
- 1964, Mesrehijjātu Lorka, Ursu-d-demmi;
- 1964, Meṣādiru ve tijārātu-l-felsefeţi al-me'aṣireţi fī Fransā;
- 1964, Muṣṭelhātu-l-felsefeţi fil-lugāţi-l-fransijjeţi ve-l-inglizijjeţi ve-l'arabijjeţi, në bashkautorësi me Dr. Ebū al-'Alā 'Afīfī ve Dr. Zekijj Nexhīb Mehmūd ve Dr. Thābit al-Efendī;
- 1964, H̱umūmu-sh-shebābi;
- 1965, Ibn 'Arabijj: hajātuẖu ve medh'ẖebuẖu: Esī Bilātjūs;[9]
- 1965, aṭ-Ṭabī'aţu li Aresṭū;
- 1965, al-Mithālijjeţu al-almānijjeţ;
- 1965, Devru-l-'arabi fī tekvīni-l-fikri-l-ūrūbijji;
- 1965, Don Kishoti;
- 1965, Resāilu Ibn sef'īn;
- 1965, Rūhu-l-haḍareţi-l-arabijjeţi;
- 1965, Rīnīẖ Vīxh: al-Fennu ve-n-nūru ve-l-lehevātu ve miṣru multḳâ ash-sherḳ ve-l-garb;
- 1965, Mesrehijjātu Eugène Ionesco: fetāţ[un] li-z-zevāxhi;
- 1966, al-Vuxhūdu ve-l-'ademu, Sartri;
- 1966, Fennu-sh-shi'ri mine-sh-shifāi li Ibn Rushd;
- 1969, al-Fireḳu al-islāmijjeţu fī-sh-shimāli-l-ifriḳijji mine-l-fet'hi al-'arabijji hattâ al-jevm, Alfred Bel;
- 1969, al-Felsefeţu al-ḳūrināijjeţu ev medh'ẖebu-l-ledhdheţi;
- 1969, al-Medreseţu al-ḳūrināijjeţu;
- 1971, Tārīḥu-l-felsefeţi fī Lībijā, vëllimi i parë, Carneades;
- 1971, Tārīḥu-l-felsefeţi fī Lībijā, vëllimi i dytë, Synesios de Cyrene;
- 1972; at-Te'līḳātu li Ibn Sīnā;
- 1972, Shurūhu 'alâ Aresṭū mefḳūdeţ[un] fī-l-jūnānijjeţi;

[8] Albert Schweitzer (1875-1965) filozof, mjek, njohës i historisë së fesë, muzicient, fizikan i njohur gjerman. Më 1952 morri çmimin Nobel për paqe.

[9] Për Asin Palacios shih: Bedevī, Fjalori enciklopedik i orientalistëve, f. ?

- 1973, Eflāṭūn fī-l-islāmi;[10]
- 1973, Resāil[un] felsefijjeţ[un] li-l-Kenedī ve-l-Fārābī ve Ibn bāxheţ ve Ibn ʿAdī;[11]
- 1974, Ṣevānu-l-hikmeţi li Ebī Sulejmān as-Suxhestānī;
- 1974, Faustus;
- 1975, al-Aḥlāḳu-n-neḏarijjeţu;
- 1975, Tārīḫu-t-tṣavvufi al-islāmijji mine-l-bidājeţi hattâ niḫājeţi-l-ḳarni ath-thānī;
- 1976, Imanuel Kanti;
- 1977, al-Aḥlāḳu;
- 1977, Ṭibā'u-l-hajvāni li Aresṭū;
- 1977, Ṭubūlu fī-l-lejli; Hajāţu Galileo: Brecht;[12]
- 1978, Exhzāu-l-hajvāni li-Aresṭū;
- 1978, al-Ummu-sh-shexhāţu- as-Sejjid Bentley ve ḫādimuḫu Mati: Friedrich Brecht;
- 1978, Menṭiḳu Aresṭū;
- 1979, al-Aḥlāḳu 'inde Kanti;
- 1979, Gates Won Berlichingen, Gete;
- 1979, Hejāţu Latharījū dī Tūrmis;
- 1979, Dirāsātu-l-musteshriḳīne havle ṣihhaţi-sh-shi'ri-l-xhāḫilijji;
- 1979, Felsefeţu-l-ḳānūni ve-s-sijāseţi 'inde Hegel;
- 1979, Muel-lefātu Ibn Ḥaldūn;
- 1979, Med'ḥal[un] xhedīd[un] ilâ-l-felsefeţi;
- 1979, Medhāḫibu-l-islāmijjiīne;
- 1979, Felsefeţul-l-ḳānūni ve-s-sijāseţi: Immanuel Kant;
- 1980, Torquato Tasso,[13] Gete;
- 1980, Hajāţu Hegel;
- 1980, Felsefeţu-d-dīni ve-t-terbijjeţi 'inde Kont;

---

[10] Një grumbull dorëshkrime të Platonit disa origjinale e disa të transmetuara, në shekullin e nëntë dhe në shekullin e dhjetë janë përkthyer në arabisht.

[11] Vepra i kushtohet veprave të filozofëve arabë.

[12] Bertolt Brecht (1898-1956), romansier, tregimtar, poet, dramaturg dhe regjisor i njohur gjerman.

[13] Torquato Tasso (1544-159) shkrimtar dhe poet italian. Kryevepra e tij është "Çlirimi i Jerusalemit". Në këtë vepër autori përshkruan përleshjet e myslimanëve dhe të krishterëve në fund të kryqëzatës së parë gjatë rrethimit të Jerusalemit.

- 1981, al-Luṣūṣu: Friedrich Schiller;[14]
- 1981, Dirāsāt[un] ve nṣūṣ[un] fī-l-felsefeţi ve-l-'lūmi 'inde-l-'arabi;
- 1982, Tārīḥu al-'ālemi, at-terxhemeţu al-'arabijjeţu al-ḳadīmeţu, Paulus Orosius;
- 1982, Wiliam Tell: Friedrich von Schiller;
- 1983, Mevsū'aţul-l-musteshriḳīne;[15]
- 1984, Mevsū'aţul-l-felsefeţi;[16]
- 1984, Ibn Rushdi, sherhu-l-burĵān li- Aresţū ve telḥīṣu-l-burĵān;
- 1985, Ādābu-l-felāsefeţi: Hunejn Bin Is'haḳ;
- 1987, Mevsū'aţu-l-haḍareţi-l-'arabijjeţi-l-islamijjeţi, tre vëllime, në bashkëpunim me një grup autorësh;[17]

---

[14] Friedrich Schiller (1759-1805) poet dhe dramaturg klasik gjerman. Është marrë edhe me histori dhe filozofi. Konsiderohet themelues i lëvizjes së klasikëve në letërsinë gjermane dhe në të njëjtën kohë konsiderohet ndër personalitet më kryesore në historinë e letërsisë gjermane, është personalitet i rangut të Getes.

[15] Rreth Mevsū'aţul-l-musteshriḳīne nuk e shoh të arsyeshme të ndalemi rreth përmbajtjes, ndonëse është i përkthyer i plotë në gjuhën shqipe. Me këtë rast po i prezantojmë në pika të shkurta vetëm dy fjalorët tjerë enciklopedik: Fjalorin enciklopedik të filozofisë dhe Fjalorit enciklopedik të civilizimit islam-arab. Nga lista e veprave të Bedevī-ut jemi ndalur në prezantimin e shkurtë vetëm të këtyre dy fjalorëve enciklopedik, ndonëse për nga pesha që kanë në fushën e botimeve janë të rangut me Fjalorin enciklopedik të orientalistëve të cilin po e prezantojmë në gjuhën shqipe. Me këtë rast do të mjaftohemi vetëm me këtë prezantim modest të këtyre fjalorëve enciklopedik. Po të fillonim që për secilën vepër të Bedevī-ut të shkruanim, qoftë edhe nga një faqe, do të na duhej një vëllim i tërë.

[16] Mevsū'aţul-l-felsefeţi (Fjalori enciklopedik i filozofisë) me autor Abdu-rr-Rrahman Bedevī, i botuar në vitin 1980, është i përfshirë në tre vëllime. Ky fjalor enciklopedik nuk i dedikohet vetëm specialistëve të filozofisë por çdo intelektuali, u dedikohet gjithë atyre që dëshirojnë të kenë informata përmbledhëse për filozofinë dhe doktrinat filozofike.

Në këtë Fjalor enciklopedik Bedevī-u ka përfshirë emrat e shkencëtarëve, e me theks të veçantë të filozofëve të botës islame dhe evropiane, termat filozofikë ose termat që kanë një dimension filozofik. Ajo që duhet theksuar me këtë rast se pjesa dërmuese e materialeve të prezantuara në këtë enciklopedi janë pjesë të shkëputura nga veprat e Bedevī-ut, sidomos nga veprat e historisë.

Një dukuri tjetër që kanë vërejtur kritikët e këtij Fjalori enciklopedik është subjektivizmi i Bedevī-ut. Sipas këtyre kritikëve, kemi materiale që janë prezantuar ndoshta në mësa të madhe e që nuk e kanë vendin në këtë enciklopedi, ndërsa në anën tjetër nuk janë përfshirë materiale që është dashur medoemos të jenë prezantuar. Gjithashtu kritikët ia shohin për të madhe mospërfshirjen e filozofisë dhe filozofëve të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Një metodologji e punës së Bedevī-ut te Fjalor enciklopedik i filozofisë dhe te Fjalori enciklopedik i orientalistëve është burimi në fund të secilit zë. Kujtoj që kjo metodologji e bënë më të besueshëm dhe më bindës autorin rreth informatave që ai i prezanton.

[17] Mevsū'aţul-haḍareţi-l-'arabijjeţi-l-islamijjeţi, në tre vëllime, në bashkëpunim me një grup autorësh, Bedevī-u ka hartuar një Fjalor enciklopedik voluminoze gjithëpërfshirëse. Ky fjalor enciklopedik përfshin trashëgiminë kulturore arabe me fillimin e epokës islame duke përfshirë të gjitha fushat, duke filluar me çështjet fetare, shkencore, sociale, artistike etj.

Enciklopedia është botuar në tre vëllime.

- 1988, Ibn Rushd: Telḥīṣu-l-ḳijāsi li-Aresṭū, seria e trashëgimisë, numri i fashi-kullit 17;
- 1988, John Locke:[18] Risāleţ̧[un] fī-t-tesāmuhi;
- 1993, al-Felsefeţ̧u ve-l-felāsefeţ̧u fīl-haḍareţ̧i-l-'arabijjeţ̧i;
- 1994, al-Edebu-l-almanijju fī niṣfil-l-ḳarni;
- 1994, al-Muāmereţ̧u ve-l-hubbu;
- 1996, T[i]rāxhidijātu, Asholian's;
- 1996, T[i]rāxhidijātu, Sophoclest;
- 1996, Felsefeţ̧u-l-xhemāli ve-l-fenni 'inde Hegel;
- 2000, Sīreţ̧u hjātī;[19]
- 2001. Muhammad, Vepër e Ibn Is'hakut.[20]

Vëllimi i parë i Mevsū'aţ̧ul-haḍareţ̧i-l-'arabijjeţ̧i-l-islamijjeţ̧i është përfshirë në 673 faqe dhe në këtë vëllim janë përfshirë shtatë kapituj.

Kapitulli i parë: Filozofia dhe filozofët në civilizimin arab me autor Abdu-rr-Rrahman Bedevī;

Kapitulli i dytë: Shkenca e kimisë tek arabët, me autor Dr. Fāḍil aṭ-Ṭāī;

Kapitulli i tretë: Shkenca e farmacisë tek arabët, me autor Dr. Fāḍil aṭ-Ṭāī;

Kapitulli i katërt: Shkenca e fizikës tek arabët, me autor Dr. Ahmed Demirdāsh;

Kapitulli i pestë: Botanika tek arabët, me autor Dr. Abdu-s-Selā an-Nuvejḫī;

Kapitulli i gjashtë: Shkenca e gjeografisë tek arabët, me autor Dr. Shākir Ḥaṣāk;

Kapitulli i shtatë: Shkenca e gjeologjisë tek arabët, me autor Dr. 'Alī as-Sekrī.

Vëllimi i dytë i Mevsū'aţ̧ul-haḍareţ̧i-l-'arabijjeţ̧i-l-islamijjeţ̧i është përfshirë në 596 faqe në tetë kapituj.

Kapitulli i parë: Shkenca e usuli dinit, me autor Dr. Hasan Hanefī;

Kapitulli i dytë: Shkenca e suli fik'hut, me autor Dr. Hasan Hanefī;

Kapitulli i tretë: Intelekti ...., me autor Dr. Hasan Hanefī;

Kapitulli i katërt: Kur'ani dhe shkencat kur'anore, me autor Dr. Muhammed Ahmed Ḥalfullaḫ;

Kapitulli i pestë: shkenca e hadithit dhe shkencat tjera të kësaj fushe, me autor Dr. Muhammed Ahmed Ḥalfullaḫ;

Kapitulli i gjashtë: Selefizmi, me autor Dr. Muhammed 'Umāreḫ;

Kapitulli i shtatë : Revolucioni, me autor Dr. Muhammed 'Umāreḫ;

Kapitulli i tetë: Sektet në islam, me autor Dr. Muhammed 'Umāreḫ.

Vëllimi i tratë i Mevsū'aţ̧ul-haḍareţ̧i-l-'arabijjeţ̧i-l-islamijjeţ̧i është përfshirë në shtatë kapituj:

Kapitulli i parë: Jurisprudenca islame, me autor Dr. 'Alī 'Abdul-Ḳādir;

Kapitulli i dytë: Arti luftarak tek arabët para dhe pas periudhës islame, me autor gjeneral Xhemāl Mehfūḍ;

Kapitulli i tretë: Ndikimi i kryqëzatave në botën arabe, me autor Dr. Ḳāsim 'Abduḫu Ḳāsim;

Kapitulli i katërt: Disa aspekte të jetës së përditshme në periudhën e Selāṭ̄n al-Memālīk, me autor Dr. Ḳāsim 'Abduḫu Ḳāsim;

Kapitulli i pestë: Sistemi i qeverisjes dhe administrimit në periudhën e ejubitëve dhe memalikëve, me autor S'īd 'Āshūr;

Kapitulli i gjashtë: Kritika dhe retorika, me autor Dr. Shukrī 'Ajād;

Kapitulli i shtatë: Proza, me autor Muhammed Bedevī la-Meḫjūm;

[18] John Locke (1632-1904) filozof eksperimental, intelektual dhe politikan anglez.

[19] Vepër autobiografike e Bedevī-ut në dy vëllime;

[20] Ibn Is'haku konsiderohet ndër të parë musliman që ka shkruar monografi kushtuar Muhammedit a.s.

- 2004, Drama Jungfrau von Orleans[21] kushtuar një tragjedie romantike: Friedrich von Schiller;

b. Publikime të jashtme:

- 1972, Philosophie et Theologie de l'Islam a l'epoque classique - in Philosophie;
- 1955, Autobibliografia De Ibn Arabi;
- 1964, Le Problème de la mort dans la Philosophie Existentielle;[22]
- 1968, La transmission de la philosophie grecque au monde arabe;
- 1972, Histoire de la Philosophie en Islam - 2 Tomes;
- 1976, Storia Della Filosofia - La Filosofia Medievale (with Anouar Abdel_Malek، Benedykt Grynas، Patrick Hodhart، Jean Pepin), Milano;
- 1979, Quelques figures et thèmes de la philosophie islamique;
- 1981, Milenario de Avicena;
- 1987, Ghazali، La raison et le miracle;
- 1988, Aristotle Aujourdhui;
- 1989, Défense du Coran Contre ses critiques;
- 1990, Défense de la vie du Prophète Muhammad contre ses Détracteurs;
- 1999, Averroès - Ibn Rushd;

Përgatiti:
Isa Memishi

[21] Kjo dramë i është kushtuar një tragjedie romantike, autor Johann Christoph Friedrich von Schiller.
[22] Ky punim ka qenë tezë e doktoratës e mbrojtur në frëngjisht dhe nuk u përkthye fare në arabisht.

Abdel Rahman Badawi – the philosopher

(Summary)

In his presentation of Carl Brockelmann in the Encyclopedia of Orientalists, Badawi acknowledged the importance of his work called the “History of Arabic Literature”, which was written in five volumes. In this paper, we acknowledge the importance of Badawi’s work to those who study western philosophy, in particular existentialism, the importance of the Encyclopedia of Orientalists to those who study Orientalism and Orientalists, as well as the importance of the “History of Tasawwuf” to those who study it.

عبد الرحمن البدوي – فيلسوفا

(خلاصة البحث)

عبد الرحمن بدوي عندما قدم أشهر المستشرقين كارل بروكلمان في"القاموس الموسوعي للمستشرقين" كان يسأل من هو الذي يستطيع تحقيق النجاح دون كتاب "تاريخ الأدب العربي" في خمسة مجلدات ونسأل الآن من هو الذي سينجح في الشرق في دراسة الفلسفة الغربيةæ على نحو أدق الوجودية äÇäaï يستخدم أعمال البدو æÃì من هو الذي يريد أن يعرف أكثر عن الاستشراق و المستشرقين و لا يستخدم "القاموس الموسوعي للمستشرقين" و هل هناك í Ãباحث في المشرق الذي يتعامل مع دراسة التصوف و لا يرجع إلى كتاب "تاريخ التصوف" للبدوي.

NURUDDIN MAHMUDI - STRATEGU I PAPREKSHËM*

Ky sulltan u paraqit në kohën e dobësive të përgjithshme të myslimanëve në të gjitha segmentet e gjendjes së tyre fetare dhe shoqërore. Ishte kjo kohë në të cilën myslimanët gradualisht largoheshin nga burimet e diturisë, kur u pushtuan nga risitë (bidatet) në fe, kur përhapej pabesueshmëria dhe të gjitha llojet e të metave.

Me të vërtetë në historinë tonë islame ekziston një numër i madh i personaliteteve të rëndësishëm dhe të guximshëm, dhe se me siguri një numër i madh i myslimanëve deri më tani nuk ka dëgjuar për emrin e këtij sundimtari të drejtë, i cili ka luajtur një rol të madh, me vullnetin dhe ndihmën e Allahut, në mbrojtjen e fesë tonë të ndritur dhe të fitores së myslimanëve. Ai dhe baba i tij sulltan Imaduddin janë figura me të cilët krenohen ithtarët e Ummetit tonë dhe ata janë simbole të ndritshme të rimëkëmbjes së fesë sonë në kohën kur myslimanët kishin rënë në kriza dhe dobësi të mëdha. Ai gjithashtu kishte përgatitur terrenin për ekspeditat pushtuese të Salahuddin el-Ejubit. Historiani dhe juristi (fakihu) i madh Islamit Ebu Shame, duke krahasuar Nuruddin Mahmudin dhe Salahuddin el-Ejubin thotë: "Në atë periudhë ko hore këta dy ishin sikur dy Omerët (Omer ibn Hattabi dhe Omer ibn Azizi) në periudhën e parë të islamit. Që të dy le t'i shpërblejë Allahu xh.sh. me shpërblimin më të mirë, sepse, me të vërtetë, kanë qenë shembulli më i mirë i sundimtarit që kanë lënë pas vetes përshtypje të

mira. Përparësia e Nuruddinit ndaj Salaudinit qëndron në atë sepse themeluesi i rilindjes islame dhe i të zgjuarit të asaj kohe, arriti që me mençurinë dhe drejtësinë e vet t'i shtyjë masat myslimane në xhihad kundër kryqëzatave në të gjitha anët e shtetit të tij."

Arsimim i plotë

Nuruddini u lind në Bagdad, më 17. Shevall, 511, sipas hixhrit/1117. Baba i tij asokohe ishte udhëheqës i formacioneve ushtarake myslimane, ndërsa pas shpërnguljes në Mosul, u bë administrator i këtij qyteti të vjetër. Kohën e fëmijërisë e kaloi nëpër mesxhide, shkolla dhe oborre mbretërore ku mësonte Kuran, përcillte ligjërata nga hadithet dhe nga gjitha dituri të tjera. U aftësua në kalërim, në gjuajtjen e shtizave dhe me të gjitha llojet e armëve tjera të shkathtësive luftarake. Në këtë mënyrë ai qysh në fëmijëri e arriti një arsimim të plotë: shkencor, fetar dhe ushtarak.

Aktivisht merrej me leximet dhe mësimet e veprave nga sheriati si dhe në mënyrë konsekuente e trasonte traditën e Muhamedit a.s.. Kohën e gjatë e kalonte në adhurimin e Allahut (ibadet) dhe në kryerjen e shumë punëve tjera të mira, shoqërohej me dijetarë dhe besimtarë të vërtetë, dhe të gjitha këto i plotësonte me guximin dhe trimërinë e tij të madhe, me fuqinë fizike dhe me shkathtësitë e mëdha në shfrytëzimin e armëve luftarake.

Ez-Zehebiu thotë: "Nuruddini lexonte shumë, namazet rregullisht i kryente me xhemat, shpesh agjëronte nafile, dallohej për nga karakteristikat e devotshmërisë, asnjëherë nuk ka ekspozuar mendjemadhësi dhe krenari, i kopjonte dijetarët dhe njerëzit e mirë, i respektonte dhe i vizitonte njerëzit e devotshëm." Ibn Esiri për të thotë: "Ka qenë njohës i mirë i drejtimit të shkollës hanefi duke mos ia mbajtur anën vetëm kësaj shkolle juridike, hadithet i mësonte nga dijetarë të njohur të asaj kohe por edhe vetë ua përcillte të tjerëve hadithet."

Shumë shpesh e përshkruante musafin dhe librat tjerë të rëndësishëm, për t'i shitur dhe që nga parat e fituara të ushqehet apo t'i ndaj për lëmoshë. Shembulli më i mirë i modestisë së tij është fakti që dhu-

ratat të cilat i arrinin prej mbretërve, princërve dhe personalitete të tjera, ai i shiste duke mos i mbajtur paratë e fituara për vete por iu linte vakëfeve dhe qëllimeve tjera humanitare.

Në shërbim të popullit

Nurudini ka qenë njëri prej atyre i cili rregullave të sheriatit iu ka përmbajtur me përpikëri, duke mos i shkelur në asnjë moment rregullat e Allahut dhe duke mos i tejkaluar kufijtë e ndaluar, edhe pse në momente të caktuara shumica kanë menduar se është në interes të përgjithshëm që të mos trasohet ndjekja e atyre rregullave. Mjafton të lexohet letra të cilën ia dërgon një besimtar dhe dijetar nga Mosuli, me emrin Omer Mulla, dhe përgjigjen e tij kthyer këtij besimtari. Ky besimtar në letrën e tij shkruan: "Numri i atyre që bëjnë ngatërresa dhe prishin rendin në tokë është shtuar, ndërsa situata kërkon që kjo sa më shpejt dhe në mënyrë sa më efikase të ndalet dhe të rregullohet, kurse kjo mund të rregullohet vetëm me vrasje, burgosje, dhe tortura ndaj atyre që përhapin prishjen e rendit dhe qetësisë."

Sulltani në këtë i përgjigjet: "Allahu i ka krijuar krijesat (njerëzit) dhe atyre iu ka përshkruar ligjin-Sheriatin, dhe Ai më së miri e di se çka është në interesin e tyre dhe nuk na përket neve që t'i shtojmë diçka asaj që Allahu e ka përshkruar. Kush shton diçka, që me të të konsiderojë se Sheriati nuk është i plotë dhe sipas mendjes së tij ai po e plotëson , duhet ta dijë, se po mundohet të tregohet si një trim i madh e që me këtë ai pasqyron një jo kulturë kundruall Allahut. I drejtohem Allahut me lutje që neve por, edhe ty, të na udhëzojë në rrugë të drejtë." Kur i arrin kjo letër këtij besimtari dhe dijetari nga sulltani, ky njeri e tuboi rreth vetes popullin e Mosulit, iu lexoi letrën dhe më pas ju tha: "Vërejeni letrën e besimtarit dërguar sundimtarit dhe letrën e sundimtarit drejtuar besimtarit. Kush në të vërtetë është besimtar i devotshëm??"

Ebu Shame thotë: "Me të vërtetë ai sërish i futi te sundimtarët karakteristikat e drejtësisë, maturisë së harxhimit të kapitalit shtetëror, devotshmërisë dhe largimin nga harami. Biografia e tij ishte bindshëm

më e mira prej të gjithë atyre që jetuan në kohën e tij. I anuloi tatimet dhe tagrat të cilat deri aso kohe iu kishin imponuar popullatës jo vetëm në krahinën e vet, por më vonë mbas angazhimeve personale arriti që këto tatime dhe tagra t'i anulojë edhe në Sham, Xhezire, dhe Egjipt."

Shkaku për t'i anuluar tatimet dhe tagrat e paligjshme, nga ana e këtij sulltani, ishte ligjërata e thurur në vargje e Ebu Osmanit, i cili ankohet për gjendjen e rëndë të qytetarëve për shkak të tatimeve duke ia tërhequr vërejtjen e dënimit për ata që bëjnë padrejtësi. Kjo e kishte frikësuar shumë sulltanin, por edhe ëndrra e ministrit të tij Muvefakuddin el-Kajseranit, i cili kishte pa ëndërr duke ia larë teshat sulltanit. Sulltani e urdhëron që ta shkruajë një vendim me të cilën do të anulohen të gjitha tagrat dhe tatimet ndaj shtetit. Pastaj i thotë: "Ky është komentimi i ëndrrës tënde." Për sqarimin e këtij vendimi ai shkroi dhe i dërgoi në të gjitha qytetet duke urdhëruar që të lexohet haptazi: "Anulimi i këtyre tatimeve është në vend të luftës së juaj kundër armikut dhe mbrojtjes së vendit të juaj, bashkëshorteve dhe fëmijëve të juaj nga pabesimtarët.

Njëra prej dëshmive më të mëdha për drejtësinë e tij është edhe urdhër lëshimi që të formohet një gjyq në të cilën do të gjykohen funksionarët e lartë shtetërorë po që se ata do të veprojnë në mënyrë të padrejtë ndaj nënshtetasve të vet. Ai personalisht merrte pjesë në këto seanca bashkë me gjyqtarë dhe myfti, dhe kurë dera e tij nuk ishte e mbyllur as për të varfër e as për pasanikë. Bisedonte me njerëz të të gjitha shtresave, duke i shfrytëzuar dituritë dhe përvojat jetësore të tyre, dhe në të njëjtën kohë i largonte padrejtësitë nga ata të cilëve u ishte bërë.

Përulja dhe respekti ndaj dijetarëve

Edhe pse shteti i tij për nga territori ishte shumë i madh e po ashtu edhe pozitën të cilën e zinte, ai kohën e gjatë e kalonte duke iu ndihmuar të paaftëve dhe të varfërve, duke i vizituar besimtarët dhe dijetarët duke i përkrahur materialisht që të qëndrojnë në këtë rrugë.

Hafëz Inb Kethiri thotë se ka qenë shumë rigoroz dhe i afërt me princër në punët e shërbimeve zyrtare, ndërsa ata ndaj tij kishin sjellje të një respekti të madh dhe askush nuk guxonte të ulet afër tij e që më parë të mos kërkonte leje për te. Në rast se shkonte tek ai ndonjë dijetar, ai personalisht e priste duke u ngritur në këmbë, e përcillte deri te vendi, ku qëndronte ai ulur dhe me përulje zhvillonte biseda me ta. Ka qenë shumë shpirtmadh ndaj njerëzve të ditur, për ta thoshte: "Ata janë ushtria e Allahut dhe mbas lutjeve të tyre ne i mposhtim armiqtë, ata në bejtul-mall (thesari i shtetit) kanë shumë më shumë hak në pjesën e asaj që iu dhamë. Dhe nëse janë të kënaqur me ato çka iu japim, ajo është e drejta e tyre, ndërsa ne do të jemi të kënaqur nëse për neve ata do t'i luten Allahut."

Pasqyrimi i modestisë së tij ishte edhe kur lëshoi urdhrin që të gjithë hatibët t'u shmangen të gjitha titujve të tij kur ditëve të xhumasë i luten Allahut për të.

Një ditë një njeri kishte ngritur aktakuzë ndaj tij-sulltanit. Ai ia kishte dërguar një letër kadiut që ndaj tij në gjyq duhet të veprojë njëjtë sikur me çdo klient apo palë tjetër. Në kohë të caktuar kishte arritur në gjyq duke qëndruar krah për krah me njeriun i cili e kishte akuzuar. Pas hetimit dhe veprimit dëshmues u vërtetua se akuza nuk ishte e bazuar dhe se mjetet materiale që kundërshtoheshin i takonin sulltanit. Sulltani pas këtij gjykimi tha: "Me këtë njeri erdha që të na gjykoni, në mënyrë që askush të mos mungojë kur do të thërritet në proces gjyqësor pa marrë parasysh pozitën e tij. Ndërsa ne sundimtarët jemi vetëm shërbëtorë të pejgamberit e Allahut, dhe shërbëtorë të sheriatit. Atë që ai na ka urdhëruar me doemos duhet ta zbatojmë, ndërsa nga ajo që na ka ndaluar duhet të largohemi. Unë më së mirë e di që ky

njeri tek unë nuk ka kur njëfarë haku, ndërsa tani para të gjithë juve unë personalisht dëshmojë se i kam fituar të gjitha ato materiale kam dhe se të gjitha po ia fali atij." Ekzistojnë edhe shumë kësi shembuj që më së miri e ilustrojnë modestinë dhe drejtësinë e tij.

Luftërat e kryqëzatave

Kah fundi i shekullit pestë, (të hixhretit) krishterët duke e shfrytëzuar dobësinë e myslimanëve që zhvillohej në të gjitha aspektet e jetës, ata filluan t'i dërgojnë ekspeditat e tyre ushtarake njërën pas tjetrës, me qëllim të okupimit, në rend të parë vendet e Lindjes së afërt me parullën "fitorja e kryqit" dhe "të çlirohet kaburi (varri) i Isait", e pastaj t'i pushtojnë edhe të gjitha vendet tjera të myslimanëve. Thirrjes së kësaj parulle iu përgjigjën me qindra mijëra ushtarë barbarë dhe në mënyra më të neveritshme i pushtuan tokat myslimane, duke i vrarë dhe mbytur myslimanët në mënyra më të tmerrshme dhe, duke ua shkatërruar pasuritë e tyre natyrore. E gjithë kjo bëhej me qëllim të fshirjes së kësaj feje nga sipërfaqja e tokës. Për një kohë shumë të shkurt periodike ata arritën që të okupojnë me qindra qytete myslimane, me ç'gjë kryen krime të cilat historia e njerëzimit deri më tani nuk i kishte parë. Do ta japim një shembull të fillimit të shekullit XI (1098.) kur kryqtarët në Jerusalem therën 70.000 qytetarë myslimanë, të cilit nuk përfshiheshin në formacionet ushtarake. Kleriku Villiam Mur, i njohur si historian i luftërave të kryqëzatave (vdiq më 1185.) duke i përshkruar sjelljet barbare të ushtarëve të krishterë thekson: "Gjithkënd që e kanë takuar e kanë mbytur, pa shikuar moshën, gjendjen fizike, apo gjininë." ("Historia", vëllimi II, fq. 435.). V. Mur, në vazhdim duke e përshkruar gjendjen e qytetarëve dhe të rraskapiturve citon: "Në çdo vend kishin kryer masakra dhe gjakderdhje ashtu që nga gjaku dhe trupi i myslimanëve të masakruar qyteti dukej i lemerishëm deri në atë masë sa që nga ato pamje ushtarëve tanë u binte të fikët... Pasi që kishin vrarë gjithkënd që kishin takuar, udhëheqësve ushtarakë iu ishte bërë me dije se një numër i madh i myslimanëve kishin ikur dhe ishin strehuar në tempullin e shenjtë (Mesxhidul-Aksa

dhe rreth saj) të cilët më pas me ushtri ia mësyn atij vendi. Të gjithë ata që ishin strehuar atje u masakruan duke mos pasur aspak mëshirë ndaj fëmijëve, grave dhe pleqve. Tërë ajo hapësirë ishte vërshuar nga gjaku i myslimanëve..." (kleriku V. Mur, nga burimi i njëjtë fq. 436.) Ky klerik në veprën e njëjtë në një vend tjetër, thekson se numri i myslimanëve të masakruar në hapësirën e oborrit të xhamisë llogaritej në 10.000 veta! Në faqen tjetër thotë: "Ishte bërë më e pamundshme të shikohej në një numër aq të madh të të vdekurve, për derisa në Jerusalem nuk kishte mbetur asnjë vend, që nuk ishte përplot me kufoma të tilla.

Vetë pamja e atyre trupave me koka të prera nuk ishte pamje e vetme që fuste frikë dhe tmerr, por ishte edhe ajo e luftëtarëve të cilët që nga koka e deri në këmbë ishin qullosur me gjakun e myslimanëve."

Pastaj "shenjtëria" e tij, me paturpësi të madhe, duke i arsyetuar këto krime të tmerrshme thotë: "Kjo ishte një gjykim i drejtë nga Zoti që t'i mundim ata të cilët me ritualet e veta që mbështeten në trillime dhe besëtytni e kanë përlyer varrin e Jezuit. Me vdekjen e tyre ata i kanë fshirë mëkatet e veta dhe mënyra e vetme për pastrimin e vendit të shenjtë ishte derdhja e gjakut të tyre."

Sa herë që myslimanët dobësohen për shkak largimit të tyre nga feja e vet dhe shmangies nga xhihadi, pa besimtarët gjithherë vërsulen ndaj tyre me dëshirë që t'i shkatërrojnë dhe t'i fshijnë nga faqja e dheut dhe atë me të gjitha mjetet të lejuara dhe të palejuara duke mos treguar me këtë rast aspak mëshirë dhe ndjenja njerëzore. Ata më së miri i ka përshkruar Allahu xh.sh. në Kuran me fjalët: ***Si ata të cilët nëse ju mundin, nuk përfillin ndaj jush as farefisni dhe as marrëveshje. Ata ju bëjnë lajka me fjalët e tyre, kurse zemrat e tyre kundërshtojnë nga se shumica e tyre janë besëthyes.*** *(Et Tevbe, 8.)* Këto sulme të pamëshirshme njësoj i kanë goditur edhe emirët, të cilët luftonin mes vete dhe shtyheshin për pushtet, por edhe masën tjetër të gjerë të cilët në jetën e tyre të përditshme i trasuan dy drejtime, kënaqjen e epsheve të veta dhe plotësimin e pasionuar të dëshirave të tyre, si dhe dashuria ndaj dynjasë apo tërheqja në vetmi dhe largimi nga të mirat e kësaj bote.

Në të dyja këto raste njerëzimi për disa shekuj është larguar, nga xhihadi dhe ambienti luftarak.

Me xhihad kundër okupatorit

Në ambientin e këtyre çrregullimeve dhe të disfatave të një pas njëshme, roli i një numri të vogël të dijetarëve reformues, ishte shumë i madh dhe i rëndësishëm. Ata xhihadin e udhëhiqnin në disa fusha (ushtarake, fetare, shoqëroro-sociale, morale) me qëllim që masat myslimane t'i kthejnë në vlerat fisnike të fesë së tyre dhe në përcjelljen e synetit të Muhamedit a.s. pejgamberit të Allahut. Përpjekjet e këtyre dijetarëve mbas disa gjeneratave dhanë fryt që rezultoi me një rilindje të fuqishme shkencore, kthimi te syneti burimor dhe vazhdimi i kësaj rruge, me ç'rast u lajmëruan sundues dhe udhëheqës të fuqishëm të cilët duke i çliruar vendet e okupuara myslimane flamurin e xhihadit dhe islamit e ngritën sërish lart. Në mesin e pionierëve të këtyre udhëheqësve ishte Imaduddin Zenki. Ky udhëheqës ushtarak turk ishte administrues i krahinës Mosul (qytet në Irakun e sotëm). Për një kohë shumë të shkurtë ai arriti që t'i bashkojë krahinat më të mëdha të El-Xhezires (krahinë shumë e madhe e cila sot gjendet në veriun e Irakut, Sirisë dhe në jug lindje të Turqisë) i cili pastaj e nisi xhihadin kundër okupatorit krishterë. Shumë kala dhe qytete i rikthej prej armikut, ashtu që pas një sulmi të ashpër, në vitin 1128 u çlirua qyteti Hale (veri të Sirisë). Pas kësaj fitoreje Imaduddin Zenki u bë udhëheqësi i parë ushtarak i cili shumë fuqishëm i kundërshtonte kryqtarët, dhe i cili rreth vetes mund të tubonte një ushtri shumë të madhe me të cilët do ta rrezikonte, pozitën e fort të kryqtarëve që e gëzonin deri më tani në Lindjen e Afërt. Ajo çka i jepte vlera të veçanta Imaduddinit, ishte vendosmëria e tij që të qëndrojë në xhihad dhe luftë kundër pabesimtarëve.

Luftërat e tij kundër armikut zgjatën njëzet vjet, kurse fitorja më e rëndësishme ishte gjithsesi ajo e vitit 539., sipas H., e cila u zhvillua për pushtimin e Rehe-s (qytet në jug të Turqisë) që njëherë ishte kryeqyteti i njërës prej pesë provincave të mëdha të krishtere. Ndërkaq,

vdekja e hershme dhe e papritur atë e zuri derisa e kishte rrethuar qytetin-kështjellë Xhuber në vitin 541. H.

Gjurmëve të babait

Me vdekjen e tij kryqtarët filluan të çlodhen, sepse veç iu kishte hyrë frika për statusin e tyre në Lindjen e Afërt dhe kishin menduar se ai për një kohë shumë të shkurtër do të arrijë t'ua kthejë myslimanëve territoret e humbura si dhe t'i bashkojë ata. Por, ky gëzim i tyre nuk zgjati shumë, sepse Allahu i lartmadhërishëm bëri që djali i tij Nuruddini ta vazhdojë rrugën e babit të vet dhe ta plotësojë misionin e tij madhështor. Ai i pafrikësuar sikurse një luan i ri, i sulmonte kështjellat e tyre duke i pastruar vendet e myslimanëve nga populli kriminel. Flamurin e Islamit më vonë ia dorëzon Salauddin Ejubit.

Me Nuruddinin filloi rikthimi në front

Xhihadi në rrugën e Allahut te sulltan Nurudini, nuk ka qenë një zgjidhje e përkohshme, as parullë e karakterit kalues, me ndihmën e së cilës do t'i arrinte interesat personale, të cilat momentalisht i diktonte situata politiko-ushtarake. Caku themelor i xhihadit të tij ka qenë përgatitja e masës për luftë kundër pa besimtarëve të cilët prej ditës në ditë i pushtonin territoret e myslimanëve. Për shkak të këtij caku madhështor ai u angazhua me tërë përpjekjet e veta, që të mobilizoi gjitha forcat myslimane që i kishte në dispozitë duke i bashkuar edhe sundimtarët e ndarë myslimanë. Ai shumë mirë e dinte se është e pamundur që ta nënshtrojë armikun dhe t'i çlirojë territoret e okupuara vetëm me anën e një beteje. Për këtë arsye ai u shërbye me një taktikë të jashtëzakonshme ushtarake, ashtu siç na prezanton edhe gjenerali dhe eksperti ushtarak Bessam Aseli: "Ndiqte taktikën e shmangies të betejave të mëdha, shërbehej me sulme dhe befasi të vogla por efikase të cilat ishin të drejtuara kah stacionet e vogla ushtarake, kështjella të pambrojtura (vetmuara), apo edhe krahina të vogla me qëllim të ndërprerjes së komunikimit dhe furnizimit me gjëra ushqimore dhe materiale ushtarake. Këto fitore të vogla por konstante kanë luajtur një rol të

madh në rrënimin e moralit luftarak të armikut. Nga dita në ditë ata përjetonin humbje të vogla dhe me këtë edhe humbje në njerëz dhe çdoherë e më tepër përjetonin dëshpërime dhe pikëllime. Kur dëshiruan të përparojnë kah lindja dhe t'i marrin disa qytete egjiptiane, Nuruddini me shpejtësi të madhe nxitoi dhe duke iu thyer komunikimet e rëndësishme i parandaloi në arritjen e këtyre qëllimeve shumë të rëndësishme për ta. Ky ishte edhe një goditje e fuqishme për moralin luftarak të tyre dhe në të njëjtën kohë edhe një dobi e madhe materiale dhe psikologjike, për ushtarët myslimanë..."

Ai veçanërisht pati sukses që me anë të xhihadit në zemrat e myslimanëve të mbjellë ndjenjën se këtë luftë të cilën po e zhvillojnë kundër krishterimit është luftë e bindjes dhe imanit, dhe në këtë mënyrë ai injektoi masën e madhe të luftës shpirtërore në zemrat e ushtarëve myslimanë. Për këtë arsye Ibn Kethiri transmeton se në mesin e krishterëve ishin përhapur zëra se Allahu po i ndihmon Nuruddinit në luftë dhe po e bën atë që të korrë fitore për shkak bindjeve të tij ndaj Allahut dhe për shkak të elanit të myslimanëve në luftë. Krishterët flisnin: "Ekziston fshehtësia mes Allahut dhe Nuruddinit, sepse ai neve nuk po na mund për shkak numrit të ushtarëve të vet dhe shkathtësive të tyre, por me anë të lutjeve, namazeve të natës dhe të bindjeve të veta ndaj Allahut."

Bindja ndaj Allahut-arma më e fortë

Në të vërtetë, ky sulltan në shekullin e gjashtë sipas hixhrit, e ka ngjallur programin dhe metodën e Muhamedit a.s.,të mënyrës së luftërave të krijuara sipas themeleve të besimit kundër armiqve të njerëzimit. Në këtë tekst të shkurtër është e pamundur që sipas radhitjes t'i numërojmë të gjitha fitoret, qofshin edhe ato të mëdhatë, të cilat i ka arritur ky sundimtar dhe prijës ushtarak gjatë periudhës së shkurtër të sundimit të tij. Këtu do t'i përcjellim fjalët e In Xhevziut për këtë sulltan: "Nuruddini prej pa besimtarëve arriti ta kthejë administratën myslimane mbi qytetin Nejfa dhe 50 qytete dhe kështjella."

Për lavdinë dhe popullaritetin e tij mjafton fakti që me ushtrinë e vete ka arritur t'u bëjë ballë dy ekspeditave të mëdha ushtarake të kryqëzatave, të cilat përbëheshin nga qindra mijëra fanatikë fetarë dhe aventurierë të cilët ishin të etshëm për gjak të myslimanit.

Ekspedita e parë kishte për qëllim pushtimin e Damaskut, të cilën arriti ta rrethojë në vitin 543, sipas hixhrit, apo 1148 të kalendarit g. Në mesin e kësaj ekspedite ishin edhe mbreti i Francës Luigji VII, Konradi mbreti i Gjermanisë si dhe një numër i madh i princërve dhe regjentëve të shteteve evropiane. Atyre iu bashkëngjitën Beldevini III mbreti i Bejtull-Makdisit dhe princër tjerë lokalë. Ata së bashku e rrethuan qytetin me qëllim që ta shtinë në dorë. Por u detyruan të tërhiqen të përulur dhe në mënyrë psikologjike të poshtëruar, duke përjetuar humbje të mëdha në njerëz.

Rezultati më i rëndësishëm i dalë nga kjo disfatë është pamundësia e kryqtarëve që t'i realizojnë fitoret më vendimtare dhe më të rëndësishme sikur se që kanë pas sukses gjatë marshimeve të para të tyre. Nga ana tjetër, u rrit fuqia ushtarake myslimane, deri në atë masë sa që arritën ta ndërtojnë një baraspeshë ushtarake shumë të rëndësishme në të gjitha vijat e frontit, dhe pas saj edhe kalimi në fazën e sulmit.

Ekspedita e dytë ndodhi në vitin 565, sipas hixhrit/1169, ndërsa si cak e kishin që ta shtinë në dorë Egjiptin, sepse kishin hetuar që në këto hapësira po kërcënohet rreziku për vetë ekzistimin e kryqtarëve, veçanërisht nga ai moment kur Nuruddini e çliroi Egjiptin. Kështu ata nga ana veriore dhe jugore kishin mbetur nën bllokimin dhe rrethimin e plotë të ushtrisë myslimane, ashtu që duke e rrethuar kështjellën Dimjat, ata ishin munduar edhe ta pushtojnë, por në këtë i kundërshtoi trimi dhe prijësi i ri ushtarak Salauddini, i cili kishte arritur që t'i mbajë kanalet e komunikimit me sulltanin. Pastaj vetë Nuruddini i udhëhoqi disa aksione të befasishme nëpër qytete dhe fshatra të krahinave të kryqtarëve në Shamë. Në këtë mënyrë atyre ua dobësoi presionin ushtarak dhe njëkohësisht edhe e zgjeroi shtetin e vet. Ekonomikisht kjo i kishte ligështuar aq shumë sa që gradualisht kishte ndikuar edhe deri te dobësimi i tyre i gjithmbarshëm dhe i kishte

detyruar që ta ndërpresin rrethimin e këtij qyteti dhe kthimin në shtetet e tyre. Gjatë kthimit, Allahu i Madhërishëm me anën e furtunave të forta nëpër det i kishte fundosur edhe disa anije të Perandorisë Bizantine.

Njëra nga fitoret më të suksesshme të Nuruddinit ishte shkatërrimi i mbretërisë së Antakisë, thyerja e plotë e saj dhe robërimin e Glosenit mbretit të tij në vitin 555 hixhri. Po ashtu fitoreve të rëndësishme u takon edhe pushtimi përfundimtar i mbretërisë Er-Reha, në vitin 546 h./1151, si dhe vrarja e mbretit të tyre Rejmond në vitin 544 h.

Ndihma e Allahut pranë përpjekjeve maksimale

Sipas pohimeve të ekspertëve ushtarakë, Nuruddini gjatë luftërave të veta kishte shfrytëzuar taktika të ndryshme luftarake. Prej atyre taktikave ishin sulmet e drejtpërdrejta, sulmet provokuese, kundër ofensivat e befasishme, sulmet diversante në vendet e rëndësishme strategjike. Për këtë mënyrë të luftës atë e obligonte: vetë zhvillimi i veprimeve luftarake, zgjerimi i vijës frontale e cila shtrihej që nga jugu i Turqisë së sotme, e deri në Kajro, dhe e tërë kjo e kushtëzonte që ushtria e tij të jetë sa më e lëvizshme dhe të ketë një shpejtësi të madhe të manovrimit.

Beteja Husnu Harem ishte vetëm njëra nga shembujt e dinakërisë, mendjehollësisë ushtarako-strategjike dhe shkathtësisë së tij. Kjo betejë kishte ndodhur në vitin 559./1162, ndërsa në vetë fillimin e saj ka mundur të rezultoi me disfatën më të madhe të ushtrisë myslimane, edhe vetë sulltan Nuruddini për pak sa nuk pësoi. Megjithatë, ai sërish shumë shpejt e bëri organizimin e ushtrisë dhe prijësve myslimanë iu dërgoi letër që t'i dërgojnë ndihmë në njerëz. Një numër i madh i prijësve iu përgjigj këtij apeli duke qëndruar në krye të ushtrisë së tyre, ndërsa disa të tjerë i dërguan zëvendësit e tyre në krye të ushtrisë, vetëm prijësi Fahruddin, i cili administronte me qytetin-kështjellë Kejfa kishte vendosur që të mos i përgjigjej dhe të mbetet në qytetin e vet, pasi që ishte konsultuar me parinë e tij. Megjithatë, Fahruddini të nesërmen urdhëroi ushtrinë e vet që të përgatiten për të

shkuar në ndihmë, në çka këshilltarët e tij për këtë e pyetën: "Si mund ta kesh sot një qëndrim krejtësisht të kundërt nga dita e mëparshme?" Ai iu kishte përgjigjur: "Nuruddini bashkë me mua kemi bërë hapa drejt shtigjeve të fitores dhe nëse unë nuk do t'i ndihmoja, atëherë popullata e qytetit do ta refuzojnë dëgjueshmërinë ndaj meje dhe do të më largojnë nga pushteti. Nuruddini iu kishte shkruar letër dijetarëve dhe besimtarëve që t'i nxisin njerëzit në xhihad dhe t'iu përkujtojnë atyre masakrat që i kanë bërë të krishterët myslimanëve. Secili prej tyre kishte tubuar për rreth miqtë dhe pasuesit e vet duke lexuar libra të Nuruddinit, duke qarë dhe mua më mallkojnë dhe dërgojnë lutje për te. Për këtë arsye unë medoemos duhet të shkoj dhe t'i ndihmoj."

Xhihadi është obligim i shenjtë i myslimanit

Kur u tubuan të gjitha formacionet myslimane, Nuruddini u nis bashkë me ata në drejtim të Harimit, një fortifikatë shumë e rëndësishme strategjike, e cila gjendej në një tatëpjete dhe e cila ishte me përplot luftëtarë-kryqtarësh. Ai e rrethoi atë dhe u shkaktoi mundime të mëdha jo vetëm kryqtarëve, të cilët ishin brenda qytetit, por edhe vëllezërve të tyre nga feja, romakëve dhe ermenasve, të cilët ishin bashkuar për ta mposhtur Nuruddinin me ushtrinë e tij. Atyre në ndihmë iu kishin ardhur fiset dhe princërit, klerikët dhe murgët më të dalluar: Mbreti i Armenisë Soroshi, administratori i Tarablisë Rajmondi, mbreti i Antakisë Buhmenti III, Kollomoni, komandant i njohur ushtarak bizantinas. Kur iu afruan Harimit, Nuruddini me ushtrinë e vet u tërhoq në vendin e quajtur Artah, me qëllim që kryqtarët t'i tërheqë në një vend ngushticë të thellë që ta shpartallojë prapavijën e tyre të fortë. Ushtria e kryqtarëve për një kohë të shkurtër i ndoqën, por shumë shpejt u ndalën sepse e hetuan mashtrimin e myslimanëve, ashtu që ata u kthyen në Harim. Prapa tyre menjëherë u vërsulën luftëtarët trima të ushtrisë myslimanëve dhe kur iu afruan, sërish e përgatitën një mashtrim. Ishin përgatitur për një ballafaqim në një fushëbetejë të hapur me ç'rast armiku filloi sulmin nga krahu i djathtë i ushtrisë myslimane. Por, ata filluan të tërhiqen në përputhje me planin dhe marrë-

veshjen paraprake. Kryqtarët u vërsulën pas tyre duke menduar se ata po ikin nga që janë frikësuar dhe ashtu gradualisht duke i trasuar gjithnjë thellë e më thellë, u futën në territorin të cilën ushtarët myslimanë e kishin rrethuar. Në këtë mënyrë një numër i madh i kryqtarëve u gjendën para një rrethimi të plotë të cilët u bënë pre (plaçkë e luftës) e lehtë e luftëtarëve guximtarë myslimanë. Ata u munduan të bëjnë rezistencë por, pas një kohe të shkurtër, përjetuan një debakël të vërtetë, ashtu që kryesisht të gjithë ata udhëheqës të lartpërmendur u zunë robër dhe në mesin e tyre mbreti Emanuel, ndërsa numri i kryqtarëve të vdekur kaloi mbi 10.000. Pas kësaj beteje shumica e komandantëve myslimanë e propozuan Nuruddinin, që kjo betejë e madhe të kurorëzohet me sulmin në Antaki, në mënyrë që ta çlirojnë nga pjesa e mbetur e administratorëve dhe ushtarëve të cilët e mbronin. Ai refuzoi këtë propozim me fjalët: "Vetë qytetin është lehtë ta pushtojmë, por problemi është me kështjellën e saj e cila është shumë e papërshtatshme dhe mirë e mbrojtur, ndërsa ata nga frika prej nesh mund ta dorëzojnë në duar të bizantineve, kurse dëshira ime më e madhe do të ishte që për fqinj ta kem Bohemin (administratorin e atij qyteti) se sa ndonjë administrator bizantines." Dëshmi e kësaj strategjie të urtë të tij është se më lehtë do të luftohej kundër mbretit të Antakisë sesa kundër ushtrisë bizantine, e cila është më e madhe dhe më e fuqishme.

Kështu Nuruddini, me ndihmën e Allahut, ishte në vendin e parë dhe pas asaj pranë aftësive të tij ushtarako-strategjike, pa u frikuar fare korte fitore të një pas njëshme derisa nuk u takua (ndërroi jetë)me Zotëruesin e tij Fisnik.

Kush e dëshiron sinqerisht shehadetin Allahu do ta gëzojë

Me të vërtetë ashtu siç e përshkruajnë historianët dhe biografët, ai ishte ummet në një person. Jetën e vet e kaloi ose duke e dërmuar kalin e tij nëpër fushëbeteja, ose duke organizuar formacionet ushtarake, ose duke ngritur fortifikata, ose duke vështruar nëpër vendqëndrimet kufitare, ose duke i tubuar, bashkuar dhe përgatitur myslimanët për xhihad, ose iu ndihmonte njerëzve dhe vendoste drejtësi në mesin e

tyre, ose ndërtonte objekte dhe institucione të cilat në momente të duhura dhe në të ardhmen do t'i shfrytëzonin myslimanët. Ndërsa pjesën tjetër të kohës e kalonte duke u larguar nga njerëzit dhe dynjalluku dhe duke e ushqyer shpirtin me adhurim dhe lutje që ia drejtonte Krijuesit me ia pranuar veprat e mira.

Tërë jeta e tij ishte adhurim (ibadet), dhe shumë herë dëshironte që t'i eksponohet rreziqeve dhe befasive luftarake që Allahu xh.sh. në këtë mënyrë ta dhurojë me shehadet në rrugën e Tij. Ndërkaq, Allahu i Madhërishëm ka dashtë që të mos jetë ashtu, por që pas një sëmundjeje të shkurtër të vdesë, me 11 shevvall, 569, k.h. Me vdekjen e tij myslimanët e humbën një udhëheqës fenomenal dhe muxhahid të madh, i cili me tërë forcën dhe diturinë e vet luftoi që Islami përsëri të mbisundojë me hapësirat që i kishin okupuar armiqtë e Allahut. Me shkathtësitë e tij luftarake dhe kryerjen e veprave të mira në çdo moment kur për ato i vinte rasti, ka bërë që ta duan dhe nderojnë qofshin ata edhe armiqtë e tij.

---

* Marrë nga libri "Kolosët e Islamit"

Nga boshnjakishtja:
Shevki Sh. Voca

NURRUDIN MAHMUD – A GREAT STRATEGIST

(Summary)

He emerged at a time of general weakness of Muslims in all the segments of their religious and social life. During these times, Muslims were moving away from sources of knowledge, they started introducing bidahs (innovations) in religion, religious disbelief was spreading, etc.

نور الدين محمود – الاستراتيجي النادر

(خلاصة البحث)

ظهر هذا السلطان في وقت الضعف العام للمسلمين في جميع النواحى الدينية والاجتماعية و في هذا الوقت كان المسلمون تدريجيا يبتعدون من مصادر العلم و انشغالهم بالبدع في الدين و بدأ انتشار الشرك و جميع أنواع العيوب.

Mr. Qemajl Morina

KONTRIBUTI I HOXHË KADRI PRISHTINËS, NË MBROJTJEN E TËRËSISË SË TOKAVE SHQIPTARE

Prijësit fetarë shqiptarë dhe përfaqësuesit intelektualë të tre besimeve më të mëdha të Shqipërisë, u përfshinë në luftën për pavarësinë e Shqipërisë, e cila u arrit formalisht më 28 nëntor 1912.[1] Me këtë rast nuk mund të lëmë pa përmendur aspektin kryesor, se po të mos ishin intelektualët më të mirë të tre besimeve myslimanë, katolikë dhe ortodoksë, po të mos ishin përfshirë në rilindjen e Shqipërisë, që e filloi aktivitetin e saj kryesisht pas vitit 1878, me përpjekjet e Abdyl Frashërit dhe të patriotëve shqiptarë për çlirimin e popullit shqiptar dhe trojeve të tij nga Porta e Lartë, si dhe nga lakmitë grabitqare të fqinjëve, pavarësia e Shqipërisë nuk do të bëhej realitet, njëqind vjetorin e së cilës po e festojmë në këtë vit.

Kontribut të veçantë në këtë aspekt dhanë edhe prijësit fetarë të besimit islam, të cilët nuk e patën lehtë të kyçen në këtë proces, sepse ata duhet t'i kundërviheshin shtetit, i cili deri pak kohë më parë kishte përfaqësuar interesat e tyre, sepse shqiptarët me pozitën e tyre në shtetin osman kishin qenë pjesëmarrës në strukturat më të larta të tij: (mbi

[1] Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, 1985, f. 1044.

36 sadriazemë (kryeministra), ministra, valinj, komandantë ushtarakë, shejhul islam etj.)

Në mesin e këtyre personaliteteve bënë pjesë edhe Hoxhë Kadri Prishtina, i cili më mirë se gjithkush tjetër mishëron lidhjen mes Shqipërisë dhe Kosovës. Ai u lind në Kosovë, ku edhe kaloi një pjesë të rinisë, kurse në Shqipëri kaloi pjesën tjetër të jetës deri në vdekje. Në Shqipëri, ai zhvilloi pjesën më të gjatë të aktivitetit të tij politik, i cili kishte tre synime kryesore:

I pari: forcimin dhe demokratizimin e shtetit shqiptar, sepse pa një shtet stabil dhe të fuqishëm shqiptar nuk kishte mundësi të ketë një Kosovë të lirë.

I dyti: çlirimin e Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare nga okupimi i sllavo-grek, për ta realizuar atë, ai themeloi "Komitetin për mbrojtjen e Kosovës".

I treti: ruajtjen e identitetit kombëtar dhe fetar të shqiptarëve, për ç'gjë nxori revistën "Udha e së vërtetës".

Jeta dhe vepra e Hoxhë Kadri Prishtinës

Hoxhë Kadriu është biri i Lutfullahut, i cili kishte nëntë fëmijë. Në vitin 1878, vit i shënuar në historinë e kombit tonë, Lutfullahut i lindi djali i parafundit, Kadriu. Ishte viti i ngjarjeve të mëdha, që synonin pikën kulmore të Rilindjes Shqiptare. Kadriu i vogël u mëkëmb e hodhi shtat së bashku me ato ngjarjet dramatike të Atdheut, të cilat i mbetën në kujtesë të pashlyera për tërë jetën[2].

Përgatitja shkollore

Në vitin 1885, kur Kadriu arriti moshën për shkollë, i ati e dërgoi në shkollën fillore turke të Prishtinës. Shkollën fillore dhe plotore të qytetit e kreu me sukses. Duke e parë etjen e birit për të mësuar, i ati e regjistroi në gjimnazin turk të Shkupit. Edhe në Shkup Kadriu u dallua midis shokëve për zgjuarsinë e tij dhe la mbresa te mësuesit. Zelli

[2] Eqber Skendi, Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina), Prishtinë, 1992, f. 9.

i Kadriut për të mësuar e shtyri Lutfullahun të mendonte mirë për të ardhmen e birit. Djalit i duhej krijuar mundësia që të vazhdonte shkollimin më tutje. Kjo ishte porosia e shokëve dhe e mësuesve për të birin.

Në atë kohë, profesioni i mësuesit si dritëdhënës i kombit, ishte një dëshirë e flaktë e të gjithë atdhetarëve, prandaj dhe Lutfullahu të birin e regjistroi në "Daru-t-Tedris", Shkollë e Lartë Pedagogjike në Stamboll[3].

Për dy vjet rresht ai doli i shkëlqyeshëm në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe mori diplomën. Ai mësoi pedagogji, psikologji, histori, letërsi etj. Por, për Kadriun kjo shkollë dyvjeçare qe gjysmake. Ai donte të vazhdonte më tej në këtë degë, por nuk iu dha mundësia. Megjithëkëtë, u regjistrua në Medresenë Islame të Fatihut në Stamboll. Atje, përveç shkencave islame, mësoi gjuhën arabe dhe persishten. Edhe këtë shkollë e mbaroi me sukses të shkëlqyeshëm. Më 1903, në moshën 25-vjeçare, u regjistrua për të marrë provimet e drejtësisë me korrespondencë dhe më 1904 i mbaroi ato, duke marrë gradën shkencore "Profesor"[4].

Formimi patriotik

Gjatë kohës sa vazhdonte studimet në Stamboll, ai u fut në klubet patriotike, që qenë krijuar atje. Dhe krijoi lidhje të ngushta me atdhetarë shqiptarë. Takimet dhe bisedat që zhvillonte me ta, ndikuan në formimin e tij atdhetar të mëtejshëm, për të kapur më kryesoren ndër hallkat e atdheut. Patriotët paraprijës i quajti mësues të tij, kurse dijet që përfitoi prej tyre, i vlerësoi si universitet në vete. Ai recitonte e komentonte me pasion veprat e bashkatdhetarëve, si të Samiut, Naimit, Pashko Vasës, Hoxhë Tahsinit etj. Për një kohë ai u bë një ndër veprimtarët më të flaktë në rrethet patriotike shqiptare të Stambollit. Tani-

[3] Jup Kastrati, Hoxhë Kadriu (me rastin e 40 vjetorit të vdekjes), Buletin i ILPSH. Nr. 3, Shkodër 1965, f. 435.

[4] Eqber Skendi, Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina), Prishtinë, 1992, f. 14.

më, në shenjë respekti, ata filluan ta thërrisnin "Hoxha" (që në gjuhën persiane do të thotë i ditur", "i mësuar", "profesor"). Në atë kohë ai zotëronte mirë frëngjishten, turqishten, arabishten, persishten, e më vonë edhe gjermanishten.

Në prill 1904, policia hynë në shtëpinë e Hoxhë Kadriut dhe mbasi kontrolluan dhomën ku banonte, e arrestuan me pretekst se vepronte kundër interesave të pushtetit turk, dhe e dërguan për të vuajtur dënimin në burgun e politikanëve, në Jedikule[5], ku e priste fati i keq i dhjetëra patriotëve të tjerë shqiptarë. Nga kushtet e vështira, gjatë pesë vjetëve, sa qëndronte në burg, Hoxhë Kadriu u sëmur, mori tuberkulozin e eshtrave, prandaj iu desh të bënte amputimin e këmbës mbi gju. Në saje të intervenimit të shokëve të tij, Hoxhë Kadriu lirohet nga burgu më 1908, dhe kthehet në Prishtinë. Ende pa u çmallur mirë me familjen, pushteti turk e ktheu në Turqi, me motivacion se "qenka liruar gabimisht". Internohet përsëri në Turqi, por kësaj radhe në qytetin Tokat[6]. Internimi i tij në Turqi, s'e mposhti dot idealin që kishte për të realizuar synimet e tij kombëtare. Me fitoren e Revolucionit Xhonturk, Hoxhë Kadriu u gjend në liri, kurse më 1913, së bashku me të gjithë kundërshtarët tjerë, edhe ky u internua. Papritur, në dhjetor 1913, ata morën vendimin për largimin nga Turqia të gjithë njerëzve që propagandonin kundër Perandorisë Osmane. Në fund të dhjetorit 1913, Hoxhë Kadriun e hipën me forcë në një vapor austro-hungarez për ta nxjerrë jashtë territorit të Turqisë. Pas një udhëtimi të gjatë, duke u ndalur në Palestinë, Egjipt, Rumani e Austri, ai arriti në Durrës.

[5] Po aty, f. 16.
[6] Po aty, f. 23.

Kthimi në Shqipëri

Më 1914, Hoxhë Kadriu kthehet në Shqipëri, dhe vendoset në Shkodër. Aty u lidh me veprimtarinë që zhvillonin patriotët shqiptarë mu në atë kohë kur lakmitë e shteteve fqinje për ta copëtuar Shqipërinë ishin më të mëdha se asnjëherë më parë.

Si vendbanim, Hoxhë Kadriu zgjodhi Shkodrën, por syrin e zemrën, sigurisht, i kishte në Kosovën e pushtuar e të martirizuar. Prandaj, ai donte të ishte sa më afër saj. Në ato vite ai shkruante: "... Jam i lidhur aq fort që edhe larg saj të gjendem, shpirti dhe zemra ime do të jenë në Shkodër. Prandaj, dëshiroj që Shkodra t'i afrohet flakës së zjarrit të dashtunisë të atdheut dhe të kombit dhe të ngrohet pra në këtë zjarr. Zakonet prapanike, fanatizmat fetare, frymëzimet fantastike të mos pengojnë ndriçimin e mendjes dhe ngritjen e nivelit arsimor. Në Shkodër më kanë lindur edhe më janë shfaqur dëshirat e mia, që Shkodra kundër rrymave politike dhe propagandave të dëshmonte të mos e humbasin ngjyrën kombëtare dhe për këtë qëllim të ketë gazeta, revista dhe disa shkolla që të përparojë gjuha e jonë. Në kohëra të afërta dhe të largëta të fatkeqësive, Shkodra ka qenë streha dhe krahu i kombit tonë"[7].

Gjatë qëndrimit të ushtrisë austriake në Shkodër, një ditë komisari i jashtëzakonshëm, Moiso Krajli, e kishte thirrur Hoxhë Kadriun dhe, pas një bisede të gjatë, i propozonte të punonte në ofiqe më të larta, ku të dëshironte dhe ia numëroi me radhë: "Kryemyfti, drejtues i përgjithshëm i arsimit ose i drejtësisë". Hoxhë Kadriu i refuzoi ofertat e propozuara, pasi, siç deklaroi, e kishte kuptuar se politika e Austrisë ishte kundër "independencës së Shqipërisë". Sipas tij, këto poste ishin larg nga ideali për të cilin luftonte. Për këtë arsye ai preferoi të punonte si avokat i thjeshtë, e jo të ishte në shërbim të okupatorit të vendit të tij.

[7] Po aty, f. 29.

Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës"

Edhe pse Komiteti emërtohej "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës[8]", përvoja tregon se udhëheqësit, anëtarët e tij kishin për qëllim mbrojtjen, pavarësinë dhe integritetin e shtetit shqiptar dhe se ata ishin përfaqësues të vërtetë të mbarë kombit shqiptar. Për ta ishte i dashur dhe i shtrenjtë çdo cep i atdheut, prandaj u përpoqën një lloj për paprekshmërinë e çlirimin e Shkodrës e të Vlorës e të Korçës, të Kosovës dhe të gjitha trojeve shqiptare.

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore përsëri shtroi para popullit tonë problemin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar. Në këto kushte rritet lëvizja për të shpëtuar vendin nga copëtimi i ri dhe për bashkimin kombëtar, kështu që më 7 nëntor 1918, u formua komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës"[9] pati si organ të vetin gazetën "Populli", që u botua në Shkodër nga 18 janari 1919 deri më 27 gusht 1920. Gazeta kishte kryeredaktor atdhetarin vlonjat, Salih Nivica. Ajo u ngrit fuqimisht në mbrojtje të të drejtave kombëtare, kundër planeve hegjemoniste të shteteve fqinje, dhe projekteve që hartonte Konferenca e Paqes në dëm të tërësisë dhe të pavarësisë së Shqipërisë.

Ky objektiv i Komitetit më së miri shihet nga proklamata e janarit të vitit 1919, në të cilën shprehet qëndrimi ndaj politikës italiane dhe franceze në Shqipëri, ku në mënyrë të qartë thuhet se "qëllimi i tij kryesor është të vendosë një Shqipëri independente, të përjashtuar nga çdo lloj protektorati, të çlirojë Kosovën e ta bashkojë me Shqipërinë dhe se do të kundërshtojë cilindo që do t'i kundërvihet këtij qëllimi".

Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", që e drejtonte Hoxhë Kadriu, luftonte jo vetëm për një Shqipëri të pavarur, por edhe për shpëtimin e Kosovës nga okupimi serb. Ai bëri një sërë protestash para Lidhjes së Kombeve kundër kolonizimit e serbizimit të Kosovës nga Krajlët e Serbisë. Kështu, në shtator të vitit 1924, komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", me udhëzimet e Hoxhë Kadriut,

[8] Lush Culaj, Komiteti mbrojtja kombëtare e Kosovës (1918-1924), Prishtinë, 1997.
[9] Po aty, f. 39.

dërgoi në Gjenevë një delegacion që të protestonte pranë Lidhjes së Kombeve kundër barbarizmave të qarqeve shoviniste serbe nëpër Kosovë. Delegacionin e përbënin: Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Bedri Pejani, të cilët paraqitën protestën. Në të, përveç të tjerash, thuhej: "...ky regjim hekuri, zjarri e grabitjeje përbën shkakun kryesor të një emigrimi në masë të popullsisë shqiptare drejt Turqisë, emigrim ky që bëhet në kushte të tmerrshme e që kushton jetën qindra familjeve dhe pjesa tjetër, që mbeten, dënohen me një mjerim të pashërueshëm.... mjafton me dijtë se për mija krime të bëra në mes ditës asnjë nuk është ndjekë nga gjyqet .....Është vendi i vetëm në botë, ku mund të vriten njerëzit në prani të gjyqtarëve që heshtin"[10].

Hoxhë Kadriu e urrente diplomacinë evropiane, e cila me hipokrizinë e saj merrte nëpër këmbë të drejtat e popujve të vegjël.

Kështu, ky atdhetar i flaktë, që ishte një nga figurat më të ndritura të lëvizjes Kombëtare të Kosovës, me themelimin e komitetit në fjalë, mori përsipër një barrë të rëndë, të vështirë dhe delikate. Këtë barrë ai e mbajti deri në vdekje, me besim të patundur në fitore. Ky komitet, qëllim kryesor kishte çlirimin e Kosovës dhe ribashkimin e saj me shqiptarinë. Kështu shkruante edhe vetë Hoxhë Kadriu: "Komiteti ynë ka për qëllim themelor bashkimin e kombit".

Kjo del e qartë që në nenin e parë të programit, ku thuhej: "Me i dalë zot vetësundimit e tërësisë së tokësore të Shqipërisë". Për të arritur këtë qëllim e në mbështetje të nenit 1 u përcaktua rruga që duhej të ndiqej. Në nenin 2 thuhej: "Me përdorur çdo mjet për me i librue (çliruar) Kosovën e Dibrën, e çdo vend ku flitet shqip e me i bashkue në sundim të Shqipnisë Lirë"[11]

Komiteti për "Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës", përveç aktivitetit diplomatik në zgjidhjen e çështjes kombëtare, ai u drejtohej popullit me anë të proklamatave për aksione luftarake, kështu shohim në një apel drejtuar popullit në gusht të vitit 1919, se koha kishte treguar se "nuk ka më njerëzi e drejtësi dhe se fjalën e mbrame do ta thotë pushka besnike e shqiptarit".

[10] Jup Kastrati, Hoxhë Kadriu, kumtesë (me rastin e 40-vjetorit të vdekjes), f. 439.
[11] Hasan Prishtina, "Permbledhje dokumentesh", 1908- 1934, Tiranë 1983, f. 175.

Hoxhë Kadriu disa herë ishte zgjedhur deputet në Parlamentin shqiptar dhe kishte kryer funksionin e ministrit të Drejtësisë.

Pas sa e sa vuajtjesh të rënda shëndetësore, në moshën 47-vjeçare, më 20 janar 1925, kaloi në botën e amshueshme, atdhetari i madh, burrështeti, juristi në zë, organizatori i drejtësisë shqiptare, publicisti i njohur, "babai i Kosovës", guximtari dhe njëri nga promotorët kryesorë të mendimit politik shqiptar. Ditën që vdiq Hoxhë Kadriu, nga Kosova shkruanin:

"Lajmi i vdekjes së Hoxhës sonë, Kadri efendiut, babai i të gjithë kosovarëve dhe sidomos mbështetja e të gjithë idealistëve kosovarë....na pikëlloi dhe na hidhëroi zemrat.... vdekja e të ndjerit Hoxhë, nuk është dhembje pikëlluese vetëm për familjen e tij, por është për të gjithë Shqipërinë. Po sidomos për kosovarët është një humbje e madhe që s'mund të zëvendësohet".

Me gjithë përpjekjet e shumta, Hoxhë Kadri Prishtina nuk mundi ta realizojë ëndrrën e tij që ta shohë Kosovën të pavarur, por ai trasoi rrugën për gjeneratat e mëvonshme.

Idetë Islame të Hoxhë Kadriut në revistën "Udha e s'Vërtetës"

Në dallim nga bashkëkohanikët tjerë prej dijetarëve islamë, Hoxhë Kadriu pati fatin e mirë. Për veprimtarinë patriotike të tij është shkruar si në Historinë e Shqipërisë, ashtu edhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar[12], janë organizuar sesione shkencore dhe janë botuar mjaft artikuj në shtypin tonë, qoftë në Shqipëri[13], Kosovë[14], a në Diasporë.

[12] Tiranë, 1985, f.386.

[13] Tiranë, 1984, vell. 3 f. 165.

- Jup Kastrati, Hoxhë Kadriu, kumtese me rastin e 40 vjetorit te vdekjes.
- Zamir Shtylla, Rreth krijimit te veprimatrisë se Komitetit MKK, Studime Historike, 1968, nr. 3. F. 434.
- Komiteti "Mbrojtja Kombetare e Kosoves" (permbledhje kumtesash), Tiranë, 2004.

[14] Shkendija, Hoxha Kadriu-atdhetar dhe demokrat i shquar (me rastin e 65 vjetorit të vdekjes), f. 6.

- Bujku, Diplomat e dhe luftëtar për çështje kombëtare (me rastin e 70 vjetorit te vdekjes), 20 janar 1995.

Në shumicën e shkrimeve të lartpërmendura nuk është hulumtuar një segment tejet i rëndësishëm i veprimtarisë së Hoxhë Kadriut, që është aspekti Islam i jetës dhe i veprës së këtij dijetari të madh. Bile Jup Kastrati, në kumtesën e tij me rastin e 40-vjetorit të vdekjes shkruan: "Hoxha Kadriu vërtet studioi për fe, por kurrë nuk qe fanatik. Ceremonitë fetare për të nuk kishin rëndësi. Urrente ndasitë fetare dhe punoi për bashkimin e popullit".

Po ashtu, Eqber Skëndi në monografinë e tij të cituar më parë (që ka 216 faqe), revistës "Udha e s'Vërtetës" i kushton vetëm pesë faqe. Por, kjo nuk është për t'u habitur, kur dihet se gjatë kohës së monizmit, edhe historia te ne ishte e ideologjizuar deri në atë masë, saqë fare pak përkonte me realitetin. Po kjo ndodhi edhe me Hoxhë Kadriun tonë.

Fakti që drejtori i policisë austriake në Shkodër, për shkak të qëndrimit dinjitoz të Hoxhë Kadriut ndaj okupimit të Austrisë, e kishte thirrur në bisedë dhe i qe drejtuar me fjalët: "Ju, Hoxhë Kadriu, po merreni me propagandën e panislamizmit dhe po krijoni një bashkim midis myslimanëve". Në asnjë shkrim që kemi pasur rastin të lexojmë, nuk është përmendur fare kjo çështje.

Në kohën kur Hoxhë Kadriu punonte në Shkodër si avokat i thjeshtë, kishte menduar të nxirrte një revistë mujore, në të cilën të shpreh te pikëpamjet e tij islame. Pasi mori leje nga përlimtarja (bashkia) e Shkodrës dhe në marrëveshje me shtypshkronjën "Ora", vendosi të botonte në Shkodër revistën e tij mujore me titull "Udha e s'Vërtetës". Si nga titulli i revistës, ashtu edhe nga përmbajtja e shkrimeve në të, del e qartë se ishte e pranishme fryma Islame[15] në jetën dhe veprat e Hoxhë Kadriut, të cilat do të trajtohen edhe në revistën e tij me vërtetësinë dhe sinqeritetin, me të cilin ishte gatuar jeta e tij. Nën titullin e revistës vinte motoja: "Kërkimi i së vërtetës është e drejta e mendjes".

- Mr. Lush Culaj, Komiteti mbrojtja kombëtare e Kosovës (1918-1924), Prishtinë, 1997.
- Eqber Skendi, Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina), Prishtinë, 1992.
- Qemajl Morina, Hoxhë Kadri Prishtina - mendimtar islam, Prishtinë, 2000.

[15] Qemajl Morina, Hoxhë Kadri Prishtina – mendimtar islam, Prishtinë, 2000, f.17.

Revista "Udha e s'Vërtetës" ishte, siç deklaronte Hoxhë Kadriu, fletore fetaro politike-letrare. Në fakt ai tribunën e revistës e përdori për t'i demaskuar disa të pavërteta, të cilat kohë pas kohe plasoheshin në shtypin shqiptar të asaj kohe në dëm të fesë Islame. Ai këtë më së miri e shpreh në "Parathënie" të numrit të parë të revistës së tij[16].

Ashtu siç është traditë te dijetarët myslimanë, pas parathënies fillon me "Bismil-lahir-rrahmanir-rahim", pastaj e falënderon "Të madhin Zot që premtoj për popullin shqiptar të shkruajë e të këndojë ky në gjuhën e vet amtare edhe të gëzojë lirin e pavarësinë e vet".

Pastaj i përcjell "salatet" dhe "selamet" "Muhamed Mustafas, ma të mbramit Pejgamber në fytyrë të tokës, që pranojë në vathë të vetin shumicën e madhe të shqiptarëve".

"Është e qartë se kleri mysliman ka dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e tij të gjatë për ruajtjen identitetit kombëtar ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do ta vëmë re se prania e klerikëve myslimanë është kudo e pashmangshme. Mund të fillosh nga Hoxha Tahsini i madh – erudit e të vazhdohet me më tej me Daut efendi Boriçin (në Lidhjen e Prizrenit), me Hafiz Ibrahim Shkupin (në Kongresin e Manastirit), me myfti Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin (në shpalljen e pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit), me Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Ndroçin (në Kongresin e Durrësit, më 1918) me Mutesim Këlliqin (në Kongresin e vitit 1920) etj.", shkruan Pirro Prifti këto ditë në artikullin e tij me titull: "Kleri shqiptar – vendimtar në Pavarësinë e Shqipërisë".[17]

Shqipëria në 100-vjetorin e saj mbetet e përçarë politikisht. Kosova vetëm katër vjet më parë, pas shumë peripecive dhe krajatave mundi të arrijë pavarësinë e saj. Ndërkohë, që shqiptarët tjerë vazhdojnë të jetojnë me statusin e pakicave në trojet e tyre etnike, në shtetet për rreth Shqipërisë. Kjo ishte e natyrshme, sepse nuk patëm një shtet të fuqishëm shqiptar gjatë njëqindvjetshit të kaluar. Andaj, në epokën e

[16] Udha e s'Vertetës,nr. 1, vjeti i I-rë, tetuer 1923, Shkodër 1923, f.2-3.
[17] "Sot news", 8 korrik 2012.

globalizmit mund të triumfojnë vetëm të fuqishmit. Për një të ardhme më të mirë lypset që spektri politik shqiptar, si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, të jetë unik dhe interesat shtetërore dhe kombëtare të jenë mbi ato personale dhe partiake. Vetëm si të këtillë do të jemi të denjë për respekt nga populli ynë, por edhe nga popujt tjerë.

Mr. Qemajl Morina

THE CONTRIBUTION OF HODJA KADRI PRISHTINA IN DEFENDING THE TERRITORIAL INTEGRITY OF THE ALBANIAN LANDS

(Summary)

Albanian religious leaders as well as intellectuals (belonging to the three largest religious groups in the country) joined the struggle for the independence of Albania, which was formally achieved on November 28, 1912. If it were not for them, if they had not joined the struggle for the revival of Albania, which began after 1878, with the efforts of Abdyl Frasheri and other Albanian patriots for the liberation of the Albanian nation and its territories from the High Porte, the independence of Albania would have never been achieved.

كمال مورينا

مساهمة خوجا قدري بريشتينا في حماية و سلامة الأراضي الألبانية

(خلاصة البحث)

شارك رجال الدين والمثقفون الألبان الممثلين لأديان الثلاثة الكبرى في ألبانيا في النضال من أجل استقلال ألبانيا والتي تم تحقيقها رسميا في ٢٨ نوفمبر ١٩١٢. و بهذه المناسبة لا يمكن أن تترك دون ذكر الجانب الرئيسي أنه بدون مشاركة المثقفين من الديانات الثلاث : الإسلام و الكاثوليكية والأرثوذكسية في نهضة ألبانيا التي بدأت أساسا بعد عام ١٨٧٨ بجهود عبدá فراشري والوطنيين الألبان من أجل تحرير الشعب الألباني وآراضيه من الباب العاليæ الشهوات المفترسة للجيران لما تحقق استقلال ألبانيا الذى نحتفل بالذكرى المئوية هذا العام.

Mr.sc. Rrezehana Hysa

PËRPJEKJA E PATRIOTËVE SHQIPTARË PËR FORMIMIN E SHTETIT SHQIPTAR DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE

Lufta pesëshekullore e popullit shqiptar për liri dhe formimin e shtetit të pavarur shqiptar kulminacionin e arriti në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, gjegjësisht në vitet 30-40 të shekullit XIX, e cila bashkëveproi edhe si Lëvizje e gjerë ideore edhe si luftë e armatosur, në themel të së cilës ishte bindja e popullit shqiptar para vetes dhe të tjerëve, se ata janë populli më i lashtë në Ballkan, me tradita, kulturë dhe gjuhë autoktone të cilët luftojnë për të drejta të barabarta sikur të gjithë popujt të tjerë të Evropës, për të fituar autonominë e pastaj pavarësinë e plotë të Shqipërisë, më 28 nëntor 1912.[1] Për zgjimin kombëtar dhe ngritjen e ndërgjegjes së popullatës shqiptare, rilindësit u përpoqën të përhapin dijen dhe arsimin kombëtar, të botonin libra dhe gazeta, të hapin klube dhe shoqëri të ndryshme, ta jetësojnë postulatin feja e shqiptarit është shqiptaria, dukuri e cila iu kundërvu qeverisë turke, e cila e shfrytëzonte si alibi besimin e kombit shqiptar të ndarë në tre komunitete fetare, myslimane, krishtere dhe ortodokse për për-

[1] Fjalori enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985, faq.1044.

çarje kombëtare.[2] Ata me nismën e Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave Kombëtare Shqiptare më 1877, themeluan në Stamboll "Shoqërinë e të shtypurit të shkronjave shqip", më 12 tetor 1879, me në krye Sami Frashërin. Qëllimi i kësaj shoqërie ishte të krijonte degë të saj kudo që kishte shqiptarë dhe njëkohësisht me fondet e grumbulluara të hapte shkolla shqipe, të ngrinte shtypshkronja, të botonte tekste shkollore, revista shqipe etj..[3]

Nga Rilindja Kombëtare Shqiptare doli Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878 si organizata e parë politike dhe ushtarake mbarëshqiptare, e cila e përfaqësoi kombin shqiptar në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që kishte për synim para Portës së Lartë dhe faktorit ndërkombëtar njohjen e kombit shqiptar, ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare, bashkimin e tyre në një njësi të vetme me administratë shqiptare, jetësimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare etj. Në pranverë të vitit 1879, Lidhja e Prizrenit gjeti mbështetjen në katër Vilajetet e Shqipërisë, prandaj ajo duke qenë e mbështetur nga forcat e armatosura arriti të largonte autoritetet osmane dhe të ngrinte në mjaft krahina organet e veta qeverisëse. Kësisoj u krijuan gjykata shqiptare, taksat paguheshin në favor të Lidhjes dhe jo të autoriteteve osmane dhe shërbimi ushtarak tanimë kryhej në Shqipëri. Programi kombëtar i Lidhjes së Prizrenit gjeti mbështetje në shumë kuvende të mbajtura në veri dhe në jug të Shqipërisë.[4]

Lidhja Kombëtare Shqiptare nëpërmjet platformës së saj politike iu kundërvu vendimeve të Kongresit të Berlinit[5], i cili pas Traktatit të Shën Stefanit, të 3 shkurtit 1878, vendosi copëtimin e trojeve shqiptare në katër shteteve të huaja dhe atë: nën juridiksionin e shtetit bullgar krahinat shqiptare të Korçës, Pogradecit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Gostivarit, Tetovës, Shkupit, Kaçanikut, Kumanovës. Viset veriore të Kosovës deri në afërsi të Mitrovicës, do t'i aneksonte Serbia, ndërsa Malit të Zi do t'i jepej Ulqini, Anamalia, Hoti, Gruda, Kelmendi, Pla-

[2] Po aty…faq.1044.
[3] Grup autorësh:Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, 1999, faq.96.
[4] Po aty… 1999, faq.93.
[5] Fjalor encklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985, faq.1044-1045.

va, Gucia dhe Rugova, ndërsa pjesa tjetër do të mbetej nën sundimin osman. Ky copëtim ngjalli shqetësim të madh te popullata shqiptare, e cila iu kundërvu me protesta që kundërshtuan me të gjithë mjetet zbatimin e këtij Traktati, edhe pse shtetet jo nënshkruese e kundërshtonin vendimin e Shën Stefanit, prandaj kërkonin rishikimin e saj në një mbledhje tjetër ndërkombëtare.[6]

Kësisoj, më 13 qershor 1878, përfaqësuesit e gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës u mblodhën sërish në Berlin, për të shqyrtuar dhe rishikuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Kongresi i Berlinit nuk e njohu kombin shqiptar dhe përfundimisht vendosi që viset shqiptare që ishin të banuara me popullatë shqiptare dhe që Traktati i Shën Stefanit ia kishte dhënë Bullgarisë, do të mbeteshin në sundimin osman. Ndërkaq Serbia nuk do të zgjerohej në drejtim të Mitrovicës dhe Prishtinës, por iu dhanë krahinat e Pirotit, të Trenit, të Vranjës dhe të Nishit, që më parë i qenë premtuar Bullgarisë, ndërsa Malit të Zi t'i jepeshin krahinat e Tivarit, Podgoricës, të Plavës, Gucisë, Rugovës dhe të Kolashinit, ndërsa Çamëria iu dha Greqisë. Vendimet e Kongresit të Berlinit për copëtimin e Shqipërisë i cenuan rëndë të drejtat dhe interesat kombëtare të popullit shqiptar, prandaj ata në shenjë revolte u çuan në protesta dhe kryengritje të përgjithshme, që kishin për synim mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë.[7] Prandaj, në janar të 1879, udhëheqësit e Lidhjes Kombëtare Shqiptare në Jug organizuan në Prevezë një Kuvend të jashtëzakonshëm, në të cilën morën pjesë qindra delegatë, të cilët kundërshtuan kalimin e krahinave shqiptare brenda kufijve grekë. Për t'i mbrojtur të drejtat e shqiptarëve përpara Fuqive të Mëdha, në pranverë të vitit 1879, u nis një delegacion shqiptar në Evropë, i përbërë nga Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni, të cilët para faktorit ndërkombëtar e dënuan vendimin e padrejtë të Kongresit të Berlinit për copëtimin e Shqipërisë dhe njëkohësisht shprehën vendosmërinë e popullit shqiptar për të mbrojtur ve-

[6] Grup autorësh: Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, 1999, faq.86.
[7] Po aty…, faq, 90.

ndin e tyre prej pushtuesve të huaj derisa ta sigurojnë autonominë e Shqipërisë.[8]

Ndërkaq në verë-vjeshtë të vitit 1879, në krahina të ndryshme të Shqipërisë pati goditje të mëdha kundër administratës shtetërore dhe lokale turke, por që ishin në favor të Shqipërisë. Prandaj, në janar të vitit 1881 shqiptarët mbajtën Kuvendin e Prizrenit, në të cilën morën pjesë vetëm përkrahësit e autonomisë së Shqipërisë. Nga ky Kuvend ata ngritën qeverinë e përkohshme shqiptare si rezultat i çlirimit të disa territoreve të Shqipërisë prej forcave osmane, në krye të së cilës qëndronte Ymer Prizreni-kryetar, Shaip Spahiu nënkryetar, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi etj.[9] Qeveria e përkohshme e Lidhjes organizoi forcat e veta ushtarake të rregullta dhe ngriti administratën e re shqiptare. Sukseset e arritura nga qeveria e re e Lidhjes prej Vilajetit të Kosovës e deri në Dibër, shqetësuan së tepërmi autoritetet osmane në Stamboll, gjë që Porta e Lartë organizoi një ekspeditë të madhe ushtarake të përbërë prej dyzet batalionësh gjegjësisht me rreth 20.000 ushtarë të komanduar nga mareshal Dervish Pasha, të cilët e shtypën menjëherë qeverinë shqiptare të Ymer Prizrenit, si rezultat i betejave të njëpasnjëshme e të përgjakshme të pushtetit osman dhe vendosjes së regjimit të ashpër barbar nëpërmjet burgosjes, persekutimeve, arrestimeve të mijëra veprimtarëve dhe luftëtarëve të Lidhjes. Ndërsa Qeveria e Prizrenit e mobilizuar me rreth 6.000 trupa shqiptare të komanduar nga Sulejman Vokshi dërgoi një memorandum para Fuqive të Mëdha, përmes së cilit kërkonte ndërhyrjen e forcave të tyre për ta shpëtuar Shqipërinë nga kauza që ishte krijuar, mirëpo një ndërhyrje e tillë nuk u realizua nga faktori ndërkombëtar. [10]

Në vazhdën e agjendës së tyre, patriotët shqiptarë në kuadër të Lidhjes Kombëtare Shqiptare ushtruan veprimtari mjaft domethënëse në katër Vilajetet shqiptare gjegjësisht themeluan një varg shoqërish atdhetare në Rumani, Bullgari, Egjipt etj. Hapën Mësonjëtoren e parë të Korçës më 1887, gjegjësisht 11 vjet pas Kuvendit të Prizrenit. Bën të

[8] Po aty…, faq.90.
[9] Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, 1996, faq.110.
[10] Grup autorësh, v.p.e cituar, , 1999, faq.95.

mundur botimin e shumë veprave letrare politike, organizuan dhe udhëhoqën kryengritjen e armatosur që kishte për synim autonominë administrative, bashkimin në një Vilajet të vetëm dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale etj. Edhe përkundër shpërndarjes me forcë të saj nga Porta e Lartë më 1900 ajo në vitin 1905 në Manastir formoi Komitetin për Lirinë e Shqipërisë, e cila pati degë në shumë qytete shqiptare. Krerët e Lidhjes Kombëtare Shqiptare, veç tjerash, organizuan mbajtjen e Kongresit të Manastirit, më 1908, në të cilën u vunë bazat e alfabetit shqip për tërë Shqipërinë dhe tërë shqiptarët, mbajtjen e Kongresit të Elbasanit më 1909, dhe hapjen e Normales pedagogjike si një ndër pikat kryesore të dala nga ky Kongres, mbajtjen e Kongresit të Dibrës më 1910, e shumë e shumë aktivitete dhe organizime të tjera madhore për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe Shqipërinë në veçanti. etj.[11].

Më 1908-1912 gjegjësisht në prag të pavarësisë së Shqipërisë u intensifikua përpjekja shumëshekullore e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, prandaj kudo në Shqipëri dhe trojet shqiptare shpërtheu kryengritje e armatosur që kishin për synim ta dobësonin Perandorinë Osmane, dhe e cila u shoqërua me veprimtari më të gjerë politike dhe diplomatike, me kuvende nëpërmjet së cilës dolën disa memorandume, ndër ta edhe Memorandumi i Greqisë, i hartuar nga Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi etj., dhe i miratuar më 23 qershor 1911, në Pllajën e Greqisë së Malësisë së Madhe nga Kuvendi i përgjithshëm i krerëve shqiptarë në bashkëpunim me përfaqësuesit të Komitetit shqiptar të Podgoricës, që e drejtonin Kryengritjen antiosmane të 1911. Qëllimi i këtij Memorandumi, i cili përmbante 12 kërkesa dhe që iu paraqitën Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha në emër të të gjithë shqiptarëve ishin: njohja e plotë e kombit shqiptar, bashkimin e katër Vilajeteve në një të vetëm, vendosjen e administratës civile e financiare shqiptare, krijimin e organeve gjyqësore, të policisë me vendës, përdorimin e gjuhës shqipe në administratën shtetërore, në gjyqe, kuvende krahas turqishtes, lirinë e plotë për zgjedhjen e deputetëve shqiptarë, mësim

[11] Fjalor enciklopedik shqiptarë, Tiranë 1985, faq.1044-1045.

në gjuhën shqipe dhe hapjen e shkollave shtetërore në gjuhën shqipe, kryerjen e shërbimit ushtarak brenda vendit, përdorimin e një pjesë të mirë të të ardhurave fiskale për nevojat e vendit, etj., kërkesa të cilat nuk u aprovuan nga pala turke por u përvetësuan me konsekuencën më të madhe nga të gjithë kryengritësit shqiptarë dhe ishin si nismë drejt veprimeve të hapura kundër regjimit turk, të cilat më vonë u shtypën si broshurë në Librin e Kuq dhe u arkivuan si dokument tejet i rëndësishëm historik për Shqipërinë dhe shqiptarët.[12]

Lidhja Kombëtare Shqiptare themeloi edhe Shoqërinë e zezë për shpëtim (1911-1912), me një shtrirje në një varg qytetesh shqiptare si Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Manastir, Shkup etj., dhe e cila bashkëpunonte me një sërë kolonish të tjera shqiptare jashtë vendit. Programi i saj mbajti qëndrim të drejtë në frymën e programit të Lidhjes Kombëtare, dhe njëkohësisht veproi energjikisht në kryengritjen antiosmane të vitit 1911, ndërsa anëtarët e saj morën pjesë në përgatitjen e Kuvendit Kombëtar të Vlorë dhe aktin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.[13]

Për rrethanat politike dhe shoqërore në Shqipëri, ishin të interesuar edhe shtetet ballkanike, ngase sipas disa kalkulimeve diplomatike, Perandoria Osmane shkonte drejt dobësimit, andaj ata e shikonin çështjen shqiptare si problem që duhet zgjidhur, por duke pasur në agjendën e tyre okupimin dhe copëtimin e Shqipërisë. Prandaj, për qëllimet e veta strategjike ajo kishte dërguar në trojet shqiptare vëzhgues, raportues, konsuj e gazetarë, me detyrë që ta përcillnin situatën. Kësisoj në një takim midis ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, Milovanoviq dhe Bullgarisë, Geshov, më 28 tetor të vitit 1911, në Sofje, ndër të tjera u bisedua që territoret e banuara me shqiptarë të ndahen në favor të shteteve fqinje me Shqipërinë dhe atë: pjesa jugore e Shqipërisë dhe Maqedonisë t'i takojnë Greqisë, pjesa verilindore në vijën tokësore Bregallnicë-Veles-Durrës t'i takojë Serbisë dhe pjesa e

[12] Po aty…faq.690.
[13] Po aty.., faq.1030.

mbetur Bullgarisë.[14] Mirëpo nga ana tjetër shqiptarët ishin të bindur se e vetmja rrugë për të arritur objektivin e Shqipërisë autonome dhe moscopëtimin e trojeve shqiptare ishte kryengritja e armatosur. Andaj, Ismail Qemali dhe prijësit e tjerë në Korfuz, organizuan mbajtjen e Komitetit Qendror Shqiptar, në të cilën u shqyrtua situata e përkeqësuar në Shqipëri, dhe mundësia e koordinimit të këtij Komiteti me Lëvizjen e armatosur të malësorëve të Shqipërisë, e cila rezultoi si e suksesshme. Aty veç tjera u vendos edhe ndërlidhja e këtij komiteti me organizatat e tjera në Bullgari, Mal të Zi, Itali etj.[15]

Nga ana tjetër, qeveria xhonturke ishte në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe e shihte se e kishte humbur kredibilitetin në popull, prandaj u detyrua të bëjë disa reforma të dëshiruara nga popujt që ishin në varësi të saj. Kësisoj, në janar të 1912, ajo dërgoi një komision qeveritar në Shqipëri, i njohur me emrin si komisioni i reformave me në krye Haxhi Adil Beun, ministër i Punëve të Brendshme dhe disa këshilltarë evropianë nga shtete evropiane, që ishin lojalë ndaj xhonturqve. Pas shumë negociatash puna e komisionit dështoi ngase premtimet e komisionit ishin boshe, ndërkaq qëndrimi i tij në trojet etnike shqiptare rezultoi me përleshje të armatosura mes çetave shqiptare dhe forcave osmane.[16] sidomos në Rrafshin e Dukagjinit dhe në malësinë e Gjakovës, ndërsa me kalimin e kohës gjegjësisht në periudhën mars-maj, aksionet e armatosura shqiptare u përhapën edhe në Vilajetet e tjera të Shqipërisë dhe e shndërruan atë në kryengritje të përgjithshme antiosmane. Për ta vënë kryengritjen e armatosur në një udhëheqje të vetme dhe në një platformë të përbashkët politike, drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare me në krye Hasan Prishtinën në gjysmën e muajit maj 1912, organizuan Kuvendin e Junikut, që kishte për synim autonominë e Shqipërisë. Pas këtij Kuvendi, forcat osmane morën ofensivë kundër popullatës shqiptare, e cila kjo e fundit u detyrua të tërhiqet me qëllim të rigrupimit, furnizimit me armë dhe përga-

[14] Skender Asani: Kryengritja e përgjithshme e shqiptarëve e vitit 1912 sipas burimeve, Shkup, 2010, faq.19-21.
[15] Po aty…, faq.25.
[16] Skender Asani, v.p.e cituar, faq.33.

titjen e strategjive për aksione të armatosura në të gjithë Vilajetin e Kosovës dhe në viset përreth.[17]. Pas rigrupimit dhe forcimit të forcave shqiptare dhe sukseseve të arritura në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut 1912, qeveria xhonturke u detyrua të japë dorëheqje. Kabineti i ri qeveritar xhonturk dërgoi në Prishtinë Mehmet Pashë Derallën, për t'iu kundërvënë kërkesave të drejtuesve të kryengritjes shqiptare, të cilën e përfaqësonte Hasan Prishtina. Ky veprim shkaktoi përçarje midis drejtuesve të kryengritjes ngase disa drejtues të tjerë të Lëvizjes si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, nuk e panë të arsyeshme të përkrahnin grupin e Hasan Prishtinës për t'i përforcuar pozicionet e tij. Ndërkaq nga bisedimet e Prishtinës, të korrikut të vitit 1912, të udhëhequr nga Hasan Prishtina, pala shqiptare shtroi 4 kërkesa me karakter kombëtar të ngjashme me ato të Kuvendit të Junikut, me anë të së cilës synohej autonomia territoriale-administrative e Shqipërisë. Në këto çaste vendimtare Hasan Prishtina u bëri thirrje të gjithë forcave atdhetare të të 4 vilajeteve që të dërgonin përfaqësuesit e tyre për bisedime, por pjesëmarrja e tyre nuk u bë e mundshme ngase Komisioni qeveritar i nxirrte pengesa grupimit atdhetar shqiptar dhe kryengritësve shqiptarë.[18]. Mirëpo, rrethanat e krijuara politike e shoqërore jepnin sinjal se vendi ishte në prag të Luftës Ballkanike, prandaj Hasan Prishtina, duke qenë i vetëdijshëm për rrezikun e ndërhyrjes së Aleancës Ballkanike dhe gllabërimin e tokave shqiptare, në gusht të 1912, mori përgjegjësinë që t'i informojë drejtuesit e kryengritjes në Shqipërinë e mesme dhe jugore, se kërkesat shqiptare ishin pranuar duke i dhënë fund kryengritjes, gjë që për të cilën ky qëndrim i Hasan Prishtinës shkaktoi pakënaqësi te një pjesë e drejtuesve të Kryengritjes si Isa Boletini, Idriz Seferi, Mersim Dema dhe të tjerë, të cilët edhe përkundër thirrjes së Hasan Prishtinës për çarmatim ata i qëndruan stoik Kryengritjes deri në ditën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28.11.1912.[19]

[17] Ramiz Abdyli:Lëvizja kombëtare shqiptare 1911-1912, I-II, Prishtinë 2004, faq.432.
[18] Po aty.., faq, 433.
[19] Po aty…, faq.435.

Ndërkaq, rrethet më të përparuara e patriotike të vendit për ta shpëtuar vendin nga copëtimet ballkanike, më 14 tetor 1912, organizuan në Shkup një mbledhje në të cilën unanimisht u vendos që shqiptarët në mënyrë imediate t'i rrëmbenin armët për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe krijimin e një shteti të vetëm kombëtar të menaxhuar nga vetë shqiptarët. Andaj, disa nga pjesëtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u autorizuan të punonin për përzgjedhjen e delegatëve shqiptarë fillimisht në krahinat e çliruara të veriut të Shqipërisë. Një veprim të tillë politik e ndërmori edhe Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi me shokë jashtë atdheut, të cilët kishin shkuar për të lobuar dhe kërkuar mbështetje edhe të shteteve të Evropës për shpalljen dhe njohjen e sovranitetit të shtetit shqiptar, për arsye se ata tanimë kishin arritur në përfundim se zgjedhja e drejtë e çështjes shqiptare në kushtet e reja të krijuara nga Lufta e Parë Ballkanike ishte shpallja e pavarësisë dhe formimi i një qeverie të përkohshme shqiptare të zgjedhur nga një Kuvend Kombëtar me seli në Vlorë. Më 5 nëntor të 1912, gjegjësisht disa ditë para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Bukuresht të Rumanisë, u organizua edhe një mbledhje tjetër me kolonitë shqiptare të atjeshme, në të cilën u vendos që të krijohet një "komitet drejtues", i cili do të merrte në dorë qeverisjen e vendit. Ndërsa sipas sondazheve të bëra nga Ismail Qemali, në qarqet diplomatike të Vjenës vërtetuan se kancelaritë e Fuqive të Mëdha ishin në favor dhe në mbështetje për një Shqipëri autonome. Prandaj, fillimisht në Vlorë ishin dërguar 37 delegatë, ndërsa në ditën e dytë ky numër arriti në 63. Të gjithë delegatët ishin nga krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe përfaqësonin të gjithë trevat shqiptare pa dallime feje dhe krahine, duke filluar prej Shkodrës, Rrafshit të Dukagjinit të Kosovës në veri e verilindje, Dibrës, Strugës, Ohrit në lindje e deri në Çamëri në Jug. Pas shumë debatesh Kuvendi ditën e parë mori vendimin historik që Shqipëria të jetë **shtet i lirë në vete dhe i mosvarun**, ndërsa më 4 dhjetor 1912, delegatët shqiptarë nga të gjithë krahinat e Shqipërisë krijuan qeverinë e përkohshme shqiptare të kryesuar nga Ismail bej Qemali, kryeministër dhe zëvendësi i tij Nikollë Kaçori. Kabineti qeveritar ishte i përbërë prej disa digastereve ministrore si: Ministria e

Punëve të Brendshme, e kryesuar nga Myfyt bej Libohova, Ministria e Financave - nga Abdyl bej Toptani, Ministria e Mbrojtjes nga Mehmet Pashë Deralla, Ministria e Drejtësisë nga Petro Pogo, Ministria e Arsimit nga Luigj Gurakuqi, Ministria e Punëve Botore nga Mit'hat Frashëri, Ministria e Postës-Telegrafit-Lef Nosi.[20] Kuvendi kombëtar i Vlorës, veç tjerash zgjodhi edhe një pleqësi prej 18 vetash me në krye Vebi bej Dibrën, që ishte organ këshillues dhe kontrollues i qeverisë.[21].

Aktin historik të formimit të shtetit shqiptar të mbështetur nga forcat kombëtare shqiptare gjegjësisht aktin e pavarësisë, i cili i kurorëzonte luftërat shekullore të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, kryeministri i sapozgjedhur i Shqipërisë indipedente Ismail bej Qemali ua konfirmoi të gjithë krahinave të vendit nga të cilët u prit me ovacion të madh krijimi i saj. Për njohjen sovrane të shtetit shqiptar dhe krijimin e këtij realiteti të ri në jetën politike të kombit shqiptar, Qeveria e Vlorës ua konfirmoi zyrtarisht edhe miqve ndërkombëtarë të saj.[22]

Qeveria e Vlorës veproi në kushte shumë të vështira ngase ende vazhdonte Lufta e parë Ballkanike dhe vendi ende ishte i pushtuar nga trupa ushtarake turke, serbe, malazeze e greke, prandaj fillimisht ajo veproi në rrethet e Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit[23]. Kabineti qeveritar i kryesuar nga Ismail bej Qemali u tregua i suksesshëm në qeverisjen e vendit dhe u mbështet në përvojën e përparuar evropiane ngase mori masa të shpejta për organizimin dhe zhvillimin e vendit. Në kuadër të qeverisë së Vlorës u miratua "Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile", si ligj themelor i shtetit shqiptar në nëntor të 1913, por që nuk e kishte vlerën e një kushtetute të mirëfilltë, ngase nuk e definonte formën e qeverisjes monarki apo republikë, organet më të larta të pushtetit, kompetencat, raportet midis tyre etj, por me anë të saj vendi u nda në prefektura, nënprefektura dhe komuna. U ngritën

[20] Fjalor enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985, faq.587-588.
[21] Historia e popullit shqiptarë, v.p e cituar faq.116.
[22] R.H.Shënimi im…
[23] Historia e popullit shqiptarë, v.p. e cituar, faq.116-117.

gjykata shtetërore, forcat e armatosura kombëtare të policisë dhe xhandarmërisë etj. Qeveria mori në dorë të ardhurat financiare, doganat, u nënshkrua një marrëveshje për ngritjen e një banke, e cila nuk u realizua etj. Gjuha shqipe u shpall e detyrueshme në të gjithë administratën e vendit. U çelën shkolla shqipe, u rihap normalja e Elbasanit. Shumë të rinj u dërguan në studime jashtë shtetit. Në Vlorë filloi të botohej gazeta "Përlindja e Shqipërisë" etj.[24]

Në tetor të 1912, shtetet e Aleancës Ballkanike i shpallën Luftë Perandorisë Osmane, që ishte në favor të Aleancës, ngase ushtria turke pësoi disfatë dhe u tërhoq me humbje të mëdha. Kësisoj shpartallimi i ushtrisë osmane krijoi kushte të volitshme për realizimin e planeve pushtuese të shteteve ballkanike, por që ishin në kurriz të Shqipërisë, prandaj shqiptarët që sapo kishin përfunduar luftën kundër Turqisë, të sulmuar nga të ashtuquajtur aleatë ballkanikë u detyruan të zhvillojnë një luftë tjetër me ta për arsye se një pjesë e konsiderueshme e trojeve shqiptare tanimë ishin të pushtuara nga regjimi serb, malazez dhe grek. Brenda pak ditëve armata serbe pushtoi Prishtinën, Prizrenin dhe bashkë me forcat malazeze Gjakovën. Prej këtej një pjesë kaloi Drinin dhe nëpërmjet Dukagjinit iu drejtua Shkodrës që e rrethoi së bashku me forcat malazeze Mirëditën, Lezhën, Krujën, Tiranën dhe Durrësin. Trupa të tjera serbe pushtuan Kumanovën arritën në Shkup e Manastir dhe marshuan drejt perëndimit duke pushtuar Ohrin, Dibrën, Elbasanin. Ushtria greke pas fitores së Tesalit dhe në Epir rrethoi Janinën, pushtoi Sazanin dhe zbarkoi në Himarë, të cilën e pushtoi së bashku me disa fshatra përreth.[25]

Copëtimin e Shqipërisë nga të ashtuquajtur aleatë ballkanikë, diplomatët shqiptarë me në krye Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin dhe Isa Boletinin, ia paraqitën Konferencës së ambasadorëve në Londër, me të cilën menaxhonte ministri i Jashtëm britanik E.Grei, më 30 maj 1913. Në Konferencën e Londrës, Shqipëria ishte në qendër të vëmendjes. Pas shumë diskutimesh në mbledhjen e parë u vendos që Shqi-

[24] Po aty…, faq.117
[25] Fjalor enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985, faq.639

përia të shpallej shtet autonom nën sovranitetin e sulltanit, dhe e drejta që Fuqitë e Mëdha të caktojnë kufijtë e Shqipërisë, si dhe çdo çështje tjetër që kishte të bëjë me të, ndërsa me vendimin përfundimtar të 29 korrikut 1913, Shqipëria njihet si principatë sovrane duke përjashtuar çdo lidhje vartësie nga Perandoria Osmane. Në Konferencën e Londrës u vendos edhe për organizimin e brendshëm të Shqipërisë, gjegjësisht ai tanimë i lihej në dorë Fuqive të Mëdha, ndërsa roli i forcave kombëtare iu ngarkua një komisioni ndërkombëtar dhe organizimi i rendit iu besua oficerëve të huaj.[26]

Ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Londrës, ndonëse e pranuan krijimin e shtetit shqiptar, mirëpo në mënyrë krejt arbitrare lanë jashtë territorit shqiptar, gjysmën e territorit të vendit dhe gjysmën e popullsisë shqiptare si: Kosovën dhe viset e tjera shqiptare, Plavën, Gucinë, Kumanovën, Tetovën, Dibrën, Gostivarin, Strugën, Ohrin etj., që padrejtësisht iu dhanë Serbisë dhe Malit të Zi, ndërsa në dhjetor të 1913, me protokollin e Firencës, Çamëria dhe viset tjera në jug iu falën Greqisë.[27]

Përfundim

Rilindja Kombëtare Shqiptare konsiderohet se është periudha më e ndritur e lëvizjes së popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Ajo nëpërmjet elitës kombëtare shqiptare hartoi dhe jetësoi platformën afatgjate politike, shoqërore dhe arsimore kundër sundimit turk, ndërsa në kryengritjet e njëpasnjëshme kundër pushtuesve osman mori pjesë e gjithë popullata shqiptare.

Lidhja Kombëtare Shqiptare veprimtarinë e saj e zhvilloi në disa faza: faza e parë vitet 30-70-të kundër reformave centralizuese të Portës së Lartë, faza e dytë 1878-1881 me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, e treta 1881-1908 me formimin e Qeverisë së përkohshme të Ymer Prizrenit, Lidhjen e Pejës, formimin e komiteteve për lirinë e Shqipërisë dhe e katërta 1908-1912 me intensifikimin e kryengritjes së arma-

[26] Po aty…, faq.503
[27] Po aty.., faq.665

tosur kundër pushtimit osman dhe aktin historik të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, e cila ishte vepër dhe fitore e përbashkët e tërë popullatës shqiptare pa dallime feje dhe krahine. Formimi i Qeverisë së Vlorës nëpërmjet Kuvendit të saj e radhitën Shqipërinë dhe kombin shqiptar denjësisht krahas popujve të tjerë të Ballkanit dhe Evropës. Nëpërmjet qeverisë së Vlorës, u krijua për herë të parë ushtria mirëfilltë kombëtare, policia dhe xhandarmëria shqiptare, zbatimi i ligjit dhe i së drejtës, buxheti i shtetit shqiptar, ndërsa në fushën e arsimit ajo vuri në konjuktura dhe ndërtoi një sistem të mirëfilltë arsimor dhe të obligueshëm për djem dhe vajza shqiptare, duke mos u shkëputur nga tabani kombëtar por i mbështetur në përvoja të shteteve evropiane.

Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar:

- Akademia e shkencave të Shqipërisë: Fjalor enciklopedik shqiptarë, Tiranë, 1985
- Fjalor enciklopedik shqiptar, Tiranë 2002
- Grup autorësh: Historia e popullit shqiptar, Tiranë, 1999
- Historia e popullit shqiptar, Tiranë, 1996
- Ramiz Abdyli: Lëvizja e kombit shqiptar I-II 1911-1912, Prishtinë, 2004
- Skënder Asani: Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912, sipas burimeve bullgare, Shkup, 2010
- Shefik Osmani: Fjalori i Pedagogjisë, Tiranë, 1983

Mr.sc. Rrezehana Hysa

THE EFFORTS OF ALBANIAN PATRIOTS FOR THE ESTABLISHMENT OF AN ALBANIAN STATE AND THE ALBANIAN ISSUE AT THE CONFERENCE OF THE AMBASSADORS

(Summary)

The 5 century long efforts of the Albanians for freedom and the establishment of an independent state culminated during the Albanian National Renaissance, respectively, during the '30-'40s of the XIX century. This was an ideological movement, which was accompanied by military measures. The idea that the Albanians are the oldest people in the Balkans lies at the foundations of this movement. They seek the rights the other peoples in Europe already have to gain autonomy and the full independence of Albania, which was achieved on November 28, 1912.

رزهانة هوسا

جهود الوطنيين الألبان لإنشاء الدولة ألبانية و القضية الألبانية في مؤتمرC لسفراء

(خلاصة البحث)

äÇ حرب الشعب الألباني من أجل الحرية و إنشاء دولة مستقلة ألبانية خلال خمسة قرون حقق ذروتها خلال النهضة القومية الألبانية أي خلال السنوات ٣٠-٤٠ في القرن التاسع عشر والتي كانت أيضا حركة إيديولوجية واسعة و نضالا مسلحا. و كان أساسها إيمان الشعب الألباني و الآخرين أنهم أقدم شعب في البلقان بالتقاليد والثقافة واللغة الأم الذين يقاتلون من أجل حقوق متساوية كجميع الشعوب الآخرين في أوروبا للحصول على الحكم الذاتيæ من ثم الاستقلال الكامل لألبانيا في ٢٨ نوفمبر ١٩١٢.

Mexhid Yvejsi

40-VJETORI I XHAMISË, QENDRESË ISLAME SHQIPTARE-AMERIKANE PËR SHTETET NJU-JORK dhe NJU XHERSI

Më 12 nëntor 2012, u bënë 40 vjet nga dita e përurimit të Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane, e cila me kalimin e kohës erdhi duke e zhvilluar veprimtarinë në fushën jo vetëm fetare, por edhe në atë atdhetare, shoqërore, arsimore, edukative, kulturore...
Merita të veçanta kanë shumë veprimtarë, por këtu po veçojmë dy prijësit e parë të kësaj Qendre Islame, Myderrizin, Salih Efendi Myftia dhe Imamin, z.Isa Hoxha, për të cilët po paraqesim nga një jetëshkrim në shenjë nderimi dhe përkujtimi!

Feja Islame në Amerikë

Feja Islame në Amerikë, ishte e pranishme madje edhe para se të themelohen Shtetet e Bashkuara. Historianët kanë shënuar se deri në 30% e robërve zezakë nga Afrika të sjellë në Amerikë, ishin myslimanë.

Princi Abdul Rrahman nga Afrika Perëndimore, i liruar nga kryetari John Quincy Adams, më 1828, pas 40 vjetëve burgim, ishte një nga mijëra afrikanët myslimanë.

Myslimanët në Amerikë

Myslimanët nga Andalusia vizituan kontinentin amerikan para se evropianët ta "zbulojnë" atë që sot quhet Amerika Veriore, shumë vite para Kristofor Kolombos, siç ka shkruar Sharif el-Idrizi, në shekullin XII-të.

Myslimanët nga Afrika vazhduan ta praktikojnë fenë islame edhe në Amerikë, kjo binte në sy kur mblidheshin në vende të veçanta, private, ku kryenin faljen e namazit. Ruhen ende dy dokumente të vitit 1731, për myslimanët afrikanë, ku përmenden me emra dy besimtarë, të cilët ishin Ayuba Sulejman Diallo dhe Omar Ibn Said.

Omar Ibn Said (1770-1864) është një shembull, dëshmi, dëshmi e dokumentuar, i një besimtari të devotshëm, i cili erdhi në Amerikë, në vitin 1807. Lindur në vitin 1770 në Futa Tooro, sot Senegali, jetoi në Karolinën Veriore, edhe pse ishte skllav, e praktikonte fenë islame me përpikëri, me devotshmëri. Ka shkruar disa tekste fetare në gjuhën arabe, të cilat janë: Lutje Zotit, Si të lutemi, Namazi, Bismilah, Fazat Kur'anore, ka shkruar edhe një autobiografi.

Sipas një dokumenti kinez, i njohur si Sung Document i vitit 1178, shënohet se udhëtimi i detarëve myslimanë te një vend i njohur si Mu-Lan-pi (Amerika).

Abu Bekr, mbret mysliman i Perandorisë Maliane, në vitin 1310, ka udhëhequr një sërë udhëtimesh detare te Bota e Re.

Xhamitë në Amerikë

Xhamitë në Amerikë nuk shërbejnë vetëm si objekte fetare adhurimi, por ato shërbejnë edhe si objekte shoqërore, kulturore…Sipas një studimi me titull The Mosques in America: A National Portrait," (Xhamitë në Amerikë: Një Portret Kombëtar), Myslimanët në Shtetet e Bashkuara janë që disa brezni, shumica me prejardhje nga vendet arabe, që nga koha e Perandorisë Osmane, si Siria, Libani, Jordani. Shumica prej tyre janë arabë, turq, kurdë, shqiptarë..

Sipas studimit të lartpërmendur, xhamia e parë është ndërtuar nga shqiptarët në vitin 1915, në Main. Në vitin 1919, shqiptarët myslimanë themeluan xhaminë e dytë në shtetin Connecticut. Pas shqiptarëve, në vitin 1926, në Brooklyn, N.Y., tatarët nga Polonia themeluan një xhami.

Myslimanët afro-amerikanë themeluan xhaminë e parë në Pittaburgh, PA, në vitin 1930.

Komuniteti libanez e hapi xhaminë e parë në vitin 1935, në Cedar Rapids, Iowa.

Myslimanët afro-amerikanë, nën udhëheqjen e Shejh Daud Ahmed Fejsalit, themeluan xhaminë në Nju-Jork, në vitin 1955.

Sot në Amerikë janë mbi 3000 xhami, shumica prej tyre janë themeluar pas vitit 1970.

Shqiptarët në Amerikë

Ishte viti 1876, kur shqiptari i parë shkeli në truallin amerikan. Sipas disa burimeve, ky shqiptar ishte nga Korça, dhe më pas ndërroi drejtimin duke u spostuar në Amerikën e Jugut dhe duke përfunduar më pas në Argjentinë.

Ishte viti 1889 kur shqiptari i dytë, i cili vuri këmbën në tokën amerikane. Ky ishte Kolë (Nikolas) Kristofori, prej fshatit Katund të Korçës, që arriti në Amerikë. Ky është emigranti i parë shqiptar, që është regjistruar dhe i njihen gjeneralitetet.

Në vitin 1900, kur ende s'kishte Shqipëri, numri i shqiptarëve, të cilët jetonin në Amerikë ishte 42, kryesisht në shtetin Massach. Prejardhja e tyre ishte kryesisht nga jugu i Shqipërisë, dhe vinin nga zonat më të thella.

Sipas studiuesit Haris Sillajxhiç, në fundin e Luftës së Parë Botërore (1918) numri i shqiptarëve aty ishte 50 mijë.

40-vjetori i Xhamisë në Brooklyn, Nju-Jork

Pas Luftës së Dytë Botërore, për shkaqe të ndryshme, në veçanti për shkaqe politike dhe ekonomike rritet numri i shqiptarëve të shpërngulur në Amerikë. Shumica prej tyre vendosen në qytete të mëdha, të zhvilluara, siç janë Çikago, Detroiti, Nju-Jorku...

Në qytetin më të madh të Amerikës, në Nju-Jork, ishin të vendosur numri më i madh i shqiptarëve, tani jo vetëm nga Jugu i Shqipërisë, por edhe nga Veriu i Shqipërisë, shumica ishin myslimanë...

Duke u rritur numri i shqiptarëve myslimanë, rritej edhe nevoja për të themeluar një Qendër Islame, Xhami, që t'u shërbejë besimtarëve shqiptarë. Kështu, më 16 maj 1966, në Sheraton Atlantic Hotel të Nju-Jorkut, nën udhëheqjen e Salih Efendi Myftiut, u mbajt mbledhja e Kuvendit të Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane, në të cilën u miratua Kushtetuta Themeltare e Qendrës Islamike Shqiptare, prej nëntëmbëdhjetë pikash…

Në pikën e parë thuhet: Të themelohet Xhamia e Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane, për qytetet Nju-Jork dhe Nju Xhersi, e cila ka karakter fetar dhe ka për synim forcimin e moralit, zhvillimin e filozofisë islame ndër besimtarët myslimanë shqiptarë…

Mbas përpjekjeve të vazhdueshme rreth gjashtëvjeçare, edhe pse ishte plakur, kishte mbi 70-të vjet, nga gëzimi që shqiptarët myslimanë po themelojnë një Xhami, Salih Efendiu punonte si të ishte djalë i ri…

Më 12 nëntor 1972, Salih Efendi Myftiu me Bismilah e preu shiritin e Xhamisë në Brooklyn të Nju-Jork-ut, pranë së cilës ishin tubuar qindra besimtarë shqiptarë, që nga orët e hershme të mëngjesit, disa prej tyre të veshur me kostume kombëtare, sipas krahinave shqiptare…

Në mesin e masës së tubuar dalloheshin disa personalitete të shquara si Imam Isa Hoxha, Baba Rexhebi i Teqesë Bektashiane nga Detroit-i, dr. Rexhep Krasniqi, kryetar i Komitetit "Shqipëria e Lirë", etj. Aty dalloheshin edhe përfaqësuesit e medieve amerikane: Joseph Pa-

scal nga "Zëri i Amerikës" në Uashington, Robert Kessler i gazetës "The New York Times", reporteri i gazetës "Dayli News" të Nju-Jorkut, etj.

Kushtrimi për themelimin e kësaj xhamie madhështore u përhap si vetëtimë në mbarë botën, nga Amerika në Australi, e dëshmojnë urimet e përgëzimet që vinin në vazhdimësi…Kjo ndezi ndjenjat fetare dhe kombëtare ndër shqiptarët e mërguar, në një kohë kur në Shqipëri këto ndjenja ishin ndaluar…

Më 12 nëntor 1972, në orën 15:00, pas dite, Salih Efendi Myftiu me Bismilah e preu shiritin e Xhamisë në Brooklyn të Nju-Jorkut, pranë së cilës ishin tubuar qindra besimtarë shqiptarë, që nga orët e hershme të mëngjesit, disa prej tyre të veshur me kostume kombëtare, sipas krahinave shqiptare…

Mbas prerjes së shiritit, filluan urimet, përgëzimet e besimtarëve, përqafimet me përzemërsi, me lot në sy nga gëzimi për këtë xhami...

Kur besimtarët hynë në faltore, kryetari i Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane, z.Rexhep Kumbarçe, përshëndeti të pranishmit në gjuhën shqipe dhe anglishte dhe ia dha fjalën imamit të xhamisë, burrit të Malësisë së Gjakovës, z.Isa Hoxha, i cili ndër të tjera tha:

"Të gjitha falënderimet, lëvdimet, janë vetëm për Krijuesin e Gjithësisë. Vetëm Krijuesit i përulemi! Vetëm Krijuesin adhurojmë dhe vetëm Krijuesit i kërkojmë për udhëheqje në rrugën e drejtë!"

"O Zot fuqiplotë dhe mëshirues i madh!"

"Sot të bashkuem në kët vend të shejtë dhe në këtë ditë gëzimi për të festue hapjen e kësaj Qendre Islame Shqiptare-Amerikan në Brooklyn, Nju-Jork. te Ti së pari e drejtojmë mendjen dhe zemrën tonë për të kërkue ndihmën dhe bekimet t'Ueja për nji punë të mbarë e për mbarëvajtjen e popullit tonë shqiptar."

"Populli shqiptar, edhe pse shekuj me radhë ka kalue shumë valë e dallga të rrezikshme, prapëseprapë, po ai popull mujti me mbajtë besimin Islam, Katolik e Ortodoks."

"O Zot! Me rastin e inaugurimit të kësaj Qendre të Re të besimit islam shqiptar në qytetin e Nju-Jorkut, na përvujtnisht të lutemi t'i dhurojsh popullit shqiptar punë të mbarë, nder e lavdi dhe të derdhish

bekimet Tua mbi të gjithë ata besimtarë, të cilët sakrifikuan çdo gjë për ta ndërtuar këtë Qendër jashtë Atdheut... “

Pas imam Isa Hoxhës, z.Rexhep Kumbarçe, paraqiti folësin kryesor, të ditës nënkryetarin e Qendrës Islame, z.Mustafa Elezi, pinjoll i familjes të Jah Elezajve të Dragobisë, i cili, ndër të tjera, tha:

”Shpresoj se kjo Qendër nuk do të përdoret vetëm për predikime fetare, por do të shërbejë edhe si shkollë për edukimin e brezit të ri. Gjithashtu do të jetë edhe Qendra e afrimit edhe e mirëkuptimit e të gjithë shqiptarëve, prandaj me të drejtë do të quhet Qendër Fetare-Kombëtare...”

”Falënderoj të gjithë ata vllazën shqiptarë që kontribuen për themelimin e kësaj Qendre. Uroj që kjo Qendër e Re Fetare të ketë sukses në misionin e saj shpirtnor dhe kombëtar dhe njëkohësisht të bahet qendra e dashamirësisë të mbarë gjakut shqiptar...!”

Më 12 nëntor 2012 u bënë 40 vjet nga dita e përurimit të Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane, e cila me kalimin e kohës erdhi duke e zhvilluar veprimtarinë në fushën jo vetëm fetare, por edhe në atë atdhetare, shoqërore, arsimore, edukative, kulturore...

Merita të veçanta kanë shumë veprimtarë, por këtu po veçojmë dy prijësit e parë të kësaj Qendre Islame, Salih Efendi Myftia dhe Imam Isa Hoxha, për të cilët po paraqesim nga një jetëshkrim në shenjë nderimi e përkujtimi!

Xhamia, Qendra Islame Shqiptare-Amerikane, Brooklyn, Nju-Jork, themeluar më 12 nëntor 1972

Myderriz Salih Ef.Myftia, imam Isa Hoxha, veprimtar dhe nxënës të Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane në Brooklyn, Nju-Jork, 1973

Albanians Open a Mosque Here

The New York Times

Një shkrim me dy fotografi nga gazeta më e njohur amerikane "The New York Times" për hapjen e xhamisë në Brooklyn, Nju-Jork. Në fotografi: Myderriz Salih Ef.Myftia, kurse duke bërë dua dallohet Haxhi Koçi nga Dibra, Halit Demlushi nga Gjakova, Musli Mulosmana nga Malësia e Gjakovës..

Imam Osman Zaga, pasardhësi i Salih ef. Myftiut, Imam Isa Hoxhës, duke predikuar në xhaminë e Brooklynit, Nju-Jork

Xhemati i xhamisë në Brooklyn, Nju-Jork, duke dëgjuar me vëmendje predikimin e imamit, Osman Ef. Zaga

Pamja e brendshme e xhamisë në Brooklyn, Nju-Jork,
themeluar para 40 vjetësh, më 12 nëntor 1972

MYDERRIZ SALIH EF. MYFTIA (1891-1978)

**SHEMBULL I BESIMTARIT,
DIJETARIT
DHE ATDHETARIT…**

**ISH-MYFTIU I SHKODRËS
DHE I PREFEKTURËS
SË KOSOVËS,**

**LUFTËTAR KUNDËR
NAZI-FASHIZMIT
DHE KOMUNIZMIT…**

**THEMELUES I QENDRËS
ISLAME SHQIPTARE-
AMERIKANE,**

**PËR SHTETET NJU-JORK
DHE NJU XHERSI, NË SHBA,**

**UDHËHEQËSI SHPIRTËROR I
MYSLIMANËVE SHQIPTARË**

**NË SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS…**

*Myderriz Salih ef.Myftia
(1891-1978)*

"Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, e përveç të mençurve këtë nuk e kupton askush." *(Kur'ani, 2:269)*

Salih Efendi Myftia ishte një nga personalitetet më të njohura të botës shqiptare në atdhe dhe në mërgim…Një jetë të tërë, ky burrë i dheut, i shërbeu me përkushtim fesë dhe atdheut…

U lind në vitin 1891, në Shkodër, një nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë, djep i kulturës, ekonomisë, qytet i shquar për ndjenjat fetare dhe kombëtare…

Salih Efendi Myftia rrjedh prej një familjeje shumë të njohur besimtarësh, dijetarësh, atdhetarësh, që brez mbas brezi u përpoqën që të përhapin dritën e besimit, imanit, për të mbarën e vatanit…

Këtë rrugë e ndoqi me përkushtim edhe Salih Efendiu, por në rrethana krejt të ndryshme, herë më të mira, herë më të vështira… Përjetoi dy luftërat ballkanike dhe dy luftërat botërore, por fenë dhe atdheun kurrë nuk i la pas dore…

Gjatë shkollimit u dallua si nxënës, ndërsa pas diplomimit u shqua si mësimdhënës… Shërbeu edhe si imam në Shkodër, ishte edhe myderriz, në vitin 1927, shërbeu si myfti në Krujë, më vonë shërbeu si kryemyfti i prefekturës së Shkodrës dhe Kosovës…

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste, prill, 1939-shtator 1943, dhe nga Gjermania naziste, shtator, 1943-nëntor, 1944, Salih Efendi Myftia, jo vetëm që nuk u pajtua me pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi dhe nazizmi, por iu kundërvu atyre edhe me armë, derisa u internua në Gjirokastër…Sikur luftoi kundër fashizmit, nazizmit, luftoi edhe kundër komunizmit…

Më 28-29 nëntor 1944, kur Shqipëria u pushtua nga komunizmi, Salih Efendiu nga Shkodra, Shqipëria, u largua jo për të shpëtuar, por për ta vazhduar luftën kundër komunizmit …

E vazhdoi në forma të tjera edhe për 34 vjet, derisa ndërroi jetë… E vazhdoi veprimtarinë në katër kontinente, në Evropë, në Afrikë, në Azi dhe në Amerikë…

Në Amerikë u vendos në Nju-Jork, pranë djalit, dr. Fuad Myftiu (1924-2007), i cili u doktorua në drejtësi në Firencë, Itali, më 1951.

Me të ardhur në Nju-Jork, ku gjeti mijëra shqiptarë të emigruar për shkaqe politike dhe ekonomike, iu përvesh punës për organizimin e tyre në dobi të çështjes fetare dhe kombëtare.

Më 16 maj 1966, në Sheraton Atlantic Hotel të Nju-Jork-ut, nën udhëheqjen e Salih Efendi Myftiut, u mbajt mbledhja e Kuvendit të Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane, në të cilën u miratua Kushtetuta Themeltare e Qendrës Islamike Shqiptare, prej nëntëmbëdhjetë pikash…

Në pikën e parë thuhet: “Të themelohet Xhamia e Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane, për qytetet Nju-Jork dhe Nju Xhersi, e cila ka karakter fetar dhe ka për synim forcimin e moralit, zhvillimin e filozofisë islame ndër besimtarët myslimanë shqiptarë”…

Mbas përpjekjeve të vazhdueshme rreth gjashtëvjeçare, edhe pse ishte plakur, kishte mbi 70-të vjet, nga gëzimi që shqiptarët mysimannë po themelojnë një Xhami, Salih Efendiu punonte si të ishte djalë i ri…

Më 12 nëntor 1972, Salih Efendi Myftiu me Bismilah e preu shiritin e Xhamisë në Brooklyn të Nju-Jorkut, pranë së cilës ishin tubuar qindra besimtarë shqiptarë, që nga orët e hershme të mëngjesit, disa prej tyre të veshur me kostume kombëtare, sipas krahinave shqiptare…

Në mesin e masës së tubuar dalloheshin disa personalitete të shquara, si Imam Isa Hoxha, Baba Rexhebi i Teqesë Bektashiane nga Detroit-i, dr. Rexhep Krasniqi, kryetar i Komitetit "Shqipëria e Lirë", etj. Aty dalloheshin edhe përfaqësuesit e medieve amerikane: Joseph Pascal nga "Zëri i Amerikës" në Uashington, Robert Kessler i gazetës "The New York Times", reporteri i "Dayli News", etj….

Kushtrimi për themelimin e kësaj xhamie madhështore u përhap si vetëtimë në mbarë botën, nga Amerika në Australi, e dëshmojnë urimet e përgëzimet që vinin në vazhdimësi…Kjo ndezi ndjenjat fetare dhe kombëtare ndër shqiptarët e mërguar, në një kohë kur në Shqipëri këto ndjenja ishin ndaluar…

Salih Efendi Myftiu, në Qendrën Islamike Shqiptare-Amerikane të Brooklyn-it, Nju-Jork, shërbeu derisa ndërroi jetë, derisa shkoi në jetën e vërtetë, më 19 maj 1978, në moshën 87-vjeçare…

Hytbet, predikimet, ligjëratat, muhabetet, këshillat e tij, ishin plot urtësi, ishin shumë frymëzuese, shumë tërheqëse, rigjallëruese, për mendjet, zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të kombeve të tjera, të cilëve iu fliste shkurtimisht në arabisht, turqisht…

Salih Efendiu kishte një fjalor të pasur, fliste gjuhën shqipe pastër, një të folme si në Shkodër, kur fliste dukej si një bylbyl në kodër…

Ishte i afërt, i dashur, i ëmbël me të gjithë, kishte kënaqësi të bisedonte me rini, në veçanti me ne nga Kosova…

E pyeta njëherë: Myfti Efendi, pse po bën dallim? Ai u përgjigj: "Po, Mexhid i dashur, po baj pak dallim, sepse ju jeni, si të them, jeti-

më…”Kosova ka kenë, asht dhe do të jetë, kala e shqiptarizmit, Kosova do të jetë kala e islamizmit…! Djelmt e mi - pa Kosovë s’ka Shqipni…”

Salih Efendi Myftiu ishte i vogël me trup, por i madh me vepra, i përkushtuar në shërbim për Fe e Atdhe, në Shqipëri, në mërgim…

Ishte i madh në jetë, i madh në vdekje…Kjo u dëshmua, kur për tre ditë me radhë erdhën për ngushëllime, rreshta të gjatë, pa mbarim, nga bashkatdhetarët në mërgim, në shtëpinë mortore: “Frank Campbell-Funeral Home” në qendër të Nju-Jorkut…

Varrimi ishte madhështor, me lutje e me fjalime, nga përfaqësuesit e të gjitha besimeve, shoqatave, partive, enteve, që s’ishte pa asnjëherë në ato anë, kjo ishte befasi edhe për qytetarët amerikanë…

Për këtë jam dëshmitar okular…Jam dëshmitar vetë…

Salih Efendiun, All-llahu e shpërbleftë me Xhennet…

IMAM ISA HOXHA (1918-2001)

Imam Isa Hoxha ka qenë Imam i Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane në Brooklyn, për qytetet Nju-Jork dhe Nju Xhersi, e cila u themelua më 12 nëntor 1972…

Imam Isa Hoxha (1918-2001)

U lind më 25 maj 1918, në Bytyç, rrethi i Tropojës, në Malësinë e Gjakovës. Mësimet fillestare i kreu në Tropojë, ndërsa një vit ishte në Medresenë e Madhe të Gjakovës, kurse vitet tjera i vazhdoi në Medresenë e Tiranës.

Imam Isa Hoxha rrjedh prej një familje fetare dhe atdhetare, e cila ka qenë në ballë të Lëvizjeve Kombëtare…

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, familja e madhe e hoxhëve të Bytyçit ka luftua për çlirimin e atdheut kundër pushtuesve fashistë-nazistë dhe pas lufte kundër regjimit komunist…

Isa Hoxha, me kushëririn e tij, Ramizin, me pushkë në dorë ishin në Lëvizjen e Kryezive të Gjakovës, që përpiqeshin për çlirimin e Kosovës dhe për një Shqipëri Etnike, demokratike…

Diktatura komuniste, pjesëtarëve të familjes Hoxha, në rrethin e Tropojës, u konfiskoi pasurinë, si të tjerëve në gjithë Shqipninë, i futi nëpër burgje e kampe përqendrimi dhe kur erdhi përfundimi: dy prej tyre vdiqën në burg, ndërsa të tjerët vuajtën 132 vjet internim dhe burgim…!

Në vitin 1949, Imam Isa Hoxha u detyrua të largohet nga Shqipëria… Jetoi në fillim në Gjakovë, mandej nëpër Kosovë, Vojvodinë dhe Slloveni, për t'u shpërngulur në vitin 1959 në Trieshtë, Itali.

Gjatë qëndrimit në Itali, në Trieshtë gjeti shumë shqiptarë, që ishin shpërngulur nga trojet etnike për çështje politike dhe ekonomike. Këtu ra në kontakt me Imam Beqir Malokin nga Gjakova, i cili shërbente në Romë si Imam i Qendrës Islame dhe menjëherë u mirëku-

ptuen, që bashkëpunimi të fillojë sa më parë, në dobi të besimtarëve myslimanë shqiptarë…

Në kampet e Italisë, për rreth tre vjet, Imam Isa Hoxha u vu në shërbim të besimtarëve, duke iu lehtësuar dhimbjet shqiptarëve…

Prej vitit 1962, kur erdhi në Amerikë, Imam Isa Hoxha e vazhdoi veprimtarinë fetare-kombëtare, në dobi të çështjes shqiptare…

Në vitin 1972, në Brooklyn, Nju-Jork, u themelua Qendra Islamike Shqiptare-Amerikane, për qytetet Nju-Jork dhe Nju Xhersi, ku Imam Isa Hoxha shërbeu si imam në Xhami.

Xhamia madhështore u përurua më 12 nëntor 1972, ku Salih Efendi Myftiu, nga Shkodra, me Bismilah e preu shiritin e Xhamisë në Brooklyn të Nju-Jorkut…

Pranë xhamisë ishin tubuar qindra besimtarë shqiptarë, që nga orët e hershme të mëngjesit, disa prej tyre të veshur me kostume kombëtare, sipas krahinave shqiptare…

Në mesin e masës së tubuar dalloheshin disa personalitete të shquara, si Imam Isa Hoxha, Baba Rexhebi i Teqesë Bektashiane nga Detroit-i, dr. Rexhep Krasniqi, Kryetar i Komitetit "Shqipëria e Lirë", etj.

Aty dalloheshin edhe përfaqësuesit e medieve amerikane: Joseph Pascal nga "Zëri i Amerikës" në Uashington, Robert Kessler i gazetës "The New York Times", reporteri i gazetës "Dayli News", etj….

Kushtrimi për themelimin e kësaj xhamie madhështore u përhap si vetëtimë në mbarë botën, nga Amerika në Australi, e dëshmojnë urimet e përgëzimet që vinin në vazhdimësi…Kjo ndezi ndjenjat fetare dhe kombëtare ndër shqiptarët e mërguar, në një kohë kur në Shqipërinë komuniste këto ndjenja ishin ndaluar…!

Veprimtaria e Imam Isa Hoxhës nuk kufizohej vetëm me çështjet fetare në xhami, por ai përpiqej edhe për çështjen kombëtare, në veçanti, për Kosovë e Çamëri…shpesh thoshte:

"Nëse s'jemi atdhetarë, s'mund të jemi as besimtarë. Besimtari i drejtë duhet t'jetë edhe atdhetar i vërtetë. Pa Kosovë e Çamëri s'ka as Shqipni…!"

Për vite të tëra, Imam Isa Hoxha ishte në ballë të demonstratave madhështore pranë Pallatit të OKB-së në Nju-Jork, para Shtëpisë së Bardhë në Uashington dhe fjala, porosia e tij kishte peshë, kishte rëndësi, për Kosovë, Çamëri, për Shqipëri…!

E kam njohur për së afërmi, Imam Isa Hoxhën, këtë burrë Malësie; në Nju-Jork, ku banoja, e kisha, më kishte, mik shtëpie. Nga banesa ime te shtëpija e tij nuk kishte më shumë se 200 metra largësi…! Në Nju-Jorkun e madh, në Amerikën e largët, nuk e kisha askënd më të afërt…! Së paku, një herë në javë e vizitonim njëri-tjetrin, kështu për më se dhjetë vjet e vazhdonim muhabetin…!

Dy muaj pas përfundimit të luftës, pikërisht më 15 gusht 1999, me vullnetin e Zotit (xh.sh.), na u dha rasti të takohemi mbas afro 20 vjetësh, në zyrën e Myftiut të Kosovës, dr. Rexhep Boja, ku ishin të pranishëm edhe bashkëpuntorët e tij: Resul ef.Rexhepi, mr. Qemajl Morina, mr. Naim ef. Tërnava, kryeimami i Kosovës, Sabri ef. Bajgora e të tjerë…

Për dhjetë ditë, deri më 25 gusht 1999, Imam Isa Hoxha, me një delegacion nga Qendra Islamike Shqiptare-Amerikane, me kryetarin z. Nijazi Tonuzin, ishte mysafirë të Bashkësisë Islame të Kosovës…

Më 19 gusht 1999, ditën e Xhumasë, në Xhaminë e Madhe, në qendër të Prishtinës, ku edhe oborri dhe rrugët ishin mbushur përplot besimtarë e kureshtarë, Imam Isa Hoxha mbajti predikimin, të cilin e përfundoi me këto fjalë:

”O Zot! Për hir të Dëshmorëve të Kosovës, mëshiroje gjithë njerëzimin, në veçanti popullin shqiptar, kudo që gjendet, ndriçoje mendjen e tyre dhe shpëtoje prej mjerimeve e fatkeqësive…!”

Imam Isa Hoxha, përveç veprimtarisë fetare, arsimore, atdhetare, kulturore, kombëtare, është marrë edhe me krijimtari. Ka shkruar, ka botuar, shumë punime, studime rreth çështjeve fetare, filozofike, të cilat janë botuar, kryesisht, në revistën “Përpjekja jonë”, që botohej në Nju-Jork, nga Qendra Islamike Shqiptare-Amerikane, ka botuar edhe librin ”Të mësojmë Islamin”….

Mbas një veprimtarie 50-vjeçare, për çështje fetare dhe kombëtare, Imam Isa Hoxha ndërroi jetë në shtëpinë e tij, në qytezën Old Ta-

pan, West Wood, në shtetin Nju-Xhersi, në Amerikë, më 20 tetor 2001.

Me rastin e vdekjes, kancelari i Kryepeshkopatës Ortodokse Shqiptare në Boston, At Arthur Liolini, për Imamin Isa Hoxha, u shpreh kështu:

”Si At shpirtëror, i ndjeri Imam Isa Hoxha ka lënë një vend të zbrazët në zemrat e familjes së tij dhe të besimtarëve myslimane në rrethin e Nju-Jorkut në mbarë Amerikën. Por, ai ka lënë si trashëgim një jetë kushtuar Perëndisë me plot vepra të vyera, e të mbushura me shembuj të bekuar. Imam Isa ishte vërtet një bari i mirë: serioz në sjellje dhe në detyrën e tij si udhëheqës fetar, i qartë dhe i thellë e me ndjenja kombëtare. Për më tepër, ai kishte një zemër të pastër, ndërgjegje të çiltër, mendime dhe shprehje të urta dhe një frymë mikpritëse të ngrohtë. Janë të shumtë ata dhe ato që e deshën si njeri: dhe në mes atyre admiruesve jam edhe unë.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!”

At Artur Liolin

Boston

Varrimi i tij ishte madhështor, më 24 tetor 2001, në praninë e dhjetëra hoxhallarëve, të qindra, mijëra, atdhetarëve, që kishin ardhur nga çdo anë, mes tyre edhe qytetarë amerikanë, u përcoll me fjalime, me nderime, Imam Isa Hoxha, ky burrë i Malësisë, që një jetë të tërë ia kushtoi fesë, lirisë, Shqipërisë…

Shënim:

Autori i shkrimit, përkujtimit, që nga themelimi i Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane, në vitin 1972 deri në vitin 1982, ka qenë veprimtar në këtë Qendër, duke shërbyer herë-herë si imam, arsimtar, nënsekretar, reporter-gazetar...

Burimet kryesore:

1. Curtis IV, Edward E. Muslims in America: A Short History (2009).

2. Curtis IV, Edward E. Encyclopedia of Muslim-American History (2010).

3. Ghanea Bassiri, Kambiz. A History of Islam in America: From the New World to the New World Order (Cambridge University Press; 2010) chronicles the Muslim presence in America across five centuries.

4. Edwin E. Jacques, The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present, 1995.

5. Fischer, Bernd J. "Albanian refugees seeking political asylum in the United States: process and problems" in Journal of Ethnic and Migration Studies 31.1 (2005).

6. Smith, Jane I; Islam in America (2nd ed. 2009).

7. Përpjekja e Jonë (Our Effort) Vol.III, No.4, 1972, New York, 1972.

8. Vehbi Bajrami, Shqiptarët e Amerikës, Botuar nga Albanian Publishing, New York 2003, 1007 faqe.

Mexhid Yvejsi

40TH ANNIVERSARY OF THE ALBANIAN-AMERICAN ISLAMIC CENTER OF NEW YORK AND NEW JERSEY

(Summary)

On November 12, 2012, the 40th anniversary of the Albanian-American Islamic Center was marked Apart from religious activities, various activities (patriotic, social, educational, cultural, etc.) have been conducted in this center as well. Many people have contributed to its success but we will distinguish its first two leaders, Muderiz, Salih Efendi Myftia and Imam, Isa Hoxha. Herewith, we will present their biographies to honor and commemorate them.

مجد عويس

ذكرى ٤٠ للمسجد والمركز الإسلامي ألباني - الأمريكي للدول نيويورك ونيو جيرسي

(خلاصة البحث)

في ١٢ نوفمبر ٢٠١٢ مرت ٤٠ عاما من تاريخ افتتاح المركز الألباني - الأمريكي الإسلامي والذي مع مرور الوقت قام الى الجانب الأنشطة الدينية بالانشطة الوطنية والاجتماعية والتربوية والتعليمية والثقافية ...

و لهذا يرجع الفضل لكثير من الناس ولكن هنا نختص اثنين من زعماء هذا المركز الإسلامي و هما : المدرس صالح أفندي المفتي و الإمام عيسى خوجا و بهذه المناسبة نقدم نبذة عن سيرتهما تكريما لذكراهما !

Mr. Rexhep Suma

EFEKTI SERIOZ I MEDIEVE MBI STRUKTURËN FAMILJARE

Komunikologët, në vazhdimësi janë preokupuar me sferën e komunikimit me publikun dhe ndërlidhjet mes mjeteve të komunikimit masiv dhe publikut, gjegjësisht familjes. Në këtë botë konkurruese, ku gjigantët ekonomikë dhe ata të fushës së komunikimit ia lënë vendin njëri-tjetrit, globi është kthyer në një fshat global elektronik, ndërkaq informacioni është bërë malli dhe mjeti i parë (Madikiza & Bornman, 2007).,[1] dhe se komunikimi global është në një gjendje të vazhdueshme fermentimi dhe zhvillimi,(Mowlana,1996). Ai, jo vetëm virtualisht zë një vend mjaft të rëndësishëm, në të gjitha aspektet bashkëkohore të sistemeve globale, kombëtare dhe lokale, por i ka evidencuar botës gjithashtu disa kontradikta dhe pasiguri që kanë ekzistuar edhe më parë.[2] Mjetet e komunikimit masiv duhet të shihen si një dhunti (nimet) nga i madhi Zot xh.sh., që i ka vënë në shërbim të jetës dhe të mirës njerëzore, që me anë të tyre kemi arritur që të

[1] Madikiza, L& Bornman, E., "International Comunication:shiftting paradigms theories and foci of iterest", COMMUNICATO, Volume 33 (2), 2007, p.14.

[2] Mowlana,H.1996. *Global communication in transition:the end of diversity?* Thousand Oaks, Ca:Sage./ Mowlana, H. And L.J. Wilson.1990. The passing of modernity: communication and the trasnsformation of society.New York: Longman.

shkurtojmë distancat dhe hapësirat gjeografike, dhe si rezultat ka shndërruar planetin tokësor në një fshat global, ku emocionet dhe ndjenjat e njerëzve shkëmbehen mes tyre. Në këtë rrafsh masmedia luan rolin e veçantë në këtë rrugë zhvillimore duke qenë një partner në mos të jetë qenësore në formimin dhe emancipimin e njeriut në sferën edukuese si dhe në formësimin dhe krijimin e mendjeve për të përcaktuar pozicionet politike dhe në ndërtimin e aleancave të ndryshme ekonomike e ushtarake si dhe në ndërtimin e njeriut në aspektin edukativ dhe kulturor. Ndonëse në thelb Ironia është se gjithnjë është duke u folur për ndikimin e medieve mbi të gjitha aspektet e jetës, në veçanti familjen por ndikimi i saj në fenë e njeriut dhe dobësimin e tij në ruajtjen dhe kultivimin e fesë është i humbur ose është pothuajse fare pak. Është gabim të mendohet se mediet vizuale dhe ato të printuara, bota e hapur e internetit, Bluetoothi mund të rangohen në shkallën e "botës lajkatare" udhëton pa synime e objektiva, që synim ka komercializmin, argëtim apo mbushje e vakuumit media. Apo nga disa perceptohet si informim mbi aktivitetet protokollare politike. Kjo është vetëm një pjesë e realitetit mbi mediet, pasi që ato janë instrumente që mund të depërtojnë dhe të shkatërrojnë apo deformojë celulën e shoqërisë, familjen. Që siç tha një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë se "ne zhvillojmë luftë idesh në atë masë, siç zhvillojmë luftë kundër terrorizmit dhe sipas opinionit tim ju shihni në medie gjithnjë e më shumë po kemi më pak veshje dhe kjo është mënyra më e mirë për të depërtuar".

Tejet qenësor është fakti se kush i zotëron dhe kontrollon mediet dhe politikat e tyre

Mediet më të fuqishme, sot, gjenden në Perëndim, që ndryshe nga industria argëtuese, synojnë që botës islame t'i servojnë produkte që ata të pranojë dhe të dëgjojnë lajmet e ngjarjet dhe zhvillimet politike e kulturore nga këndvështrimi perëndimor dhe duke anashkaluar polemikat e opinionit nga këndvështrimi tjetër, dhe si të tillë të receptohet pa kurrfarë diskutimi mbi çështjet jetike që kanë të bëjnë me ne. Disa media kanë mision që të dëmtojnë rëndë imazhin dhe fotografinë e

islamit dhe myslimanëve duke i paraqitur ata si njerëz të prapambetur, duke i etiketuar si reaksionarë, injorantë dhe shtypës të të tjerëve duke publikuar modele anormale që nuk përfaqësojnë Islamin dhe ymetin. Po ashtu shtrembërimi i imazhit të islamit po ashtu duke e shpjeguar se është fe e prapambetjes sikurse thonë për poligaminë, rrahja me kamxhik, gurë, prerja e dorës si një lloj të arbitraritetit dhe shtypjes së të tjerëve. Po ashtu faqet e medieve kanë rrezikuar dhe dëmtuar duke mos bërë dallimin mes kasapit dhe viktimës, ku fshihen krimet e kryera kundër myslimanëve në Palestinë nga çifutët dhe të qeverive të tjera myslimane duke vënë theksin mbi pakicat sikurse ata po shtypen dhe si të tillë meritojnë pavarësinë, të tilla si ajo që ndodhi në Timorin Lindor etj. Ndër medie gjithnjë e më shumë po thellohet ndjenja e urrejtjes ndaj myslimanëve, dhe kjo është shumë e qartë pas 11 shtatorit, ku viktimë e këtyre ngjarjeve kanë rënë shumë myslimanë të pafajshëm. Pra, fajësia nuk është ndalur mbi kryesit e veprave terroriste porse urrejtja është zgjeruar në adresë të çdo myslimani duke thelluar frymën e armiqësisë ndaj myslimanëve, ***"Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive të juaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes."*** *(El Mumtehine, 8)*

Teoricienët e gazetarisë kanë dhënë definicione dhe përkufizime të ndryshme rreth asaj se çka konsiderohet media. Sa violent mund të jetë televizioni? Çfarë ndikimi mund të ketë në anëtarët e familjes, apo e shndërron televizioni shoqërinë në të sëmurë?

Në ç'shkallë është lidhshmëria mes filmit me dhunë dhe sjelljes agresive të të rinjve? Si është mbrojtja dhe kujdesi shpirtëror i shoqërisë? A stimulohen sjelljet kriminale prej skenave kriminale? A interpreton Audienca pamje televizive në mënyrën e drejtpërdrejt apo ia përshtatin mënyrën dhe stilit të tyre? A japin ide mediet se si audienca të shfaqë dhunë?

Mirëpo, duhet sqaruar faktin, se masmediat jo çdoherë janë promovuese të dhunës, apo prodhuese të vetë dhunës, pasi që nga kjo nuk varet nga ajo çdo gjë, por ato i nënshtrohen politikave të drejtpërdrejta të qarqeve, qoftë politike apo pushtetarëve dhe rrallëherë mediet janë treguar fitimtare para presioneve, të cilat kanë rezultuar në dobi të atij që bën presionin. Nëse ndalemi dhe analizojmë në esencë se nga buron dhuna, ajo fare lehtë mund të kuptohet, se buron nga kontesti historik dhe kulturor. Për dhunën edhe vetë perëndimorët thonë se rrënjët dhe zanafillën e lashtë e ka në vetë qytetërimin e lashtë të kontinentit, dhe njëherësh është pjesë përbërëse e identitetit kulturor. Kjo ka provokuar pozitivisht shkencëtarët dhe intelektualët që të organizojnë konferenca, tryeza dhe tubime të ndryshme me karakter shkencor për këtë çështje. Rasti më tipik është në Gjermani. Shoqata Gjermane e Psikanalizës, Psikosemantikës dhe Psikologjisë (GDPT) në vitin 2001 ka mbajtur konferencë me temën ”Dhuna dhe qytetërimi”, ku janë hedhur shumë ide dhe mendime lidhur me temën në fjalë. Një nga pjesëmarrësit e kësaj konference ishte edhe Alf Gerlahut, i cili, mes të tjerash, në këtë konferencë ka thënë se dhuna nuk është një dukuri që vjen nga jashtë, që është e huaj dhe e pashpjegueshme, por duket se ajo është pjesë e brendshme dhe ndoshta me një rëndësi të madhe në qytetërimin tonë të orientuar drejt progresit. Edhe media si një reflektim i prodhimeve dhe formimeve kulturore patjetër që është e ndikuar fuqishëm nga kjo kulturë, e cila në esencë ka dhe manifeston dhunë. Sa për ilustrim, në kohën e Perandorisë Romake ”Dhuna si mjet pushtimi, e kombinuar me dhunën si art dhe si kulturë masive, u bë joselektive, deri në atë masë sa provoi të viktimizonte edhe të dërguarin e Zotit, Jezusin (Isain)”.[3] Por, edhe në vetë letrat dhe shkrimet e veprat e kokave dhe gjenive evropiane nuk iu ka munguar aspekti i tematizimit të dhunës e të krimeve, dramaturgjia e rilindjes evropiane (dramaturgjia e Shekspirit), e cila është vazhduese e të njëjtit zhanër nga antika greke. Kryevepra “Hamleti”, e cila ende deri më sot mban të pushtuara skenat e teatrove evropiane edhe më gjerë, në esencë ka një

[3] Milazim Krasniqi, “Dhuna dhe qytetërimi perëndimor”, Logos-A, Shkup, 2006, f. 41.

fabul lidhur me krimin dhe shpagimin e krimit brenda familjes së oborrit mbretëror në Danimarkë. ”Ne vetëm mund të imagjinojmë, se sa emocione ka prodhuar kjo tragjedi e Shekspirit dhe sa vazhdon të prodhojë edhe sot, duke e tematizuar vëllavrasjen (mbretvrasjen), uzurpimin e sundimit, tradhtinë bashkëshortore, hakmarrjen dhe dëshirën e dashurisë. Se sa ndikojnë të gjitha këto ide dhe përmbajtje në relativizmin moral të shoqërive, nuk do të merret kurrë vesh nga njerëzia”.[4] Sipas ekspertëve të masmediave, nuk mund të neglizhohen, as të injorohen pasojat negative dhe të dëmshme të mjeteve të reja të komunikimit, sepse indiferenca ndaj këtyre pasojave mund të ketë dëme të pariparueshme për shoqërinë njerëzore.

Dhuna televizive, efektet e dhunës dhe të agresionit, sjelljet antisociale të fëmijëve

BBC-ja ka një politikë tashmë të konsoliduar prej kohësh, që ora nëntë e mbrëmjes të jetë ora kryesore e transmetimit të programeve të televizionit. Përpara saj, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, të gjitha programet në kanalet e brendshme duhet të jenë të përshtatshme për një publik të gjerë në të cilin përfshihen edhe fëmijët. Sa më herët të vendoset transmetimi i një materiali, aq më shumë mundësi ka që ai të shihet prej fëmijëve kur ata janë vetëm.

Megjithatë, BBC-ja pret nga prindërit që të marrin mbi vete përgjegjësitë për të gjykuar nëse një program i veçantë është i përshtatshëm për t’u parë nga fëmijët e tyre, apo jo. Kjo orë i kujton gazetarëve sa kujdes i veçantë duhet të tregohet lidhur me përfshirjen e skenave të mirëfillta të seksit dhe të akteve të dhunës, si edhe të përdorimit të gjuhës së vrazhdë.[5] Megjithatë, ekziston një rregull që TV-ja duhet të evitojë kapjen e publikut në befasi. Rreziqet që tregojnë fëmijët për imitimin e skenave të dhunës janë reale. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në lidhje me skenat e karatesë ose të përdorimit të armëve që janë lehtësisht të gjindshme prej fëmijëve, si p.sh. thikat, shishet apo

[4] Milazim Krasniqi, po aty, f. 59.
[5] Vlerat dhe standardet e BBC-së,f 47

edhe vetë litarët, që në shoqërinë tonë janë bërë mjete me anë të të cilave po kryhet një krim apo vetëvrasje. Por, gjithashtu është e rëndësishme që të mos fshihen apo të mos zvogëlohen pasojat e dhunës në jetën e përditshme. Një nga televizionet amerikane këtë e ka treguar në një raport dokumentar me anë të gjuhës së dokumenteve dhe statistikës. Në bazë të këtij raporti, në vitin 1999, projektet e programeve apo të filmave të pamoralshëm kanë qenë 3 në më shumë se 10 vjet. Po ashtu, në vitin 1989, programet e TV-ve filluan të japin filma të pamoralshëm me homoseksualë dhe në çdo 10 vjet ajo është rritur në 24%.

Në këtë raport thuhet se përdorimi i fjalëve të pista në vitin 1999, është rritur në 5,5% në krahasim me vitin 1989, dhe se dhënia e pamjeve të dhunës, po ashtu, ishte rritur ndjeshëm. Në bazë të disa statistikave të marra nga tri kanalet kryesore të televizioneve amerikane, CBS, ABC dhe NBC, del se ata në çdo javë japin të paktën 113 skena të agresionit me armë të ftohta, 92 raste të agresionit me armë zjarri, si dhe 9 raste mbytjeje dhe therjeje, 78 rrahje dhe 179 raste të shkeljes së ligjit. Ndërkaq, nëse i marrim për bazë të gjitha televizionet amerikane, që nuk janë të pakta, atëherë del se numri i këtyre skenave është shumë i madh dhe rezultati është fakt, se qytetarët amerikanë në çdo ditë të javës shikojnë skena dhune dhe kjo jo vetëm në filma, por edhe në raportet dhe emisionet e ndryshme.[6]

Urrejtja në skenat filmike shpie në rritjen e dhunës dhe përleshjeve në shoqërinë amerikane. Ndërkohë, Xhorxh Grenber dhe Teri Gras, dy analistë amerikanë, në bazë të studimeve të tyre, kanë arritur në përfundim se shikuesit e pasionuar të dhunës në televizion jetojnë në një botë të frikshme dhe se u besojnë shumë pak qytetarëve tjerë, duke u përpjekur të largohen nga bota reale. Po të shikojmë shoqërinë amerikane, ne i shohim shumë lehtë ndikimet e kësaj frike dhe mosbesimin. Masat e mëdha, të rrepta, të sigurimit në shtëpi, në qendrat blerëse dhe në vende të tjera, janë disa nga shkaqet tjera për këtë realitet,

[6] Prezantimi pa masë i dhunës në television http://groups.msn.com/ulqini/botainformatike.msnw?action=get_message&mview=0&ID_Message=837&LastModified=4675501353470745203 10/14/2004.

duke ecur edhe vetë SHBA-ja drejt një rreziku.[7] Këto mendime i mbështesin edhe disa organizata profesionale në SHBA, (ndër të tjera, Shoqata e mjekëve të përgjithshëm, Shoqata e mjekëve të fëmijëve, Shoqata e psikologëve dhe ajo e psikiatrisë), me ç'rast në vitin 2000 hartuan një deklaratë të përbashkët ku thuhej: "Në këto kohë ekzistojnë mbi 1.000 studime që konfirmojnë se tej mase është e lidhur dhuna e medieve dhe sjelljet agresive në disa fëmijë). Po ashtu, edhe në rrafsh global, disa studiues të ndryshëm për realitetet shoqërore të vendeve të ndryshme janë nxjerrë përfundime të argumentuara, të cilat jo vetëm ndryshojnë shumë, por janë edhe të kundërta. Për shembull, në vitin 1986, një grup ndërkombëtar shkencëtarësh publikuan të dhënat e një studimi panel, të realizuar në pesë shtete, të cilat në një masë të konsiderueshme përfaqësojnë disa karakteristika kulturore, kryesore, të katër kontinenteve të botës: SHBA-në, Australinë, Finlandën, Poloninë dhe Izraelin. "Nga hulumtimet në Poloni dhe në SHBA, studiuesit arritën në përfundim se shikimi i programeve me dhunë televizive përgjithësisht i stimulon të rinjtë polakë dhe amerikanë që të kenë prirjet për modele sjelljesh agresive.

Porositë televizive janë konstruksione për fëmijët

Studimet e shumta, të cilat janë bërë për të vlerësuar ndikimet e programeve televizive dhe shumica e studimeve mbi ndikimin e televizionit, kanë të bëjnë me fëmijët e kuptueshëm. Duke pasur parasysh vëllimin e madh të orëve të kaluara për të parë televizion dhe mundësitë e implikimit për socializim. Numri dhe frekuenca e akteve dhe e episodeve të dhunës u diagramuan për një sërë llojesh të ndryshme të programeve. Drama televizive shfaqet me karakter tepër të dhunshëm; ku mesatarisht 80 për qind e programeve të tilla përmbajnë dhunë me një frekuencë 7.5 episode dhune për orë. Madje, programet e fëmijëve kanë një shkallë më të lartë dhune, megjithëse vrasjet janë zakonisht më të pakta. Filmat vizatimorë përmbajnë numrin më të lartë të akteve

[7] Dr.Zyhdi Dervishi, Dhuna Televizive si metër psiko-kulturor, www.albpr.org.

dhe të episodeve të dhunës në krahasim me çdo lloj tjetër të programeve televizive.[8]

Komunikuesit e ndajnë mendimin se fëmijët me sjellje dhune janë vetë ata që zgjedhin apo që preferojnë programe me përmbajtje dhune, ngase kjo me njëfarë mënyre "mbush", mbështet mënyrën e sjelljes së tij, pasi, sipas teorisë së Shramit, fëmija i frikësuar emocionalisht zgjedh përcjelljen e programeve që përmbajnë dozë të madhe të dhunës, që si e tillë mbështet sjelljet e tij dhe qëndrimet e veta. Fëmija i frikësuar zgjedh këto programe, pasi që ndjen një jokomoditet në vetvete, gjë që mund të ndikohet nga dhuna televizive.[9]

Po ashtu, portretizimet në medie evokojnë imitimin, i cili është një element kyç në ndikimin e pamjeve televizive te fëmijët dhe të rinjtë, për të prodhuar dhunë. Industria televizive e reklamave synon që shikuesit të imitojnë atë që shohin.

Në shumë raste, të dënuarit për krime të rënda pohojnë se janë frymëzuar, apo kanë imituar me përpikëri aktorët e tyre të preferuar, të cilët kanë bërë të njëjtën vepër në një film. Televizioni mëson sjellje destruktive, sidomos te fëmijët, të cilët janë shumë të prekshëm nga kjo. Ata janë të gatshëm të imitojnë sjelljet violente të heronjve të tyre. Krimet, vrasjet e vetëvrasjet kryhen si pasojë e imitimit të pamjeve televizive. I tillë është rasti i fëmijës nga një fshat i Lezhës (Shqipëri), i cili vari vetën në vitin 1996, duke dashur të imitonte të njëjtën sjellje që kishte parë në televizor.

Mënyra se si një individ i interpreton arsyet e veprimit agresiv, pas vëzhgimit të tij, ka një efekt të madh në sjelljen agresive të mëvonshme. Kur ka një "dietë" të qëndrueshme media-dhunë shikuesi fiton një lloj desensibilizimi, si rrjedhim i të kuptuarit apo i njohjes në detaje të një agresioni të tillë.

Mbrojtësit e televizionit pretendojnë shpesh se nëpërmjet tij fëmija edukohet dhe se emisionet, ndonëse përmbajnë skena dhune, në thelb janë prosociale, pasi në të gjithat skenat e dhunshme televizive

[8] Anthony, Giddenc. "Sociologjia",botues Fondacioni Soros,2004 Tiranë f. 425.
[9] Ibrahim,Imam "El-ilam idhai vet televizjuni",darul fikr el arabij,Kajro, 1979 f .133.

triumfon i miri, apo e mira mbi të keqen. Në të vërtetë, fëmija nën 8 vjeç nuk e ndjek dot fabulën e ngjarjeve që sheh në televizor, por ai tërhiqet vetëm nga skenat spektakulare dhe agresive.

Shpjegimi i efekteve negative të dhunës te fëmijët ka mjaft rëndësi. Kur dhuna në programin televiziv përfundon pa gjak, pa plagosje, pa dëmtime të mëdha, kur heroi merr plagë të lehta, shikuesi, sidomos fëmija, nuk i sheh pasojat e dhunës. Kur agresioni paraqitet i justifikuar, ai sjell si pasojë më shumë sjellje të dhunshme në të ardhmen, sesa kur agresioni nuk është i justifikuar te vëzhguesi. Historitë e krimeve nuk janë dëshmi shkencore. Kështu, zbuluesit përdorin zbulime bashkëlidhëse dhe eksperimentale për të ekzaminuar efektet e shikimit të dhunës. Një teknikë, e përdorur gjerë me nxënësit, kërkon të dijë nëse e parashikon agresivitetin e tyre shikimi i televizorit. Në njëfarë mase kjo ndodh. Sa më e dhunshme është ajo që sheh fëmija, aq më agresiv bëhet edhe ai. Lidhja është modeste, por një dukuri e tillë është vënë re në SHBA dhe në Evropë.

Kjo na çon në përfundimin se një dietë me televizion të dhunshëm është thjesht ushqim për agresionin. Studiuesit kanë hedhur edhe tezën e kundërt, se fëmijët dhe personat e dhunshëm, në përgjithësi, kanë prirje për të parë dhunë televizive. Ose një faktor i tretë, p.sh., zgjuarsia e ulët bën që disa fëmijë të parapëlqejnë dhunën televizive dhe të sillen dhunshëm. Një nga debatet më të rëndësishme në kinema është vala e dhunës dhe ndikimi i saj negativ në shoqërinë humane.

Dhuna afatshkurtër dhe afatgjatë

Teoricienët e komunikimit, Bushman dhe Anderson, në një shkrim kritik me titull "Dhuna mediale dhe shoqërore amerikane", vënë theksin pikërisht në këtë të vërtetë. Ata bëjnë kërkesën për të drejtën themelore të njeriut, për një jetë të shëndoshë dhe larg dhunës. "Vëllimi i dhunës në mediet amerikane është shumë i madh dhe se analiza e më shumë se 8 mijë orë programeve satelitore dhe televizive amerikane tregon se 60 % e tyre është e mbushur me dhunë dhe se përqindja e prodhimit të filmave të dhunshëm kinematografikë, që nuk janë të

përshtatshëm për adoleshentët nën moshën 15-vjeçare, është gjithnjë e në rritje. Si shembull, në filmin "Vrasësit e lindur" të Kuentin Tarantinos duhet thënë se dhuna dhe vrasja janë të pranishme që në fillim të filmit, i cili është një film i përkrahur, që në fillim të daljes së tij. Në të vërtetë, shikimi i këtij filmi ka ndikimet e veta të pallogaritshme dhe të parikuperueshme te të rinjtë dhe në veçanti te fëmijët.

Megjithatë, gazetarët duhet të rrisin pasqyrimin e fëmijëve në medie dhe ta zgjerojnë atë edhe me analiza të gjendjes së fëmijëve në shoqëri. Po ashtu, ata duhet që të reflektojnë mbi dilemat etike të intervistimit të fëmijëve, si dhe për rrethanat e intervistës. Po ashtu, gazetarët duhet t'i trajtojnë fëmijët si gjithë njerëzit e tjerë dhe jo në mënyrë paternaliste, sensacionale, viktimizuese apo shfrytëzuese.

Duke pasur parasysh gjithë kujdesin që duhet treguar kur trajton fëmijët, gazetarët duhet të përpiqen të rrisin praninë dhe vizibilitetin e fëmijëve në medie:

* Gazetarët duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për gjuhën dhe termat e përdorur, sidomos kur pasqyrohet krimi dhe drejtësia për të mitur;
* Media duhet të përmirësojë dhe të punojë më shumë në drejtimin e përdorimit të fotove, arkivave të pamjeve dhe diçiturave;
* Gazetarët duhet të përpiqen të përfshijnë ekspertët për fëmijët dhe mendimet dhe të dhënat e tyre më shpesh;
* Gazetarët gjithnjë duhet të kenë parasysh përkufizimin e interesit publik të kodit të etikës, kur marrin vendime për të intervistuar fëmijët dhe për të botuar informacion rreth tyre.

Në apelin e tij për një Rend të Ri (RRBIK-NWICO) Masmoudi (1970)[10] komenton se :.." parimi i lirisë për informacion u shndërrua në liri e agjentit informues, dhe si e tillë, në një instrument dominimi në duart e atyre që kontrollojnë median". Studiuesit gjithashtu nënvizojnë se Perëndimi, veçanërisht SHBA-të, vërtet kanë përfituar nga nocione të tilla si "tregu i lirë i ideve" dhe "qarkullim i lirë informaci-

[10] Masmoudi, M., "The new world information orden", Journal of Communication 29: 1979,p. 172-198.

onit" dhe se këto koncepte u zhvilluan në rang ndërkombëtar krahas ekspansionit ekonomik amerikan dhe të perëndimit dhe shërbente për të justifikuar ekspansionin (Ayish, 2001; Thussu 2000, 2005). Meqë pjesa dërrmuese e burimeve mediatike botërore ishin përqendruar në vendet perëndimore, ndërmarrjet private perëndimore kishin më shumë përfitime nga mungesa e kufizimeve për qarkullimin në komunikim. Organizatat që kishin lidhje me median dhe komunikimin e përdorin parimin e qarkullimit të lirë për të sjellë argumente kundër barrierave tregtare për shpërndarjen ndërkombëtare të produkteve dhe shërbimeve të tyre si dhe ndaj përpjekjeve për të ndaluar mbledhjen e lajmeve brenda territoreve të vendeve të tjera.

Invazioni elektronik, kërcënon kulturat e vendeve periferike

Bizneset e perëndimit, nga ana tjetër, kanë përfituar nga reklama dhe marketingu që shoqëronte produktet dhe shërbimet e tyre në tregjet e huaja. Industritë e informimit dhe argëtimit të Perëndimit kanë shërbyer edhe për të mbështetur dhe superlativizuar mënyrën e jetesës së Perëndimit si dhe vlerat e kapitalizmit dhe liberalizimit në arenën ndërkombëtare.[11] Vendet e periferisë, për shembull, detyrohen të jenë të varur ndaj teknologjisë dhe investimeve të perëndimit, sidomos për produktet e medieve të Perëndimit, sidomos programeve televizive, të cilat bëjnë të nevojshëm importet e mëdha nga vendet e qendrës. Këto importe shërbejnë për të nxitur, ndonëse në mënyrë indirekte, stilin e jetës Perëndimore-amerikane si dhe mallrat dhe produktet perëndimore. Rezultati është një i ashtuquajtur invadim elektronik, që kërcënon kulturat e vendeve të periferisë dhe nxit një stil jetese prej konsumatori në kurriz të vlerave të komunitetit. "Termi ' imperializëm kulturor' përdoret kështu për të argumentuar se qarkullimi ndërkombëtarë i medieve, i të dyjave llojeve hardware dhe software, shërben për të forcuar vartësinë dhe për të penguar zhvillimin e vërtetë", (Ayish,

[11] Doc Jaup Zenuni,Komunikimi ndërkombëtarë, Tiranë 2011 f.47.

2005).[12] I lidhur ngushtë me 'imperializmin kulturor' është koncepti i 'imperializmit të medieve' i cili e vë theksin në mënyrë më specifike: "... te pabarazitë në media midis qendrës dhe periferisë dhe se si këto pabarazi pasqyrojnë çështjet e gjëra të varësisë, shfrytëzimit dhe hegjemonisë veçanërisht nga pikëpamja e medieve ndërkombëtare të dominuara nga Perëndimi si agjencitë e lajmeve, revistat, filmat, radiot dhe televizionet" (Boyd-Barret, 1977)[13]. Po ashtu në këtë vazhdë në ndërlidhje me konceptet e mësipërme është edhe koncepti i 'kolonializmit elektronik' që u referohet pabarazive në infrastrukturën e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, në hardvare dhe në rolin e Koorporatave Ndërkombëtare (Multinational Corporations) në këtë aspekt (McPhail, 1981).[14]

Në hiperkomercializimin dhe rritjen e kontrollit të korporatave lind edhe një anim politik implicit në përmbajtjen e medieve. Konsumarizmi, pabarazia klasore dhe individualizmi priren të konsiderohen si diçka natyrale, madje edhe fitimprurëse, kurse aktiviteti politik, vlerat qytetare dhe veprimtaritë kundër tregut margjinalizohen. Në Indi për shembull, të ndikuara nga gjigantët e medies globale, "...mediet e ristrukturuar të lajmeve... tani fokusohen më tepër te stilistët e modës dhe mbretëreshat e bukurisë se tek realiteti e zymta të një vendi të varfër dhe të dhunshëm", (Mishra, 2000).[15]

Në veçanti temë studimore është shtrirja e ndikimit nga mediet në individin nga mesazhi që bartin te masa. Ky ndikim ka bërë me atë që të hulumtohet kjo fushë dhe të përqendrohen në shpjegimin e llojit (masës) së ndikimit dhe natyrës së saj në formimin e opinioneve e vizioneve të ndryshme rreth çështjeve të ndryshme që janë me interes

[12] Ayish, M., "From 'Many voices, one world', to 'Many worlds, one voice': reflections on international communication realities in the age of globalization.", JAVNOST –THE PUBLIC 12 (3): 2005, pp.13-30.

[13] Boyd-Barret,O., "Media imperialism:towards an international framework for the analysis of media systems", in *Mass Communication and society.* J. Curran, M. Gurevitch and J. (eds), 1977, pp. 116-135. London: Edward Arnold.

[14] McPhail, T.L., *"Electronic colonialism: the future of international broadcasting and communication"*, Beverly Hills, CA: sage, 1981.

[15] Mishra, Pankaj., "Yearning to be great, India loses its way". New York Times, 16 September 2000, p.A 27.

për publikun. Për këtë çështje ka teori që janë përpjekur permanent që të japin përgjigje me pyetjen se a ndikojnë mediet?, Kur, dhe si ku secila teori ofron përgjigje mbi këtë bazuar në rrethana konkrete dhe nga këndvështrime të ndryshme. Të gjithë komunikologët janë të një mendimi se mediet janë me ndikim, por sa është ky ndikim, në çfarë rrethana dhe cilësie kjo është çështja që është ngritur në nivelin e debatit shkencor, ku ky motiv ka nxitur shkencëtarët e komunikimit publik që të hartojnë mijëra kërkime e studime shkencore për të konkluduar në ndikimin e medies (mesazhit) tek masa. Në saje të rëndësisë që kanë, kanalet e komunikimit kanë tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve. Veçanërisht në vitet 50-të - 60-të të shekullit të kaluar teoricienët e medieve i kushtuan mjaft vëmendje këtij elementi duke sjellë prurje të rëndësishme teorike. Kjo punë u bë e njohur sidomos nga teoricieni i komunikimit Marshall McLuhan (1984).[16], i cili hodhi për herë të parë në përdorim shprehjen "Media është mesazhi". McLuhan besonte se "media përmes së cilës shpërndahet përmbajtja e mesazhit ka po aq ndikim mbi perceptimin e kuptimit të mesazhit nga shoqëria dhe individi sa edhe përmbajtja që ajo përcjell. Më tej ai shprehej se çdo lloj i medies inkurajon nivele të ndryshme pjesëmarrjeje te personi që zgjedh ta konsumojë atë, dhe duke qenë se është kështu, media përmes së cilës një person ndeshet me një pjesë me përmbajtje të caktuar do të ketë ndikim mbi kuptimin që ky individ do të ketë për këtë përmbajtje.[17] Bazuar në studimet e reja dukshëm është rritur shkalla e ekspozimit e shikimit të fëmijëve ndaj televizionit që nga viti 1990 e tutje sa që është tepër e zakonshme kjo dukuri saqë mbi 90% e fëmijëve që s'kanë mbushur ende moshën 2 vjeçare përcjellin televizionin rregullisht.

Që nga shpikja e televizionit më 1950, ka evoluar dukshëm duke hyrë thellë në jetën familjare saqë më 1955, ¾ e familjeve amerikane

[16] McLuhan, M. (1984). Ihmisen uudet ulottuvuudet. 9english original: Understanding media: The extension of man. (1964) Juva: WSOY.

[17] Paivi Blom. "Choosing channels while acting as a channel: Perceptions of cross-border managers on mediated and strategy communication", aalto University, School of economics, department of languages and Communication", 2010, p.1

zotëronin një aparat televiziv. Kjo përhapje e shpejtë e teknologjisë së re është shquar edhe kur krahasohet me shpikjet e fundit të tilla si celularët dhe telefonat e ndryshëm, të cilët ofrojnë produkte janë shtyrë shpesh nga faktorët ekonomikë dhe faktorët rregullues. Njeriu në shikim të parë mendon se programet që përmbajnë dhe përçojnë mesazhe dhune janë vetëm formë argëtimi dhe nuk përmban vërtet efekte serioze. Psikologjia dhe studiuesja e fëmijëve, dr. Debra Kowalski, në këtë vazhdë shpjegon: "Fëmijët që kanë ekspozim kaq shumë në media, mesazhet që vijnë të gjithë ... janë shumë të rëndësishme dhe ato forma se si një fëmijë e sheh botën dhe atë që një fëmijë sheh si të rëndësishme .... Shumë nga mesazhet që lidhen me dhunën dhe seksualitetin mund të ndikojnë negativisht në botën e një fëmije.

"Përsëritja e dhunës në vazhdimësi detyrimisht i bënë fëmijët të jenë më depresivë. E njëjta gjë ndodh me të rriturit, por fëmijët në këtë rrafsh ndjehen dhe janë më të pambrojtur. Kjo vlen edhe për mesazhet të cilat përmbajnë skena seksuale. Në fakt, ekspozimi relativisht pak për materiale pornografike në një moshë të hershme mund të prishë një fëmijë në mënyrë të konsiderueshme dhe të ndërveprojnë me veprime tjera dhe jonjerëzoret. Ajo gjithashtu mund të ndikojë në mënyrën se si ata ndërveprojnë në raportet shoqërore me moshatarët, si dhe të krijojë ankth familjar dhe frikë në situata të tjera.

Michael Suman, koordinator i Qendrës për Politikën e Komunikimit në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxhelos, ka zhvilluar një hulumtim mbi efektet e medieve e në veçanti mbi dhunën që shkakton televizioni mbi fëmijët që zgjati tre vjet, doli në përfundim se skenat që shoqërohen me dhunë në televizion lënë tre efekte negative mbi individin:

1. Rrit masën e dhunës (violencës)

Studime të panumërta tregojnë se dhuna në televizion në fakt të çon në sjellje agresive, sjellje të që reflektohet dukshëm në sjellje dhe imitim. Duke ndjekur emisione me tematika apo skena që përmbajnë element të dhunës ata marrin edhe si model ata dhe fillojnë t'i imitojnë në jetën e tyre apo aktivitetet e tyre të përditshme.

2. Desensitizim dhe egërsi

Skenat apo mesazhet me dhunë që përcjellin mjetet e komunikimit masiv e në veçanti televizioni mbjellin ndjenjën e egërsisë te masa. Dhe si pasojë krijon sjellje që e bën njeriun të pashpirt ndaj njerëzve që kanë qenë viktima të dhunës." Ted Baehr, specialist i fushës së filmit dhe televizionit dhe botues në produksionin "Guide Movie", lidhur me skenën e dhunës në TV shprehet se "ne themi" kjo është ok, ne kemi parë atë në televizion. Kjo sjellje është e mirë. "Ne sikur këto skena t'i kishim parë vite më parë nuk janë objekt për sjellje (dhe gjuha) se disa vite më parë, ne sigurisht do të ishim të fyer e përçmuar do të kemi qenë të fyer nga ... Ne kemi bërë shumë desensitizim, dhe kjo vërtet është korruptuese.

3. Frikë

Skenat e dhunës i bëjnë ata (fëmijët) më të frikësuar. Fëmijët krijojnë idenë false se dhuna apo abuzimi ata i rrethon dhe është prezent në çdo qoshe dhe se nuk ka asnjë të mirë në këtë botë. Ndërsa kjo mund të jetë pjesërisht e vërtetë, ajo është mashtruese dhe mund të shkaktojnë dëme shumë gjatë fazave të zhvillimit të jetës.

Në sferën e sjelljeve dhe agresivitetin që mbjellin mediet me individin ka bërë që Dr. Jay Martin nga Universiteti i Kalifornisë Jugore në hulumtimin e tij empirik disavjeçar mbi 732 fëmijë, të konkludojë se këto skena mbjellin konflikte me prindërit, acarohen dhe luftohen me kolegët dhe delikuencës duke u lidhur me numrin total të orëve të shikimit të televizionit."

Nga kjo që u tha vetvetiu lind pyetja se a lejojmë që familjet tona të përcjellin emisione apo skena që në thelb kanë dhunë dhe agresivitet.

Përfundim

Elementi dhunë në media përbën një kërcënim të hapur për shëndetin publik dhe si e tillë shpie drejt apo vë në rritje dhunën dhe sjelljet agresive në familje. Lajmet e televizionit që kanë mesazhe dhune gjithashtu kontribuon në rritjen dhe shtrirjen e dhunës në mesin familjar që kryesisht po merr forma shqetësuese që nganjëherë po përfundon edhe me vetëvrasje. Nga ana tjetër, video-lojërat janë të aftë për të prodhuar një rritje në agresion dhe dhunë në afat të shkurtër. Aq më shumë ne si pjesëtarë të islamit kemi obligim që t'i ruajmë familjet tona nga çdo negativitet apo dukuri që bie ndesh me mësimet e Kur'anit dhe mësimet profetike, të cilat janë pusullë për jetën e myslimanit. ***"O ju që keni besua, ruane veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë*** *(zjarrin)* ***e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara."*** *(Et-Tahrimë, 6)*

Mr. Rexhep Suma

THE EFFECT OF MEDIA ON FAMILY STRUCTURE

(Summary)

Communicologues have been constantly concerned with the sphere of communication with the public, respectively, the interrelation between means of mass communication and the public, respectively, families.

In this competitive world with its revolving economic and communication giants, the globe has since been transformed into a global electronic village and information has emerged as a primary commodity and resource. The conclusion can be drawn that global communication is in a continuous state of ferment and evolution (Mowlana 1996).

رجب سوما

التأثير الجدي للاعلام في بنية العائلية

(خلاصة البحث)

الاختصاصيون في علم الاتصال كانوا قلقين بشكل مستمر في مجال الاتصال بالجمهور والتفاعل بين وسائل الإعلام والجمهورÃ í الأسرة .æهذا العالم التنافسي حيث عمالقة الاقتصاد يتركون أماكنهم لبعضهم البعض و تحول العالم اليوم الى قرية عالمية إلكترونية فى حين تحولت المعلومات الى سلعæ الوسيلة الأولى (ماديزيكا و بورنمان ٢٠٠٧) و أن الاتصال العالمي في حالة مستمرة من التخمير والتنمية (مولانا، ١٩٩٦) .

Sedat Islami

QASJET E MEDIAVE NDAJ TË DREJTËS FETARE ISLAME NË PERIUDHËN E PASLUFTËS NË KOSOVË

Abstrakt

Kosova në periudhën e pasluftës është duke u përballur me probleme nga më të ndryshmet. Papunësia e madhe, varfëria e skajshme, përqindja e së cilës për çdo ditë shënon rritje, mungesa e sundimit të ligjit, krimi i organizuar janë disa prej këtyre problemeve por jo gjithsesi të vetmet. Shqetësuese në këtë periudhë transicioni mbetet edhe respektimi i të drejtave dhe lirisë së njeriut. Ky punim mëton të hedhë dritë mbi të drejtën fetare dhe qasjet në trajtimin e saj në mediet kosovare në periudhën e pasluftës. Fokusimi bëhet në të drejtat e komunitetit fetar më të madh në vend, ndërsa boshti i diskutimit sillet rreth tri çështjeve më të debatuara: të drejtës për vënien e shamive në shkollat publike, futjen e një lënde fetare në kuadër të shkollave publike, dhe ndërtimin e një xhamie të madhe në kryeqytet për nevojat e besimtarëve.

Hyrje

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë një ndër temat që debatohen shpesh dhe shumë. Megjithëse ekzistojnë karta dhe dokumente shumë të rëndësishme që mbrojnë ato në thelb dhe parim, prapë, shkelja e tyre apo edhe keqinterpretimi bën që kjo temë të aktualizohet kohë pas kohe. Viteve të fundit për të drejtat është debatuar mjaft shumë edhe në Kosovë. Në fokus ka qenë e drejta fetare, një nga ato shumë të drejtat e njeriut që garantohen me ligj. Në fakt, në rastin tonë, ligji ka qenë ai që ka ndezur debatin, i cili ndonjëherë ka marrë karakter zhvillimi edhe në rrugë, respektivisht janë organizuar protesta, për të shprehur pakënaqësinë përkitazi me privimin nga të drejtat fetare.

Debati ka qenë lajm gjatë kohës, kështu të përfshirë në të nuk kanë qenë vetëm qendrat vendimmarrëse por edhe të tjerë. Ky punim mëton të hedhë dritë mbi qasjen e medieve ndaj kërkesave për të drejtat fetare. Për të nxjerrë përfundimet më koncize, punimi përqendrohet në tri prej të drejtave që janë debatuar më së shumti: e drejta e vijimit të mësimit apo edhe punësimit me shami, e drejta e edukimit fetar në shkollat publike, dhe ndërtimi i një xhamie të madhe në qendër të kryeqytetit. Fillimisht, kam bërë një përmbledhje të qëndrimit të medieve ndaj të drejtës fetare e më pas kam diskutuar për pikat e sipërpërmendura. Kam ndjekur një metodologji të atillë që për pikën për të cilën kam diskutuar, paraprakisht, edhe pse shumë shkurt, kam paraqitur konceptin fetar për të, në mënyrë që debati të marrë qasje konstruktive. Jam bazuar kryesisht në edicionet *online* të lajmeve ndërsa kam ko

nsultuar edhe literaturë shtesë. Punimin e kam përmbyllur me rezultatet e tij dhe rekomandimet që dalin prej tij ndërsa më pas kam përshkruar edhe literaturën konsultuese.

I. POZITA E SË DREJTËS FETARE

"Në çka t'i përkujtoj ata kundërshtarë, të cilët po qe se ndonjëri nuk iu pëlqen, së pari e paraqesin atë në formë të devijuar, e më pas orvaten që ta zhdukin porsi lugati."

(J.W. Gëte, "*Dichtung und Wahreit*", Band 16.1)

1. IKJA NGA DISKUTIMI PËR PROBLEMET THELBËSORE

1.1. Definimi i pozitës juridike

Pozita juridike e bashkësive fetare në vend vazhdon të mbetet e padefinuar ende, edhe pse qe parashtruar kërkesa disa herë dhe qenë marrë premtime se do të procedohej në Kuvendin e Kosovës, në periudhën më të shpejtë të mundshme. Moszgjidhjes së këtij problemi tash e 13 vjet i faturohen të gjitha problemet fetare në vend, nëse veç ka probleme të tilla. Në fakt, jo të gjitha bashkësitë fetare në vend nuk e kanë të zgjedhur këtë çështje. Kisha Ortodokse, siç do të shprehej një politikan yni, *"... është institucionalizuar si pjesë e Pakos Ahtisari, me atë emër dhe me këtë strukturë..."*[1]

Do të kishte qenë mirë që mediet të ngrinin për diskutim këtë çështje ngase, nëse dikush do të duhej të mos gëzonte asnjë privilegj në Kosovë, për shkak të kaluarës së papastër është pikërisht Kisha Ortodokse, liderët e së cilës madje edhe sot vazhdojnë ta injorojnë shtetin tonë dhe të provokojnë probleme.

1.2. Mosshfajësimi i faktorit fe

Përderisa BIK-u nuk ka një pozitë të caktuar, madje as si komunitet fetar, atëherë t'i drejtohet gishti për probleme të ekstremizmit në vend është pakuptimësi e llojit paradoks. Në media, jo rrallë, ndodh që për probleme që do të duhej drejtuar rendit dhe ligjit të akuzohet

[1] "BETIMI I SHKELUR", Petrit Selimi, gazeta Express, 05 Shtator 2011.

BIK-u padrejtësisht, me gjithë thirrjet e krerëve të saj për mbikëqyrje dhe kontroll më të rreptë nga organet gjegjëse[2].

Po kështu, do të kishte qenë mirë sikur mediet të ishin më transparente dhe të zbulonin të vërtetën se, jo vetëm vendi ynë, por i tërë Ballkani vuan nga ekstremizmi, pro jo ai fetar.

1.3. E drejta demokratike

Demokracia është përvetësuar si sistem shoqëror që të gjithëve ua njeh të drejtën për të kërkuar të drejtat e tyre. Një prej formave të kërkimit të këtyre të drejtave mbetet edhe protesta. Në rastin e protestave për të drejtat fetare shohim se interpretimi i demokracisë bëhet ndryshe[3]. Përkundrazi, këtë të drejtë ndonjëherë e paraqesin si vijë ndarëse ndërmjet të ligjshmes dhe të paligjshmes. Duke mos dashur të flas për kundërthëniet apo jo ndërmjet BIK-ut dhe lëvizjes "Bashkohu" rreth organizimit të protestave, ajo që dua të them se protesta, përderisa lajmërohet dhe nuk eskalon, është formë demokratike e shprehjes së pakënaqësisë. Thirrjen e medieve për të shpërfillur dhe injoruar protestat për të drejtat fetare[4] e shoh më shumë si një tentativë për të çorientuar dhe tëhuajësuar kërkesat për të drejtat fetare sesa që njëmend synojnë rrahjen e këtij problemi (legjitimitetin e protestës).

Kushdo që ka përcjellë zhvillimet gjatë kohës sa organizoheshin këto protesta ka mundur të vërejë qartë rolin konstruktiv të BIK-ut, të cilët nuk ishin asnjëherë kundër protestuesve porse donin që kërkesat, përderisa BIK-u është institucioni i vetëm fetar islam në vend, të përcilleshin përmes tij. Kjo është dëshmuar edhe me rastin kur Myftiu Tërnava bën thirrje nëpërmjet RTK-së për anulim të protestës, ndërsa përgjigjet pozitive vijnë ende sa ai ishte në emision.

---

[2] "Tërnava: Të ndalohet hyrja në Kosovë e të huajve që prishin imazhin e fesë islame", Bota Sot, 26.03.2012.

[3] "Lëvizja Bashkohu" ngre kokën prapë!, portali Kosovapress, 26 Shtator 2011.

[4] ""Bashkohu", nuk përfill Bashkësinë Islame, mban protestë për shami", gazeta koha ditore, 23.09.2011.

Këtë kemi mundur ta vërejmë edhe atëherë kur më shumë shprehet frika për kinse eskalim të situatës sesa për atë se këtyre që po protestojnë iu është shkelur e drejta[5].

Një devijim tjetër nga e drejta demokratike qenësore mund ta hasim edhe në rastin e pasqyrimit të organizimit të zgjedhjeve brenda Bashkësisë Islame. Kjo pjesë diskutimi nuk dua të tingëllojë sikur mbaj anën e zyrtarëve. E drejta mbetet e drejtë, ndërsa hoxhallarët nuk janë të pa gabime. Shqetësimet e ngritura, të paktën, meritojnë të diskutohen, por, shpërpjesëtimi i pasqyrimit të së vërtetës[6] dhe mungesa e referimit burimeve të sakta[7] ngjallin dyshimin për qëllimet jo të mira të medieve karshi myslimanëve si tërësi, ndërsa BIK-ut, si organ udhëheqës në veçanti.

Këtë e bëjnë edhe në raste tjera. Kjo më konkretisht ka të bëjë me raportin "amerikan" të Stephen Suleyman Schvartz, i njohur për qëndrimet negative ndaj myslimanëve të Ballkanit, i cili, për çudi interpretohej si RAPORT AMERIKAN[8], ndërkaq çudia nuk është pse i jepnin ngjyrë që tingëllonte zyrtare, porse ishte në kohën kur organe zyrtare të SHBA-ve shprehnin admirimin e tyre për figurën e Myftiut dhe rolin e tij konstruktiv në ruajtjen e stabilitetit në Kosovë[9].

Tek 'e drejta' hasim median të luajë një lojë me standarde të dyfishta. Nuk përkrah të drejtën e natyrshme, siç është shamia p.sh., ndërsa, për të shprehur nënshtrimin ndaj politikës, përkrahin të drejtat e shthurura, siç kemi të bëjmë me homoseksualizmin[10].

---

[5] "Shkatërrimi i feve rivale në emër të fesë së drejtë", Bota Sot, 30.06.2011.

[6] Palës së pakënaqur i jepet hapësirë më shumë se organit ekzekutiv. BIK-u emëroi shumicën e atyre që nuk fituan për kryetar Këshilli, Bota Sot, 20.03.2012; "Imami i Podujevës e padit në EULEX Tërnavën", Bota Sot, 18.03.2012; "Bilalli: Dallaverxhitë kundër sindikatës së BIK-ut", Bota Sot, 15.09.2011.

[7] "Nuk falsifikohen zgjedhjet vetëm në politikë, ashtu bën edhe BIK-u", Bota Sot, 16.03.2012.

[8] "Raporti amerikan: Naim Tërnava vehabist në BIK", Bota Sot, 26.03.2012.

[9] "WikiLeaks: Me BIK-un nuk ka mosmarrëveshje ndaj politikës së SHBA-së", Bota Sot, 10.09.2011.

[10] "TA MBROJMË HOMOSEKSUALIZMIN", gazeta Express, 6 dhjetor 2011.

2. NJËANSHMËRIA

Mediet nuk kanë ngurruar të shfaqin mërinë e tyre ndaj fesë islame. Kanë përfituar nga rasti për ta sulmuar kohë pas kohe apo për ta manifestuar urrejtjen e tyre ndaj saj. Ndonjëherë sheh se aq janë naivë saqë lidhen edhe për gjëra tejet simbolike, siç ishte rasti me ceremoninë e *synetisë*[11], që ndonëse vetëm si rit, ata e shihnin si një mënyrë që Turqia mundohet ta rikthejë ndikimin e vet në vendin tonë. Ndonjëherë has edhe në thirrje të atilla për ndërrimin e emrave të xhamisë ngase kanë emra "pushtuesish"[12].

Mediet nuk hezitonin ta ironizonin kërkesën (për të drejtë) fetare, siç ishte shkrimi i tashmë një zyrtari të lartë "HOXHA N'SHKOLLË" [13] sikur që shërbeheshin me shembuj nga brenda dhe jashtë vendit vetëm e vetëm për ta pasqyruar Islamin sa më të vrazhdë[14]. Dr. Murad Hofmann citon Salvatoren të ketë thënë: *"Mediet gjithnjë e më tepër, indoktrinojnë dhe, në mënyrë mjaft efikase, nxitin mendimin se, Islami është një religjion i pashpresë dhe mjaft i vjetruar, i cili është larguar nga reforma dhe arsimi, e kështu ka mbetur në shekullin më të errët, të mesëm.* [15]

Ja disa raste konkrete. Rasti i humoristit Rasim Thaçi, i cili u sulmua fizikisht për shkak të ofendimeve që ua bënte myslimanëve në skeçet e tij humoristike, e trajtonin si dhunë nga ekstremistët, ndërsa nuk e diskutonin fare në ishte apo jo provokim dhe ofendim i një ko-

---

[11] http://www.kosovarimedia.com/index.php/art-dhe-kultur/9851-revista-shqiptari-kushtuar-zt-asllan-dibrani.html Këtu Asllan Dibrani nuk ngurron madje të më quajë tradhtar vetëm pse kam falënderuar KFOR-in Turk…

[12] "Xhamitë ende me emërtime të ish- pushtuesve", gazeta Express, 26 shkurt 2012.

[13] "HOXHA N'SHKOLLË", gazeta Express, 4 tetor 2011.

[14] Shih se si është pasqyruar lajmi për dënimin e një gruaje që bënte magji ("Këtë dënim me vdekje mund ta marrë secili prej nesh", Bota Sot, 19.04.2012.); atij që piu alkool ("Piu alkool – u godit 80 herë me kamxhik!", gazeta Express, 12.04.2012.); martesës në moshën pesëvjeçare ("PESË VJEÇ NUSE!", gazeta Express, 09 Prill 2012.) sigurisht pas përhapjes së lajmeve gjithandej për pedofilinë si dukuri në ambiente kishtare dhe të krishtera; e madje edhe festat (datat) tona fetare i paraqesin kësisoj ("DY HERË VIT I RI", gazeta Express, 01 Janar 2012.)

[15] Cituar sipas: Hofmann, Murad, *Islami në mijëvjeçarin e tretë*, f. 93.

muniteti të tërë[16]. Nuk dua që të keqkuptohem sikur po arsyetoj sulmin e bërë ndaj tij, ngase fetarisht dihet se në ç'rrethana aplikohet masa ndëshkuese dhe kush e bën një gjë të tillë, por po them se nuk po çahet viktima.

3. NGRITJA E DISKUTIMEVE TË NXEHTA

3.1. Sfidimi i teorive fetare

Kjo mbase mund të jetë ngritje në mënyrë të heshtur e tezave që bien ndesh me fenë. P.sh. pikënisja dhe fillimi i gjithësisë, qëllimi i ardhjes në këtë botë, etj...[17]

3.2. Diskutimi për çështje delikate

Diskutimi për të drejtat merr kahe të kundërt dhe aspak të hijshme kur ato ndërlidhen me të kaluarën. P.sh. shamia, xhamia, lënda fetare shihen si një lloj lidhjeje me historinë osmane, të cilën dinë ta kumtojnë vetëm barbarisht. Ndonjëherë marrin edhe rolin e një arbitri dhe vendosin se kush ç'tabori fetar i përket[18], sikur që dinë të prekin shqiptarët në pikën e dobët të tyre, në komb apo elemente të imagjinuara të tij, siç është p.sh. Kanuni i Lekë Dukagjinit[19].

3.3. Ngritja e shqetësimeve të paqena

Për të zhvendosur vëmendjen e popullit nga problemet madhore, mediet dinë t'u rreken edhe problemeve që fare nuk ekzistojnë. Ndonëse u tha shumë se në Kosovë, megjithatë, nuk ka ekstremizëm dhe radikalizëm islamik[20] dhe se Kosova nuk rrezikohet nga ekstremizmi

[16] "Kush dhe pse e sulmoi humoristin Rasim Thaçi - Cimën?", Bota Sot, 19.04.2010.
[17] "Jemi kudo!", Bota Sot, 10.03.2012.
[18] "Si po krijohen dy kampe tradicionalët dhe radikalët myslimanë?", Bota Sot, 15.03.2012.
[19] "Fashizmi islamik kundër Kanunit të Lekë Dukagjinit", gazeta Express,03.12.2011.
[20] "Kosova mban larg elementët radikalë islamikë", gazeta Bota Sot, 28.05.2012.

por nga varfëria e papunësia e madhe[21], mediet prapë imagjinonin luftën kundër terrorizmit islamik.

4. NEUTRALITETI

Mediet dinë të ruajnë një lloj distance vetëm atëherë kur konstatimet për një çështje të caktuar vijnë nga organe, deklaratat e të cilëve nuk mund t'i komentojnë a interpretojnë ndryshe[22].

II. TRI TË DREJTAT FETARE MË TË DEBATUARA

"...prapëseprapë, nuk mund të mohohet se para së gjithash, zëdhënësit e rregullimit joreligjioz, ata që anojnë kah ateizmi, ndihen të thirrur të jenë gazetarë dhe se mediet, edhe në sferën e religjionit me vetëdije të plotë merren me politikë."

(Dr. Murad Hofmann, "Islami në mijëvjeçarin e tretë", f. 91.)

1. SHAMIA

1.1. Si perceptohet shamia në Islam

Shamia është një prej obligimeve të domosdoshme fetare për femrën myslimane. Është urdhër, të cilin në formë të prerë, Zoti e sjell në Kur'anin Fisnik.

"O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i vënë shamitë *(mbulojë)* ***e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen*** *(se nuk janë rrugaçe)* ***e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues."*** *(Kur'ani, 33:59)*

---

[21] "Kosovarët nuk e kanë problem ekstremizmin fetar, por papunësinë", gazeta Express, 18.11.2011.

[22] P.sh. deklarata e KMLDNJ-së me rastin e sulmit fizik ndaj Kryeimamit të Kosovës ("Dhuna fizike nuk i ka hije një imami", portali Kosovapress, 09 Mars 2012.). I kësaj natyre është edhe filmi komedia hyjnore, një film i shquar për antivlera, ishte paraqitur edhe në mediat tona si film që fyen në baza fetare ("'KOMEDIA HYJNORE', HOMOFOBIKE DHE KUNDËR ISLAMIT", gazeta Express, 16 Mars 2012.)

Nga citati kur'anor vërehet edhe një element se shamia nuk është simbol por urdhër dhe obligim hyjnor për të gjitha femrat myslimane sikur që është edhe element identifikues.

Mbulimi i femrës nuk nënkupton në asnjë formë dhunën ndaj saj apo shkeljen e të drejtave të saj[23], përkundrazi, femra mbulohet për ta ruajtur atë nga lapërdharët, apo edhe për t'i ruajtur vetë meshkujt që duan t'u përmbahen virtyteve të larta[24].

1.2. Si perceptohet shamia në media

Shamia nuk është trajtuar si një e drejtë fetare. Mediet janë munduar ta paraqesin vrazhdë, si element identifikues të një bote që kinse nuk ka përparim, si gjë e cila nuk përkon me aspiratat tona për anëtarësim në BE, e gjëra tjera. Madje jo vetëm kaq, por edhe nëse kanë hasur se në Evropë respektohet kjo e drejtë fetare, atëherë janë munduar të gjejnë një model përjashtues, pra një vend ku nuk respektohet kjo e drejtë, vetëm e vetëm që shamia të mos njihet si e drejtë. E ndonjëherë u janë shmangur edhe atyre lajmeve që vërtet kanë qenë lajm, e që kanë pasur të bëjnë me shaminë si të drejtë. P.sh. pjesëmarrja në lojërat olimpike me shami ishte diskutuar për të rezultuar përfundimisht me lejimin përkatës. Këtë lajm publikuan disa portale dhe websajte fetare në vend por jo edhe mediet tona[25].

Mediet tona kanë marrë një pozicion të cilin nuk e ndërrojnë. Nuk e përkrahin shaminë si të drejtë, ndërsa në nivel global iu intereson vetëm atëherë kur diskutohet mohimi i saj. Franca, që e kishin si një model dhe mbështetje, iu interesonte ç'pozicion do të merrte për këtë çështje kur në pushtet erdhi president i ri, presidenti Hollande[26].

---

[23] Topaliogllu, Beqir, *Gruaja në Islam*, f. 167-168.
[24] Buti, Muhammed Seid Ramadan, *Femra midis tiranisë së sistemit perëndimor dhe mëshirës së ligjit hyjnor*, f. 181.
[25] http://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=3407
[26] "Holland s'do të shfuqizonte ndalesën e burkas", Bota Sot, 27.04.2012.

1.3. Diskutim i argumenteve

Problemi i shamisë lindi atëherë kur Ministria e Arsimit nxori një udhëzim administrativ me të cilin ndalohej uniforma fetare[27]. Jo vetëm në medie, por diskutimi dhe në qarqe zyrtare bëhej ndërsa kishte defekte, që për mendimin tim mund të pasqyrohen më së miri në pikat në vijim:

1. Paqartësia konceptuale. Diskutohej për shaminë, ndërsa mediet thirreshin në vendet e zhvilluara[28], të cilat nuk e diskutonin asnjëherë shaminë si të drejtë por burkën. Ka dallim ndërmjet shamisë dhe burkës, dhe në kohën kur këta diskutonin për ndalimin e shamisë, në Bruksel hynte në parlament[29], për herë të parë vinte një deputete me shami madje nga radhët e Partisë Demokristiane, befasi kjo për të gjithë[30].
2. Metodologjia selektive, pra duke përjashtuar rastet kur ndonjë vend njeh të drejtën e bartjes së shamisë dhe përvetësimi i metodologjive të shteteve që e ndalojnë atë edhe pse janë shumë pak.
3. Animi politik. Mediet kanë marrë pozicionim politik, edhe pse e dinë se e vërteta nuk është në anën e saj. Nuk do të doja ta quaj shantazhim por injorimi apo thënë më mirë blasfemimi i kërkesës për mbajtjen e shamisë[31] nuk ka si të komentohet ndryshe. Mediet e dinë fare mirë se në kuadër të së drejtës së shprehjes përfshihet dhe e drejta fetare dhe se zgjidhja e këtij problemi nuk është dashur të bartet në Kuvend. Apo, e dhe po të bartej, do të duhej përkrahur, sidomos kur e vërteta qëndron në anën e besimtarëve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e ndalon shaminë. Ndon-

[27] Udhëzimit Administrativ, Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të
larta, nr. 6/2010, (neni 4. paragrafi 1.13)
[28] "Kanada ndalon burkën", gazeta Express, 13.12.2011.
[29] Avdyl Rrahmani, "*Dituria Islame*", nr. 245. Dhjetor, 2010. F. 53.
[30] http://www.ihrc.org.uk/news/articles/4332-Hijab-wearing-Mahinur-Ozdemir-joins-Christian-DemocratsBelgium-Muslim-finds-Christian-Party-compatible-
[31] http://bislame.net/web/content/view/382/9/

ëse Kosova përkufizohet si shtet laik[32], megjithëkëtë, liria e besimit garantohet, madje edhe ajo e manifestimit[33], derisa nga e drejta për arsim nuk privohet askush[34]. Një gjë e tillë vërtetohet edhe në dokumente shumë të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut[35], dhe që në të gjitha, duke përfshirë edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e drejta fetare kufizohet vetëm në rast se paraqet rrezik për sigurinë e shtetit apo shkel të drejtën e tjetrit.

Edhe në rastin kur Gjykata Kushtetuese nuk miraton këtë të drejtë, mediet do të duhej të dilnin në përkrahje të shamisë, për shkak se interpretimi mund të bëhet në rrethana dhe nga indikatorë të ndryshëm por shamia mbetet e drejtë.

2. LËNDA E EDUKIMIT FETAR

2.1. Nevoja e futjes së një lënde edukative fetare në shkolla

Bashkësia Islame e Kosovës ka kohë që ka parashtruar kërkesë për futjen e një lënde për edukim fetar. Kërkesa është bërë duke pasur parasysh gjithnjë gjendjen dhe rrethanat nëpër të cilat po kalon shoqëria, e që, përveç tjerash po rrezikon zhveshjen nga vlerat dhe edukata e mirëfilltë. Me futjen e lëndës fetare është synuar:

1. Respektimi i të drejtës fetare, si diç me të cilën njeriu ka shtegtuar përgjatë gjithë historisë[36]

---

[32] Neni 8.

[33] Neni 38, 38.2.

[34] Neni 47.

[35] Shih: DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, nenet 9, 14; DEKLARATA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË MOSDURIMIT E TË DISKRIMINIMIT NË BAZË TË FESË DHE BINDJES, e miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të KB më 25.11.1981, nenet 1 (1.1), 2 (2.1); konventa mbi diskriminimin sa i përket punësimit dhe profesionit, Neni 1. Për më shumë shih: *Të drejtat e njeriut 2, Deklarata dhe konventa të Kombeve të Bashkuara*, Prishtinë, 1994.

[36] Plutarku dhe Bergsoni kanë konstatuar se historia njerëzit i ka gjetur në gjendje të ndryshme por pa fe nuk i ka gjetur kurrë. Shih: Idrizi, Zekerija, *Xhamia në analet e historisë*, f. 15.

2. Forcimi i bazës shpirtërore,
3. Menaxhimi i problemeve shoqërore, si depresioni, stresi, pesimizmi, sidomos kur dihet se trajtimi fetar është i pazëvendësueshëm,
4. Çrrënjosja e mbetjeve të idesë komuniste[37]
5. Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi ashtu siç mendon edhe Bashkimi Evropian,
6. Pasimi i vendeve të zhvilluara që e kanë si pjesë përbërëse të arsimit të tyre, madje Jan Figel, ish-komisionari evropian për Arsim, Kulturë dhe Shumëgjuhësi, thoshte së "marrëdhëniet e ngushta midis arsimit dhe vlerave fetare dhe morale janë si vendimtare për të ardhmen e Evropës.[38]"

2.2. Koncepti i përmbajtjes së kësaj lënde

Bashkësia Islame e Kosovës, ndonëse pati parashtruar kërkesën për futjen e një lënde edukative fetare nëpër shkolla, megjithëkëtë, nuk synonte doemos ta imponontе edhe planprogramin e vet, që të kuptohej gabimisht e kinse ka qëllime a tendenca, siç e akuzonin për kinse instalim të një shteti sheriatik. Për këtë gjë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ishte nikoqire e një konference rajonale për “Mësimet mbi fenë në institucionet publike të arsimit: përvojat nga rajoni dhe modalitetet e përshtatshme për Kosovën”, në të cilin morën pjesë ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, të cilët debatuan në mënyrë shkencore për modalitetet e aplikimit të mësimbesimit në procesin e arsimit publik në Kosovë[39]. U fol për përvojat e rajonit dhe për mundësinë e aplikimit të një sistemi të pranueshëm. Pra, konferenca mëtonte gjetjen e një plan-programi të aplikuar tashmë në vendet në rajon. Madje, si rezyme e kësaj konference patën dalën edhe rekomandime, një prej të cilave ishte edhe që BIK-u të jetë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë

[37] “Edukimi islam nëpër shkolla, domosdoshmëri e kohës” Fehmi Ramadani, portali Telegrafi, 14.09.2009.
[38] “Edukimi fetar në Evropë”, Muhamet Brajshori, portali Telegrafi, 30 Gusht 2011.
[39] http://bislame.net/web/content/view/492/9/

me MASHT-in, në mënyrë që plan-programi të mos jetë "tendencioz."

Ajo çfarë dua të them është se programi do të ishte nën mbikëqyrjen e MASHT-it, dhe se nuk do të përdorej -kushtimisht- për të bërë propagandë fetare.

2.3. Mediet dhe diskutim rreth konceptit të tyre

Futja e një lënde fetare në sistemin tonë arsimor është parë me sy të keq nga mediet. Përgjithësisht është qarë halli i laicizmit të shtetit. Futja e kësaj lëndë është konceptuar si një bombë nukleare, që do ta zhdukë laicizmin. Për këtë shkak shoh se nuk iu dhemb vetëm kjo por edhe ajo se kjo lëndë duhet të ligjërohet nga hoxha e kjo qenka trishtuese për ta. Kjo po rrezikuaka edhe stabilitetin (imagjinar) të vendit. Kam përshtypjen se pasqyrimi ka qenë i shkallës më të ulët të marrëzisë, ngase, sikur nuk kanë mjaftuar vetë këto arsyetime banale porse janë munduar që në lojë të fusin edhe të tjerë, ose të përkrahin ata që mendojnë keq, p.sh. personelin e Gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë[40], të cilët pa i pyetur askush fare, por ndoshta për t'u deklaruar më katolikë se papa, dolën kundër futjes së kësaj lënde. Në fakt, nuk ishte vetëm laicizmi pse ata shprehën kundërshtinë e tyre porse edhe frika se BIK-u po e luftuaka identitetin shqiptar dhe se osmanët na paskan lënë mbrapa[41]. Broçkulla. Mediet është dashur që të mos i japin hapësirë lansimit të çfarëdo ideje. Kam përshtypjen se asnjëra nga këto arsyetime nuk qëndron.

1. *Laicizmi* ka lindur në Evropë, por këta nuk ia kanë kthyer fesë shpinën. Sot, në shumë vende të botës mësohet edukimi fetar përkatës, dhe kjo nuk paraqet rrezik për sigurinë e tyre. Kjo ngase laicizmi nuk nënkupton apriori mohimin e fesë. Claudio Magrisi në

[40] "Sami Frashëri" kundër Edukatës Fetare", gazeta Express, 27 gusht 2011. Kështu është edhe iniciativa e grave intelektuale për ndalimin e shamisë ("Gratë intelektuale të Kosovës kundërshtojnë ndërhyrjen e fesë në shkollë", gazeta Express, 27.08.2011.)

[41] Arsimtarët e "Sami Frashërit" kundër "Edukatës fetare", gazeta Koha Ditore, 27.08.2011.

librin 'Panairi i tolerancës[42]' jep shpjegime shumë të mira. Laik, një fjalë aq e pasur në kuptim dhe vlerë, nuk nënkupton aspak, siç supozohet shpesh në mënyrë injorante, të kundërtën e fesë, as nuk nënkupton në vete një besimtar, agnostik apo ateist....Laicizmi nënkupton dallimin e asaj që racionalisht është e demonstrueshme nga ajo, që, në të kundërt, është objekt i fesë...Laicitet d.t.th. tolerancë...të mos ngatërrosh mendimin dhe ndjenjën e mirëfilltë...të mos dominohesh nga ndonjë ide edhe pse i qëndron asaj...Laicizmi ka qenë një filozofi që i është kundërvënë dogmës kishtare[43], ndërsa është përkrahur nga diktatorët afetarë për të justifikuar politikat e tyre antifetare[44]. Vazhdimi i këtij avazi të vjetër ka të përbashkët me periudhën komuniste vendosmërinë për të mos u tërhequr nga akuzat ndaj fesë në plan-programet shkollore.

2. Myslimanët nuk janë të rrezikshëm. Nëse Kosova nuk paska problem tjetër veç ekstremizmit islam, aq sa ministri i Brendshëm[45] thotë se i ka në kontroll të vazhdueshëm, e të cilin praktikisht studimet nuk e shohin gjëkundi[46], e lehtë qenka puna. Nëpërmjet një sistemi arsimor, të cilin do ta përpilojnë vetë, do ta mundësojnë edukimin e gjeneratave jashtë ndikimit të ekstremistëve. Por, vetëm *llafe* janë fjalët e tyre.
3. Barra materiale. Arsyetim tjetër, e me gjasë më banali i mundshëm, është edhe ai i dhënë nga Ministria e Arsimit, respektivisht ministri Ramë Buja, i cili problemin e sheh te dhënia e 1000 rrogave. Mediet janë në dijeni për shpenzimet enorme, keqpërdorimet dhe korrupsioni që bëhet nëpër ministri dhe se përmendja e këtij fakti ka qenë turp. Andaj, është dashur ta diskutojnë atë. Sikur të mos kishte korrupsion në këtë shkallë që ka, Kosova nuk do të kishte probleme kaq të shumta.

---

[42] F. 31-32.
[43] Pajaziti, Ali, Fjalor i Sociologjisë, f. 350.
[44] Osmani, Shefik, *Fjalor i Pedagogjisë*, f. 364.
[45] "REXHEPI: SHTETI PËRCJELL RADIKALËT ISLAMIKË", gazeta Express, 29 Nëntor 2011.
[46] "Kosova s'ka rrezik nga radikalizmi fetar", Bota Sot, 18.11.2011.

3. NDËRTIMI I XHAMISË SË MADHE NË KRYEQYTET

3.1. Roli shoqëror i Xhamisë

Xhamia është një burim i përhershëm i integritetit dhe vend i ringjalljes socio-kulturore e fetare, është institucioni më i vlefshëm që mund të jetë konceptuar e krijuar ndonjëherë. Është vend ku besimtari komunikon drejtpërsëdrejti me Krijuesin...[47]

Xhamia është objekti shoqëror i parë i ndërtuar mbi sipërfaqen e dheut. Në Kur'an është regjistruar kjo e vërtetë historike nga vetë Krijuesi:

***"Shtëpia** (xhamia) **e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo në Bekë** (Mekke), **e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin."** (Kur'ani: 3:96)*

Xhamia arrin që jetën shoqërore me të gjitha detajet e saj ta ekspozojë në një figurë të minimizuar; sikur është një version përmbledhës i shoqërisë, ku prezantohen pikat më të rëndësishme të saj. Ajo po kështu është edhe një përkufizim apo thënë më mire tkurrje identitetesh, ngase bën klasifikimin e sjelljeve dhe tipareve të njerëzve. Xhamia ka rendin dhe rregullat përkatëse, të cilat jo vetëm që shkrijnë dallimet shoqërore, por edhe edukojnë njeriun.

3.2. Mungesa e xhamive dhe të drejtat e besimtarëve

Komuniteti fetar më i madh në vend është komuniteti mysliman. Në bazë të statistikave të fundit[48], ky komunitet numëron 96% të banorëve të Kosovës. Megjithëkëtë, ky komunitet vuan për mungesë të hapësirave për kryerje të lutjeve fetare. Skenat e faljes në rrugë verë dhe dimrit, madje edhe atëherë kur bën vapë shumë e madhe, respektivisht acar që të ngrinë, ata falen në rrugë, në kohën kur komunitetet

[47] Idrizi, Zekerija, *Xhamia në analet e historisë*, f. 15.
[48] "Përqindjet e Republikës", portali Telegrafi, 09.02.2012.

e vogla favorizohen. Ndërtimi i katedrales në Prishtinë nuk ka qenë nevojë e besimtarëve katolikë sikur që pozita e dhënë Kishës Ortodokse ka qenë e padrejtë, edhe pse kështu nuk mendojnë politika dhe kushtetuesja[49]. Zvarritja e proceseve për ndarjen e një lokacioni për ndërtimin e një xhamie të madhe, e cila do t'i plotësonte kënaqshëm kërkesat e besimtarëve ka qenë shkak për shprehjen e pakënaqësisë së këtyre të fundit. Madje, politikanët tanë jo vetëm që na jepnin premtime boshe porse edhe shfrytëzonin momentin për të provokuar besimtarët me shaka të pakripa se "po patën para la ta blejnë edhe Grandin".

3.3. Pasqyrimi i kërkesave për ndërtimin e Xhamisë

Xhamia si institucion fetar i rëndësishëm, si vendadhurim, në përgjithësi nuk është paraqitur keq në medie. Ajo nuk paraqitet mirë kur është në pyetje ndërtimi i përmasave të mëdha, që disi Prishtinën do ta identifikonin me të. Nuk di ç'të keqe ka kjo vetëm se as politika dhe as mediet nuk e duan një gjë të tillë. I pari i Prishtinës duket që është në siklet aq të madh saqë edhe në spote reklamuese të kryeqytetit angazhohet që të mos ketë hapësirë shumë për xhami. Problemi i ndërtimit të Xhamisë së madhe kryesisht është fokusuar në këto pika:

- Kryeqyteti të mos identifikohet me të[50],
- Lokacioni të mos jetë në qendër[51], afër objekteve fetare tjera të minoriteteve,
- Financimi i ndërtimit.

3.4. Diskutim

Prishtina, deshën apo jo, është një qendër e myslimanëve. Është vend i xhamive, madje edhe i atyre të rrëzuara nga pushteti. Në kohën kur mediet e vajtojnë rrënimin e mundshëm të një çerdheje për ndërtimin e kësaj xhamie, harrojnë se:

[49] "Vetëvendosje: Vendimi Kushtetueses i motivuar politikisht", Bota Sot, 01.07.2012.
[50] "Tërnava kërkon xhami sa katedralja", portali telegraf, 26.03.2012.
[51] "Shefqeti: Kosova, jo ateiste", gazeta Bota Sot, 02.09.2011.

- Katedralja u ndërtua në vendin ku u rrënua shkolla
- Gjurmimet zbuluan pranë Teatrit Kombëtar themelet e një xhamie, apo edhe më shumë se një xhami, të rrënuar nga pushtuesi serb. U dëshmua se myslimanëve i janë uzurpuar hapësirat. Do të duhej diskutuar për këtë drejtë të tyre të rikthimit të pronës apo kompensimit të saj.

Pra, mungon një qasje pozitive ndaj një kërkese legjitime të besimtarëve. Ndërlidhja e ndërtimit të xhamisë me rrëzimin e çerdhes ka qenë arsyetim amatoresk. BIK-u, në rast të marrjes së asaj parcele, pati premtuar ndërtimin e një çerdheje të re nga mjetet e veta. Xhamia për një kohë është shuar si lajm për t'ua ndezur në shkurt të këtij viti kur KK-Prishtinës ndan një parcele te PTK-ja, e cila ishte e pranueshme për BIK-un por jo e kënaqshme[52]. E pranueshme ngase do të mbulohet një boshllëk, ndërsa e pakënaqshme ngase nuk i është dhënë pozitë sikur e objekteve tjera të komuniteteve e minoritare.

Përfundim

Nga diskutimi i mëparshëm del se:

1. Mediet kosovare, përgjithësisht, kanë qasje negative ndaj të drejtës fetare,
2. Janë të ndikuara në masë të theksuar nga politika
3. Iu mungon qasja analitike e gjërave.
4. Ndërsa si rekomandime të nxjerra nga ky punim do të veçoja:
5. Nxjerrjen e ligjit për pozitën juridike të bashkësive fetare në vend sa më parë të jetë e mundur,
6. Një studim gjithëpërfshirës të të gjitha llojeve të medieve, vizuale, të dëgjuara dhe të shkruara,
7. Organizimi i debateve publike, pasi që në raporte të ndryshme, siç ishte ai i qendrës për hulumtime "Gani Bobi"[53], theksohej se po-

[52] "Bashkësia Islame e Kosovës, nuk e pranon propozimin e Mustafës", gazeta Bota Sot, 26.08.2011.

[53] "*Interesi publik dhe religjioni*"Hulumtim i opinionit realizuar në shtator/tetor 2011.

pulli nuk janë kundër shamisë, ndërsa Kosova nuk vuan nga ekstremizmi,

8. Organizimi i konferencave rajonale për të gjetur një model të përbashkët për të drejtat fetare dhe zbatimin e tyre,

I bindur se ky punim meriton shumë më shumë se kaq, se çështja fetare kërkon analiza edhe më të thukëta dhe studime më të thella, e përmbyll punimin ndërsa deklaroj se kam synuar vetëm të vërtetën dhe kënaqësinë e Zotit tim!

Literatura konsultuese

1. Kur'ani Fisnik,
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 2008.
3. Buti, Muhammed Seid Ramadan. (2007) Femra midis tiranisë së sistemit perëndimor dhe mëshirës së ligjit hyjnor, përktheu Dr. Selim Sulejmani. Shkup: Libraria "Ebu Hanife."
4. Topaliogllu, Beqir. (2000) Gruaja në Islam, përktheu Mithat Hoxha. Turiq: Universiteti Marmara.
5. Idrizi, Zekerija. (2009) Xhamia në analet e historisë. Zurich: Fondacioni i Rinisë Islame.
6. Magrip, Claudio. (2001) Panairi i tolerancës, përktheu Guri Lekloti. Tiranë: ISHM; IDK; UNESCO.
7. Paraziti, Ali. (2009) Fjalor i Sociologjisë. Shkup: Logos-A.
8. Osmani, Shefik. (1983) Fjalor i Pedagogjisë. Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori."
9. Të drejtat e njeriut 2, deklarata dhe konventa të KB, 1994, Prishtinë: Valton.
10. Hofmann, Murad. (2007) Islami në mijëvjeçarin e tretë, përktheu Behxhet Jashari. Shkup: Furkan ISM.
11. Dituria Islame, revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, të cilën e nxjerrë Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë.

Sedat Islami

THE STANCE OF THE MEDIA TOWARDS RELIGIOUS (ISLAMIC) RIGHTS IN POST WAR KOSOVA

(Summary)

In the post war period Kosova is confronted with various problems. Unemployment, extreme poverty, which is growing day by day, the lack of respect for the rule of law and organized crime are just some of these problems. A very concerning issue during this period of transition remains the observance of human rights and freedoms. This paper deals with religious rights and the stance of the media towards such rights in post war Kosova. The focus is on the largest religious community in Kosova. The main topics of discussion are the much debated issues of the use of headscarves in public schools, the introduction of religious subjects in public schools and the construction of a large mosque in the capital for the needs of the worshippers.

سدات اسلامي

معالجة الإعلام لحقوق الدينية للمسلمين في فترة ما بعد الحرب

(خلاصة البحث)

تواجه كوسوفو بعد الحرب مشاكل عديدة ومختلفة مثل ارتفاع معدلات البطالة والفقر المدقع الذي يتزايد كل يوم و عدم سيادة القانون والجريمة المنظمة هي بعض من هذه المشاكل.æ يزداد القلق في هذه الفترة الانتقالية احترام حقوق الإنسان وحرية الإنسان . و تهدف هذه الدراسةäÇ تسلط الضوء على الحقوق الدينية و معالجتها في وسائل الإعلام الكوسوفية في فترة ما بعد الحرب و سنركز على حقوق أكبر طائفة دينية في البلاد في حين أن محور النقاش سيدور حول ثلاث قضايا الأكثر إثارة للجدل: الحق في ارتداء الحجاب في المدارس العامة وإدخال مادة الدين في برنامج المدارس العامة وبناء مسجد كبير في العاصمة الكوسوفية لتلبية احتياجات المسلمين .

Zekeriya Karabell

NË EMËR TË ZOTIT

Diku rreth vitit 570, sipas kalendarit perëndimor, Muhamed ibn Abdullah, u lind në qytetin oazë të Mekës, në pjesën perëndimore të Gadishullit Arabik. Qyteti ndahej nga Deti i Kuq nga një vijë e ngushtë dhe e rrëpirët malore, dhe ndodhej buzë shkretëtirës së gjerë që karakterizonte Gadishullin Arabik. Oaza dominohej nga fisi kurejsh, i cili kontrollonte tregtinë me deve që kalonte përmes Mekës. Rruga tregtare lidhte Jemenin, në jug, me rajonet e largëta bujqësore mijëra milje në veri, të cilat atëherë ishin të ndara midis perandorit bizantin dhe monarkut sasanian të Persisë.

Ndonëse Muhamedi ishte anëtar i fisit udhëheqës, klani i tij nuk ishte i njohur në mënyrë të posaçme. Babai i tij vdiq pa u lindur Muhamedi, ndërkaq axha i tij, Ebu Talibi, u bë mbrojtësi i tij. Për pjesën më të madhe të dyzet vjetëve të ardhshme, Muhamedi pati një jetë anonime si shumë të tjerë në Mekë; ai u bë tregtar dhe martoi një të ve, të quajtur Hatixhe. Po të kishte vdekur para moshës dyzetvjeçare, do të ishte një nga personat e panumërt të panjohur në histori, dhe Meka do të mbetej një qytet i vogël provincial, jo më shumë i rëndësishëm se mijëra të tjerë kudo në botë. Por, rreth vitit 610, Muhamedi filloi të dëgjojë zërin e Zotit, dhe për herë të parë, Zoti foli në arabisht.

Muhamedi nuk ndau këto shpallje me askënd tjetër përveç me gruan e tij. Profetët rrallë ishin mirëpritur, dhe Muhamedi nuk kishte rëndësi të mjaftueshme në komunitet për të mbrojtur veten kundër kundërshtarëve, të cilët mund të mos mirëprisnin mesazhin që i ishte dhënë. Derisa eksperienca e marrjes së shpalljeve ishte e vështirë për Muhamedin, përmbajtja ishte shoqërisht e vështirë për mekasit. Në vend të një sistemi të ankoruar nga fisi, klani dhe familja, Muhamedi shpalli një rend të ri, të ankoruar nga vullneti i Zotit dhe nënshtrimit të njeriut ndaj tij - kështu fjala *islam,* është fjalë arabe që do të thotë "nënshtrim", dhe *mysliman,* fjalë arabe për atë që nënshtrohen.

Muhamedi filloi të ndante përmbajtjen e asaj që i ishte zbritur me një rreth të vogël të miqve dhe familjes, dhe ngadalë mesazhi u përhap. Në fillim, anëtarët më të fuqishëm të Kurejshit i konsideronin predikimet si të pavend, por kur u rrit numri i njerëzve që filluan të dëgjojnë, Kurejshitët u shqetësuan. Nga ajo që mund të mblidhnin, thirrja e Muhamedit përfaqësonte sfidë për rendin social që e dominonin.

Kishin të drejtë të shqetësoheshin. Në Mekën e tyre të fisit dhe klanit, ata ishin supremë. Respektimi i ishte dhënë zotave të ndryshëm dhe shpirtrave të njohur si xhind, por fisi ishte më i rëndësishëm se çdo zot. Në këtë kohë, kishte një ndjenjë në lindje të monoteizmit, megjithëse jo më shumë e zhvilluar se një nocion i paqartë, se kishte një zot më të fuqishëm se të tjerët. Por, kurejshët e Mekës nuk ishin të përgatitur për të përqafuar vetëm Atë, pasi mund t'i jepte fund status kuo-s. Në botën e tyre, fisi, jo çdo zot, përcaktonte pozitën shoqërore dhe martesën, dhe fisi e klani mund të merrte hakun për të këqijat e bëra nga të tjerët. Autoriteti fisnor ishte absolut - deri Muhamedi shpalli se nuk ishte.

Thelbi i mesazhit ishte i thjeshtë: ka vetëm një Zot, një të dërguar dhe një zgjedhje. Zoti është Allahu, që është i njëjtë si Zoti i Abrahamit, Zoti i profetëve hebrenj, Zoti i Jezusit, dhe Zoti i të krishterëve. I Dërguari është Muhamedi, një njeri si çdo tjetër derisa u zgjodh për të bartur fjalën e Zotit në arabisht. Dhe zgjedhja është dorëzimi ndaj

vullnetit të Zotit dhe të vërtetës së shpalljes së Muhamedit, dhe në këtë mënyrë të shpëtohet për përjetësi.

Shpalljet e para theksuan fuqinë e Zotit dhe pafuqinë e njeriut kundrejt saj. Të mbledhura më vonë në Kur'an, këto ajete vizatuan një pikturë të gjallë të botës të destinuar të përfundonte në gjykimin final, dhe ato paralajmërojnë se vetëm ata që përqafojnë mesazhin e transmetuar nga Muhamedi do të bekohen. Pasi shpallja zgjati për shumë vite, ajo mori kohë para se të ngurtësohet në një sistem besimi koherent. Brenda një dekade, megjithatë, Muhamedi filloi të sfidojë direkt sistemin e Kurejshëve.

Simboli më i njohur i këtij konfrontimi përfshinte të ashtuquajturat ajetet Satanike, që ishin një version i mëhershëm i një pjese të Kur'anit që dukej se lejonte adhurimin e dyfishtë të Allahut dhe të tre zotave të Kurejshëve: al-Lat, al-Uzza dhe Menat. Ajetet Satanike mund të ishin një përpjekje për të bërë kompromis me Kurejshët, gjithnjë e më armiqësor, por Kurejshët nuk u qetësuan. I udhëzuar nga engjëlli Xhibril, Muhamedi tërhoqi ajetet. Ai pohoi se ato ishin një dredhi e djallit dhe shpalli dënimin e qartë të al-Latit, al-Uzzas dhe Menatit. Ata nuk ishin zota, deklaroi ai, vetëm emra të thjeshtë.

Ky sulm mbi sistemin religjioz ekzistues shënoi një kthim dramatik nga pajtimi me sundimtarët e Mekës. Në fillim, Muhamedi kishte theksuar drejtësinë sociale, misterin e jetës dhe fuqinë supreme të Allahut, dhe kishte shpresuar se Kurejshët do ta pranonin atë. Kur u bë e qartë se ata nuk do ta bënin, ai akuzoi jo vetëm religjionin e mekasve, por edhe Kurejshët që e mbështesnin këtë.

Sa kohë që axha i tij Abu Talib ishte gjallë, Muhamedi mund të kritikohej dhe të margjinalizohej, por nuk mund të detyrohej të heshtte apo të lëndohej fizikisht. Kur Abu Talibi vdiq më 619, megjithatë, Muhamedi ishte vënë në pozitë të pasigurt. I përballur me një fis antagonist dhe disa mundësi, ai ishte përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e një komuniteti të pasuesve, shumica prej të cilëve ishin dytësor në shoqërinë mekase, dhe ai po fillonte të tërhiqte përkrahës jashtë qytetit.

Pasi pozita e myslimanëve në Mekë u keqësua, ky nuk ishte thjesht problem diskriminimi dhe kërcënimi. Pa mbrojtjen që kishte siguruar axha i tij, Muhamedi dhe pasuesit e tij ishin të rrezikuar fizikisht, dhe ai filloi të kërkonte shtëpi të re. Ai nuk mundej, megjithatë, thjesht të ngrihej dhe të shkonte. Ai duhej të gjente një fis në një qytet tjetër i gatshëm t'i ofronte mbrojtje dhe pranim. Në një botë ku burimet ishin të pamjaftueshme dhe uji, hurmat dhe tregtia ishin shumë të kontrolluara, nuk ishte aq e lehtë lëvizja në një qytet tjetër për të filluar një jetë të re, dhe sigurisht jo në krye të tetëdhjetë pasuesve.

Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, Muhamedi negocoi përmes ndërmjetësve të tij një marrëveshje me disa fise në oazën e Jethribit, të njohur më vonë si Medina, dyqind milje në veri të Mekës. Ata e dëshironin që Muhamedi të bëhej udhëheqësi i tyre. Fiset e Medinës ishin në rrugë pa krye, dhe ishin të gatshëm t'i drejtoheshin Muhamedit, pasi mund të vepronte si arbitër neutral. Pasi siguruan shtëpinë në Medine, Muhamedi dhe pasuesit e tij filluan pastaj të lënë Mekën, qetë, në grupe të vogla, që Kurejshët të mos i vërenin.

Lëvizja nga Meka në Medine, më 622, e njohur si Hixhra, ishte një nga momentet përcaktuese në historinë islame. Ajo çoi në krijimin e një komuniteti të pavarur dhe gjithnjë e më të fuqishëm mysliman. Gjithashtu, e vendosi këtë komunitet në kontakt direkt me tre fiset çifute. Muhamedi priste se ata do ta pranonin si të fundit në linjën e gjatë të profetëve. Ata nuk e bënë.

Ithtarët e Librit

Bota e Arabisë në fillim të shekullit të 7-të ishte shumë pak e populluar. Vendbanimet ishin të përqendruara në burimet e ujit, dhe këto tërhiqnin tregtarët dhe fiset. Disa adhuronin perënditë lokale; e të tjerët jo. Por kishte gjithashtu edhe një numër të konsiderueshëm të hebrenjve dhe të krishterëve. Të krishterët ishin nga disa sekte të ndryshme, dhe disa ndiqnin doktrinat e krijuara nga patrikët në Kostandinopojë. Të krishterët monofizitë të Egjiptit, të cilët besonin se natyra njerëzore e Krishtit është absorbuar nga natyra e tij hyjnore, ishin

shumë të çmagjepsur me perandorin bizantin dhe interpretimin zyrtar të Trinisë; të krishterët e Sirisë dhe Palestinës më pak të çmagjepsur; dhe të krishterët asirianë (nestorin) të asaj që sot është Iraku, të cilët kishin opinionin e tyre për natyrën e Krishtit, u konsideruan për një kohë të gjatë si heretikë nga baballarët e kishës më në perëndim. Por, megjithëse të krishterët e Arabisë ishin të ndryshëm, Muhamedi dhe mekasit ishin të njohur me konturat e fesë së tyre, duke përfshirë jetën e Krishtit dhe rregullat bazike të Testamentit të Ri.

Hebrenjtë kanë qenë në Arabi me shekuj. Para lindjes së Muhamedit, mbreti arab Dhu Nuwas u konvertua në Judaizëm dhe pastaj nisi atë që doli të jetë një mini-masakër kundër të krishterëve. Në shumë anë, hebrenjtë arabë nuk dalloheshin nga fiset tjera. Realitetet e ashpra të jetës së shkretëtirës dhe mënyra se si njerëzit iu adaptuan dhe mbijetuan nuk dallonte nga klani apo besimi. Hebrenjtë visheshin sikur të gjithë të tjerët, dhe përballeshin me të njëjtat sfida që kishte sjellë natyra. Ata bënin tregti me kurejshët dhe fiset tjera udhëheqëse arabe, dhe flisnin një dialekt të arabishtes. Për shkak të Zotit dhe aspekteve të caktuara të ushqimit, martesës dhe ligjit, ata dallonin nga aspekti kulturor. Megjithatë, ata kryesisht ishin më të afërm sesa të huajt për Muhamedin, dhe kjo mund të shpjegojë shpresën e tij fillestare se ata do ta mirëprisnin atë dhe mesazhin e tij. Kur'ani është mjaft i qartë, se ekziston linja e vazhdueshme nga profetët hebrenj përmes Jezu Krishtit, që çon në fund te Muhamedi. Kur hebrenjtë e Medinës refuzuan të pranojnë këtë, Muhamedi dhe pasuesit e tij gjithnjë e më të fuqishëm filluan t'i trajtonin ata si armiq.

Në fillim, kur Muhamedi arriti në Medine, u arrit një marrëveshje midis dy fiseve jo-hebrenje, tre fiseve hebrenje, dhe komuniteti të ri të Muhamedit dhe ndjekësve të tij. Qoftë një dokument i shkruar apo një marrëveshje verbale, ajo u bë e njohur si Kushtetuta e Medinës, dhe ishte model i ekumenizmit. Gjithashtu, ajo ishte një domosdoshmëri. Duke ditur rrethanat e arritjes së Muhamedit në Medine, ishte e domosdoshme që palët e ndryshme të pajtohen sesi kjo konfederatë do të qeverisej. Pa atë, nuk kishte asnjë mënyrë për zgjidhjen e konflikteve që do të lindnin pashmangshmërisht.

Shumë prej neneve të kushtetutës trajtonin marrëdhëniet midis myslimanëve të sapoardhur dhe fiseve kryesore të Medinës. "Besimtarët dhe vartësit e tyre përbëjnë një komunitet të vetëm (umma)" ishte neni i parë, dhe sipas historisë së mëvonshme islamike, një nga më të rëndësishmit. Në atë deklaratë të thjeshtë, uniteti i myslimanëve ishte vendosur kudo. Deri këtë ditë, ka një ndjenjë të thellë në botën islame se të gjithë besimtarët përbëjnë një komunitet. Kjo do të thotë se kufijtë shtetërorë dhe dallimet doktrinare që ndajnë myslimanët janë të gabuar dhe të padrejtë.

Duke vendosur parimin e unitetit, kushtetuta tregoi përgjegjësitë e fiseve: ata duhej të ruanin veten dhe të administronin drejtësinë për anëtarët e tyre, dhe vrasja ishte e ndaluar. Asnjë mysliman nuk duhej të vepronte në kundërshtim me vullnetin apo nevojat e myslimanëve të tjerë, ndërkaq besimtarët ishin të urdhëruar të kujdeseshin për vartësit e tyre. Dhe sa për hebrenjtë, ata "i takonin komunitetit dhe ruanin fenë e tyre; ata dhe myslimanët duhet të ndihmonin njëri-tjetrin kur ishte nevoja". Aleancat ndërfisnore ishin thuajse të panjohura në Arabinë para-islamike, dhe fiset nuk kishin nevojë të ndanin një sistem religjioz për të vepruar bashkërisht. Në këtë kuptim, Muhamedi dhe palët tjera të interesuara mund të tërhiqeshin nga precedenti i kaluar duke hartuar Kushtetutën e Medinës.[1]

Për një moment të shkurtër, Medina u bë një komunitet i unifikuar hebre-mysliman. Sipas kushtetutës, "hebrenjtë kishin religjionin e tyre, dhe myslimanët kishin religjionin e tyre", dhe të dy jetonin krah-

[1] Ky përshkrim mbështetet në Stephen Humphries, *Islamic History: A Framework for Inquiry* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 1991), 92-98, dhe W. Montgomery Watt, *Islamic Political Thought* (Edinburgh: University of Edinburgh Press, 1968), 4-9 dhe shtojca. Watt mbështetet në kronikën e Ibn Is'hakut, një nga biografët kanonikë të Profetit, i cili shkroi në shekullin VIII. Për aleancat para-Islamike, shih Michael Cook, *Forbidding Wrong in Islam* (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 150ff. Disa studiues e vënë në dyshim nëse kjo marrëveshje ka ekzistuar në të vërtetë dhe besojnë se është shpikur nga kronistët që kanë shkruar disa mijë vjet pas faktit. Por, largimi plotësisht i nocionit duket i marrë. Shih John Wansbrough, *Quranic Studies: Sources and Methods of Scriptural Interpretation* (New York: Oxford University Press, 1977) dhe Patricia Crone e Michael Cook, *Hagarism: The Making of the Islamic World* (Cambridge: Cambridge University Press, 1976).

përkrah si të barabartë dhe mbështesnin njëri-tjetrin kur dhe ku mbështetja ishte e nevojshme. Muhamedi e shihte veten si të fundit në serinë e profetëve hebrenj, dhe mësoi ndjekësit e tij të ktheheshin nga Jerusalemi kur luteshin. Në këtë komunitet hibrid, Muhamedi kishte rolin e të parit midis të barabartëve dhe gjyqtarit të konflikteve. Kushtetua e Medinës krijoi një precedent për bashkëjetesë paqësore dhe të ngrohtë. Fatkeqësisht, kjo nuk zgjati shumë.

Ishin tre fise të fuqishme hebreje, dhe i pari me të cilin u konfrontua Muhamedi ishte Benu Kajnuka. Arsyeja e saktë për ndarjen nuk është e qartë. Kronisti i shekullit të nëntë al-Baladhuri raportonte vetëm se "hebrenjtë e Kajnukas ishin të parët që shkelën marrëveshjen dhe Profeti i dëboi nga Medina".[2] Buhariu, i cili shkroi gjithashtu në shekullin e nëntë, ka përmendur se komuniteti mysliman u rrit, imigrantët myslimanë kishin nevojë për më shumë tokë dhe më shumë pemishte të hurmave, dhe ngurrimi i hebrenjve për t'iu dorëzuar autoritetit të Muhamedit i bëri ata objektiv të ligjshëm. Faktor tjetër më i rëndë ishte refuzimi i fiseve hebreje të ndihmonin Muhamedin gjatë betejës së Bedrit, kur myslimanët e Medinës, për habinë e kurejshëve, mposhtën një ushtri të vogël të dërguar nga Meka. Të tjerët pohojnë se armiqësitë shpërthyen pasi një grua arabe ishte viktimë e një shakaje që rezultoi në ngritjen e fundit të saj shumë lart, që ndikoi që një mysliman të vriste kryesin, i cili ndodhi të jetë hebre. Cilido qoftë shkaku, hebrenjtë e Benu Kajnukas refuzuan të vërtetonin pohimet e Muhamedit për profetët. Pas bllokimit, ata u dëbuan, dhe kjo çoi në ndryshimin simbolik të mënyrës sesi myslimanët luteshin. Në vend të kthimit nga Jerusalemi, ata tani ktheheshin nga Meka. Jerusalemi do të mbetet qytet i shenjtë për myslimanët, por pas syrgjynosjes të Benu Kajnukas, Meka u bë pika kryesore.

Gjatë tre vjetëve të ardhshme, myslimanët e Medinës u rritën me të konvertuar, duke përfshirë disa hebrenj. Ngjarjet ndërruan midis përleshjeve me kurejshët dhe konfrontimit me fiset e mbetura hebreje.

---

[2] Abu-l Abbas Ahmad ibn Jabir al-Baladhuri, *The Origins of the Islamic State*, trans. Philip Khuri Hitti (Piscataway, N.J.: Gorgias Press, 2002), 33. Ky është ribotim i edicionit origjinal të vitit 1916, të publikuar nga Columbia University Press.

Pasi që Muhamedi udhëhoqi pasuesit e tij drejt fitores në fushën e betejës kundër mekasve, ai u prish me fisin e dytë hebre, Benu Nadir. Ata u dëbuan pas rrethimit dyjavor, por ndryshe nga pararendësit e tyre, ata nuk u lejuan të marrin armët e tyre.

Fisi i fundit, Benu Kurejdha, që kishte parë sesi Muhamedi konsolidoi fuqinë e tij, bëri një zgjedhje fatale: ata u bashkuan me mekasit, të cilët po përgatisnin një sulm përfundimtar kundër Medinës. Myslimanët morën kontrollin e karvaneve tregtare dhe ndanë Mekën nga burimi i pasurisë dhe fuqisë së saj. Derisa në të vërtetë Benu Kurejdha nuk kishte përmbushur aleancën me mekasit, ata nuk mbështetën Muhamedin, dhe ishin në negociata me armiqtë e tij. Në çdo mënyrë, ata ishin në një pozitë të vështirë. Fitorja për mekasit do të dobësonte autonominë dhe ndikimin e Medinës, dhe do të pakësonte fuqinë e fisit të mbetur hebre, madje edhe nëse ia largonte kërcënimin e Muhamedit. Fitorja e myslimanëve ishte jo aq më e mirë, dhe në fakt doli të jetë shumë më e keqe. Pasi që mekasit dështuan të marrin Medinën më 627 dhe u detyruan të tërhiqeshin, Muhamedi urdhëroi sulmin mbi Kurejdhat, të cilët u dorëzuan pas një rrethimi që zgjati afër një muaji. Këtë herë, ndëshkimi nuk ishte dëbimi; ishte ekzekutim.

Fati i hebrenjve të Medinës nuk krijoi një precedent të mirë për marrëdhëniet e ardhshme, por historia pasuese ka zmadhuar konfliktin. Disa nga armiqësitë midis myslimanëve dhe hebrenjve të Medinës kishin të bënin me Zotin dhe profetësinë, por po aq kishte të bënte me pushtetin dhe kush e kishte atë. Pas largimit të tyre në Medine, Muhamedi dhe myslimanët u përpoqën të krijojnë një shtet të zbatueshëm, dhe hebrenjtë e Medinës si edhe mekasit paraqisnin kërcënim real. Në Arabinë e shekullit të shtatë, kur fiset luftonin, dëbimi ishte pasoja tipike e humbjes, dhe ekzekutimi i të gjithë meshkujve të rritur, megjithëse ekstrem, nuk ishte përtej kufirit të lejuar. Në fakt, ai nuk do të ishte përtej kufirit të lejuar kudo në botë në atë kohë, dhe veprime shumë më brutale ishin të rëndomta.

Hebrenjtë mund të ishin kërcënim për Muhamedin, por Muhamedi ishte gjithashtu kërcënim për hebrenjtë. Ai ofroi një vizion të botës që ishte befas i ngjashëm me Torën. Shumë prej ngjarjeve në Kur'an

ishin pjesë e traditës hebreje dhe të njohur për hebrenjtë. Por, tregimi i Muhamedit i këtyre ngjarjeve ishte i ndryshëm, në mënyrë delikate dhe domethënëse. Për shembull, në Kur'an, Jusufi (Josefi) është burgosur pse ka refuzuar avantazhet e një gruaje të fuqishme, dhe ajo grua nuk ishte gruaja e faraonit, por më saktë gruaja e guvernatorit. Megjithatë, në një skenë jo në Bibël, ajo tërheq akuzat e saj kur Jusufi (Jozefi) sjellët në gjykatën e faraonit. Konsekuencat teologjike të këtyre mospërputhjeve mund të jenë minore, por problemi si për hebrenjtë dhe myslimanët ishte fakti se ato kurrë s'kanë ekzistuar. Musa (Moset), Nuhu (Noah), Jakubi (Jakobi), dhe figura të tjera heroike biblike të rëndësishme në Kur'an, dhe derisa historitë e tyre janë shumë të ngjashme me ato në Tora, ato nuk janë saktësisht të njëjta. Dhe kjo në vete hapi një çarje midis Muhamedit dhe hebrenjve.

Reagimi i fiseve hebraike ishte miksturë e mahnitjes dhe përqeshjes. Ata e shihnin Muhamedin si një malok, dhe supozonin se ai nuk mund të rregullonte Biblën. Të paktën kjo është përshtypja e transmetuar nga burimet e mëvonshme. Është e vështirë të jesh i sigurt për atë që ka ndodhur në jetën e Muhamedit, duke ditur kohën e gjatë midis regjistrimit të asaj që ka ndodhur dhe ngjarjeve aktuale. Derisa ungjijtë, për shembull, janë shkruar brenda disa dekadave pas vdekjes së Jezusit, biografitë e shkruara më autoritare të Muhamedit datojnë nga më shumë se dy shekuj pas vdekjes së tij. Megjithatë, është e vështirë të imagjinohet se hebrenjtë e Arabisë, që e mendonin veten të ishin trashëgimtar të traditës dymijëvjeçare, do të nxitonin të pranonin një njeri nga Meka, i cili pohonte se veshte mantelin e një profeti. Në fillim, ata mund të rrinin anash nga Muhamedi dhe ende të shpresonin ta përdornin atë për të ruajtur paqen në Medinë. Pasi fuqia e tij politike dhe ushtarake u rrit, dhe ai filloi të tërheqë më shumë të konvertuar, ai u bë një kërcënim. Fiset hebraike bënë atë që mundën për të minimizuar Muhamedin. Ata dështuan, por mënyra sesi u trajtuan pastaj ka pak të bëjë me hebraizmin e tyre.

Në një shkallë të konsiderueshme, mënyra si Muhamedi iu kundërvu hebrenjve ishte pak e ndryshme nga ajo që pasardhësit e tij direkt u sollën me fiset arabe, të cilat refuzuan t'u përkulen kalifëve

myslimanë. Në fakt, ajo ishte pak më ndryshme nga mënyra sesi fiset ndërluftuese të Izraelit trajtuan njëri-tjetrin gjatë ngritjes dhe rënies së mbretërisë së Davidit dhe Solomonit, të treguar me hollësi në Bibël. Ajo që është nxjerrë dhe ruajtur në memorien historike, megjithatë, është ajo nga ditët e themelimit, Islami nuk ka toleruar Judaizmin. Kjo memorie ka depërtuar në kulturat myslimane dhe në kulturën perëndimore, derisa konteksti është zhdukur.

Pasazhet nga Kur'ani që flasin për hebrenjtë, janë shpesh të lidhura me pasazhet që flasin për të krishterët. Muhamedi ka takuar më pak të krishterë se hebrenj, por të krishterët ishin gjithashtu pjesë e peizazhit teologjik. Në veri dhe matanë Detit të Kuq në perëndim, Perandoria Bizantine qeverisej nga një perandor i krishterë, dhe derisa Muhamedi dhe banorët e tjerë të bregdetit perëndimor të Arabisë nuk ishin të përfshirë në çështjet që shqetësonin bizantinët, pjesë të lajmeve qarkullonin përgjatë rrugëve tregtare. Kështu ndodhi me një pjesë të teologjisë së krishterë, e cila ishte mbledhur me traditat herreje për të formuar nga perspektiva e Muhamedit (si dhe të arabëve të tjerë) një tërësi të vazhdueshme të vetme, nga Nuhu (Noah) te Ibrahimi (Abrahami), për të çuar paepshëm te Jezusi.

Në Kur'an, hebrenjtë dhe të krishterët janë trajtuar shpesh si një popull, të lidhur me njëri-tjetrin, por të dalluar nga komuniteti i ri i myslimanëve. Së bashku, hebrenjtë dhe të krishterët janë quajtur *ahl al-kitab*, Ithtarët e Librit; "Libri" është Bibla. Kur'ani është ambivalent rreth Ithtarëve të Librit, dhe ajetet (vargjet) që flasin për ta alternojnë midis respektit dhe përçmimit. Në një anë, Ithtarët e Librit, si myslimanët, janë të zgjedhur nga Allahu për të marrë mesazhin. Kjo i jep të drejtën e njohjes dhe nderit. Sipas Kur'anit 28: 63 apo 29:46. Këto janë dy nga shumë pasazhet, ku myslimanët janë të urdhëruar të trajtojnë të krishterët dhe hebrenjtë me respektin maksimal, pasi ata iu përgjigjen thirrjes së Zotit më herët dhe i qëndruan besnik besimit të tyre.[3]

[3] Fragmentet nga Kurani janë marrë nga A.J.Arberry, *The Koran Interpreted* (New York: Touchstone, 1955, 1996).

Pushtimet

Arritjet politike të Muhamedit ishin madhështore. Ajo që ndodhi pas vdekjes së tij ishte mahnitëse. Midis vitit 627 dhe 632, Muhamedi largoi hebrenjtë nga Medina, mundi rezistencën e fundit mekase, dhe zgjati shtrirjen e Islamit në gjithë Gadishullin Arabik dhe në veri drejt kufijve të Perandorisë Bizantine dhe Sasaniane. Kur Muhamedi vdiq, më 632, vjehrri i tij dhe një nga të konvertuarit e parë dhe më të vjetër, Ebu Bekri, u zgjodh si trashëgimtar i tij dhe iu dha titull *kalif rasul Allah*. Titulli fjalë për fjalë përkthehet si "trashëgimtar i të Dërguarit të Zotit", po çka do të thoshte në praktikë ishte hamendje e gjithkujt. Ajo qartë nuk sugjeronte se Ebu Bekri ishte gjithashtu i dërguar i Zotit, pasi Muhamedi ishte paralajmëruar si "vula e profetëve", dhe kështu i dërguari i fundit që do të dërgohet nga Allahu para fundit të botës. Ajo gjithashtu nuk do të thoshte se Ebu Bekri apo çdo kalif pasues kishte të njëjtin autoritet moral apo religjioz që Muhamedi e kishte.

Çështja e autoritetit religjioz ngrit një çështje të rëndësishme: cila është lidhja midis kishës dhe shtetit në Islam? Për shkak të rolit të Muhamedit, si profet dhe lider, nganjëherë thuhet se Islami ka lindur si një teokraci. Nga disa anë, kjo është e vërtetë. Komuniteti i Medinës ishte një komunitet religjioz i një komuniteti besimtar dhe politik, i përbërë nga emigrantët myslimanë, fiset arabe të Medines, dhe për një kohë hebrenjtë, me Muhamedin si të parin midis të babaitëve. Por, derisa Muhamedi ishte bekuar si profet dhe i nderuar, ai nuk shihej si i pagabueshëm, të paktën jo gjatë jetës së tij. Ai ishte, kështu, një teokraci që nënkuptonte atë dallim midis një Zoti të gjithëfuqishëm dhe një lideri të nderuar.

Megjithëse Medina në kohën e Muhamedit admirohej nga myslimanët si një ideal, ajo kurrë nuk ka qenë një model i zbatueshëm për shoqërinë myslimane. Kur Muhamedi ishte gjallë, nuk kishte ndarje të kishës-shtet. Megjithatë, pasi komuniteti mysliman mori karakterin ushtarak pas vdekjes së tij, kishte një ndjenjë të qartë se sfera politike

dhe ushtarake ishte e ndarë nga ai shpirtëror dhe personal. Kjo ishte mbështetur nga Kur'ani, i cili bënte një dallim të qartë midis shpirtit dhe trupit, dhe midis botës në tokë dhe botës tjetër. Disa ajete në Kur'an flasin për historinë e njerëzimit dhe çështjet materiale; të tjerat flasin për fuqinë misterioze të Zotit dhe parëndësinë e njeriut përballë kësaj. Muhamedi ishte profet dhe lider politik, por derisa këto role ishin të bashkuara në të, ato dallonin.

Pyetjet që rrethojnë parametrat e autoritetit të kalifit demonstrojnë se shumica e myslimanëve e kuptojnë dallimin. Askush nuk e vinte në dyshim se Ebu Bekri, si kalif, do të udhëhiqte ushtritë. Por, shumica refuzonin mendimin se ai kishte trashëguar autoritetin doktrinar të Muhamedit. I respektuar për urtësinë e tij dhe i duartrokitur për devotshmërinë e tij, Ebu Bekri urdhëroi ushtarët e tij të sulmojnë fiset që kishin përdorur vdekjen e Muhamedit, si justifikim për ndarjen nga komuniteti i Islamit. Fragmentimi i komunitetit pas vdekjes së Muhamedit, ishte një test kritik: nëse Ebu Bekri nuk do të arrinte të ruante koalicionin që Muhamedi e kishte mbledhur, është më se e mundshme që Islami do të fikej para se madje të lulëzonte dhe se mesazhi kurrë nuk do të dilte nga shkretëtira. Luftërat e shkurtra dhe të përgjakshme, të zhvilluara nga Ebu Bekri për rivendosjen e federatës, mund të jenë shprehur në termat religjiozë si braktisje e fesë, por po ashtu edhe dimensioni politik ishte i rëndësishëm.

Këto luftëra, jo vetëm që betonuan trashëgiminë e Muhamedit, por gjithashtu krijuan një hierarki të prioritete që vazhdon deri sot. Shumë prej fiseve arabe që Ebu Bekri i mposhti vetëm kohëve të fundit ishin bërë myslimanë; të tjerët kurrë nuk ishin konvertuar sinqerisht. Të gjithë u trajtuan si armiq të besimit, të cilit nuk meritonin (dhe nuk u është dhënë) aspak mëshirë. Që atëherë, renegatizmi ka qenë krimi më i rëndë kundër komunitetit mysliman, më i madh se disa urdhra sesa çdo gjë që jomyslimani mund të bëjë. Vetëm myslimani mund të jetë renegat mysliman, dhe vetëm renegatizmi konsiderohet i pafalshëm. As të krishterët dhe as hebrenjtë nuk ka ngjallur atë nivel të armiqësisë, as gjatë jetës së Muhamedit dhe as gjatë gati katërmbëdhjetë shekujve pasues.

Brenda dy vjetëve pas vdekjes së Muhamedit, pjesa më e madhe e Gadishullit Arabik ishte nën kontrollin e kalifit. Në disa raste, kishte masakra, por qëllimi kryesor i Ebu Bekrit ishte të nënshtronte dhe të bashkonte fiset, e jo t'i asgjësonte. Një nga mënyrat më të mira për të siguruar besnikëri për të ardhmen ishte të shpërblente përkrahësit në këtë botë me pasuri materiale. Zakonisht, prijësit e fiseve konsoliduan autoritetin e tyre duke udhëhequr pasuesit e tyre në sulmet e suksesshme. Por, me Arabinë më shumë apo më pak të unifikuar, dhe sulmet ndërfisnore që nuk ishin më të lejuara, kalifi duhej të kërkonte diku tjetër pre, dhe objektivat më premtues ishin perandoritë e pasura të Persianëve dhe Bizantinëve në veri.

Në një periudhë më pak se një dekadë, arabët pushtuan hapësirën që tani mbulohet nga Egjipti, Izraeli, Siria, Libani, Jordania, Iraku, Turqia jugore, Irani perëndimor dhe Gadishulli Arabik. Në atë kohë, Irani dhe Iraku kontrolloheshin nga Perandoria Persiane Sasaniane, dhe rajonet në perëndim të lumit Eufrat qeveriseshin nga perandori bizantin në Kostandinopojë. Që të dyja ishin shtete të zhvilluara e të centralizuara, me religjione shtetërore monoteiste - Zoroastrianizmi në Persi dhe Krishterimi në Bizant. Që të dyja kishin ekzistuar për shekuj, dhe kishin trashëguar strukturat shtetërore, ushtritë, dhe traditat perandorake që kishin zgjatur për shumë shekuj. Sasanianët ishin të fundit në linjën e gjatë të monarkëve dinastikë që kishin sunduar Persinë, pjesë e një trashëgimie që përfshinte Dariusin dhe Xerxesin dhe ushtritë që gati kishin pushtuar Greqinë Antike pesëqind vjet para lindjes së Krishtit. Për pjesën e tyre, bizantinët ishin degë direkte e Perandorisë Romake, dhe Krishterizmi ishte bërë religjion shtetëror pas konvertimit të Perandorit Konstantin në dekadat e para të shekullit të katërt.

Në vështrimin e parë, fakti se nomadët arabë dolën nga shkretëtira dhe shkatërruan këto dinasti është e vështirë të kuptohet. Por, në histori sikur në jetë, koha është gjithçka. Sasanianët dhe Bizantinët sapo kishin përfunduar një luftë kryesisht të hidhur dhe të rëndë kundër njëri-tjetrit. Sasanianët kishin marrë Jerusalemin dhe Damaskun dhe kishin depërtuar thellë në Azinë e Vogël, duke izoluar Egjiptin dhe

Afrikën Veriore dhe duke rrezikuar integritetin e Perandorisë Bizantine. Perandori Heraklius ishte përballur njëherësh me invazionin e fiseve sllave që kërcënonin Kostandinopojën nga Ballkani. Vetëm për shkak të aftësive të tij të mëdha si lider dhe gjeneral, ai arriti të përballojë këto sulme të dyfishta. Derisa lufta midis persëve dhe bizantinëve nuk ishte konflikt religjioz në vetvete, mbreti persian e trajtonte Herakliusin me përbuzje, dhe Jerusalemi ishte zgjedhur për poshtërim. Si pasojë, kur Herakliusi filloi të ndryshonte rrjedhën, ai shkatërroi për hakmarrje tempujt zoroastrian të zjarrit.

Herakliusi dëshmoi guximin e tij si lider dhe si komandant kur zmbrapsi sllavët dhe sasanianët. Kulmi ishte çlirimi i Jerusalemit. Duke arritur një fitore të pamundshme, Herakliusi shkoi në qytetin e shenjtë më 630. Te fanfari i madh, ai personalisht ktheu Kryqin e Vërtetë në vendin e tij në Anastasis (të quajtur më vonë Kisha e Varrit të Shenjtë) dhe e shpalli triumfin e fundit të perandorisë si fitore për Krishtin. "Kishte shumë gëzim në hyrje të Jerusalemit", thuhej në një dokument të kohës, "zhurma e të qarit dhe psherëtimave dhe lotët e shumtë...ekzaltimi ekstrem i perandorit, i princave, i të gjithë ushtarëve dhe banorëve të qytetit; dhe askush nuk mund të këndonte himnet e Zotit tonë për shkak të emocionit të madh dhe prekës të perandorit dhe gjithë turmës".[4]

Por lufta iu kishte shkaktuar dëme të dy regjimeve, në thesaret dhe ushtarët e tyre, dhe kurrë nuk e kishin marrë fuqinë e tyre të plotë katër vjet më vonë kur pasardhësi i Ebu Bekrit, kalifi Umer ibn al-Hatab, urdhëroi forcat e tij të sulmojnë. Perandoria Persiane ishte zhytur në një luftë civile të shkurtër por shkatërruese, dhe Herakliusi ishte tërhequr i rraskapitur nga roli aktiv në udhëheqjen e ushtrive bizantine. Për dallim nga një perandori, fuqia e të cilit po zbehej, kalifi i ri ishte gjenerator fizik dhe ushtarak, një i konvertuar i hershëm i njohur për

[4] Kronika është shkruar nga historiani armenian, Sebeos, dhe është cituar në A. A.Vasiliev, *History of the Byzantine Empire*, vol. I (Madison: University of Wisconsin Press, 1952), 199. Shih gjithashtu George Ostrogorsky, *History of the Byzantine State* (London: Blackwell, 1956), 110ff. Për interpretimin unik të origjinës së kalifatit, shih Patricia Crone, *God's Rule: Government and Islam* (New York: Columbia University Press, 2004).

pasionin, rreptësinë dhe besnikërinë e tij të shfrenuar ndaj Muhamedit. Në një moment të sundimit të tij, Umeri mori titullin *amir al-mumin*, Komandanti i Besimtarit, që u bë pjesë e nofkës së të gjithë kalifëve pasues. Umeri mori dimensionin ushtarak të rolit të tij me seriozitet dhe e kreu në mënyrë brilante.

Tre beteja vendosën para se gjithash fatin e të dy perandorive. Më 634, në Ajnadin, në jug të Jerusalemit, dhe më 636, në Jermuk, në Siri, divizionet kryesore bizantine në rajon u zhdukën nga forca më të vogla dhe më lëvizëse arabe. Më 637, në betejën e Kadisijës, afër Eufratit, ushtria persiane e udhëhequr nga gjenerali Rustum u asgjësua. Kryeqyteti persian Ctesiphon u pushtua, dhe për një dekadë e gjysmë në vijim, perandori Sasanian u ndoq nga detashmentet arabe në gjithë Persinë derisa u kap dhe u vra. Në perëndim, më 639, komandanti mysliman Amr ibn As pushtoi Egjiptin. Qytetet e Aleksandrisë dhe Heliopolisit (në veri të Kajros) ranë shpejt, dhe më 641, i gjithë Egjipti ishte nën kontrollin e kalifit.

Pasi ushtritë arabe ishin drejtuar matanë Lindjes së Afërt dhe Afrikës Veriore, ata u përballën me një problem: si do t'i qeverisin njerëzit e mposhtur? A do të ketë eksod të arabëve nga gadishulli në qendrat kryesore urbane? A do të sulmojnë dhe pastaj të tërhiqen me prenë? A do të izolojnë veten nga të krishterët, hebrenjtë dhe zoroastrianët që përbënin popullsinë e tokave të pushtuara? Dhe si do të trajtonin shoqëritë që kryesisht ishin bujqësore, që kërkonte një organizim tjetër social që puna e ujitjes të mos dëmtohej, për të siguruar frytet? Disa arabë ishin vendosur në qytetet si Meka, por të tjerët ishin kryesisht nomadë, dhe nuk ishin mësuar të jetonin në një vend gjatë një viti. Nuk kishte asgjë në Kuran për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve të reja dhe urgjente, dhe shpejtësia befasuese e fitoreve do të thoshte se nuk kishte luks për të ndenjur duarkryq dhe për të menduar për opsionet.

Edhe pse Kur'ani ishte shumë i qartë rreth Ithtarëve të Librit, megjithatë, kishte disa udhëzime për trajtimin e popullsisë së krishterë të Sirisë, Palestinës dhe Egjiptit. Zoroastrianët, të cilët përbënin një pjesë të madhe të Perandorisë Persiane, iu ishte dhënë gjithashtu mbroj-

tja. Si Kurani, libri i shenjtë i zoroastrianëve, Avesta, në fillim ishte shpallje gojore, por pjesë të saj ishin shkruar përfundimisht. Kjo e bëri të mundshme që pushtuesit arabë të përfshinin zoroastrianët si Ithtarë të Librit, thjesht pasi ata kishin një libër. Por përveç *ahl al-kitab*, ishte zhvilluar edhe një kategori, *ahl al-dhimma* (Njerëzit e Paktit), që përfshinte jo vetëm zoroastrianët, por të gjitha sektet dhe religjionet lokale që ishin të huaj për arabët e Mekës dhe Medinës.

Linja midis Ithtarëve të Librit dhe Njerëzve të Paktit është vështirë të dallohet. "Pakti" i parë ishte me sa duket ndërmjet hebrenjve të mundur të Medinës dhe Muhamedit, por është e paqartë nëse një pakt i tillë ka ekzistuar apo nëse ishte një shpikje e teologëve të mëvonshëm. Gjatë shekujve, dallimet ligjore midis Ithtarëve të Librit dhe Njerëzve të Paktit ishin subjekt i marrëveshjeve dhe debateve të panumërta. Juristët myslimanët, si juristët në çdo vend, analizuan çdo pikëpamje të besueshme, dhe kontrolluan çdo çështje hipotetike që mund të imagjinonin. Në mes të shekullit të shtatë, megjithatë, ideja e dhimmive (term për dikë që i është dhënë mbrojtja e garantuar për Njerëzit e Paktit) ishte futur në Perandorinë arabo-myslimane.[5]

Ithtarët e Librit, të cilët jetonin nën sundimin mysliman ishin dhimmijë. Ata ishin vënë mënjanë, në mënyrë të favorshme, për shkak se posedonin shkrime të shenjta të frymëzuara nga Zoti (Allahu). Kjo iu dha atyre respekt të vogël të myslimanëve. Por, për të fituar statusin e favorizuar, Ithtarët e Librit duhej të pranonin autoritetin e sundimtarëve të tyre myslimanë, dhe duhej të paguanin një taksë lokale. Në këmbim, atyre iu lejohej të qeverisnin vetveten. Ata mund të luteshin lirshëm në kisha apo sinagoga apo në tempujt e zjarrit. Ata mund të hanin mishin e derrit dhe të pinin alkool. Ata zgjidhnin liderët e tyre lokalë, të cilët kishin liri të madhe veprimi mbi shumicën e aspekteve të jetës së përditshme, nga martesa e deri te trashëgimia dhe prona,

[5] Shih Claude Cahen, "Dhimma", në *Encyclopedia of Islam* (Leiden: E. J. Brill, 1991); Bat Ye'or, *The Decline of Eastern Christianity: From Jihad to Dhimmitude* (London, 1996), 121ff.; Suhayl Qasha, *Al-Masihiyan fi al-Dawlah al-Islamiya* (Të krishterët në shtetin mysliman), (Beirut: Dar al-Malak, 2002), 54ff,; C. E. Bosworth, "The Concept of Dhimma in Early Islam", in Bosworth, *The Arab, Byzantium, and Iran* (Burlington, Vt.: Ashgate Publishing, 1996), 285ff.

nga krimet e vogla e deri te krimet e pasionit. Ithtarët e Librit nuk kishin ushtri; ata nuk kontrollonin asnjë qytet apo provincë; por shumicën e kohës, liheshin vetëm.

Kjo nuk do të thoshte se ata ishin trajtuar mirë, vetëm se nuk ishin trajtuar keq sa trajtoheshin zakonisht njerëzit e mposhtur. Gojëdhëna e mëvonshme sugjerojnë se Muhamedi dhe Umeri, për shembull, nuk ishin të gatshëm të zgjeronin këtë tolerancë për hebrenjtë dhe të krishterët që jetonin në vetë Arabinë, dhe Umeri thuhet të ketë zbatuar dëbimin e fundit të madh të hebrenjve të Arabisë, kur largoi fiset hebreje nga oaza e Hajberit. Jashtë Gadishullit Arabik, megjithatë, trajtimi ishte shumë më mirëdashës.

Pushtimet arabo-myslimane ishin shumë më pak të dhunshme dhe përçarëse sesa luftërat perse-bizantine që menjëherë i paraprinin atyre, apo se shumë luftëra të mëparshme pushtuese të ndërmarra nga Aleksandri i Madh apo legjionet romake. Ndonëse kishte një numër të betejave të egra, shumë qytete ranë pa gjakderdhje. Damasku në shekullin e 7-të ishte një pjesë shumë e rëndësishme e Perandorisë Bizantine, por banorët e saj ishin të zhgënjyer me perandorin dhe udhëheqësit kishtar në Kostandinopojë. Çështja kryesore ishin konflikti doktrinar i gjatë mbi natyrën e Krishtit dhe peshkopët në Kostandinopojë kishin pak durim me papajtueshmërinë e kishave në Damask dhe kudo në Lindjen e Afërt. Si rezultat, kur u përball me një ushtri arabe afër mureve të saj, Damasku bëri vetëm rezistencë minimale.

Të rrethuar nga pesë mijë kalorës të komanduar nga Halid ibn al-Walid, qytetarët e Damaskut ishin në mëdyshje: kishin pak entuziazëm për të sakrifikuar jetët e tyre në mbrojtje të perandorisë, por nuk dëshironin të dorëzonin qytetin për t'u përballë me masakër. Peshkopët e sekteve të ndryshme të qytetit hynë në bisedime me Halidin, për të diskutuar dorëzimin paqësor. Për t'ua lehtësuar shqetësimet e tyre, Halidi shkroi një premtim në një copë pergamene, në të cilën thuhej:

Në emër të Zotit, Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Kjo është ajo që Halidi do t'ua japë banorëve të Damaskut, nëse hyn aty: ai premton se do t'u japë siguri për jetët, pasurinë dhe kishat e tyre. Muret e qytetit të tyre nuk do të rrëzohen; dhe asnjë mysliman nuk do të vendoset

në shtëpitë e tyre. Veç kësaj, ne ju japin paktin e Allahut dhe mbrojtjen e profetëve të tij, kalifëve dhe të besimtarëve. Sa kohë që ata paguajnë taksën lokale, asgjë përveç të mirës nuk do t'iu ndodhë.

Pasi siguruan këto premtime nga Halidi, peshkopët hapën portat, i lejuan myslimanët të hyjnë në qytet, dhe paracaktuan humbjen e garnizonit bizantin.

Skena të ngjashme u përsëritën kudo në Lindjen e Afërt. Banorët e krishterë të qytetit Hims, në veri të Damaskut, ishin aq shumë të tërbuar me Heraklin, sa që zgjodhën të bashkohen me arabët për të luftuar kundër bizantinëve. Komandantët arabë i premtuan banorëve të Himsit, se do të mbroheshin nëse dorëzoheshin. Në vend të kësaj, ata dolën vullnetarë për të ndihmuar. "Ne duam sundimin dhe drejtësinë tuaj shumë më mirë sesa shtetin e shtypjes dhe tiranisë në të cilin jemi. Ushtrinë e Heraklit, në fakt do ta zmbrapsim nga qyteti". Gjithashtu, hebrenjtë iu bashkuan kauzës. "Betohemi në Tevrat", ata i thanë komandantëve myslimanë, "asnjë guvernator i Heraklit nuk do të hyjë në qytetin e Himsit përveçse nëse mposhtemi dhe rraskapitemi".[6]

Në mënyrë të ngjashme, gjenerali arab, i cili udhëhoqi pushtimin e Egjiptit, Amr ibn al-As, shkoi rrugës së tij për të zbutur shqetësimet e të krishterëve egjiptianë. Legjenda thotë se para se të bëhej mysliman, Amri kishte shpëtuar jetën e një dhjaku të krishterë nga Aleksandria. Në shenjë mirënjohje, dhjaku i kishte blerë Amrit të gjitha mallrat, dhe Amri pastaj filloi të bënte tregti të rregullt në Egjipt. Delta e Nilit ishte burimi kryesor i furnizimeve me drithëra, dhe Aleksandria ishte qendër tregtare. Ishte Arm ibn al-Asi, i cili me sa duket bindi kalifin Umar të autorizojë pushtimin, dhe një nga arsyet që dha ai ishte se popullsia e krishterë, si të krishterët e Sirisë, ishte e pakënaqur me sundimin e Kostandinopojës.

---

[6] Është cituar Khalid ibn al-Walid, dhe të gjithë banorët e Himsit në al-Baladhuri, *The Origins of the Islamic State*, 187, 211. Megjithëse disa përshkrime të krishterëve dhe hebrenjve që vërsulen ndaj arabëve mund të jetë ekzagjeruar nga al-Baladhuri. Ai është larg nga i vetmi historian i hershëm që ka regjistruar pakënaqësinë e gjerë të sundimit bizantin.

Çarja midis kishës egjiptiane dhe Kostandinopojës, ishte rritur për dekada, dhe ishte e bazuar në politikë dhe teologji. Kisha Kopte e Egjiptit ndiqte doktrinën e Monofizitizmit, e cila konstatonte se Krishti ka një natyrë, dhe ajo natyrë është hyjnore. (Termi "monofizit" rrjedh nga greqishtja që do të thotë "një natyrë"). Kjo ishte në kontradiktë direkte me besimin që ishte vendosur nga Këshilli i Kalcedonit, gati dyqind vjet më parë, i cili konsideronte se Krishti ka natyrë njerëzore dhe natyrë hyjnore. Megjithëse këto debate nuk duken aq meritore për të luftuar dhe për të vdekur për to, në shekujt e parë të Krishterimit natyra e saktë e Krishtit ishte çështja më përçarëse. Luftërat ishin zhvilluar mbi atë nëse Krishti ishte njëlloj hyjnor dhe njerëzor, më shumë njerëzor se hyjnor apo më shumë hyjnor se njerëzor. Gjithashtu, ndarjet midis Egjiptit dhe Kostandinopojës, kishin dimension politik. Peshkopi, i cili ishte dërguar nga perandori për të mbajtur koptët në linjë, pati sukses vetëm në kërcënimin e egjiptianëve me masakra dhe inkuizicione. Në kohën e pushtimeve arabe, masa e armiqësuar ishte thellë e mëritur nga sundimi bizantin.

Amr ibn al-As shfrytëzoi këto tendosje për të fituar besnikërinë e egjiptianëve, dhe kjo mund të shpjegojë se pse Egjipti iu dorëzua aq shpejt një ushtrie prej më pak se pesë mijë ushtarë. Më vonë, kronistët arabë madje pohuan se Kisha Kopte i kishte mbështetur aktivisht arabët dhe i ndihmoi ata që të mposhtin garnizonet bizantine në Delta, pas premtimit të marrë nga Amri se kisha e tyre do të ishin të patrazuara dhe barra e tyre taksore e menaxhueshme. Për koptët dhe peshkopët e tyre, ky ishte një shkëmbim i pranueshëm. Ata e dinin se duhej t'i paguanin taksa dikujt, dhe të paktën myslimanët do t'i lejonin të praktikonin besimin e tyre në mënyrën që dëshironin, të lirë nga autoriteti represiv dhe arrogant i Kostandinopojës.[7]

Në shumë anë, pushtimet ishin të shpejta dhe kryesisht pa gjak. Në vend të skenave të zakonshme të vdekjes dhe shkatërrimit të kotë, qy-

[7] Shih për shembull Ibn Abd al-Hakam, *History of the Conquests of Egypt, North Africa, and Spain*, ed. Charles Torrey (Piscataway, N.J.: Gorgias Press, 2002), dhe Jamal al-Din Shayyal, *Tarikh Misr al-Islamiya* [The Islamic History of Egypt] (Alexandria: Dar al-Ma'arif, 1967).

tetet e okupuara nga arabët trajtoheshin pothuajse me butësi, dhe dukej se kishin mirëpritur zëvendësimin e sundimtarëve. Duke ditur rrëmujën e ushtrive persiane dhe bizantine në rajon, dhe mungesës së rezistencës së fortë të organizuar, kjo kishte kuptim. Në esencë, nuk kishte nevojë për dhunë të vërtetë. Kjo nuk i ka parandaluar pushtuesit tjerë në kohë të tjera nga kryerja e mizorive të neveritshme. Pse atëherë, pushtuesit myslimanë ishin relativisht dashamirës? Numri i paktë i burimeve e bën të vështirë përgjigjen në këtë pyetje, por një gjë është e pamohueshme: Kur'ani i mësoi myslimanët të respektojnë Ithtarët e Librit, dhe kjo është pikërisht ajo që bënë. Historia e hershme e Islamit ka qenë kundër sfondit të tolerancës për religjionet e të mposhturit.

Kishte gjithashtu edhe arsye pragmatike. Krahasuar me numrin e personave të shpërndarë në mijëra milje të territorit, përqindja e arabëve dhe myslimanëve ishte e vogël. Kalifët e parë kishin kuptuar se nuk kishte asnjë mënyrë për ta për të sunduar pa kooperimin aktiv të të pushtuarve. Në fakt, po të mos liheshin sistemet administrative lokale të paprekura, kalifi nuk do të ishte në gjendje të mblidhte taksat; pa zyrtarët lokalë, kush do t'i mblidhte fizikisht ato? Dhe derisa kishte presion mbi kalifin për të lejuar komandantët e tij për të sulmuar dhe grabitur qytetet e pushtuara, kjo mund të krijonte komplikime të tjera. Posa të bëhej kjo, çka pastaj? Shumë prej liderëve fisnorë, të cilët i udhëhiqnin ushtritë, dëshironin gjithashtu që kalifi të lejonte trupat e tyre të merrnin tokë dhe të zëvendësonin administratorët bizantinë apo persianë. Por atëherë ushtritë do të shpërndaheshin, duke i lënë rajonet e sapomarra në një gjendje të cenueshme dhe potencialisht kaotike.

Zgjidhja ishte krijimi i qyteteve të garnizoneve, në Basra dhe Kufa në atë që tani është Iraku jugore, dhe lënia vetëm e një numri minimal të trupave në qendrat e vjetra urbane të krijuara. Vendbanimet e garnizoneve në jug të Irakut, dhe më vonë një në Fustat (Kajro), në Nil, ishin një mënyrë për të mbajtur ushtritë të padëmtuara, por kjo do të thoshte se kishte disa ushtarë të çmuar për të ruajtur kontrollin e qyteteve më parë bizantine, si Damasku, Jerusalemi dhe Antiohu, apo qendra persiane si Rayy dhe Merv. Kjo e bëri imperativ për myslimanët

që të bëjnë sa më pak që ishte e mundur për të prishur status-konë në vendet e sapomarra. Ata larguan shtresën e lartë të administratës bizantine dhe persiane, por në fillim shtresat tjera nuk i prekën. Në këtë kuptim, toleranca fetare ishte një komponent pragmatik i një strategjie të përgjithshme i të qëndruarit ndaras nga njerëzit e pushtuar.

Të dhënat e mëvonshme i portretizojnë ushtritë myslimane duke pushtuar gjithë rajonin. Por, derisa ata iu shkaktuan humbje shkatërruese legjioneve të dy perandorive, dhe pastaj okupuan një numër të madh qytetesh, shumë njerëz në vendet që tani kontrolloheshin nga arabët ishin të paqartë për atë që kishte ndodhur. Në fakt, për vite, shumë pak dinin detaje të përgjithshme për pushtuesit. Ata e dinin se sundimi bizantin ishte zhdukur, dhe se njerëz që visheshin e flisnin ndryshe ishin paraqitur duke kërkuar pagimin e taksave. Ata mësuan se këta ishin arabë, të cilët e quanin veten myslimanë, dhe ngadalë, ata grumbulluan perceptimet bazike për Islamin. Por më 680, një i krishterë i quajtur Xhon nga qyteti Fenek në rajonin e Mosulit shkroi një raport se ishte shumë i painformuar për Islamin dhe për pushtimet myslimane, megjithëse lavdëroi arabët për respektimin e të krishterëve të zakonshëm dhe murgjve të krishterë. Të krishterët tjerë nga rajone të ndryshme ishin ngjashëm të hutuar. Kjo ishte pjesërisht rezultat i izolimit të shumicës së njerëzve dhe kohës që nevojitej që lajmet të përhapeshin nga metropolet në provinca. Por, gjithashtu ishte rezultat i natyrës së veçantë të pushtimeve. Siç ka thënë një studiues, myslimanët lanë gjurmë aq të ndritshme në pjesët e botës që okupuan saqë u desh më shumë se një shekull para se njerëzit nën sundimin e tyre të fillojnë të rregullojnë jetët e tyre në mënyrë kuptimplote dhe të kuptojnë se çka kishte ndodhur midis viteve 630 dhe 640.[8]

Fakti i thjeshtë është se po të mos ishin në Damask, apo pjesët qendrore të Irakut, nëse nuk do të ishin në Deltën e Nilit, apo në qendrat e vjetra të fuqisë së sasanianëve, jeta e tyre nuk do të ndryshonte në mënyrë dramatike pas pushtimeve. Njëherë çdo vit apo të ngjashëm,

[8] Chase F. Robinson, *Empire and Elites After the Muslim Conquest: The Transformation of Northern Mesopotamia* (Cambridge: Cambridge University Press, 2000), 28ff.

një grup i ushtarëve dhe guvernatori lokal mund të paraqitej për të kërkuar pagesën, por i njëjti rast ishte gjithashtu edhe nën regjimin e mëparshëm. Në kohë, disa ushtarë vendoseshin në qytetin tënd, dhe ata mund të ishin myslimanë. Gradualisht, guvernatorët lokalë të emëruar nga kalifi krijuan rrjetet e tyre tregtare dhe kulturore, të cilat ishin të lidhura me botën më të gjerë të Islamit, por kjo ndodhi aq ngadalë saqë mund të ketë qenë gati e paperceptueshme për çdo person që ka jetuar gjatë këtyre viteve.

Pjesa më e madhe e kësaj është në kundërshtim me historinë e imagjinuar të luftëtarëve arabë që bartnin Kur'anin në një dorë dhe këllëçin në tjetrën. Po, ata ishin të shtyrë nga religjioni, dhe po, ata ishin luftëtarë të shkëlqyeshëm, të lëvizshëm, origjinalë dhe trima. Ata kombinuan traditën para-islamike të kalërimit me solidaritetin dhe sigurinë e besimtarëve të vërtetë. Por, ata ishin gjithashtu fisnorë, dhe fiset shumë rrallë pranojnë të konvertuarit. Mesazhi i Islamit i ishte dhënë Muhamedit në arabisht për një audiencë arabe, dhe derisa arabët besonin se mesazhi ishte i vërtetë universalisht, ata nuk dolën jashtë rrugës së tyre për të bindur jo-arabët. Ata kërkon të sundonin dhe të taksonin popujt e Lindjes së Afërt dhe më tej, por ata nuk u përpoqën të shpëtonin shpirtat e tyre apo t'i tregonin dritën e vërtetë. Nëse jo-arabët dëshironin të dëgjonin mesazhin, ai ishte aty për t'u dëgjuar, por ato nuk pranoheshin nëse e bënin. Konvertuesit jo-arabë në fillim nuk trajtoheshin më mirë sesa Ithtarët e Librit, dhe në disa rrethana ata mund të jenë trajtuar më keq. Ka pasur raporte, të ndryshuara pa dyshim nga armiqësi të mëvonshme, se guvernatori i Irakut në fund të shekullit të shtatë, Haxhaxh ibn Jusuf, i njohur si administrator brutal, por efektiv, kishte mbledhur të gjithë të konvertuarit jo-arabë nga Basra dhe Kufa, kishte bërë tatuazh në ballet e tyre, dhe i kishte kthyer në fshatrat e qytetet e tyre.

Përfundimisht, trajtimi çnderues i të konvertuarve mund të çojë në revolucion, por pas njëqind vjetëve pas pushtimeve, perandoria sundohej nga një elitë arabe që vetëm gradualisht u absorbua në shoqëritë që kishin pushtuar. Derisa në Egjipt dhe rajonin Tigër-Eufrat u krijuan qytetet garnizone, madje në qoshet e largëta të perandorisë, në Anda-

luzi në perëndim apo në qoshet e largëta të asaj që sot është Irani verilindor dhe Afganistani, arabët qëndruan mënjanë dhe të ndarë, të sigurt në besimin e tyre, të painteresuar në punën misionare.

Studiuesit që në të kaluarën kanë nxitur imazhin e Islamit të përhapur me shpatë, por kjo nuk ka ndryshuar imagjinatën më të përhapur. Besimi, se pushtimet arabe ishin luftëra të konvertimit, ishte shumë imun ndaj fakteve. Konvertimi i detyruar mund të ketë qenë në mospajtim direkt me Kur'anin, i cili shpall në një nga ajetet e tij me më pak dykuptimësi: "Nuk ka detyrim në fe". (2:256). Ky urdhër i qartë hyjnor është zbatuar nga pushtuesit e parë.

Vetëm në një rast të parëndësishëm imazhi i Islamit i lidhur me shpatën është i pranueshëm. Eventualisht, vendet e gjëra që ranë nën dominimin mysliman u bënë shoqëri myslimane. Procesi i konvertimit ndodhi, dhe vetëm për shkak të këtyre fitoreve të para ushtarake të pasuara nga dinastitë e fuqishme myslimane që arritën, me disa vështirësi, të ruajnë kontrollin. Kjo nuk ishte një arritje e vogël. Historia është e mbushur me fitore që nuk kanë çuar në perandori të reja. Deri aty sa që shpata dhe Kur'ani së bashku larguan Krishterimin, si religjioni dominues në Afrikën Veriore, Egjipt, Lindjen e Afërme, dhe shumë më vonë, Turqi, ata shkuan bashkë. Vetëm për shekuj të ndryshëm mund të thuhet se Islami është përhapur me forcë, dhe thjesht nuk mund të thuhet se pushtimet e para imponuan Islamin mbi të pushtuarit.[9]

Edhe pse ka dokumentime të mjaftueshme të këtyre fakteve, jo të gjitha raportet e pushtimeve bartin një përshtypje të tolerancës myslimane, dhe hendeku midis asaj që ka ndodhur dhe asaj që njerëzit mendojnë se ka ndodhur, është pjesërisht rezultat i kronistëve të krishterë. Në kohën e rënies së Jerusalemit, patriarku Sofronius udhëhoqi rezistencën kundër arabëve dhe negocio dorëzimin e qytetit. Ai gjithashtu shërbeu si ciceron i Umerit më 638, kur kalifi bëri pelegri-

[9] Për analizën më të mirë të konvertimit në Islam, shih Richard Bulliet, *Islam in the Medieval Period* (Cambridge: Harvard University Press, 1979). Për analizë të detajuar të Kuranit 2: 256, shih Yohanan Friedman, *Tolerance and Coercion in Islam: Interfaith Relations in Muslim Tradition* (New York: Cambridge University Press, 2003), 100ff.

nazhin për të marrë qytetin personalisht. Megjithëse Jerusalemi ishte ulur nga myslimanët në favor të Mekës, ai vazhdonte të konsiderohej një vend i shenjtë, dhe Umeri kuptoi rëndësinë e kalimit të tij në duart e myslimanëve. Derisa po hynte në mure, ai po udhëtonte me devën e tij të zakonshme të bardhë dhe kishte veshur veshjen modeste beduine. Umeri takoi patriarkun e shkëlqyeshëm, të veshur me veshjet e shtrenjta të zyrës së tij, dhe i rrethuar nga shpura e tij njëlloj e shkëlqyeshme. Kalifi vizitoi vendet e shenjta, duke premtuar se ai do ta linte të paprekur Anastasin (Varrin e Shenjtë). Ai pastaj urdhëroi ndërtimin e një xhamie në Malin e Tempullit, e cila më pak se një shekull më vonë u zëvendësua me al-Aksanë.

Okupimi i Jerusalemit ishte në mesin e tronditjeve të fundit që ishin njohur, dhe për një qytet që ishte sulmuar, grabitur dhe shkatërruar aq shumë herë, kjo ishte thuajse diçka. Megjithatë, kjo nuk i bëri arabët që të munden. Ndërtimi i një xhamie në vendin e Tempullit të Solomonit, ishte parë nga hebrenjtë dhe të krishterët si një shenjë e pakënaqësisë së rëndë të Zotit. Patriarku interpretonte fitoren e arabëve, si një ndëshkim për mëkatet e të krishterëve. “Nëse dëshirojmë të jetojmë si të dashur dhe të kënaqur me Zotin”, i thoshte ai kongregacionit të tij, “ne duhet të gëzohemi me rënien e armikut saraçin dhe të shikojmë shkatërrimin e tyre të afërt dhe të dëshmojmë dorëzimin e tyre përfundimtar. Shpata e tyre që do gjakun, do të hyjë në zemrat e tyre, harku i tyre do të thyhet dhe shigjetat e tyre do të nguliten në ta”.

Sofroniusi ishte mbrojtës i patundur i besimit të dy natyrave, të shenjtëruar nga Këshilli i Kalcedonit, dhe përdorte triumfin e arabëve si justifikim për të kundërshtuar sektet disidente kudo në Lindjen e Afërme, veçanërisht koptët egjiptianë, për refuzimin e kësaj formule. Si ndëshkim, Zoti ka dërguar arabët për të “grabitur qytetet, shkretuar fushat, djegur fshatrat, për t’ua dhënë flakën kishave të shenjta, për të përmbysur manastiret e shenjta, duke kundërshtuar ushtritë bizantine të rreshtuar kundër tyre”. Duke vepruar si një agjent i zemërimit të Zotit, Muhamedi, vazhdoi patriarku, ishte një “djall”, dhe mesazhi i tij

një blasfemi. Por, të krishterët duhet të fajësojnë vetëm veten për humbje, dhe kjo ka çuar te humbja e tyre e plotë.[10]

Patriarku e shikonte okupimin mysliman si një tragjedi në shkallë kozmike. Ashtu veproi padroni i tij, perandori Herakli. Për të dy, humbja shkatërruese për vdekje. Duke kaluar shumë vite në luftën për kontrollin e Jerusalemit nga sasanianët, Herakli kishte supozuar se ishte favorizuar nga Zoti, dhe kur rivendosi Kryqin e Vërtetë në Kishën e Anastasit më 630, ai duhet të ketë besuar veten si të bekuar. Kur dëgjoi se një udhëheqës i shkretëtirës me titullin e habitshëm të "kalifit" kishte hyrë në qytetin e shenjtë si pushtues, ai u godit emocionalisht dhe fizikisht. Ai ishte në Antioch në atë kohë, dhe pas avancimit të arabëve, u tërhoq në bregdetin e Azisë së Vogël. Në Kostandinopojë, kundërshtarët shfrytëzuan avantazhin e dështimeve dhe filluan të komplotonin. I sëmurë dhe i dëshpëruar, Herakli u kthye në kryeqytet dhe familja filloi të konspirojë kundër tij. Ai vdiq brenda disa muajve.

Derisa perandori dhe patriarku i tij në Jerusalem, e panë suksesin mysliman si rezultat i mëkatit të krishterë, disa shkuan edhe më tej dhe pohuan se Islami nuk ishte asgjë më shumë se një herezi e krishterë. Kështu tha Xhoni nga Damasku, një nga teologët e fundit më të njohur të krishterë të Lindjes së Afërt myslimane. Megjithëse u rrit në Damask, ai la qytetin diku në fund të shekullit të shtatë dhe kaloi një pjesë të rëndësishme të jetës së tij duke shkruar kundërshtime të zemëruar për teologjinë myslimane. Për dallim nga portreti i përgjithshëm i komandantëve të parë arabë të lënë nga historianët myslimanë të mesjetës, Xhoni i Damaskut dënoi Islamin si njerëz që kanë gabuar kultin e Ishmaelitëve, paraardhësit të Antikrishtit... Ai rrjedh nga Ishmaeli, i cili ka lindur nga Abrahami i Hagarit, prandaj ata quhen hagarenë dhe ishmaelitë. Dhe ata i quajnë ata saraçen, duke qenë se janë larguar duarbosh nga Sara...Këta ishin idhujtarë dhe adhurues të yllit

[10] Një kronikë e mirë për rënien e Jerusalemit dhe vizitën e Umarit mund të gjendet në Karen Armstrong, *Jerusalem: One City, Three Faiths* (New York: Knopf, 1996), 226-34. Për Sophronius, shih Robert Hoyland, *Seeing Islam as Others Saw It: A Survey and Evaluation of Christian, Jewish and Zoroastrian Writings on Early Islam* (Princeton, N.J.: Darwin Press, 1997), 66-74.

të mëngjesit...dhe derisa në kohën e Heraklit ishin thjesht idhujtarë. Që nga ajo kohë deri tani një profet i rremë u paraqit në mesin e tyre, i quajtur Muhamed, i cili, duke gjetur një Testament të Ri dhe të Vjetër dhe me sa duket pas bisedës me një murg arain, krijoi herezinë e tij.

Sipas Xhonit, Muhamedi pastaj "krijoi tregime të pavlera", të cilat u mblodhën nga pasuesit e tij për të formuar thelbin e një sekti.[11]

Në thelb, Xhoni e trajtoi Islamin jo ndryshe nga dhjetëra herezi të tjera që kishin fëlliqur Krishterimin e hershëm. Derisa interpretimi i tij ishte i vrazhdë, denoncimi i tij i Islamit, si një herezi e krishterë, është një testament i fuqishëm për lidhjen e ngushtë midis dy besimeve. Polemistët e krishterë kurrë nuk e kanë përshkruar Zoroastrianizmin si bastardim të Krishterimit, e as evropianët e mëvonshëm nuk i lidhën hindusët dhe budistët me Krishterimin. Ndarja e Kishës së krishterë në fillim pasqyronte interpretimet alternative dhe të kundërta të shkrimeve të shenjta. Këto ndarje mund të zgjasin me dekada apo madje me shekuj, por përfundimisht një palë humbi apo ishte e margjinalizuar dhe pastaj u etiketua si "herezi" nga ajo "ortodokse". Xhoni i Damaskut, duke shkruar në kohën kur fuqia e kishës në Lindjen e Afërme ishte venitur, ishte i frikësuar dhe i zemëruar nga suksesi i Islamit. Ai besonte se myslimanët kishin shtrembëruar fjalën e vërtetë të Zotit, duke mohuar hyjninë e Krishtit, ashtu siç kishin bërë heretikët më parë. Ndryshe nga këta heretikë, megjithatë, Islami i kishte rezistuar përpjekjeve për ta shtypur atë dhe tani ishte sfidë direkte për legjitimitetin dhe mbijetesën e Kishës Bizantine.

[11] Hoyland, *Seeing Islam as Others Saw It*, 480ff.; Hught Goddard, *A History of Muslim-Christian Relations* (Chicago: New Amsterdam Books, 2000), 38-41.

Ndarjet e komunitetit

Qëndrimet e myslimanëve ndaj Ithtarëve të Librit nuk ishin edhe aq në fokus në këto vite të hershme. Në vend të kësaj, gjenerata e parë e myslimanëve ishte e okupuar me përcaktimin e një rendi të ri politik. Vala e parë e pushtimeve pushoi në mes të shekullit të 7-të, për shkak të ndarjeve të brendshme. Pasuesi i Muhamedit ishte problem madje edhe me zgjedhjen e Ebu Bekrit, por pas Umer ibn al-Khatabit, çështja u bë më akute. Kalifi i tretë, Othmani, u vra, dhe Ali bin Ebu Talib, i cili ishte i martuar me vajzën e Muhamedit, Fatimën, dhe ishte gjithashtu kushëri i Profetit, u bë pastaj kalifi i katërt. Gjatë sundimit të shkurtër të Aliut, uniteti i dobët i fiseve arabe u prish. Debati qendror ishte mbi atë se kush duhej të ishte trashëgimtari i duhur i Muhamedit. Klane të ndryshme të Kurejshëve përpiqeshin për këtë. Aristokracia e Mekës u përpoq të shfrytëzonte rastin dhe ishin të sfiduar nga medinasit, të cilët pohuan se pasi që i ishin bashkuar Muhamedit të parët, ata kanë përparësi. Madje, midis medinasve dhe familjes së afërt të Muhamedit kishte ndarje.

Nëse këto ndarje politike dhe fisnore nuk mjaftuan për të krijuar kaos, pati një dimension të shtuar doktrinar: a duhej që kalifi të ishte i lidhur dhe të rridhte nga Muhamedi nga gjaku, apo ishte devocioni faktori më i rëndësishëm? Shkurt, çështja ishte nëse kalifi duhet të ishte monark trashëgues, i cili do t'ia kalonte pushtetin e tij te fëmijët, apo i pari ndërmjet të barabartëve, i cili do të fitonte autoritetin e tij përmes respektimit të komunitetit.

Aliu ishte më kontroversi nga katër kalifët e parë. Ngjitja e tij në kalifat shkaktoi luftë civile. Ai kishte mbështetës besnikë të fortë, të cilët besonin se ai kishte qenë i preferuari i Muhamedit dhe pastaj padrejtësisht i ishte mohuar kalifati për mbi dy dekada. Në të njëjtën kohë, ai ishte sulmuar jo vetëm nga klanet rivale dhe pretenduesit tjerë, por nga grupe që besonin se kalifati duhet të rezervohet dëlirësinë e besimit pavarësisht lidhjeve të gjakut me Muhamedin. Lufta civile që përfundoi me vrasjen e Aliut më 661, ishte kaleidoskop i fraksione-

ve luftuese, dhe natyra përkrahëse e burimeve pasuese e bën më të vështirë për të klasifikuar atë që ka ndodhur. Aliu duket se u përpoq të negociojë me armiqtë e tij për të mbajtur të pacenuar komunitetin mysliman, por kjo vetëm armiqësoi disa nga mbështetësit e tij. Puristët që e vranë u ndjenë se ai i kishte tradhtuar dhe kishte hequr dorë nga përgjegjësia e tij duke mos bërë fushatë të fuqishme kundër armiqve të tij. Derisa specifikat janë të mjegullta, rezultati nuk është: kalifati i Aliut hapi një hendek religjioz brenda komunitetit mysliman. *Shi'a Ali* apo *"grupi i Aliut"*, u bënë të njohur si Shi'ia, dhe të tjerët u bënë të njohur si sunni, apo "tradicionalistë". Çdonjëri nga këta në fakt u fragmentua në fraksione dhe sekte të shumta, por ndarja Sunni-Shi'a ka zgjatur deri këtë ditë.

Për gjeneratat pasuese të myslimanëve, vdekja e Aliut shënoi fundin e "Kalifatit të Drejtë". Katër kalifët e parë që të gjithë ishin personalisht të lidhur me Muhamedin, me gjak, miqësi apo martesë. Kalifi që zëvendësoi Aliun, Muavija, ishte një nga Kurejshët dhe në lidhje me Uthmanin. Ai kishte qenë gjeneral madhështor gjatë pushtimeve të para, dhe pastaj guvernator i Sirisë. Por vetëm me mbështetjen admiruese të qyteteve garnizone dhe të Kajros, vetëm kur djali më i madh i Aliut, Hasani, u pajtua që të mos kontestojë lidershipin e Muavijës, vendi i tij në kalifat ishte i sigurt.

Dinastia Emevite e themeluar nga Muavija zgjati për rreth një shekull. Perandoria myslimane ndryshoi nga bashkimet e lirshme të organizuara dhe dinamike të fiseve në një shtet më të strukturuar që shtrihej në mijëra milje dhe udhëhiqej nga Damasku. Në fillim, Emevitët ishin drejtuar më shumë te çështjet e brendshme sesa vazhdimi i luftërave të zgjerimit, por përleshjet me bizantinët vazhduan, veçanërisht duke ditur afërsinë e Damaskut me qendrën e Perandorisë Bizantine. Emevitët ndërtuan flotë ushtarake, dhe pushtuan Kretën e ishujt Rode, por këto ishin të parëndësishme krahasuar me territorin e pushtuar vetëm disa vite më parë. Vdekja e Muavijës dhe absurditeti i djalit të tij nxiti luftë tjetër civile, e cila shfaqi përsëri mbështetësit e Aliut dhe rebelimin në Mekë dhe Medine. Pas kësaj, Emevitët triu-

mfues ndërmorën një valë të re pushtimesh dhe sulme më substanciale kundër Kostandinopojës.

Emevitët udhëhoqën perandorinë e parë myslimane, që në mënyrë direkte u përplas me të krishterët e Evropës. Duke avancuar nga Egjipti, ushtritë arabe morën Kartagjenën (Tunizinë) nga fundi i shekullit të 7-të, dhe pastaj vazhduan në perëndim përgjatë bregdetit të Mesdheut. Në fillim të shekullit të 8-të, Tarik ibn Zijad, një skllav i liruar i guvernatorit mysliman të Afrikës Veriore, pushtoi Spanjën me një ushtri, të cilën e udhëhoqi përgjatë ngushticës që do të merrte emrin e tij, Xhebel Tarik, të njohur në perëndim si Xhibraltar. Gadishulli Iberik në këtë kohë sundohej nga vizigotët, një fis gjerman që kishte pushtuar rajonin gjatë ditëve të fundit të Perandorisë Romake. Si në Egjipt, marrëdhëniet ndërmjet sundimtarëve dhe të të sunduarve ishin të tendosura dhe armiqësore, dhe popullsia lokale nuk kishte dalë për të ndaluar avancimin e Tarikut. Qytetet si Kordoba dhe Toledo ranë pa luftime, dhe derisa gotët bënë pak rezistencë, i gjithë gadishulli, i quajtur nga arabët al-Andalus, shpejt ra nën kontrollin e Tarikut. Vetëm Pirinejet qëndronin midis tij dhe Evropës. Ai mund të kishte vazhduar avancimin e tij po të mos ishte kthyer mbrapsht nga kalifi, i cili, siç do të shihet, faktikisht kurrë nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për pushtimin e Spanjës, dhe nuk ishte e qartë se çfarë vlere i dha perandorisë së tij.

Pushtimi i Spanjës pati ndikim të pallogaritshëm mbi Evropën dhe zhvillimin e civilizimit perëndimor, por fillimisht, ishte shënim për Emevitët. Shumë më e rëndësishme për myslimanët në atë kohë ishte se suksesi i Emevitëve ishte humbje për ata që besonin se komuniteti duhet të udhëhiqet jo nga dinastia më e fuqishme, por nga më e devotshmja dhe e pastërta.

Zhvendosja e kryeqytetit në Damask, betonoi rendin e ri dhe zvogëloi ndikimin e Medinës dhe Mekës. Rezultati ishte se Perandoria Emevite evoluoi si perandoritë tjera. Klasa e saj sunduese dhe një përqindje e vogël por në rritje e nënshtetasve të saj ishin myslimanë, por shteti qeverisej dhe ishte organizuar më shumë si bizantinët, persianët apo shtetet mesjetare në Evropën e krishterë. Kalifi ruajti titullin

Komandant i Besimtarëve, dhe ishte arbitri i fundit i debateve religjioze, por e njëjta ishte e vërtetë për perandorin bizantin. Kalifi kishte autoritet suprem mbi gjykatën, guvernatorët dhe ushtrinë, por të njëjtën e bëri perandori Han në Kinë. Dhe në çështjet e besimit, ligjit dhe doktrinës, Emevitët filluan t'u nënshtrohen dijetarëve fetarë dhe gjykatësve.

Për kalifin në Damask, ajo që e interesonte ishte kontrolli, rendi dhe të hyrat. Kontrolli mbahej duke vendosur guvernatorë të fuqishëm në çdo provincë dhe duke i bërë përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave. Vendbanimet e garnizoneve në qytetet që po lulëzonin, dhe ushtritë e kalifit ishin ruajtësit e fundit të paqes. Por ditë pas dite, natyra e decentralizuar e perandorisë do të thoshte se qytetarët e saj gëzonin autonomi substanciale. Shumica dërrmuese e këtyre qytetarëve ishin Ithtarë të Librit, dhe autonomia do të thoshte tolerancë për besimet religjioze dhe institucionet e tyre. Derisa pushtuesit nuk ia impononinposhtërimin të pushtuarve, kjo nuk ishte eksperiencë mbizotëruese. Për koptët e Egjiptit, për popullin e Andaluzisë dhe për të krishterët e Lindjes së Afërt, sundimi i Emevitëve ishte më i mirë dhe më i bezdisshëm sesa ai që kishte qenë para ardhjes së arabëve dhe Islamit. Komunitetet u lejuan të organizojnë veten, me ndërhyrjen minimale nga shteti. Derisa koptët, për shembull, ishin qytetarë të dorës së dytë për sa i përket elitës sunduese arabe, ata gjithashtu kishin qenë të dorës së dytë për sa i përket elitës sunduese bizantine. Të paktën, nën arabët ata nuk u përballën me persekutim religjioz. Ata duhej të paguanin një taksë lokale, dhe nganjëherë duke iu nënshtruar kufizimeve në udhëtim, veçanërisht midis fshatrave dhe qyteteve, por kjo nuk është se nëse shumica e egjiptianëve kanë gëzuar liri personale nën bizantinët, ajo iu është mohuar nga myslimanët.

Sot, miliona njerëz - veçanërisht në botën myslimane - akoma besojnë në mitin se kalifi ka sunduar shpirtin si dhe trupin e nënshtetasve të tij dhe se perandoritë e hershme myslimane përfaqësonin sintezë unike dhe të fuqishme të besimit dhe fuqisë. Kjo ka pasur implikime shqetësuese për mënyrën sesi është definuar Islami në botën moderne. Shumica e njerëzve që kanë jetuar nën sundimin mysliman në sheku-

llin e 7-të dhe 8-të nuk do të njihnin këtë pamje të botës së tyre. Vetëm nëse ata do të sfidonin në mënyrë direkte dhe të qartë autoritetin e kalifit dhe përfaqësuesve të tij, ata do t'i lejohej një shkallë e jashtëzakonshme e tolerancës. Padyshim se ka shembuj të të kundërtës së kësaj. Njerëzit me pushtet zakonisht abuzojnë me këtë pushtet, dhe guvernatorët e tepruan. Në vend të kësaj, sistemi ishte dizajnuar për të ruajtur pothuajse status-kuonë, dhe kjo nënkuptonte një klasë udhëheqëse të vogël të myslimanëve që cenonte sa më pak që ishte e mundur popullatën shumicë krishtero-hebreje.

Në dekadat e para të shekullit të tetë, pushtimet fillestare kryesisht kishin përfunduar. Emevitët ndërmorën disa sulme të tjera mbi Kostandinopojën, dhe një, i udhëhequr nga vëllai i kalifit më 717, gati pati sukses. Emevitët sulmuan nga toka dhe deti dhe rrethuan kryeqytetin. Kombinimi i urisë, mercenarëve bullgarë dhe zjarrit grek asgjësoi flotën arabe dhe dobësoi ushtrinë. Kjo ishte hera e fundit që Emevitët iu afruan Kostandinopojës, dhe më vonë, perandori bizantin, rimori pjesën më të madhe të Azisë së Vogël dhe shtyu Emevitët matanë maleve dhe i ktheu në luginat e lumenjve dhe shkretëtirat e Sirisë dhe Irakut.

Brenda botës myslimane, të krishterët filluan të konvertohen në Islam, kryesisht në numër të vogël sesa në grumbull. Pas largimit nga qytetet garnizone, arabët u integruan ngadalë në shoqëritë që kalifët e parë ishin përpjekur t'i mbanin të veçuara. Ata u martuan, ndërkaq gratë e fëmijët e tyre u bënë myslimanë. Ushtarët arabë gjetën mënyra për t'u vendosur dhe siguruar tokë; tregtarët arabë nisën të tregtonin; dhe klerikët filluan të krijojnë një sferë speciale të ndikimit. Të krishterët, të cilët shpresonin të avanconin gjetën punë me guvernatorët apo udhëheqësit lokalë apo madje në gjykatën në Damask, si qatipë, përkthyes dhe këshilltarë. Dhe ngadalë, i lindur nga kontakti në qytete dhe fshatrat përreth, u zhvillua një kulturë e re dhe hibride që ndërthuri elementë të Islamit, Krishterimit, Judaizmit dhe Zoroastrianizmit, dhe të shoqërisë perse, bizantine, egjiptiane, greke dhe arabe. Në Afrikën Veriore dhe Spanjë, berberët dhe vizigotët u përzien. Po të ekzistonte fraza, kjo do të quhej botë multikulturore.

Toleranca e myslimanëve ndaj Ithtarëve të Librit, u shtri në kontekstin e dominimit të padiskutuar mysliman. Pushtuesit i lejonin vetes të ishin tolerantë pasi që Ithtarët e Librit paraqisnin kërcënim të vogël. Gjatë jetës së Muhamedit nuk ishte kështu. Hebrenjtë e Medinës mund të rrezikonin statusin e Muhamedit, si profet dhe lider i komunitetit, dhe rezultati ishte trajtimi i ashpër. Por, pas fillimit të pushtimeve, dhe kur u bë e qartë se të krishterët e Lindjes së Afërme nuk do të mund t'i rezistonin dominimit mysliman, myslimanët adoptuan politikën e tolerancës që ishte sublime dhe sekulare, sublime pasi ishte e bazuar në Kur'an dhe sekulare pasi i lejonte ata të udhëhiqnin një perandori me fuqi minimale.

Jeta e Muhamedit dhe pushtimet që pasuan krijuan një strukturë për një milenium e gjysmë në vazhdim. U mbollën farat e konfliktit dhe bashkëjetesës paqësore, dhe megjithatë historia pasuese magjepsëse, pjesa më e madhe e asaj që ka ndodhur, ka dalluar vetëm në specifika. Të njëjta vërejtje janë zhvilluar pafund, me ndryshim të temës, por jo shmangie radikale nga rezultati.

Për shekuj pas pushtimeve të para, bashkëjetesa ishte normë, por askush nuk mund të dëgjojë jehonën e kësaj sot. Rënia e Jerusalemit, dëbimi dhe ekzekutimi i hebrenjve të Medinës, dhe luftërat midis Emevitëve dhe bizantinëve - këto kujtohen. Ajo që ndodhi më pas në Damask, në Irak, Iran dhe Andaluzi, është bërë mirazh - panorama e saj paraqitet në botën moderne, duke regëtuar në periferinë e vizionit tonë kolektiv, dhe pastaj avullohet dhe zhduket. Ndryshe nga mirazhi, megjithatë, e kaluara është reale, dhe askund nuk është më reale sesa buzë Tigrit në oborrin e kalifit në Bagdad.

Nga anglishtja:
Fuad Morina

Zachary Karabell

IN THE NAME OF THE LORD

(Summary)

Sometime around the year 570 in the Western calendar, Muhammad ibn Abdullah was born in the oasis town of Mecca, just off the western coast of the Arabian Peninsula. The town was separated from the Red Sea by a narrow, steep mountain range, and it sat at the edge of the vast desert that defined most of the Arabian Peninsula. The oasis was dominated by the Quraysh tribe, who controlled the camel trade that passed through Mecca between Yemen, in the south, and the more settled agrarian regions hundreds of miles north, which were divided between the Byzantine emperor and the Sasanian monarch of Persia.

زكريا كارابل

باسم الله

(خلاصة البحث)

حوالي في عام ٥٧٠ وفقا للتقويم الغربي ولد محمد بن عبد الله في مدينة مكة المكرمة في الجزء الغربي من شبه الجزيرة العربية . وكانت المدينة منفصلة من البحر الأحمر من خلال خط ضيق و جبلي وكانت تقع على حافة الصحراء الشاسعة التي تتميز شبه الجزيرة العربية و كانت قبيلة قريش تسيطر على الواحة و كانوا يسيطرون على تجارة الإبل التي كانت تمر عبر مكة المكرمة و كان يربط الطريق التجاري اليمن في الجنوب مع المناطق الزراعية البعيدة آلاف الأميال في الشمال والتي كانت منقسمة بين الإمبراطور البيزنطي و العاهل الساساني في بلاد فارس.

Prof. Dr. Zejnullah Gruda

ME RASTIN E 100 VJETORIT TË LUFTËRAVE BALLKANIKE

KRIMET NJËSHEKULLORE NDAJ SHQIPTARËVE – KRIMET GJATË LUFTËRAVE BALLKANIKE

Mbamendja na mundëson të dëgjojmë atë që s'mund të dëgjohet dhe të shohim atë që nuk shihet". Plutarku

Fillimi i tragjedisë afro njëshekullore të Kosovës – Gllabërimet e tokave shqiptare - Okupimi serb i Kosovës në Luftërat Ballkanike 1912/1913

Tragjedia e popullit shqiptar të Kosovës është e gjatë (vjetër) afro një shekull ose po aq sa Kosova ka qenë në kuadër (nën sundim) të Serbisë, Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, Mbretërisë së Jugosllavisë dhe Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Kjo lidhje e Kosovës me shtetet e sllavëve të jugut është imponuar nga Luftërat Ballkanike dhe është mbajtur deri në dezintegrimin e Jugosllavisë gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX.

Gjatë kësaj kohe (shekullit XX) statusi i Kosovës dhe i shqiptarëve ka ndryshuar siç ka ndryshuar edhe rregullimi i shtetit brenda të cilit janë gjendur, ku janë trajtuar si pjesë e shtetit unitar, si njësi au-

tonome, si njësi konstitutive e federatës jugosllave sipas Kushtetutës së vitit 1974 etj.

Gjatë asaj kohe, pozita e shqiptarëve s'ka qenë e njëjtë. Por, pos periodave të shkurtra, p.sh. 1970-1981, pozita e shqiptarëve në pjesën më të konsiderueshme të kohës ka qenë shumë e vështirë e ndonjëherë atyre u është kanosur gjenocidi. Kjo vlen sidomos për kohën e Luftërave Ballkanike, për periodën midis dy luftërave botërore, periodën pas Luftës së Dytë Botërore kur qarqet shoviniste serbe dëshironin t'ua mëvishnin shqiptarëve bashkëpunimin me forcat fashiste për të hapur rrugën për ndëshkimin dhe dëbimin e tyre jashtë dhe në periodën pas vitit 1989 deri në vitin 1999.

Natyrisht, synimet e veta imperialiste ndaj Kosovës serbët i kanë shfaqur shumë herët dhe i kanë mbështetur në të ashtuquajtura "të drejta historike." Ç'është e vërteta, ky argument është imponuar jo për shkak të vlerës së tij të madhe (decizive) por për shkak se serbët nuk kanë mundur ta marrin dhe ta mbajnë Kosovën duke u mbështetur në "parimin kombëtar", të cilin, përndryshe, e kishin përqafuar dhe mbrojtur në kohën e pavarësimit të tyre.

Në ndërkohë serbët, të vetëdijshëm për rëndësinë e faktorit etnik, do të bëjnë plane dhe do të ndërmarrin aksione të vazhdueshme për të ndryshuar strukturën kombëtare të popullsisë së Kosovës. Për këtë arsye, planifikoheshin, organizoheshin dhe realizoheshin sjellje të kolonëve serbë e malazez në Kosovë qysh nga përfundimi i Luftërave Ballkanike e deri në prag të luftës së fundit më 1998/1999, e në anën tjetër ndërmerreshin masa për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi dhe stimulimin e dyndjeve për në vendet e tjera të botës. Kjo përbën një ndër faqet më të errëta të politikës shoviniste dhe imperialiste të Serbisë dhe të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve.

Ndryshimi i argumentimit për sendërtimin e aspiratave serbe ndaj Kosovës ka ndodhur afro një shekull më parë dhe lidhet me emrin e Nikola Pashiqit, që kishte udhëhequr Serbinë nga viti 1909 deri më 1918, i cili në fillim angazhohej për "parimin kombëtar" dhe për nevojën e përcaktimit të kufijve sipas kriterit etnografik d. m. th. që ndarja të bëhej në atë mënyrë që kufijtë e shteteve ballkanike të shtrihen

deri aty ky shtrihen kufijtë etnografikë. Mirëpo, me ardhjen e serbëve në këto anë, ndryshe nga si pretendonin, gjetën vetëm disa monumente mesjetare serbe, "muret e ftohta, të cilat nuk i rruajnë krahinat, të cilat kanë vlerë për arkeologun dhe artistin, si për shembull, Deçani, që mund ta emocionojnë shpirtin e romantikëve nacionalë, por për stabilitetin e regjimit të ri në këto vise nuk kanë kurrfarë rëndësie."[1] Atëherë politikanët serbë dhe Serbia kishin dështuar në përpjekjet e tyre që shqiptarët t'i paraqesin para botës si serbë që e kanë ndërruar fenë nën presionin turk, "si serbë të shqiptarizuar." Prandaj serbët, në Konferencën e Londrës, nuk angazhoheshin më për kufijtë etnografikë, por "për kufijtë, natyrorë, gjeografikë dhe strategjikë", sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të arsyetonin jo vetëm gllabërimin e Kosovës, të Sanxhakut dhe të Maqedonisë, por edhe përpjekjet për gllabërimin e pjesës veriore të Shqipërisë. Në këtë situatë, e vetmja mbështetje për ekspansionizmin serb dhe për pushtime koloniale kishte mbetur "parimi historik" ose "të drejtat historike" megjithëse edhe historia nuk ka qenë aleate e mirë e Serbisë nëse përjashtohen mitet dhe falsifikimet. Kjo del shumë qartë nëse përkujtojmë vetëm çka shkruante njëri ndër udhëheqësit dhe ideologët e ekspansionit serb Stojan Protiq (Balkanikus) në veprën "Problemi shqiptar dhe Serbia e Austro-Hungaria", të botuar më 1913. "Shqiptarët janë në Gadishullin Ballkanik më se dy mijë vjet: ata janë aty banorë autoktonë. Në Gadishullin Ballkanik janë radhitur, njëra pas tjetrës, kultura dhe qytetërime të ndryshme: greke, romake, bizantine, venedikase, sllave (serbe, kroate, bullgare). Shqiptarët kanë qenë pra në qendër të kulturës dhe të qytetërimit; dhe jo vetëm të njërës, por të shumë sosh."[2]

Nga historia dihet qartë se sllavët kanë arritur (depërtuar) në Ballkan gjatë viteve 570-580 kurse kolonizimin masivi e kanë filluar në fillim të shekullit VII.[3] Gjithashtu dihet se këto territore dhe populli i

[1] Dimitrije Tucoviq, Nga një garnizon i kufirit, 12 (25) nëntor 1913. Tucoviqi, Zgjedhje punimesh II, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 192.
[2] Balkanikus (Stojan Protić), Albanski problem i Srbija i Austro-Ugarska, Beograd, 1913, str.23.
[3] Georgije Ostrogorski, Istorija Vizantije, Narodna knjiga, 1998, str. 110-111.

tyre, sikurse edhe disa territore dhe popuj të tjerë, kanë qenë në kuadër të shtetit të vjetër serb për më pak se dy shekuj (në shekullin XIII dhe XIV) ose nga fundi i shekullit XII deri nga mesi i shekullit XIV kur ka vdekur car Dushani (1355)[4] dhe kur turqit fillojnë zaptimin sistematik të Gadishullit Ballkanik, respektivisht, deri më 1389, kur turqit u shkaktuan humbjen vendimtare serbëve dhe aleatëve të tyre në Fushë Kosovë, pas së cilës Serbia u shndërrua në vasal të Turqisë.[5] Pas kësaj beteje, jo vetëm Kosova, por i tërë Ballkani ra nën sundim disa shekullor të Turqisë.

Çlirimi i popujve ballkanikë nga sundimi otoman filloi në shekullin XIX. E para ishte pavarësuar Greqia më 1827 e pas gjysmë shekulli edhe Serbia, Mali i Zi dhe Rumania më 1878. Serbia para pavarësisë kishte statusin e krahinës autonome, të shtetit vasal në periodën nga 1856-1878 kur ishte pranuar si shtet i pavarur në Kongresin e Berlinit. Atëherë kishin filluar edhe lëvizjet çlirimtare të bullgarëve, të shqiptarëve, të maqedonasve etj. Për këta që i referohen historisë është mirë të përkujtohet se Serbia deri në vitin 1876, kur ishte nën vasalitetin e Turqisë, kishte jo plot 38.000 km^2 sipërfaqe e në kohën e Luftërave Ballkanike ose afro 30 vjet pas pavarësimit kishte gjithsej 48.300 km^2.[6] Sot Serbia, pa Vojvodinën dhe Kosovën, ka një sipërfaqe prej 55.968 km^2, por pretendon në një territor prej 88.361 km^2, që është më se dy herë më shumë se sa kishte në kohën e fitimit të pavarësisë. Afërsisht gjysma e këtij territori, që e përbëjnë Vojvodina, Kosova dhe Sanxhaku, janë okupuar gjatë luftërave ballkanike dhe pas Luftës së Parë Botërore dhe prej atëherë janë mbajtur me dhunë dhe kundër vullnetit të popujve të tyre në kuadër të shteteve të krijuara më pastaj.

Kjo vlen edhe për Kosovën. Ky territor, gjatë shekujve, ka ndërruar sundimtarët: duke qenë nën sundimin e Perandorisë Romake, bullgarëve për dy shekuj (pas vitit 851), Perandorisë Bizantine, Serbisë (që përfshinte pjesë të Greqisë, pjesë të dominuara nga sllavët dhe

[4] Georgije Ostrogorski, op. cit., str. 495-496; Stephen Schwartz, Kosova – Prejardhja e një lufte, Prishtinë, 2006, f. 8-9; 26.
[5] Georgije Ostrogorski, op. cit., str. 506-507.
[6] Balkanikus (Stojan Protić), op. cit., str. 63.

Shqipërinë), Perandorisë Otomane etj. Para Luftës Ruso – Turke dhe Kongresit të Berlinit territoret shqiptare ishin nën sundimin e Perandorisë Otomane dhe ishin të ndarë në katër vilajete: Vilajeti i Shkodrës, Janinës, Kosovës dhe Manastirit.

Gllabërimi i këtyre territoreve nga fqinjët e tyre, të cilët më herët ishin pavarësuar ose ishin në rrugë për t'u pavarësuar, fillon pas Luftës Ruso-Turke 1877-1878 dhe Kongresit të Berlinit më 1878 dhe zgjat deri në përfundimin e Luftërave Ballkanike 1912/1913. Kështu, konsulli britanik në Beograd, më 26 nëntor 1878, e informonte sekretarin e Ministrisë së jashtme se banorët e mbi 100 fshatrave shqiptare në Toplicë dhe në luginën e Vranjës ishin mizorisht të përzënë nga serbët prej shtëpive dhe tokave të tyre[7]; më 1879 Plava e Gucia i cedohen (jepen) Malit të Zi; më 1881 distrikti i Artës i cedohet (jepet) Greqisë; më 1913 grekët e pushtojnë Janinën, kurse malazeztë Shkodrën; malazeztë atëherë kanë okupuar Bjellopojën, Beranën, Plevlën, Plavën, Gucinë dhe Pejën, e bashkë me serbët edhe Gjakovën, kurse serbët, pas betejës së Kumanovës, kishin pushtuar Manastirin dhe më pastaj ishin drejtuar kah veriu dhe kishin pushtuar Prizrenin dhe Gjakovën dhe përmes Mirditës kishin dalë në Lezhë, kurse malazeztë kishin marrë San Giovani di Medua-n; Serbia e Mali i Zi bashkë kishin okupuar Durrësin, ndërsa në ndërkohë serbët kishin okupuar Dibrën, Ohrin dhe Elbasanin. Grekët, nga ana e tyre, kishin okupuar Korçën, Prevezën dhe Pentepigadian dhe e kishin rrethuar Janinën dhe kishin bombarduar Vlorën, e më pastaj kishin okupuar edhe Klisurën e Tepelenën.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 dhe nën presionin e jashtëm disa nga këto territore i janë lënë Shqipërisë, por pjesa më e madhe ka mbetur nën sundim të shteteve fqinje - Gre-

[7] Leo Freundlich, Albania's Golgota Indictments Against the Exterminators of the Albanian people, Collected and edited by Leo Freundlich in Vienna 1913. Reprinted in Prishtina, 2001. Ky tekst me titull "Shfarosja e shqiptarëve" është përkthyer në shqip nga Salih Maqedonci dhe është botuar krahas tekstit në anglisht, f. 34. British Museum, "Accounts and Papers" 38 – 1878-9 LXXX 79, 574-575. Kjo letër është reprodukuar në veprën: Skender Rizaj, "The Albanian League of Prizren" English documents, Prishtinë, 1978, pp. 241-242.

qisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Kjo shihet qartë po qe se kihet parasysh fakti se në fillim të vitit 1917 kishte prej 1,500,000 deri në 2,000,000 shqiptarë prej të cilëve vetëm rreth 800,000 deri në 1,000,000 jetonin brenda kufijve të Shqipërisë që ia kishte caktuar Komisioni Ndërkombëtar më 1913. Shumë qytete, fshatra, krahina dhe fise "plotësisht shqiptare" ("thoroughly Albanian", "wholly Albanian"), "kryesisht shqiptare" ("mainly Albanian") ose "gjysmë shqiptare" ("semi-Albanian") i ishin lëshuar (dhënë) Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë si Gruda, Hoti, Plava, Gucia, Ulqini, Tivari, Triepshi, Kuçët, Peja, Gjakova, Prishtina, Prizreni Kalkandelen (Tetova), Luma, Dibra, qarku i Janinës dhe Prevezës[8], përveç numrit të konsiderueshëm të (shumë) vendbanimeve rreth Novi Pazarit, të pjesës së epërme të basenit të Moravës në veri të Kurshumlisë dhe Prokuples dhe vendbanimeve të shpërndara të shqiptarëve rreth Shkupit, Velesit (Koprulu), Kumanovës etj. Madje tri të katërtat (3/4) e popullsisë së Ohrit ishin shqiptarë e vetëm një e katërta (1/4) ishin bullgarë. Përveç kësaj, shqiptarët bënin shumicën e popullsisë në Beotia, Attica, Megara dhe Argolis dhe tërë popullsinë e ishujve Spezzia, Hydra, Salamis dhe Paros. Përveç këtyre ekzistonte një numër i vendbanimeve shqiptare në luginën e Spercheus, në Phocis, në Achaea, Corinth dhe Arkadian Jugore, që tregon qartë faktin se shqiptarët gjendeshin çdo kund, përveç në disa vende dhe përbënin një të pestën e popullsisë së Mbretërisë së Greqisë.[9]

Fatkeqësisht, konspiracionet për gllabërimi i tokave shqiptare kanë vazhduar edhe më vonë, kurse në to kanë marrë pjesë, përveç fqinjëve, edhe shtetet imperialiste të kohës: Anglia, Franca dhe Rusia. Mjafton të përmendim Traktatin famëkeq të Londrës të vitit 1915 me të cilin fuqitë imperialiste kishin paraparë madje edhe ndarjen e Shqipërisë së përgjysmuar midis Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi për ta reduktuar në një principatë autonome me Durrësin dhe rrethinën e tij. Këto plane kanë dështuar edhe falë kontributit të Revolucionit të

[8] Albania (Handbooks prepared under Direction of the Historical Section of the Foreign Office No. 17), London, Published by H. M. Stationery Office, 1920, pp. 24-25; 69-70.
[9] Ibid., pp. 24-25.

Tetorit, pas triumfit të të cilit ishin publikuar traktatet e fshehta që zbulonin komplotet imperialiste për gllabërimin e popujve të vegjël e të dobët dhe presidentit të atëhershëm amerikan Wudroow Wilson.

Dhe tashti po i kthehemi prapë Kosovës. Kosova, pra, është okupuar gjatë luftërave ballkanike 1912/13 në kundërshtim me "parimin kombëtar" dhe "në kundërshtim me aspiratat e shqiptarëve që ishin shprehur në lëvizjen nacionalçlirimtare 1878-1912." Po kjo është përsëritur edhe me rastin e okupimit të sërishëm të Kosovës me 1918, kur shqiptarët ishin "kundër inkorporimit në shtetin serb, respektivisht jugosllav."[10] Pikërisht atëherë, socialisti i shquar serb Dimitrije Tucoviq shkruante për fqinjin (Shqipërinë) "gjysma e popullsisë së të cilit ka mbetur brenda kufijve tanë të rinj" (kufijve *të Serbisë* Z. G.)[11] kurse akademiku Vladimir Dedijer shkruante: "Me sa duket me asnjë vend dhe me interesat e asnjë populli nuk është bërë pazar aq paturpshëm në konferenca të paqes pas Luftës së Parë Botërore, siç është rasti me popullin shqiptar."[12]

Këto janë fakte historike, që zbulojnë sheshazi falcitetin e të ashtuquajturave "të drejta historike" të Serbisë.

Sot, natyrisht, rrallë ku dëgjohet për "të drejtat historike." Këso argumentesh kishin ngritur vetëm udhëheqësit kryesorë të fashizmit Benito Musolini dhe Adolf Hitler. I pari nga këta ju premtonte pasuesve të vet projektin për rimëkëmbjen e Perandorisë Romake dhe, për ta bërë Romën qytet që do të udhëheqë qytetërimin evroperëndimor si në antikë, kurse i dyti krijimin e "hapësirës jetike" për gjermanët me pushtimin e tokave në lindje kah kishin kaluar kalorësit teutonë. Rezultati i këtyre ideve tashmë është i njohur mirë. Të tjerët si Anglia, Franca, Spanja, Portugalia, Holanda, që me shekuj kanë mbajtur nën sundim vende e popuj të shumtë, nuk kanë mundur t'i mbrojnë ambiciet imperialiste me "të drejta historike." Përpjekja e fundit i atribuohet presidentit të Francës De Gol, i cili më 1958 kishte thënë "Algjeria

[10] Radošin Rajović, Autonomija Kosova: Istorisko pravna studija, Beograd 1985, str. 64-65.
[11] Dimitrije Tucović, Strategijske tačke u Arbaniji. Ibid., str. 143.
[12] Dedijer Vladimir, Jugoslavija od Versaja do Pariza, Beograd 1947, str. 24.

është Francë", por kjo nuk kishte mundur të ndalojë pavarësimin e Algjerisë. Rezultati i kësaj është shkatërrimi i perandorive koloniale dhe krijimi i më se 120 shteteve të reja. Dhe, kjo s'ka si të jetë ndryshe, për shkak se me të njëjtat kritere që provon t'i promovojë Serbia, Perandoria Otomane do të mund të kërkonte për ta vënë Serbinë nën sundimin e vet dy herë me më shumë të drejtë se që ka Serbia ndaj Kosovës, sepse Serbia ka qenë nën sundimin e Perandorisë Otomane për afro pesë shekuj ose nga viti 1389 deri më 1878. Kjo mund të vlejë shumë më tepër për arabët që kanë sunduar disa pjesë të Spanjës për afro tetë shekuj ose nga viti 712-1492, dhe ku janë disa nga objektet më të vlefshme të qytetërimit islam, si xhamia e Kordobës, Al Hambra e Granadës dhe shumë të tjera. Po kjo vlen edhe për Spanjën që kishte pushtuar gati tërë Amerikën Latine në fillim të shekullit XVI, të cilën e kishte mbajtur deri më 1811-1825, kur janë pavarësuar gati të gjitha shtetet e Amerikës Latine të cilave iu kishte imponuar gjuhën, fenë, arkitekturën etj., dhe ku jetojnë dhjetëra e qindra miliona pasardhës të spanjollëve që edhe sot Spanjën e konsiderojnë "atdheu mëmë." E njëjta gjë mund të thuhet edhe për anglezët që kishin themeluar në fillim të shekullit XVII Anglinë e Re në trollin e Amerikës Veriore (trembëdhjetë kolonitë e para), që ishin njerëz të gjakut të pastër anglez të ardhur nga Anglia, të cilat koloni janë pavarësuar më 1776 pas një lufte civile (që është konsideruar gjerësisht si luftë vëllavrasëse) e jo midis popujve, nga e cila në fund kanë dalë SHBA dhe dy popuj të pavarur, pavarësisht nga kontributi i Anglisë në përhapjen e gjuhës, fesë etj. Por askujt nuk i shkon ndërmend të ndërtoj aspirata hegjemoniste duke u mbështetur në historinë e largët. Madje as rusët nuk kanë përmendur ndonjëherë "të drejtat historike" mbi Ukrainën, megjithëse shteti i fuqishëm rus është krijuar në territore rreth Dnjeprit dhe territoreve përreth qysh në shekullin e IX dhe ka qenë i njohur si Rusia e Kievit ose shteti i Kievit.

Pushtimi i Kosovës, i Maqedonisë dhe i Sanxhakut gjatë luftërave ballkanike në vitet 1912/13



*Harta që tregon pushtimet e Serbisë, është botuar në librin e Alexandre Popovic , **L' Islams du sud-est European dans la periodepost –otomane**, Berlin 1986, fq.535*

Kjo është pra historia e pushtimit të Kosovës dhe e tragjedisë së shqiptarëve, të cilëve, prej atëherë, disa herë u ka kanosur zhdukja, të cilët prej Luftërave Ballkanike janë shndërruar në problem ballkanik dhe evropian, jo me fajin e tyre, por si rezultat i pushtimeve serbe dhe jo sepse shqiptarët kërkonin çlirimin por pse serbët kishin "hyrë në tokë të huaj" dhe donin ta përvetësonin[13], respektivisht, se nuk donin ta pranonin faktin se "historia ka ekzistuar edhe para krijimit të Perandorisë Serbe, dhe se trojet e Ballkanit kanë pasur zotër edhe para ar-

[13] Dimitrije Tucoviq, Nga një garnizon i kufirit. Ibid., f.192.

dhjes së serbëve" dhe se "është një popull tjetër që ka pretendime më të vjetra për këto troje."[14]

Shekulli XX ka qenë sidomos tragjik për popullsinë shqiptare të Kosovës. Kjo tragjedi ka filluar me Luftëra Ballkanike kur së pari u pushtuan këto territore nga forcat serbe ose malazeze dhe ka vazhduar deri më 1999 kur u përzunë forcat serbe dhe malazeze (forcat jugosllave) nga Kosova.

Historianë dhe dëshmitarë okularë kanë lënë dëshmi të llahtarshme për krimet që kishin bërë forcat ushtarake serbe dhe malazeze gjatë dhe pas pushtimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Luftëra Ballkanike. Mjafton të shikohen shkrimet e disa personaliteteve të shquara të kohës për të kuptuar se çfarë krimesh janë bërë ndaj shqiptarëve në atë kohë. Lav Trocki, që kishte ardhur si korrespondent për të informuar mbi luftën, në një artikull të botuar në gazetën *Kievskaya Mysl* të datës 23 dhjetor 1912 shkruante: "Tmerret filluan menjëherë pasi e kaluam kufirin e vjetër. Në orën pesë pas dite iu afruam Kumanovës. Dielli kishte perënduar dhe kishte filluar të bjerë terri. Sa më tepër që qielli bëhej më i errët, aq më të ndritshme bëheshin vetëtimat trishtuese nga flakët që ngriheshin lart. Rreth nesh gjithçka digjej. Të gjitha fshatrat shqiptare ishin në flakë, ishin të shndërruara në shtylla të zjarrit - të afërta dhe të largëta, deri në binarët e hekurudhës. Ky ishte shembulli i parë, i vërtetë dhe real i asgjësimit mizor ndërmjet njerëzve, që e pashë në këtë zonë të luftës" dhe vazhdonte "kjo pamje na ka përcjellë gjatë tërë rrugës deri në Shkup."[15] Trocki tregonte përplot raste të vrasjeve mizore të shqiptarëve, të plaçkitjeve dhe të djegieve të vendbanimeve. Trocki shkruante: "Dy ditë para ardhjes sime në Shkup, gjënë e parë të cilën banorët kishin parë në mëngjes, kur ishin çuar nga gjumi, ishte grumbulli i kufomave të shqiptarëve me kokat e

[14] Edith Durham, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Shtëpia Botuese Naum Veqilharxhi 1998, f. 333.

[15] Raportet e luftës të Lav Trockit – Luftërat Ballkanike 1912-1913, Edukata Islame, Viti XXXIV, Nr. 81/2006, f. 329. Ratni izveštaji Lava Trockog – Balkanski ratovi 1912-1913, www. ibn-sina net p. 166. The War Correspondence of Leon Trotsky: Balkan Wars 1912-1912, New York: Pathfinder, 1993.

prera, nën urën kryesore në Vardar, mu në qendër të qytetit. Disa thoshin se këto ishin kufomat e shqiptarëve lokalë, të cilët i kishin mbytur komitët, kurse të tjerët thoshin se ato kufoma i kishte prurë Vardari deri nën urë. Sidoqoftë ishte e qartë se ata njerëz, me koka të këputura, nuk ishin vrarë në luftë ..."[16] Konfirmimi i këtyre të dhënave jepet në një shkrim të Fritz Magnussen, korrespondent danez i gazetës *Riget* i cili shkruante se "Lumi (Vardari, Z.G.) më lart është i mbushur me kufoma ... madje edhe njerëzit e gjallë të plagosur, që akoma nuk kishin dhënë shpirt, ishin hedhur në lumin Vardar. Ky lumë në një distancë të qytetit gëlltit për çdo ditë nga njëzet deri në tridhjetë kufoma."[17] Trocki citon një epror serb, i cili kishte qenë i stacionuar në Ferizaj dhe deklaronte se "janë lodhur duke vrarë shqiptarë." Trocki tregonte edhe për krimet e rënda që janë bërë, përveç ndaj shqiptarëve edhe ndaj turqve dhe hebrenjve dhe shkruante se ishte penduar që kishte ardhur këtu, ku kishte parë gjëra trishtuese për të cilat nuk kishte besuar se mund të ndodhin, në këtë vend, ku për pak kishte pësuar edhe vetë, vetem pse ishte hebre.[18]

Po në atë kohë shkrimtari ebreit nga Viena Leo Freundlich kishte mbledhur dhe publikuar "Shënimet e akuzave" që është një përmbledhje me shkrime të publikuara në shtypin e kohës (gazetat) *Frankfurter Zeitung, Crusading, Daily Chronicle, Roman Massagero, Riget, Albanische Correspondenz, Deutsches Volksblatt, Daily Telegraph, Messaggero, Adeverul, Magyarorszag, Reichspost, Neue Freie Presse* dhe *Piemont*, që përmbanin të dhëna mbi mizoritë masive që kishin bërë armata serbe dhe çetnikët serbë kundër shqiptarëve për një periudhë prej më pak se gjashtë muajsh (tetor 1912- mars 1913) kur, në vend të "lirisë, vëllazërisë dhe barazisë", që kishte premtuar mbreti i Serbisë[19] "një soldateskë e egër dhe çnjerëzore kishte bërë kërdi të cilat nuk mund të përshkruhen"[20], kishte bërë ç'mos "për t'i shfarosur

[16] Ibid., f. 330; str.167.
[17] Leo Freundlich, op. cit., pp. 43-44.
[18] Raportet e luftës të Lav Trockit, op. cit., f. 335-336; str. 172.
[19] Manifesti i mbretit Petër "Për popullin serb" i 18 tetorit 1913. Leo Freundlich, op. cit., f. 38.
[20] Ibid., f. 7.

shqiptarët.” Gazeta *Daily Chronickle* e datës 12 nëntor 1912 shkruante se afër Shkupit ishin masakruar 2000 shqiptarë myslimanë dhe 5000 të tjerë jo larg Prizrenit; në Ferizaj, sipas dosjes që posedonte *Reichspos*t ishin vrarë 1200 veta, ndërsa kishin mbetur të gjallë vetëm tre shqiptarë myslimanë të moshës mbi pesëmbëdhjetë vjeçare; gazeta *Daily Telegraph* lajmëronte për 5000 shqiptarë të vrarë në rrethinën e Prishtinës. Po kjo ka ndodh në Gjilan, Gjakovë, Pejë, Preshevë, Sjenicë etj. Autori i dosjes që kishte *Reichspost* përfundonte se “Numri i shqiptarëve të vrarë në Kosovë arrin përafërsisht 25.000 veta pa kurrfarë ekzagjerimi.”[21]

Autorë të ndryshëm, në faqet e gazetave të lartpërmendura ofrojnë dëshmi të llahtarshme për krime nga më çnjerëzoret. Kështu lexuesit e kohës mund të mësonin nga deklaratat që kanë dhënë organet përgjegjëse serbe për qëllimet e luftës - se në vend të “çlirimit, lirisë, vëllazërisë dhe barazisë”, që kishin shpallur botërisht, kishin përvijuar qartë si qëllim (dëshirë) “t’i shfarosin shqiptarët” sidomos “shqiptarët myslimanë”, të cilët “duhet zhdukur dhe çrrënjosur”[22]; për vrasjet dhe masakrat më brutale duke përfshirë këtu edhe ato të “grave shtatzënë që ishin shqyer dhe bërë copa-copa në mënyrën më të tmerrshme”, fëmijët e palindur të të cilave “viheshin në bajoneta...”; për varrosjet e njerëzve për së gjalli; për hedhjen e të vrarëve nëpër bunarë (vetëm në rajonin e Shkupit ishin numëruar 38 puse të mbushura me kufoma të shqiptarëve); për vrasjen e fëmijëve me bajoneta (për të kursyer plumbat); për djegien e burrave, grave dhe të fëmijëve për së gjalli; për dhunimin e grave dhe të vajzave, herë-herë edhe para syve të prindërve dhe të burrave; për konvertimin e myslimanëve dhe të katolikëve në ortodoksë (skizmatikë); për djegien e shtëpive, fshatrave dhe vendbanimeve; për plaçkitjen e pasurisë (stolive) etj. Gazeta *Deutsches Volksblatt* e datës 14 shkurt 1913 citon një serb i cili kishte thënë: “... Shqiptarët i vramë si qentë! Kudo që i gjetëm dhe që ishte e mundur.”[23] E njëjta gazetë shkruan se “të gjitha përshkrimet dhe dëshmitë të

[21] Ibid., f. 40-52.
[22] Ibid., f. 41-42.
[23] Ibid., f. 60.

cilat kanë arritur në publik deri më tash u përgjigjen plotësisht fakteve. Nëse dikush mund të gjejë ndonjë të metë në to, kjo është bërë vetëm për shkak se nuk janë të plota (komplete).”[24]

Pushtimi i Kosovës, i Maqedonisë dhe i Sanxhakut gjatë luftërave ballkanike në vitet 1912/13

Harta, që tregon pushtimet e Serbisë, është botuar në librin e H.Xh. Uelsit, botuar në Beograd në vitin 1929, fq.668

[24] Ibid., f. 60.

Nën ndikimin e këtyre shkrimeve autori i broshurës Leo Freundlich shkruante:

"Një popull trim dhe i shquar po torturohet në kryq para syve të gjithë botës. Megjithatë, Evropa, Evropa e krishterë, Evropa e qytetëruar nuk po e nxirrte asnjë fjalë lidhur me këtë. Me dhjetëra mijëra njerëz të pambrojtur qenë prerë, gratë qenë dhunuar, pleqtë dhe fëmijët qenë ngulfatur, me qindra fshatra qenë djegur e qenë bërë rrafsh me tokë, priftërinjtë qenë prerë e masakruar. Por Evropa fle e qetë.

* * *

Serbët nuk kishin ardhur në Shqipëri si çlirues të popullit shqiptar, por si vrasës të tyre.

* * *

Një popull i pafat, me shumë telashe të imponuara, thërret për ndihmë, sepse i është ekspozuar shfarosjes totale. A do t'i dëgjojë Evropa britmat (vajin) e tij?"[25]

Kjo bëhej jo rastësisht por me qëllim të ndërrimit të strukturës kombëtare dhe fetare të popullsisë së këtyre trevave, në të cilat nuk kishte më tepër se 15% serbë dhe ortodoks dhe para se Komisioni i kufijve të caktonte kufijtë me Shqipërinë, për të cilët Konferenca e Ambasadorëve në Londër kishte sugjeruar se duhen vendosur në bazë të statistikave mbi përkatësinë kombëtare dhe fetare të popullsisë së këtyre territoreve, çka impononte qartë konkluzionin (përfundimin) se kërkesat për marrjen e këtyre territoreve nga ana e Serbisë nuk mund të mbështeteshin në "parimin kombëtar" dhe duhej ndryshuar këtë.

Dëshmi tepër të çmueshme për historinë e krimeve të Serbisë ndaj shqiptarëve ka lënë sidomos themeluesi dhe organizatori i Partisë Social Demokrate serbe dhe mendimtari i shquar marksist Dimitrije Tucoviq (1881-1914), dëshmitë tronditëse të të cilit për fatin e shqiptarëve janë të ngjashme me ato që na ka lënë Bartolome las Casas për

[25] Ibid., f. 38-40. Anglisht pp. 30-31.

fatin e indianëve të Amerikës në kohën e pushtimit spanjoll. Për këtë arsye Tucoviqi mund të konsiderohet me arsye nderi i popullit serb sikurse las Casas që është nderi dhe ndërgjegjja e vërtetë e Spanjës. Tucoviqi në plot shkrime si "Pikat strategjike në Shqipëri", "Masakrimi në Lumë", "Gjakmarrja e soldateskës", "Tërbimi malazias", "Nga një garnizon i kufirit", "Karl Pauli: tmerret e luftës", "Serbia dhe Shqipëria", "S'ka fund kurrë" etj. dënonte politikën imperialiste të Serbisë dhe sidomos krimet e mëdha që janë bërë mbi shqiptarët gjatë fushatës së pushtimit të trojeve shqiptare. Tucoviqi thekson se krimet e Luftës Ballkanike nuk janë vepër e individëve dhe e disponimit individual, por një sistem që e kanë krijuar dhe e kanë zbatuar ushtria dhe qeveria dhe ku epiqendra e çështjes "është një plan kriminal të cilin ushtria e qeveria e kanë llogaritur si nevojë të ardhshmërisë" që t'i heqin shqiptarët nga toka dhe në këtë mënyrë ta "heqin qafet armikun i cili në të ardhshmen mund të jetë i pakëndshëm." Ai theksonte se bestialiteti i serbëve "ishte forcuar me shpresat se ëndrra grykëse e borgjezisë serbe për pushtimin e gjysmës së Shqipërisë së vërtetë do të realizohej" për çka "është e nevojshme të zhduket së paku ai brez që prej Karadakut deri në Sanxhakun e Novi-Pazarit e rrethon kufirin serb dhe i cili është bërë veçanërisht masiv pas dëbimit të atij populli nga Serbia pas çlirimit të qarqeve të reja, përsëri me marrëzinë e qeverisë."[26]

Tucoviqi tregon se krimet ndaj shqiptarëve kishin filluar edhe para shpalljes së luftës, kur këta u tërhoqën me mashtrim nga zjarri artilerik. Sipas përshkrimit të një dëshmitari okular "Shrapnelat tanë (të serbëve Z. G.) bënë kërdinë më të tmerrshme në ta. Shqiptarët binin në grumbuj. Klithmat e tërbimit e të dhembjes gati barazoheshin me bubullimën e topave. Në ajër fluturonin duart, këmbët, kokat dhe copat e mishit të shqiptarëve. E kur zjarri artilerik u ndal, fushëbeteja ishte mbuluar jo me kufoma por me gjymtyrë të copëtuara që dukeshin si ndonjë masë e lyer me ngjyrë të kuqe karmini." Ai vazhdon: "Në javët e para të luftës me turqit ne nuk kishim natë, sepse lëviznim, fu-

[26] Dimitrije Tucoviq, Karl Pauli: tmerret e luftës, Ibid., f. 203-208.

shonim dhe luftonim në dritën e fshatrave shqiptare që digjeshin. Zjarret e fshatrave të djegura ishin i vetmi sinjal me të cilin kolonat e ndryshme të ushtrisë serbe lajmëronin njëra- tjetrën se deri ku kishin arritur. Kurse popullsinë shqiptare - në qoftë se nuk ishte vrarë dhe atë që kishte arritur të ikte - e shtynim para vetes dhe e detyronim, si të dëshpëruarin që shikon se si po i digjet shtëpia, që të na bënte rezistencë këmbëngulëse në Bujanovc, e pastaj që bashkë me ushtrinë turke në Kumanovë të luftonte si luan."

* * *

"Me rënien e Kumanovës ra në Shkup gjithë ai popull i kombësisë shqiptare të cilën ushtria serbe, duke depërtuar nga veriu, e shtynte para vetes dhe që aty, duke kërkuar strehë, në një pjesë të madhe e kishte gjetur – vdekjen."

* * *

"Kur pushuan operacionet e luftës, mund të dukej se do të ndalej zhdukja e popullsisë shqiptare. Ai brezi shqiptar, që e rrethonte kufirin e vjetër serb prej Mitrovicës deri në drejtim të Vranjës, tashmë ishte bërë rrafsh me tokë ..."

* * *

Mbi popullsinë shqiptare të Pejës, të Gjakovës dhe të Prizrenit fluturonte fantazma e vdekjes natën e ditën. Kush i shpëtonte i gjallë, nuk ishte i sigurt se do të gdhinte i gjallë. Sepse pikërisht natën, që është koha që është zgjedhur gjithmonë për kryerjen e krimeve më të këqija njerëzore, i mblidhnin prej shtretërve dhe hapsanave e i dërgonin në poligone të ekzekutimit. Nuk dëgjohej as pylli, e aq më pak e shtëna e pushkës, "qetësia' e "rregulli" mbretëronin gjithkund, kurse shqiptarët çdo natë zhdukeshin diku, thuajse çakejtë dhe hienat prej këtyre shkrepave i nxirrnin, i vidhnin nëpër shtëpitë e tyre dhe i çonin

e i mbytnin këta njerëz të mjerë. Paj edhe hienat do t'i mbytnin në mënyrë më njerëzore."[27]

Në dy artikuj të botuar në "Radniçke novine" më 22 tetor 1913 Tucoviqi shkruante për zhdukjen e një fshati shqiptar në Lumë ku për dy orë trupat serbe vranë 500 shqiptarë; fshat për të cilin eprorët ushtarakë serbë dinin se ishte pa fshatarë, pa burra, fshat në të cilin kanë pas mbetur vetëm gratë me fëmijë në gji, vajzat, të sëmurët e pleqtë dhe fëmijët e të gjitha moshave e, përkundër kësaj, kishin urdhëruar "ta djegin fshatin dhe gjithçka që gjejnë në të ta vënë nën thikë." Dhe kjo ishte bërë me gjithë lutjet e grave të cilat i ngritnin fëmijët përpjetë. "Të shtënat i rrëzonin gratë që i mbanin foshnjat në gjinj; skaj nënave të vdekura qanin fëmijët e tyre të vegjël që rastësisht kishin shpëtuar nga plumbat; trupat e malësoreve të bukura, belholla si bredhat, përdridheshin si krimbat në fushë; gratë lindnin nga frika. Për dy orë u vranë 500 shpirtra."[28]

Tucoviqi ka shkruar: "Ne (Serbia Z. G.) bëmë tentativë vrasjeje me paramendim mbi një komb të tërë" dhe se këto krime "do të mbahen në mend brez pas brezi, sikurse mbahen në mend Nata e Bartolomesë, Mbrëmja e Sicilisë, Kishinjeva dhe si do të mbahen në mend Demir-hisari e Doksati."[29]

Sikurse Tucoviqi edhe Kosta Novakoviq (1886-1938), që ishte punëtor politik dhe publicist, redaktor në "Radniçke novine" dhe "Glas slobode" ka qenë dëshmitar i asaj çka ka ndodhur gjatë Luftërave Ballkanike në krahinat e banuara me shqiptarë. Novakoviqi, edhe vetë oficer serb, haptazi demaskonte gjenocidin dhe barbarizmat mbi shqiptarët, për çka fajësonte drejtpërdrejt Komandën Supreme të ushtrisë serbe. Novakoviqi tregonte se "oficerëve u është dhënë urdhëresa që të nënshkruhen, me të cilën ata qortohen për shpirtmadhësi (mëshirë) dhe me të cilën urdhërohen të veprojnë pa shpirt dhe me brutalitet

[27] Dimitrije Tucoviq, Gjakmarrja e soldateskës, 22 tetor (4 nëntor) 1913, Ibid., f.156-160.
[28] Dimitrije Tucoviq, Masakrimi në Lumë; Gjakmarrja e soldateskës, Ibid., f. 154-155; 156-160.
[29] Dimitrije Tucoviq, S'ka fund kurrë …, 17 (30) mars 1914, Ibid., f. 345-347; Gjakmarrja e soldateskës, 22 tetor (4 nëntor) 1913, Ibid., f. 160.

ndaj popullsisë."[30] Atyre u urdhërohej "që të kujdesen rigorozisht për atë që edhe pakënaqësia më e vogël të shtypet (mbytet në gjak); që të mos kursehet askush në raste të rezistencës ndaj autoriteteve serbe; dhe të digjet fshati në të cilin ndihet krisma e pushkës."[31] Novakoviqi zbulonte se politika zyrtare serbe ndaj shqiptarëve mbështetej kryekëput në dhunë të pakufizuar. Sipas dëshmisë së tij "për administrimin në Shqipëri komandat ushtarake konsideronin si send të parë dhe më të nevojshëm trekëmbëshin për varje dhe frikësimin me vdekje. Eprorët ushtarakë nuk janë përpjekur të shpikin (të sajojnë) ndonjë metodë tjetër për zgjidhjen e çështjes kur ka ekzistuar një: të vrasin. Për vrasje s'është përgjigjur askush, "ngase është luftë". Nëse dikush "ka gabuar, vrite, që të mos gabojë më, që të përmirësohet – jo ai, por të tjerët. Le të mbretërojë frika, le të dridhet gjithçka para tyre. Ky ka qenë parimi kryesor i shumicës së komandave të vendeve dhe të garnizoneve."[32]

Miss Edith Durham ka qenë, pa dyshim, një ndër njohësit më të mirë të jashtëm të jetës, të zakoneve dhe të historisë së re të shqiptarëve. Miss Durham ka qëndruar një kohë të gjatë në viset shqiptare, në kohën e ngjarjeve të mëdha (Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore) çka i ka bërë të mundshme të njihet për së afërmi me jetën, ngjarjet, zakonet etj. të shqiptarëve dhe të lërë shumë dëshmi që i përshkon një sinqeritet dhe humanizëm i pashoq. Miss Durham kishte kaluar mjaftë kohë edhe midis malazezve dhe serbëve e kishte njohur edhe popujt e tjerë të Ballkanit jugperëndimor çka i ka mundësuar të lërë shënime të besueshme për popullsinë, historinë, religjionin, marrëdhëniet, zakonet, aspiratat etj. të popujve të kësaj hapësire. Miss Durham, afërsisht për një çerek shekulli, kishte shkruar gjashtë libra: *Përmes viseve serbe* (1904), *Brenga e Ballkanit* (1905), *Shqipëria e epërme* (1909), *Lufta për Shkodrën* (1912), *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike* (1920), dhe *Prejardhja e disa fiseve, dhe disa kanune e zakone të Ballkanit* (1928) që përbëjnë një thesar të paçmueshëm.

[30] Srbija i Albanci, Knjiga prva, Ljubljana, 1989, str.142.
[31] Ibid., str. 142.
[32] Ibid., str. 143.

Zonja Durham është pa dyshim nderi dhe ndërgjegjja e Anglisë sikurse spanjolli las Casas që ishte nderi dhe ndërgjegjja e Spanjës dhe serbi Dimitrije Tucoviq që ishte nderi dhe ndërgjegjja e popullit serb. E ardhur dhe duke jetuar në fillim në Mal të Zi në mes të malazezve e më pastaj edhe serbëve ishte bërë mike e tyre dhe ishte laureuar me dekoratën më të lartë në Mal të Zi dhe dekoratën Shën Sava të Serbisë.

Megjithëkëtë Miss Durham kishte denoncuar krimet e mëdha që kishin bërë mbi shqiptarët këta dy popuj. Në lidhje me masakrën e Lumës Miss Durham shkruan: "Nga fisi i Lumës shpëtuan shumë pak veta. Qëllimi i hapur i serbëve dhe i malazezve ishte shfarosja e krejt racës shqiptare."[33] Ajo tregon edhe për shumë raste të krimeve të rënda dhe citon shumë persona autoritativë që haptazi manifestonin qëllimin për të bërë gjenocid mbi shqiptarët. Kështu asaj Princi Danilo i kishte deklaruar: "Ne jemi betuar t'i shfarosim ata!" (Shqiptarët Z.G.)"[34] kurse sekretari i prefektit të qytetit të posaaneksuar të Bijelopoljës Janko Vukotiq i kishte treguar "se e vetmja betejë e ashpër, kishte qenë për marrjen e Bijelopoljës. Pas kësaj, fuqia e shqiptarëve u thye. Ne vramë një shumicë të madhe, ata nuk mundën të iknin." Ai nuk e fshehu shpresën e Malit të Zi që të hiqte qafe të gjithë myslimanët dhe të ripopullonte vendin. Mizoria e tij ishte e neveritshme. "Për shembull – tha ai – ne vramë të gjithë burrat e fisit të Rugovës. Ne i mposhtëm ata dhe pastaj çdonjërin e vramë me shpatë. Ju siguroj se nuk mbeti asnjë i gjallë."[35] Ajo po kështu citon Petar Plamenacin i cili i kishte thënë duke u zgërdhirë: "Sa më shumë të vdesin nga uria, aq më mirë për ne!"[36]

Durham tregonte se malazeztë kishin filluar me zbatimin e politikës së shfarosjes menjëherë pasi kishin marrë Gucinë dhe Gjakovën. Ata po bënin shumë ekzekutime në Guci. "Myslimanëve u kërkohej të zgjedhin ose pagëzimin ose vdekjen, dhe një numër i madh burrash

[33] Edith Durham, op. cit., f. 273.
[34] Ibid., f. 278.
[35] Ibid., f. 278.
[36] Ibid., f. 310.

vdiqën në tortura. Gratë i quan në kishë, "si delet" dhe i pagëzuan. Ato që kundërshtonin i dhunonin ushtarët. Fshatrat myslimane u plaçkitën dhe u dogjën. Bora e madhe në shtigje i pengonte të iknin ata që ishin me familje. Shumë u therën.

...Nga Gjakova vinin lajme edhe më të këqija. Malazeztë po përpiqeshin t'i kthenin me forcë myslimanët dhe katolikët në fe tjetër."[37] Atëherë malazeztë kishin vrarë 500 deri në 600 veta.[38] Një burim tjetër thotë se atëherë u vranë prej 550 deri 800 veta dhe se u kryqëzuan 12 mijë pjesëtarë të fesë myslimane. Gratë, që nuk pranonin të pagëzoheshin, i dhunonin dhe i vrisnin.[39]

Miss Durham tregon për mizoritë më të tmerrshme që bënin trupat serbe. Kështu, në një rast shkruan: "Por kur u kthyen trupat në prill, ata u argëtuan duke gjakosur për vdekje disa nga viktimat e tyre pa mbrojtje. "Jo shpejt, ashtu siç therin delen, por ngadalë. Ata bënin prerje të vogla te noçkat e duarve, në bërryla dhe në qafë, që të zgjatej shumë vdekja." Disa gra, me një pantominë të gjallë dhe të tmerrshme, përshkruanin mënyrën e prerjeve dhe si serbët kërcenin përqark viktimave që vdisnin, duke imituar dridhmat e tyre të fundit."[40]

Mary Edith Durham bënte një krahasim ndërmjet masakrave turke mbi armenët, që kishin tronditur botën e krishterë dhe masakrave mbi shqiptarët, që bënin krishterët ortodoksë. Ajo shkruante: "Masakrat në Adanë dhe mjerimi që sollën ato, nuk janë asgjë para tmerreve të përgjakshme që bënë me gjakftohtësi të plotë të ashtuquajturit pasues të Krishtit. Kisha ortodokse, me pogromet kundër çifutëve në Rusi dhe të bëmat e saj në Ballkan, mban tash rekordin botëror për mizoritë fetare."[41]

---

[37] Ibid., f. 282.
[38] Ibid., f. 303.
[39] Për krimet në Plavë e Guci: Mustafa Memić, Plav i Gusinje u prošlosti, Izd. "Velko Vlahović" – "Kultura" Beograd, 1989, str. 199-213.
[40] Edith Durham, op. cit., f. 302.
[41] Edith Durham, op. cit., f. 305.

Zejnullah Gruda

On the 100th anniversary of the Balkan Wars
THE CRIMES COMMITTED AGAINST ALBANIANS DURING THE BALKAN WARS

(Summary)

The beginnings of the tragedy of Kosova – the partition of Albanian lands - the Serbian occupation of Kosova during the Balkan Wars 1912/1913

The tragedy of the Albanians of Kosova is almost 100 years old. This is the period during which Kosova was under the rule of Serbia, the kingdom of Serbs, Croats and Slovenes, the kingdom of Yugoslavia and the Socialist Federal Republic of Yugoslavia. The association of Kosova with the latter was imposed during the Balkan Wars and continued until the disintegration of Yugoslavia during the last decade of the XX century.

زين الله غرودا

بمناسبة الذكرى ١٠٠ عام لحروب البلقان

الجرائم خلال القرن ضد ألبان - الجرائم خلال حروب البلقان

(خلاصة البحث)

بدء المأساة ما يقرب من قرن من الزمن في كوسوفا – ابتلاع الأراضي الألبانية - الاحتلال الصربي في كوسوفا خلال حروب البلقان ١٩١٢/١٩١٣

مأساة الشعب الألباني في كوسوفا هي قديمة ما يقرب قرن من الزمان أو بقدر ما كان كوسوفا تحت حكم صربيا ومملكة الصرب والكروات والسلوفينيينæ مملكة يوغوسلافياæ جمهورية يوغوسلافيا الاتحادية الاشتراكيةæ فرض هذه العلاقة بين كوسوفا و الدول السلافية الجنوبية من حروب البلقان و استمرت حتى تفكك يوغوسلافيا خلال التسعينات من القرن ٢٠.

Shaqir Shala

XHAMIA E GURIT NË ROGOVË TË HASIT

Guri, njëri prej materialeve kryesore në ndërtimin e objekteve të rëndësishme, të mureve, kalave, urave, xhamive, kullave, istikameve, galerive, tuneleve, Kështjellave, Hamameve dhe shumë Objekteve të tjera në të kaluarën, që ishin objekte e ngrehina, të cilat pasqyronin madhështinë, strategjinë, mjeshtrinë, strehimin dhe ekzistencën e popullatës dhe ushtrisë për t'u mbrojtur nga fenomenet e fatkeqësitë natyrore, por edhe për t'u mbrojtur nga faktori njeri.

Guri, si material shumë i përshtatshëm për ekzistencën e njeriut në rrethana të ndryshme jetësore për t'u përballur me vështirësitë ekzistenciale; ishte m**aterial** i bollshëm, i lirë, i qëndrueshëm, rezistent dhe praktik, për t'u përdorur në ndërtimin e objekteve të ndryshme, sipas nevojës e mundësive të njerëzve. Prandaj, kësaj pasurie shumë të dobishme të natyrës për nevojat e njeriut qysh prej kohës së jetës së njeriut nëpër shpella, e deri në ditët e sotme, i është kushtuar kujdes, se si **guri** të shfrytëzohet mjeshtërisht për nevojat jetësore të tij. Kështu, edhe sot kemi o**bjekte madhështore të ndërtuara nga gurët prej të parëve tanë, duke na lënë ato si pasuri të një trashëgimie historike**.

Vendbanimi i Rogovës së Hasit është truall që ekziston që prej kohëve të moçme të iliro-dardanëve, gjë që dëshmojnë gjetjet arkeologjike në varrezat e këtij vendbanimi që janë bërë në vitin 1972, dhe gjurmëve të tjera të shumta, ku dëshmohet kultura më e hershme **e konstatuar në rajon, e ajo është neolitike e Starçevës, e konstatuar në vendbanimin e Rogovës së Hasit në lokalitetet e Kalldërmave dhe në Katunishtë.** Edhe sot **ekzistojnë vende tumulare në këto lokalitete të pahulumtuara krejtësisht.**

Në bazë të kërkimeve arkeologjike të disa tumulave më të mëdha të vendbanimit të Rogovës së Hasit me rrethinë, e që këto gjetje i janë ekspozuar pjesërisht **Muzeut Rajonal të Prizrenit,** ku ky material i vjelë në këto tumula **paraqet një tërësi të mbyllur, por prapëseprapë dëshmohet faza kalimtare prej periudhës së gurit në atë të metalit. Kjo Fazë e neolitit është në grupe kulturore sporadike, por të përkufizuara me karakteristika specifike. Kështu, përveç grupit Bubanj-Hum, është i pranishëm edhe elementi i grupit kulturor Baden-kostolian me elemente egjeane. Pra, materiali muzeal i tumulave të vendbanimit të Rogovës së Hasit, paraqet periudhën e mesme të bronzit, ose fazën B-2, apo sipas Reineckut, Fazën C.**

Vendbanimi i Rogovës së Hasit shtrihet në anën e djathtë të bregut të lumit Drini i Bardhë, në kilometrin e 20 ndërmjet qyteteve të Prizrenit dhe Gjakovës. Ky vendbanim është cilësuar gjithmonë me kushte jashtëzakonisht të volitshme për bujqësi e blegtori, dhe se vetë lumi Dri, që ishte i pasur me peshq, kanë ndikuar që këto vise të jenë të banuara prej bashkësive fisnore, duke filluar nga e kaluara e hershme e deri në ditët e sotme.

Rogova e Hasit shtrihet në rrafshin bukur të gjerë të brigjeve të lumit të Drinit të Bardhë, në anën lindore dhe rrëzës së **Kodrës së Tupecit,** në anën perëndimore. **Kodra e Tupecit** është e vetmja k**odër gurore në formë të një suke në rrafshin aluvial të Rrethinës së Rogovës.**

Kodra gurore e Tupecit, që është ngjitas me vendbanimin e Rogovës, **ka pasur rrasa guri shumë të përshtatshme për qëllime ndër-**

timore. Nga Kodra gurore e Tupecit, janë marrë sasi e madhe **gurësh e rrasash** për nevojat e banorëve të Rogovës, nga e kaluara e deri në ditët e sotme. Kështu, banorët e Rogovës, i kanë marrë r**rasat e gurit të gjata 3-4 metra dhe iu kanë vendosur si kryevarre të vdekurve në Varret e Mëdha të fshatit dhe në varret afër Xhamisë,** ku një pjesë e tyre edhe sot ekzistojnë, që mezi i kanë shpëtuar shkatërrimit të pamëshirshëm nga faktori njeri, sidomos të duarve të kolonëve serbosllavë të ardhur si kolonë në Rogovë e rrethinë, nga viti 1929 e deri në vitin 1941, me qëllim të zhdukjes së trashëgimisë kulturore e historike shqiptare, ku r**rasat e kryevarreve 3-4 metra të gjata** që u ishin vendosur të vdekurve në të kaluarën, thyhen dhe shkatërrohen, duke i shkatërruar e rrafshuar edhe varret e tyre.

Edhe shtëpitë e banorëve të Rogovës, në këtë kohë, **kanë qenë të mbuluara me rrasa guri që janë marrë nga Kodra e Tupecit,** dhe se shtëpi të tilla të mbuluara me rrasa guri kanë ekzistuar në Rogovë deri kah fundi i shekullit XIX.

Disa prej rrasave të kryevarreve sot, që i kanë shpëtuar shkatërrimit nga faktori njeri në Rogovë

I pari **personalitet historik i Rogovës së Hasit që i shfrytëzoi rrasat dhe gurët e Kodrës së Tupecit, në mënyrë utilitare dhe të planifikuar në plane programore dhe të projekteve të hartuara**

bashkëkohore në zhvillimin urbanistik të Rogoves në shekullin XVI, është HIRËSIA E TIJ HASAN PASHË JEMISHÇIU (1535?-16 tetor 1603), i lindur po në Rogovë, ku Hasani heret mbeti jetim dhe u rrit në Rogovë te farefisi si fëmijë, kurse rininë e kaloi në Prizren, si shegërt te një i pasur, ku edhe kreu mësimet e para në Mejtepin e Qytetit. Pas moshës 20-vjeçare hyn në radhët e Ushtrisë turke, ku më pas e kreu edhe Akademinë Ushtarake në Stamboll. Mandej, ka një karrierë brilante, në fillim duke u emëruar si kryekomandant i Formacioneve Elite Jeniçere të Perandorisë Osmane, e më pastaj merr titullin AGA, kurse aty kah viti 1580, e ka titullin Pasha, ndërsa në vitet 1601, 1602 e 1603, ishte në postin e lartë të SADRIAZEMIT-VEZIRIT TË MADH si KRYEMINISTËR i Perandorisë Osmane. Ishte disa vite edhe vali i Rumelisë dhe i Shirvanit. Në këtë kohë martohet edhe me motrën e Sulltan Mehmetit të Tretë në Stamboll.

Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit, mbiemrin JEMISHÇI (turq.) = PERIMTARI, e mori në Stamboll, edhe pse arriti në pozita të larta në qeverisjen e Perandorisë Osmane, kurrë nuk e harroi vendlindjen e varret e të parëve të tij në Rogovë të Hasit. Së pari, në truallin tij në vitin 1570, e ndërtoi Vikend-Kullën prej gurit që kishte edhe bunarin me ujë pijshëm brenda kullës, e cila ende i qëndron kohës dhe është në shfrytëzim familjar.

Vikend-Kulla e gurit e Hasan Pashës në Rogovë sot, e ndërtuar në vitin 1570

Kulmi i Vikend-Kullës së Hasan Pashë Jemishçiut të Rogovës së Hasit, është në formë çemeri prej gurësh dhe është e mbuluar atëherë e sot **me rrasa guri.** Kjo Vikend-Kullë i shërbente Hasan Pashë Jemishçiut, si banesë e sigurt, sa herë që vinte për të pushuar dhe për të kaluar kohën e kufizuar në mesin e bashkëvendësve, ku kontrollonte dhe udhëhiqte realizimin e projekteve kapitale në ndërtimin e **Kasabës së Rogovës,** siç quhej dikur.

Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit, i shfrytëzoi për mrekulli pasuritë natyrore të Rogovës dhe të Rrethinës, sidomos **GURËT, RRASAT E GURËVE dhe LISAT e shumtë që i kishte Rogova asokohe për ndërtimet kapitale të infrastrukturës së Qytezës së Rogovës.** Krejt gurët e rrasat e gurëve, i muarën në Kodrën e Tupecit, që ishte ngjit me Rogovën, mandej edhe në Kodrën e Gradishit, 5 km. në veriperëndim, si edhe ne Bjeshkën e Ramajës, 5 km. në jug të Rogovës.

Kështu, Hasan Pashë Jemishçiu, së pari i shtroi rrugët kryesore të Qytezës së Rogovës me **rrasa guri** në një gjatësi prej 3 km. **Rrasat e**

gurit të shtruara janë edhe sot, por të dëmtuara dhe të mbuluara me asfalt.

Hasan Pashë Jemishçiu vazhdimisht sillte donacione të bollshme për të gjitha veprimtaritë e infrastrukturës së Kasabës së Rogovës. Kështu, **në vitin 1579 e ndërtoi Urën e moçme me 13 harqe dhe të gjatë 150 metra përstrup lumit të Drinit të Bardhë, në vendin Hija e Metës në pjesën jugore të Rogovës,** ku në gërmadhat e themeleve të **kâmzave të urës së moçme, më 9 prill 2006, u gjet pllaka e meremerit e shkruar në osmanishte, në të cilën thuhet: *"I njëjti bujar Hasan Aga, i cili u bë i pranueshëm i Mbretit të Mbretërve të botës, që të bëhet ndërtimi i rrugës te vendkalimi i lumit, ku ka bërë një Urë të përforcuar me shtylla. Valihu për këtë e tha kronostikun: O Urë e çuditshme ndërtim i fortë"!(Vlera numerike e kronostikut është 987, që tregon vitin e ndërtimit të Urës sipas kalendarit hixhrijan, që i përgjigjet vitit 1579 të erës sonë).***

Gërmadhat e Kâmzave të Urës së moçme në mes të Drinit të Bardhë sot në Rogovë të Hasit

Në vitin **1580,** Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit, **e ndërtoi Xhaminë impozante dhe Mejtepin ngjitas me të, që edhe sot janë në shërbim publik.** Mbi derën e hyrjes kryesore në Xhami, ndodhet edhe sot mbishkrimi i pllakës së mermerit e shkruar në

osmanishte, që është e vendosur në mur me duart e Hirësisë së Tij Hasan Pashë Jemishçiut të Rogovës, në të cilën thuhet: **„Pasi që Hazreti Hasan Aga e ndërtoi këtë vend që i ngjan një Parajse, e ngriti këtë Objekt me nijet për Zotin (xh.sh.). Kjo botë transitore e bëri të amshueshëm. Krijuesi le t'i pranojë të gjitha veprat bamirëse, kurse i mëshirueshëm le të bëhet Muhamedi (a.s.). Valihu i shprehu kronostikun: Qabja e dytë mesxhidi al Aksa". (Vlera numerike e kronostikut është 988 sipas kalendarit hixhrijan ose viti 1580 sipas kalendarit të erës së re).**

Krejt Objekti i Xhamisë dhe i Mejtepit, **është i ndërtuar prej gurëve të zgjedhur në formë kallëpi të një dimensioni të trashësisë.** Kështu, **Minarja e Xhamisë,** prej fondamentit të themeleve e deri në maje, **me shkallët dhe sherefën e Minarës, janë ndërtuar prej pllakave të gurëve, që secila pllakë e gurit është lidhur me njëra-tjetrën me kllâmfa të hekurit të zhytura në plumb të shkrirë në gropat e hapura me dalta çeliku nëpër pllakat e gurëve.**

Pamjet e Xhamisë së Gurit, e ndërtuar në vitin 1580 nga Hasan Pashë Jemishçiu në Rogovë

Ndërsa, **pllakat e gurëve janë të kapura edhe me llaçin e gëlqeres të përzier me lesh dhije. Për këtë vendësit e quajnë edhe Xhamia e Gurit e Hasan Pashës.**

Kjo Xhami e moçme dhe madhështore e ndërtuar në fshatin Rogovë të Hasit në vitin 1580, ishte bërë halë në sy për Serbinë, prandaj në luftën e fundit, makineria policore dhe militare serbe, e minoi xhamin më 1 prill 1999, kur të gjithë banorët e Rogovës dhe rrethinës ishin përzënë me dhunë nga trojet e tyre etnike për në Shqipëri, pra Rogova atë ditë ishte plotësisht e zbrazur nga banorët e saj. Minarja, Mejtepi dhe pjesa më madhe e objektit të xhamisë, u shkatërruan plotësisht.

Pamje tmerruese të objektit të minuar të Xhamisë në Rogovë, nga ana e policisë dhe ushtrisë serbe

Edhe dyshemeja brenda objektit të xhamisë, Mejtepi dhe hajati i saj, janë të shtruara me rrasa guri, të cilat ekzistojnë edhe sot, por nga viti 1981, dyshemeja brenda Xhamisë dhe e Mejtepit, janë mbuluar me dërrasa dyshemeje, por që rrasat e gurëve nuk janë prekur fare. Edhe Hajati i Xhamisë, atëherë e sot, është i shtruar me rrasa guri. Me gurë e Rrasa guri, është i rrethuar edhe oborri dhe varret rreth xhamisë.

Pasi që lufta e fundit përfundoi, banorët e Rogovës u kthyen masivisht përsëri nëpër trojet e tyre stërgjyshore, edhe pse makineria policore e ushtarake serbe ua kishin djegur atyre shtëpitë, ku 103 familje nuk patën se ku të strehohen se ua kishin djegur banesat, kurse të tjerëve ua kishin plaçkitur e asgjësuar blegtorinë, ushqimin, veglat bujqësore, hambarët me drithë dhe çdo gjë tjetër që u shërbente banorëve për jetesë. U vranë 26 banorë të pafajshëm të Rogovës dhe 3 të tjerë mbetën të zhdukur.

Menjëherë filloi puna në rindërtimin e objekteve të djegura dhe sanimin e gjendjes shumë të rëndë të skamjes, por falë solidaritetit

mes banorëve dhe të shoqatave bamirëse ndërkombëtare, rogovasit u mëkëmbën dhe krijuan kushte e mundësi për të jetuar përsëri në këto troje.

Banorët e Rogovës, me vetëkontribut dhe me ndihmën edhe të Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës, morën iniciativën dhe përsëri e rindërtuan minaren, Mejtepin dhe Hajatin e Xhamisë së Hasan Pashë Jemishçiut të Rogovës dhe i riparuan dëmet e shkaktuara brenda objektit të xhamisë gjatë verës së viteve 2007 dhe 2008, kështu që Xhamia impozante e Hasan Pashë Jemishçiut të Rogovës, e mori përsëri pamjen qysh e kishte më parë.

Pamje e sotme e Xhamisë së rindërtuar në Rogovë të Hasit

Përveç **Urës së Moçme me 13 harqe, në gjatësi prej 150 metrash, e ndërtuar në vitin 1579 përstrup Drinit të Bardhë në Rogovë të Hasit, nga ana e Hirësisë së Hasan Pashë Jemishçiut të Rogovës, ky ndërtoi edhe dy ura të tjera prej gurit me një hark në periferi të Rogovës, të cilat ekzistojnë edhe sot dhe janë në shfrytëzim publik në qarkullimin e komunikacionit.** Që të dyja urat nuk janë hulumtuar dhe se në themelet e kâmzave të urës, me siguri ndodhen mbishkrimet e pllakave të mermerit, sikurse u gjet ajo e Urës

së moçme, më 9 prill 2006, nën gërmadhat e Urës së moçme te vendi Hija e Metës në Rogovë.

Në afërsi të xhamisë, Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës, e ndërtoi edhe **Bunarin e Xhamisë,** që edhe sot ekziston, i cili u ka shërbyer banorëve të Rogovës dhe të rrethinës, **për ujë të pijshëm dhe për nevojat e besimtarëve për abdes të faljes së namazit. Bunari në fillim e ka pasur arkën prej gurit të shpuem, por që më vonë iu ndërrua dhe iu qit arka e betonit, të cilën e ka edhe sot, por që tani është i mbushur me mbeturina dhe i papërdorshëm për ujë të pijshëm.**

Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës, aty kah viti 1577, e ndërtoi edhe Hamamin madhështor prej gurëve të latuar, i cili furnizohej me ujësjellësin me rënie të lirë, i ndërtuar enkas për të. Ky objekt madhështor sot i tëri është në gërmadha, i pahulumtuar e i mbuluar me shtresa të dheut dhe të asfaltit. Nuk dihet se si u shkatërrua dhe si u braktis ky objekt i rëndësisë së veçantë për shëndetin dhe nevojat e popullatës së Rogovës dhe të rrethinës, administratorëve, ushtarakëve, kujdestarëve të Imaretit, karvansarajeve, Mejtepit, dyqaneve dhe të nevojave të tjera publike. Sikur të hulumtohej, me siguri që në themelet e tij gjendet pllaka e mermerit, e shkruar në osmanishte, ashtu qysh u gjetën mbishkrimet tjera të objektit të Xhamisë dhe të Urës së moçme, ku do të vërtetohej saktësisht ndërtuesi dhe viti i ndërtimit të Hamamit. Edhe sot mund të shihen kanalet e ujësjellësit, ku uji ende rrjedh që disa shekuj.

Në afërsi të xhamisë ndodhet trualli i banesave për imamin dhe myezinin e xhamisë, qyshse Hasan Pashë Jemishçiu e la si Vakëf të Xhamisë atëherë e sot. Deri vonë kanë ekzistuar edhe shtëpitë-banesa të ndërtuara prej gurësh për nevojat e shërbyesve të xhamisë. Shtëpitë e vjetra me kohë janë rrënuar, e në vend të tyre janë ndërtuar të rejat, të cilat edhe sot u shërbejnë të njëjtave qëllime, ndërsa trualli dhe oborri me bunar ekzistojnë edhe sot.

Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit, përveç vakëfeve që ka lënë në Rogovë e rrethinë, sidomos të **arave, livadheve, maleve e ba-**

shtinave për nevojat e Xhamisë së Rogovës, të cilat edhe sot u shërbejnë të njëjtave qëllime, **Hasani ka lënë** v**akëfe edhe në Gjakovë dhe në Prizren. Kështu, bejtexhiu shqiptar Mehmet Tahir Efendiu nga Prizreni, në librin e tij në vargje në arabishte, me titull: "Menàkib", shkruan se *Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit e ka shpërblyer Qytetin e Prizrenit me ujësjellës, kah fundi i shekullit XVI.* Në Prizren Hasan Pashë Jemishçiu ka lënë si vakëf edhe mullinin me 2 gurë bloje, ku ujin e ka ndarë nga Lumbardhi, dhe se mulliri ka ekzistuar deri në vitin 1912, dhe për të është kujdesur një familje prizrenase me mbiemrin Koro, ku vazhdimisht ia ka sjellë hakun-ujemin e mullinit Xhamisë në Rogovë, deri në vitin 1912, kur mulliri u shkatërrua.**

Kështu veproi Hasan Pashë Jemishçiu i Rogovës së Hasit, duke na lënë një trashëgimi të madhe dhe të pasur dhe të një rëndësie historike, jo vetëm për fshatin Rogovë, por edhe më gjerë. Hasani bëri që vendlindja e tij Rogova e Hasit, për disa dekada, të jetë një qytezë me plot kuptimin e fjalës, që në fund të shekullit XVI, ta këtë kulmin e zhvillimit të vet, kurse pas ekzekutimit të Hasan Pashë Jemishçiut, nga ana e Sulltan Mehmetit të Tretë, më 16 tetor 1603 në Stamboll, Rogovës iu ndalën donacionet që i dërgonte vazhdimisht Hasani për të funksionuar infrastruktura kapitale e Qytezës së Rogovës, dhe dalëngadalë u shuan veprimtaritë zejtare, e ndalën punën Karvan Sarajet, Imareti i Xhamisë, Hamami, administrata dhe shumë shërbime publike të asaj kohe. Vetëm Xhamia dhe Mejtepi nuk e shuan veprimtarinë e vet prej se u ndërtuan e deri në ditët e sotme.

Rogovasit do ta përkujtojnë me respekt bashkëfshatarin e tyre të çmuar, i cili bëri që Rogova një fshat i vogël dhe i pazhvilluar, kah fundi i shekullit XVI, të bëhet një Kasabà e zhvilluar në mbarë rajonin.

Nuk dihet se kush mbeti nga trashëgimtarët e tij familjarë në Stamboll, vetëm se dihet që pasi Hasan Pashë Jemishçiu ekzekutohet nga i vjehrri Sulltan Mehmeti i Tretë, gruaja e Hasanit martohet me Rrustem Pashën, boshnjak.

Mbishkrimi i Urës së Moçme-1579

Mbishkrimi i Xhamisë-1580

Shaqir Shala

THE STONE MOSQUE IN ROGOVA E HASIT

(Summary)

Stones are among the most important building materials used for the construction of various buildings, walls, fortresses, bridges, mosques, trenches, tunnels, hammams as well as other objects in the past, which reflected the greatness and mastery of certain peoples to protect them from natural disasters as well as other human beings.

شاكر شالا

مسجد الحجر في روغووا حاسي

(خلاصة البحث)

خلاصة

الحجر كواحد من المواد الرئيسية في تشييد المباني الهامة والجدران والقلاع والجسور والمساجد والأبراج والخنادق وصالات العرض والحمامات وغيرها من المباني في الماضي والتي كانت تعكس عظمة والاستراتيجية والحرفية والإسكان ووجود السكان والجيش لحماية من الحوادث و الكاوارث الطبيعية و أيضا لحماية من العامل البشري.

Mr. Muhidin Ahmeti

KURBAN-BAJRAMI MË SHUMË SE NJË FESTË
- Përmbajtjet thelbësore të Kurban Bajramit -

Hyrje

All-llahu ekber, All-llahu ekber…
Lebejjkell-llahumme lebbejk…

Po të përgjigjemi o Zot, po të përgjigjemi, duke të lavdëruar dhe falënderuar në këtë ditë të madhe të Kurban-Bajramit. Po të përgjigjemi o Zot, sikurse të janë përgjigjur bijtë e Ademit, bijtë e Ibrahimit dhe ummeti i Muhammedit (s). Të përgjigjemi, të falënderojmë, të lavdërojmë dhe të lutemi ta dëgjosh thirrjen tonë.

Sot jemi në ditën e Bajramit, Kurban-Bajramit, jemi në momentet më madhështore, të cilat i përjetojnë pjesëtarët e islamit. Sot jemi në momentet e para të Bajramit, festës më të madhe të myslimanëve. Kemi ardhur sot të falim namazin e Bajramit, dhe me këtë akt të tregojmë se jemi prej atyre të cilët e kanë pranuar All-llahun për Zot, Islamin për fe, Muhammedin për Pejgamber dhe udhëheqës, Kur'anin për Libër, Qabenë për Kible, besimtarët për vëllezër dhe Bajramin si festën e tyre më të madhe.

Kjo është një ditë që na përkujton njerëz të mëdhenj dhe ngjarje të paharruara që e përcaktuan historinë e njerëzimit. Ademi, Nuhi, Ibra-

himi, Musai, Isai dhe Muhammedi (a.s.) janë figura që na përkujtojnë fatin e gjinisë njerëzore. Xhebelu-l-Rahmeh, Arefati, Mekami Ibrahim, Sinaji, Kudsi, Mekkeja dhe Medineja, Qabeja e madhërishme, janë vendet e ngjarjeve që tregojnë rrugën deri tek ekzistenca e njeriut nën udhëzimin dhe mëshirën e Zotit (xh.sh.).

Të nderuar vëllezër, na erdhi Bajrami i Kurbanit - dita e falënderimit dhe e gëzimit. Falënderimin ia kemi borxh Krijuesit, i cili na jep jetë e gjallëri dhe na jep fuqi që të jetojmë me besim e shpresë. Gëzimin e ndjejmë nën mëshirën e All-llahut që shprehet në dritën e ditës së sotme dhe në bashkimin e mendimeve tona. Të vërtetën ia kemi borxh vetes, drejtësinë ia kemi borxh të tjerëve, ndërsa paqen e bashkëjetesën ia kemi borxh xhematit tonë, popullit tonë.

Të kremtuarit e këtyre ditëve na përkujtojnë ditët e lavdishme të së kaluarës së ndritshme Islame dhe nxisin besimtarët myslimanë në angazhime më të vendosura, për detyra më të reja dhe energji më të mëdha në organizimin dhe krijimin e një ardhmërie më të mirë e më të lumtur.

Kur'ani, Haxhi dhe Kurbani janë përmbajtjet themelore të Kurban-Bajramit, të cilët paraqesin tri ideale të larta Islame. Kur'ani paraqet arsimimin dhe devotshmërinë, Haxhi solidaritetin reciprok dhe Kurbani - sakrificën për të tjerët.

Vetaktualizimi i njeriut përmes arsimimit

Gjatë historisë, profesioni më i rëndësishëm i njeriut - krijesës më të përkryer të Zotit, ka qenë arsimimi. Kjo për arsye se përparimi shoqëror, lëvizjet përpara në të gjitha rrafshët, zhvillimi ekonomik dhe kultura e popujve ka qenë e mundur të përcillen vetëm përmes arsimimit nga gjenerata në gjeneratë. Zhvillimi njerëzor dhe nxënia e diturisë, sjellja dhe zhvillimi i aftësive, janë të mundur vetëm me anë të arsimimit. Ata që janë arsimuar kanë arritur majën e piramidës sociale duke fituar statuse të reja, e bashkë me to edhe ndonjë titull. Përveç kësaj, arsimimi profesional do të përmirësojë kualitetin dhe do të sigurojë rezultate më të mira, e kjo do të ishte me rëndësi të madhe.

Për këtë arsye zhvillimi i dijes dhe i aftësive është parë si një degë e „industrisë“. Ai person që me anë të arsimimit i siguron vetes një status të caktuar, ka rastin të bëhet i barabartë me të tjerët.“

Prioritet i myslimanëve në Evropë dhe Perëndim është të themelojnë institucione të diturisë së shenjtë dhe të përkrahin studentët, kërkuesit e diturisë, të cilët kanë vendosur ta kalojnë jetën e tyre në shërbim të kësaj feje. Ne duhet ta bëjmë çdo xhami institucion të gjallë, me studentë dhe mësues duke këmbyer njohjet për fenë dhe duke u kujdesur për gjeneratën e ardhshme në Evropë dhe Perëndim.

Prandaj, porosia e parë e këtij Bajrami për të gjithë besimtarët myslimanë është të kërkuarit e diturisë dhe shfrytëzimi i mendjes dhe i trurit të tyre për të prodhuar dituri potenciale, e cila më pastaj do të ishte në gjendje të transformohej në dituri aktive dhe kreative. Feja Islame, edhe në burimet e saj fetare por edhe në traditën historike, shumë qartë e ka theksuar faktin që faktori intelektual është mbartës i afirmimit të njeriut në çdo aspekt të jetës së tij. Jo vetëm kaq, por edhe fuqia e fesë në Islam matet me arsyen. Pejgamberi ynë, Muhammedi (a.s.) thoshte:

"Feja e një njeriu është arsyeja e tij, ai që nuk ka arsye nuk ka fe."

Kur'ani dhe Muhammedi a.s. lavdërojnë çdo punë fizike e mendore që i sjell dobi individit, familjes bashkësisë, shtetit, njerëzimit. Janë disa citate të cilat e bëjnë të qartë obligimin e myslimanëve për punë fizike e mendore (për shkencë, filozofi, tregti, zanate, bujqësi etj.)

"Thuaj, o Muhammed, a mund të jenë njësoj ata që dinë me ata që nuk dinë." (Kur'ani)

"Allahun e kanë frikë nga robërit e Tij vetëm shkencëtarët." (Kur'ani)

"Shkencëtarët janë trashëgimtarët e profetëve të Zotit." (Muhammedi a.s.)

"Në ditën e gjykimit do të matet ngjyra e lapsit të dijetarit me gjakun e dëshmorit - shehidit." (Muhammedi a.s.)

Konstatimi që "*Shkenca dhe të mësuarit është farz - detyrim për të gjithë pjesëtarët e Islamit*" (Ibni Maxhe), vë në dukje vlerën e madhe

të thirrjes Islame për këtë, aktivitetin më human dhe më të rëndësishëm të të gjithë njerëzve. Kërkimi i diturisë, mësimi dhe studimi është aktiviteti më i pëlqyeshëm i cili nuk duhet të pushojë deri në fund të jetës. Thirrja për arsimimin e gruas është thirrja e parë në histori që me dituri duhet të armatoset njësoj si mashkulli dhe femra. Ky qe një hap deri te barazia e plotë midis mashkullit dhe femrës.

Lidhur me çështjen në fjalë dhe situatën që po kalojnë shqiptarët duhet vënë në dukje gjithashtu edhe rolin e intelektualëve me vullnet dhe qëllime të mira. Ata janë shpresa më e madhe e njerëzimit. Sikurse është thënë, dijetarët - intelektualët janë kripa e kësaj bote, në qoftë se prishet kripa, do të prishet bota. Ata janë zemra e kombit! Nga intelektualët kërkohet të flasin më shumë, duhet të dëgjohet zëri i tyre, mendimi dhe qëndrimi i tyre, sepse kjo është në dobi të të gjithë njerëzve. Në qoftë se ata heshtin, hesht njerëzimi ose flasin ata që nuk janë kompetentë. Shenjë e shkatërrimit të kësaj bote është kur flet injoranti ndërsa hesht i mençuri. Mendimet e intelektualit nuk duhet të jenë të programuara me interesat e individëve apo grupeve madje as me interesat personale. Ata duhet të flasin për hir të së vërtetës dhe drejtësisë, për hir të atdheut, kombit dhe ata duhet të jenë inkurajuesit dhe luftëtarë të këtyre idealeve. Kështu u shpreh Pejgamberi a.s. duke thënë që:

"Kontributi më i madh që i bëhet të vërtetës është kur njeriut të padrejtë ia thua të vërtetën në fytyrë." Po ashtu Muhammedi a.s. tha: *"Pasardhësit e mi do të përparojnë dhe me ta do të jetë ndihma e Allahut gjithnjë derisa mbartësit e pushtetit nuk u nënshtrohen (nuk dëgjojnë fjalën) bartësve të diturisë (intelektualëve)."*

Të kuptuarit drejtë të domethënies së dispozitave dhe institucioneve Islame në mënyrë të domosdoshme kërkon arsimim. A është e mundur, vallë, që një njeri i paditur të kuptojë domethënien e lartë të dispozitave Islame, me të cilat admirohen edhe shkencëtarët më të mëdhenj. Islami është fe e jetës, i cili gjithmonë zhvillohet, shkon përpara duke e ndërruar stilin dhe formën e vet. Çdo mysliman dhe myslimane në përgjithësi dhe të rinjtë e të rejat në veçanti, u duhet patjetër të pranojnë e përvetësojnë shkrim - leximin, arsimimin dhe

shkencën, si mjete të domosdoshme për afirmimin më fisnik dhe progresin jetësor në gjirin e fesë së tyre të lartë.

Haxhi - vendi i rigjetjes dhe riaktualizimit personal

Haxhi është ibadet në të cilin njeriu e njeh vendin e vet në botën universale - në Arefat, aty ku njeriu i parë e njohu vendin e vet në Tokë. Kjo është rruga e tokësore e njeriut, i cili në dëshminë personale të besimit (fesë) e gjen kuptimin universal të jetës dhe në porosinë Hyjnore të Kur'anit, e gjen shpresën në shpëtimin personal.

Prandaj, porosia e dytë e Kurban-Bajramit është Haxhi dhe ne përsëri jemi në ditët e tij. Përsëri jemi dëshmitarë të mbajtjes së manifestimit numerikisht më të madh njerëzor, që e mban mend historia. Miliona njerëz nga vendet më të ndryshme të botës, me mund e sakrifica të mëdha, u nisen në udhëtimin më të gjatë dhe më të dashur, udhëtimi i cili shpie në takim me Zotin, historinë dhe njeriun. Haxhi i këtij viti është takimi i 1433-të i myslimanëve nga gjithë bota.

Më se 14 shekuj myslimanët nga të gjitha anët e botës i përgjigjën thirrjes së Allahut dhe me nxitim nisën me mjetet më të përshtatshme drejt Qabesë, të cilët i ngjajnë rrjedhës së një deti në të cilin nga të gjitha anët derdhën lumenjtë të vegjël e të mëdhenj.

Haxhi, sikurse thamë, është manifestimi i unitetit, harmonisë dhe vëllazërisë së vërtetë Islame. Sipas dispozitave fetare, të gjithë haxhilerët gjatë kohës së bërjes së haxhit kanë të njëjtën uniformë (ihramin) dhe që të gjithë pavarësisht nga profesioni, pozita e klasa, kanë të drejta të barabarta për të hyrë në faltoren e Zotit në Qabe. Titujt e nderit dhe të famës së kësaj bote aty nuk merren parasysh, jo më t'u jepet prioritet, para dyerve të mëshirës se Zotit të gjithë janë të barabartë. Aty në mënyrë të veçantë manifestohen fjalët kur'anore: *"Besimtarët janë vëllezër*". Ndoshta vetëm në këtë vend dhe vetëm në këtë rast mund të shohim si ofiqarët e lartë myslimanë të vendeve të ndryshme futen në bashkësi me të tjerët. Këtu na jepet shembulli më i mirë se si njerëz me ngjyrë, gjak dhe gjuhë të ndryshme mund të jenë vëllezër kur në mjedisin e tyre i japin pak më shumë vend njerëzisë dhe të me-

nduarit. Këtu mund të shihet mirë se si myslimanët gjermanë, amerikanë, rusë, kinezë, japonezë, turq, boshnjakë, shqiptarë etj., në mënyrë vëllazërore i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit dhe me lot në sy përqafohen. Ata bëjnë kështu sepse gjenden në vendin ku egoizmi dhe interesat materiale të kësaj bote nuk kanë ndikim, ku flet ndërgjegjja e pastër, zemra e pastër dhe morali i pastër, ku vëllazëria dhe paqja nuk lidhen me fjalë dhe kushte, por me ndjenjën e sinqertë të zemrës së kalitur me shkencën e pastër Islame.

Këtu njeriu ka rastin më të mirë që të njihet me popujt tjerë dhe me kushtet e tyre, ndërsa nëpërmjet njohjeve të tilla reciproke duhet të vijë deri te solidariteti i ndërsjellë, për të cilin populli gjithmonë ka nevojë të domosdoshme. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

"O njerëz. Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë të ndarë në popuj e fise që të njiheni mes vete. Më i miri tek Allahu është ai i cili bën vepra të mira."
(Huxhurat, 13)

Fjalimi i fundit i Muhammedit (a.s.) në Haxhin lamtumirës është një mesazh i mirë edhe për popullin shqiptar dhe për gjendjen nëpër të cilin ai po kalon.

Duke festuar Bajramin ne i konfirmojmë dhe i përtërimë këto porosi dhe qëllime të larta, duke sakrifikuar çdo gjë, për të mirën, paqen, harmoninë dhe mirëqenien ndërnjerëzore. Meqë flasim si myslimanë atëherë duhet të nisemi nga vetja, duhet të dimë cilat janë themelet paqes sonë, si e përjetojmë atë dhe si arrijmë deri te përbërja shpirtërore e paqes në vete. Përndryshe, paqe të vërtetë nuk do të ketë përderisa paqja nuk ngadhënjen qenien njerëzore, përderisa nuk bëhet dimensioni shpirtëror i njeriut. E kjo do të arrihet kur të jetojmë plotësisht sipas dispozitave të Zotit (xh.sh.). Nëse nuk e përfillim fjalën e Zotit (xh.sh.), nëse krahas ligjeve njerëzore nuk përfillim edhe ligjet hyjnore dhe normat e përcaktuara në to, do të jemi të detyruar t'i përjetojmë sanksionet e ligjit natyror si ndëshkim dhe goditje paralajmëruese për moszbatimin e ligjit të parë. Këtë e shpjegon qartë Muhammedi a.s. duke thënë: *"Pesë për pesë. Kur një popull nuk e kryen obligimin ndaj Zotit, Ai do t'iu dërgojë armikun për sundimtar. Në*

qoftë se gjykojnë ndryshe nga ajo që ka urdhëruar Zoti, do t'iu shfaqet varfëria. Kur të përhapet në popull imoraliteti e prostitucioni, pritni shtimin e sëmundjeve e të vdekjeve. Nëse heqin në peshë (mashtrojnë në peshë), nuk do të ketë bereqet në të mbjella dhe do të jetë vit i lig. Dhe kur të pengojnë dhënien e zeqatit, do t'i zënë thatësia."

Çështja e paqes dhe e pajtimit të njerëzve është çështje e shpirtit njerëzor. Paqja e vërtetë ekziston në shpirtrat e njerëzve o nuk ekziston fare. Marrëdhëniet reciproke mes njerëzve janë pasqyrë dhe reflektim i cilësive shpirtërore e morale. Ajo që zihet dhe vlon në shpirtin e njeriut patjetër do të shfaqet në veprat dhe raportet ndërnjerëzore. Atje ku ka paqe në shpirt atje është e vendosur, ndërsa atje ku nuk ka paqe në shpirt atje duhet mbrojtur. Nuk duhet filozofi e madhe për të treguar sa e keqe është një luftë. Vetëm një përfytyrim i një lufte të mundshme është i mjaftueshëm për ata që kanë mend të kuptojnë sa fisnik është ai zë i cili ngrihet në mbrojtje të paqes dhe marrëdhënieve të mira ndërmjet popujve, feve dhe racave të ndryshme.

Antagonizmat që lindin mes besimtarëve të feve të ndryshme tregojnë për mosnjohjen e fesë. Ata të cilët kanë raporte të tilla antagoniste, nuk e kanë kuptuar esencën e fesë, shpalljen e urdhëresave e porosive dhe ligjeve të Zotit, të cilat kanë zbritur sipas etapave në pajtim me zhvillimin shpirtëror e intelektual te njerëzit.

Edhe e ardhmja e shqiptarëve, kudo që janë dhe çfarëdo besimi i takojnë, do të jetë e lumtur, në qoftë se pjesëtarët e fesë Islame, Katolike e Ortodokse do të përqafojnë e të përvetësojnë secili fenë e vet me dije e vepër dhe të respektojnë fenë e tjetrit me sjellje të mirë. Si vëllezër nga gjuha, por edhe si besimtarë myslimanë e të krishterë duhet ta kuptojmë njëherë e përgjithmonë se realiteti dhe fati jo vetëm i yni, por i gjithë botës, që nga fillimi e deri në mbarim të saj është larmi besimesh dhe diversitet kulturash. Ky është vullneti i Zotit dhe cili mysliman apo i krishterë do ta merrte guximin të ngrihej kundër vullnetit të Zotit. Njeriu është vepër madhore e Zotit, shkatërrim për atë që cenon nderin dhe dinjitetin e veprës së Tij. Shqiptarët nuk do të kenë përçarje fetare përderisa të besojnë se fetë te shqiptarët janë pasuri e jo fatkeqësi, dhe se Zoti i vetëm është për të gjithë i njëjtë.

Ardhmëria, jo vetëm e shqiptarëve, por e gjithë njerëzimit është në maksimën: "*Beso Zotin dhe bën vepra të mira*".

Besimi dhe sakrifica - karakteristikë e Kurban-Bajramit

Kurbani është rruga njerëzore e afrimit të njeriut nga Krijuesi, sikurse është edhe namazi kurban i secilit njeri të devotshëm, do të thotë, çdo njeri i devotshëm dëshiron që përmes namazit t'i afrohet Zotit të tij. Sepse ai që është i afërt me Zotin, është i afërt edhe me njeriun, i cili ka nevojë për dashuri dhe ndihmë njerëzore.

Të nderuar vëllezër sot, pra, është dita e sakrificës. Ajo është karakteristikë e këtij Bajrami. Pa sakrifica nuk ka ngritje dhe progres. Ibrahimi (a.s.) ishte i gatshëm të flijojë edhe djalin e vet për hir të All-llahut (xh.sh.) sikurse për idealin më madhështor. Vetëm në emër të idealeve të larta, vetëm në emër të All-lahut, mund të bëhen sakrifica të mëdha për të mirën e të tjerëve, për të mirën e popullit, për të mirën e atdheut dhe të njerëzimit në përgjithësi.

Duke i festuar ditët e madhërishme të Bajramit, ne përkujtojmë sakrificat e mëdha që janë bërë gjatë historisë për realizimin e atyre qëllimeve e synimeve sublime të jetës njerëzore. Për parimin e bashkëjetesës, për atë që të realizohet atmosfera e lirisë dhe e dashurisë, shumë popuj të botës kanë dhënë sakrifica të mëdha. Pa sakrifica nuk mund të ketë as vepra të mëdha. Njerëzit do të bëhen të shquar dhe të pavdekshëm vetëm nëse janë të gatshëm të sakrifikojnë, ndërsa popujt bëhen të mëdhenj dhe të fuqishëm vetëm nëse stolisen me virtyte e ndjenja sakrifikuese për të mirën e përgjithshme për të mirën e kombit, të atdheut, të njerëzimit.

Ditët e gëzuara të këtij Bajrami na përkujtojnë Ibrahimin, Ismailin a.s. dhe gatishmërinë e tyre për të sakrifikuar çdo gjë për hir të Zotit dhe veprës së mirë.

Vendosmëria e Ibrahimit që të bëje sakrificë dhe gatishmëria e Ismailit të bëhet sakrificë, ka qenë sprovë shumë e madhe dhe e paprecedent në histori. I gatshëm të flijojë djalin, lindja e të cilit ka qenë fryt i lutjes dhe i shpresës modeste në pleqëri, gëzim i pritur gjithë

jetën. Dhuratë e Zotit që duhej kthyer Zotit. Ta bësh kurban atë, mendja njerëzore do të thoshte ta presësh palmën e gjelbër që shkretëtirës së vdekur i premton shpresë në zgjatjen e jetës, ndërsa për mendjen profetike do të thotë të vërtetuarit e nënshtrueshmërisë ndaj përcaktimit të Zotit.

Kjo është ngritja e njeriut deri te dashuria më e lartë, dashuria që shkrin çdo dashuri tjetër, deri te vullneti i çeliktë, i cili eviton çdo gjë që rrezikon dorëzimin e plotë ndaj Zotit. Ai na jep çdo të mirë, e ne në shenjë mirënjohjeje falim namaz dhe presim kurban. Ai që nuk na do, do të mbetet i pa përkujtuar, ndërsa përkujtimi i ynë është Ibrahimi për brezat e ardhshëm.

Nga sa u tha më lart, mund të konkludojmë që sakrifica është ajo rruga kryesore, e cila çon te mëshira e Zotit, pse jo edhe te miqësia e Zotit, ashtu si e fitoi Ibrahimi a.s. dhe u bë Halilullah (Mik i Allahut).

Çdo mysliman e ka për detyrë të ndjekë këtë rrugë, rrugën e atyre prijësve shpirtërorë, të cilët i ndihmuan popujt e tyre sa herë që ata e sillnin vetën buzë greminës. Rrugën e profetit të Zotit Muhammedit (a.s.) i cili thoshte se drejtimi i popujve është amaneti dhe përgjegjësia më e madhe në këtë botë dhe se popujt kanë ata prijës që i meritojnë.

Trashëgimtari i parë i Muhammedit (a.s.) Ebu Bekri (r.a.) duke pasur parasysh këtë, ju drejtua populli dhe i tha: "*Më vendosët si udhëheqës tuajin, por kjo nuk do të thotë se unë jam më i miri prej jush. Në qoftë se do të punoj mirë, më ndihmoni, nëse gaboj më korrigjoni. Jini të bindur ndaj meje derisa unë i bindëm Zotit dhe Profetit të Tij. Në qoftë se unë heq dorë nga ajo bindshmëri, më braktisni edhe ju mua".*

Një halif tjetër Malik Ibn Mervan i nxitur nga halifet e mëparshëm, tha: "*Njerëzit më të mirë janë ata të cilën falin kur kanë mundësi të dënojnë, të cilët janë modestë kur janë në pozita të larta, dhe kur janë në piramidën e pushtetit sillën me drejtësinë më të madhe.“*

Duke iu afruar fundit të përkujtojmë edhe njëherë se kurbani është rruga njerëzore e afrimit të njeriut nga Krijuesi, sikurse është edhe namazi kurban i secilit njeri të devotshëm, do të thotë, çdo njeri i devotshëm dëshiron që përmes namazit t’i afrohet Zotit të tij. Sepse ai

që është i afërt me Zotin, është i afërt edhe me njeriun, i cili ka nevojë për dashuri dhe ndihmë njerëzore.

Prandaj, dëshiro për vëllanë tënd atë çfarë i dëshiron vetvetes!

Ji përkrahës i vëllait tënd, se edhe ai do të jetë përkrahës i yti!

Vepra më e dashur për Zotin, është që njeriu ta gëzojë vëllanë e vet!

Virtyti më i mirë i Bajramit është që t'i përtërish lidhjet e shkëputura më farefisin dhe miqtë, që t'i dhurosh atij që të ka hidhëruar, që t'ia falësh atij që të ka bërë padrejtësi!

Kurban-Bajrami, pra, është gëzim i individit, familjes dhe i ummetit universal të myslimanëve. Porosia themelore e Bajramit është që njeriu t'i afrohet All-llahut (xh.sh.) përmes ibadetit të kurbanit, i cili ka për qëllim ndihmën e njeriut. Do të thotë, feja (besimi) në thelb është afrim i njerëzve në dashuri dhe bamirësi. Prandaj, edhe në këtë Bajram, gjëja më e rëndësishme është që të jemi së bashku, që t'ia falim njeri-tjetrit, që t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, në mënyrë të veçantë atyre të cilët në mesin tanë janë të moshuar, të paaftë dhe të sëmurë. Le të mbretërojë midis nesh besimi dhe le të mbretërojë në të gjithë botën paqja dhe mirësia.

Kurban-Bajrami më shumë se një festë

Bajrami i Kurbanit nuk është një feste e zakonshme fetare, ai, bile nuk është as festë, ai është thjesht Bajrami i Bekuar (Mubarek). Ka mbështetje fetare, por edhe domethënie tradicionale në kulturën e të gjithë myslimanëve, pra edhe të shqiptarëve. Të theksuarit e aspekteve të tij kulturo-historike, psikologjike folklorike (popullore) i jep karakter specifik shoqëror dhe krijon një ambient dhe atmosferë të veçantë, të cilën e ndjejnë besimtarët, dhe të cilën duhet studiuar dhe hulumtuar. Përveç se Bajrami është simbol i gëzimit, ai është edhe simbol i besnikërisë praktike ndaj islamit të shprehur përmes sakrificës dhe flijimit në rrugën e Zotit, të shprehur përmes ngadhënjimit të egoizmit, fitores mbi shejtanin në rrugën e ngritjes shpirtërore drejt mëshirës së All-llahut (xh.sh.). Vetëm përmes sakrificës dhe flijimit

mund të ruajmë bërthamën fetare Kur'anore, e cila si myslimanë na përcakton dhe pozicionon në botë e edhe këtu në Evropë dhe Perëndim. Identitetin e Shqiptarit, myslimanit në Perëndim, përveç besimit në All-llahun (xh.sh.) dhe pasimit të pejgamberit Muhammedit (a.s.) e përcakton edhe ndjenja e solidaritetit me besimtarët tjerë.

„Kush nuk kujdeset (nuk tregon interes) për myulimanët, ai nuk u përket atyre“, thotë Muhammedi (a.s.) duke na i caktuar rrethet e atij solidariteti. Pozicionimi ynë i këtillë nuk mund të jetë në mënyrën e getoizimit dhe izolimit, sepse identiteti fetar i myslimanëve në botën perëndimore mbështet në vlerat universale, të cilat provohen në ekzistencën e tyre këtu, dhe tani.

Së këtejmi rrjedh rëndësia e madhe e Kurban-Bajramit, i cili është jo vetëm një obligim fetar, por shumë më tepër - një komponent thelbësor i kulturës sonë të përgjithshme dhe një tregues i fortë i identitetit tonë.

Prandaj, shqiptarët duhet të mësohen në të ardhmen të organizojnë forma të ndryshme të avancuara sikurse janë akademitë me rastin e ditëve të shënuara të Bajrameve, në këtë rast Kurban-Bajramit. Akademitë e tilla ofrojnë mundësinë e përmbajtjeve dhe formave të reja kualitative, të cilat i kontribuojnë ruajtjes së vlerave dhe porosive të vjetra dhe promovimit të vlerave të reja kulturore, shkencore, artistike-universale të Bajramit të Bekuar. Ato nuk nënkuptojnë të mësuarit e ri të islamit, veç se janë forma të reja, të modernizuara të prezantimit të tij. Ato janë dëshmi që askujt nuk mund t‘i merret identiteti i tij e që më parë të mos shkëputet nga e kaluara e tij, kultura dhe tradita e tij. E kur të ndodhë kjo, atëherë është lehtë personi i tillë të mashtrohet dhe të sundohet. Për këtë arsye janë ditët e Bajramit të bekuar, ditët e Kurbanit dhe përmbajtjet e Qendrave kulturore islame, që të përkujtojnë, paralajmërojnë dhe trimërojnë.

Në ditët e Kurban-Bajramit me kthimin e njerëzve nga xhamia në shtëpi, fillojnë menjëherë përgatitjet për therjen e Kurbanit. Pasi të mbarojnë me therjen e kurbanit, mishi i tij ndahet në tre pjesë të barabarta. Një pjesë u jepet të varfërve, pjesa tjetër u jepet fqinjëve, farefisit dhe miqve, ndërsa një pjesë i mbetet kryefamiljarit dhe anëtarëve

të tij. Fëmijët shpërndajnë mishin e kurbanit me qëllim që të gjithë ata të cilëve u ndahet kurbani të kenë mundësi me kohë të përgatisin sillën e Bajramit. Të vizituarit e farefisit gjatë kohës së Bajramit ka një qëllim dhe domethënie unike. Besimtarët gjatë kohës së Bajramit janë të lumtur dhe të gëzuar, e gëzimin gjithmonë është më mirë ta ndash me të afërmit. Përveç kësaj, Bajramet janë koha ideale që disa mospajtime që ekzistojnë përbrenda familjes të zbuten, e ata, të cilët eventualisht janë të hidhëruar me njëri-tjetrin, të pajtohen. E gjithë kjo është e rrënjosur thellë në fenë tonë - dini Islamin, i cili kërkon nga besimtarët që të jetojnë në harmoni, në mirëkuptim dhe dashuri vëllazërore. Më në fund ditët e Bajramit janë ditë gëzimi, hareje dhe lumturie. Fytyrat e besimtarëve shkëlqejnë nga gëzimi, kënaqësia dhe lumturia në ditë e Bajramit. Pejgamberi (s) gjatë Bajramit lejonte disa forma të argëtimit dhe dëfrimit me këngë dhe lojëra të ndryshme, të cilat ishin në pajtueshmëri me dispozita dhe parimet e sheriatit islam.

Ditët e bajramit janë ditë të këndimit të tekbirëve me të cilët e falënderojmë All-llahun (xh.sh.) për begatitë që na ka dhuruar dhe na i ofron vazhdimisht gjatë jetës sonë të kësaj bote. Të gjitha traditat e shqiptarëve myslimanë që kanë të bëjnë me Bajramin, janë thellë të rrënjosura në traditën islame dhe sunnetin e Pejgamberit të nderuar (a.s.). Bajramet, edhe pse janë festa fetare islame, ato tashmë janë shndërruar në festa gjithëpopullore, të cilat kanë marrë edhe epitetin e festave kombëtare, shqiptare.

Në vend të përmbylljes

Duke e përfunduar këtë shkrim, iu dëshiroj nga zemra të gjithë myslimanëve dhe myslimaneve, gra e burra, atyre të cilët sot bëjnë tavaf rreth Qabesë dhe atyre të cilët janë në shtëpi rreth kurbanëve, e gëzofshi Bajramin, duke iu lutur All-llahut të dashur për shëndetin e tyre dhe suksese në jetë dhe punë. Në mënyrë të veçantë ua uroj Bajramin të përndjekurve, të persekutuarve, të sëmurëve dhe të paaftëve duke iu lutur Krijuesit të Lartësuar që t'iu vijë në ndihmë!

Me dëshira të veçanta Bajramin ua uroj edhe vëllezërve tanë shqiptarë, kudo që janë në Diasporë dhe të gjithë myslimanëve në botë:

E gëzofshi Bajramin e bekuar!

Literatura:

1. Ibrahim Hoxhiq, “Mbi të kuptuarit intelektual dhe primitiv të fesë”, Sarajevë, 1971).
2. Mr. Muhidin Ahmeti, Përmbledhje ligjëratash fetare, Shkodër, 1996.
3. Bilal Hasanoviq,“Izbor hutbi i vazova”, Sarajevë, 1990.
4. www.znaci.com _ Sarajevë-BiH _ 2001_2007 .
5. www.brodarevo.net/
6. N. Mual’lim, 2/ 2000)
7. www.scribd.com
8. www.muslime-in-niederkassel.de/
9. www.igmg.de/

Mr. Muhidin Ahmeti

EID AL ADHA – MORE THAN A FEAST

(Summary)

Introduction

All-llahu ekber, All-llahu ekber…

Lebejjkell-llahumme lebbejk…

We respond to you o God, we respond to you, by praising you and by thanking you on this great day of Eid al Adha. We respond to you as did the sons of Adam, the sons of Abraham and the ummah of Muhammad. We respond to you, we thank you, we praise you and we beg you to listen to our prayers.

محي الدين أحمدي

عيد الأضحى أكثر من عيد

المحتويات الأساسية لعيد الأضحى –

(خلاصة البحث)

مقدمة

الله أكبر, الله أكبر

لبيك أللهم لبيك

لبيك أللهم لبيك نحمدكæ نشكرك لهذا اليوم العظيم عيد الأضحى لبيك أللهم كما فعلوا Ã بناءÂïãæ أبناء إبراهيم وأمة النبي محمد صلى الله عليهæ سلمæ نلبيكæ نحمدكæ نشكركæ ندوعو لسماع دعوتنا.

Hajrullah Hoxha

NDËRROI JETË
MULLA AHMET ef. BERISHA 1938-2012

Më 25 tetor 2012, në ditën e bekuar të Arafatit dhe natën e madhe të Kurban-Bajramit, në moshën 74 vjeçare ndërroi jetë në Fushë-Kosovë mulla Ahmet ef. Berisha, njëri nga imamët, ligjëruesit dhe pedagogët e dalluar në Kosovë.

Mulla Ahmeti u lind më 1 maj 1938, në fshatin Majac të Llapit, në një familje të njohur fetare, nga babai H.Shaqir Lushi dhe nëna Zahidja, bijë e një familjes të njohur nga Sharbani. Shkollën fillore katërvjeçare e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin e ulët në fshatin Lupç, gjegjësisht në Besi. Njohuritë fillestare të fesë dhe leximin e Kur'anit i mësoi nga hoxha i devotshëm dhe aktiv rahmetli mulla Bahtir Majaci, i cili ua mësoi leximin e Kur'anit shumë djemve dhe vajza

MULLA AHMET ef. BERISHA
1938-2012

edhe atëherë kur mësimi i fesë ishte i ndaluar me ligj përveç në medrese.

Në vitin shkollor 1955-56 M. Ahmeti u regjistrua në medresenë "Alau-

din" në Prishtinë, por në fillim të vitit të katërt, ai u detyrua të shkojë në kryerjen e shërbimit ushtarak. Pasi u kthye nga ushtria, atë vit e vazhdoi dhe në vitin 1961, u regjistrua në medresenë e "Gazihusrevbegut" në Sarajevë dhe diplomoi në vitin 1965. Gjatë viteve të shkollimit në medrese të Prishtinës dhe Sarajevës, ka shërbyer si imam i Ramazanit në fshatin Sharban, Shkoreshnik të Podrimes, Drenas (ish-Gllogfc) të Drenicës, Majac, në Duvno të Bosnjës dhe në xhami të Zagrebit.

Pas diplomimit të tij në Sarajevë, ai u punësua imam në Zenicë, ku shërbeu një vit. Duke dëshiruar për t'u aftësuar edhe më tepër në pikëpamje profesionale, mulla Ahmeti në vitin 1966/67 u regjistrua në Universitetin e Az-herit në Kajro të Egjiptit. Pas kthimit të tij nga Egjipti, përkohësisht ka qenë imam në Zagreb, ndërsa në vitin 1973 Kryesia e Bashkësisë Islame në Prishtinë, e emëroi për imam në Deçan, detyrë të cilën e kreu deri në vitin 1986. Nga viti 1978-86 gjithashtu ai e kreu edhe detyrën e referentit fetar-arsimor pranë Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë. Gjatë kësaj periudhe mulla Ahmeti me familjen e tij banoi në Deçan. Pas lëshimit të Deçanit ai u vendos në një shtëpi, të cilën e kishte blerë prej një boshnjaku në Fushë-Kosovë, por të nesërmen milicia serbe ia kishte qitur familjen me dhunë në rrugë, në bazë të ligjit (platformës) mbi ndalimin e blerjes së pronave serbe. Pasi që në këtë rast ishte në pyetje prona e boshnjakut e jo e serbit, ai u ankua në komunë dhe në gjykatë, por kot, përgjigjja verbale ishte negative për shkak të kundërshtimit të fqinjëve serbë. Përveç kësaj komuna i kishte vendosur në shtëpi të tij dy familje të pastrehë serbe për të banuar. Më këtë rast, atij nuk i mbeti tjetër veç se të kthehet në Majac për të banuar pa kushte themelore për një jetë normale. Andaj, vetëm pas përfundimit të luftës, atij iu bë e mundshme për t'u vendosur në shtëpinë e tij të blerë para afër 15 vjetësh në Fushë-Kosovë.

Në vitin 1987 Ahmet ef. u emërua edukator në medresenë Alaudin në Prishtinë, detyrë të cilën e kreu deri në vitin 2003, kur edhe u pensionua. Në atë kohë ai ka qenë i zgjedhur anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Ylemave për një mandat katërvjeçar dhe njëkohësisht kryetar i saj një mandat njëvjeçar. Pas viteve të 90-ta ai është zgjedhur anëtar i kuvendit të Bashkësisë Islame dhe kryesisë së saj një mandate katërvjeçar. Gjatë periudhës sa ishte edukator në medrese, mulla Ahmeti e kreu edhe detyrën e imamit së pari në xhaminë e Gllogocit të Lipjanit, pastaj në xhaminë e Magurës dhe më në fund në xhaminë e Barilevës deri në pension.

Si në mbledhjet e organeve të Bashkësisë Islame, ashtu në ato të Shoqatës së Ylemave, për shkak të guximit dhe qëndrimit të tij aktiv, mulla Ahmeti gjatë diskutimit të tij, shpeshherë bënte vërejtje dhe kritika në adresë të udhëheqësisë së tyre. Do të thotë se ai ishte më i zëshmi dhe kritiku nga të gjithë ne të cilët në atë kohë ishim të pakënaqur me punën e udhëheqësve të institucioneve të përmendura sepse ishim të bindur se nuk janë duke i shfrytëzuar as ato të drejta fetare që u janë të garantuara me ligj, për shkak të lojalitetit të tepërt të tyre ndaj organeve të shtetit.

Në një mbledhje të Kuvendit të Bashkësisë Islame për RSS, të mbajtur në Novi Pazar në vitin 1984, ku merrnin pjesë edhe Reisul-ulemaja me bashkëpunëtorët e tij, kryetari i komisionit për marrëdhënie me bashkësitë fetare i Kuvendit të Serbisë, dhe disa personalitete tjera mulla Ahmeti e bëri një diskutim sa objektiv aq të ashpër. Me atë rast ai kërkoi me çdo kusht ndryshimin e nenit 28-të të Kushtetutës së Bashkësisë Islame të RSFJ, në bazë të cilit i ndalohej zgjedhja për delegat dhe kandidimi në organet e Bashkësisë Islame të gjithë nëpunësve administrativë-financiarë të këshillave të Bashkësisë Islame dhe personelit arsimo-edukativ të medresesë. Propozimin e tij ai e argumentoi duke thënë se vetë përbërja e anëtarëve të këtij kuvendi, dëshmon qartë se ky nen është diskriminues i kuadrit të shkolluar të ri dhe të aftë, shumica e të cilëve punon në administratë a në arsim dhe stimulues i kuadrit me pak të shkolluar dhe atij të moshuar. Ai pastaj mori si shembull disa prej tyre me emër dhe mbiemër duke thënë se të tillë nuk kanë aftësi më të kontribuojnë as për shtëpi të vet. Në vazhdim ai e kundërshtoi edhe kandidaturën e H. Jetish Bajramit për kryetar të Kryesisë së Bashkësisë Islame në Prishtinë, duke thënë se ka njerëz me të shkolluar e më aktiv se H. Jetishi dhe se ai është kopje e H. Ismajl Hakisë, i cili për njëzet vjet sa ishte kryetar i Bashkësisë Islame shumë pak ka kontribuar në zhvillimin dhe përparimin e saj.

Një grup i anëtarëve të Shoqatës së Ylemave në Prishtinë, nën udhëheqjen e kryetarit të saj H. Hamdi Jusufspahiqi në vitin 1986, duke udhëtuar në një ekskursion me autobus në drejtimin të Sarajevës, u ndal për të pushuar në Titovo Uuzhicë. Duke vizituar muzeun e njohur të Sirogojnës dhe një kishë të vjetër papritmas na ra në sy një parullë e shkruar në një pllakë guri në mur më këtë domethënie: “Të gjithë popujt sllavë bashkohuni në luftën kundër shqiptarëve”! Një thirrje me përmbajtje të tillë në një vend publik, jo vetëm që na befasoi por edhe na trishtoi pa masë, ngase në Kosovë ende

vazhdonte diferencimi dhe dënimet për demonstratën e vitit 1981. Askush prej nesh nuk reagoi përveç M. Ahmet Berishës, i cili iu drejtuar nikoqirit-kryetarit të Shoqatës së klerikëve të kishës ortodokse serbe, me këto fjalë: "Çka është kjo parullë armiqësore kundër popullit shqiptar?! Ai u përgjigj: "Ajo është shkruar shumë moti". Atëherë Berisha i tha: "Edhe nëse është shkruar moti, ju është dashur atë ta hidhni në mbeturina".

Pas viteve të nëntëdhjeta M. Ahmeti ishte aktivizuar në organizimin e tubimeve të ndryshme politike dhe kishte marrë pjesë në aksionin për pajtimin e gjaqeve. Me rastin e lirimit të Adem Demaçit nga burgu ai ishte anëtar i këshillit organizativ për pritjen e tij në fshatin Lupç. Në këtë tubim madhështor ku kishin ardhur njerëzit nga të gjitha trojet shqiptare Demaçi nuk kishte mundur të merrte pjesë. Nga ana tjetër milicia serbe i kishte rrethuar me autoblinda dhe cisterna me ujë duke iu dhënë afat ultimatum 15 minuta për t'u shpërndarë. Me atë rast i vetmi M.Ahmeti kishte pasur guximin të dalë para milicisë dhe të flasë me shefin e tyre. Kur e kupton ky i fundit se me profesion ai është hoxhë, kishte kërkuar që ta përdorte autoritetin e tij për të shpërndarë masën sa më parë, në të kundërtën do t'i përdornin të gjitha mjetet që i kanë në dispozicion për shpërndarjen e saj me dhunë. Duke kuptuar se situata ishte shumë e rrezikshme që mund të përfundonte me pasoja të rënda, e kishte marrë mikrofonin dhe i ishte drejtuar masës: "Vëllezër të nderuar! Të gjithë e dimë se jemi tubuar në këtë vend për ta pritur një njëri të madh z.Adem Demaçin. Edhe pse ai deri më tani nuk u paraqit në mesin tonë, qëllimi i ynë u plotësua. Andaj, ju lutemi të gjithëve që të shpërndaheni në mënyrë të qetë". Me këtë apel të tij të urtë masa e tubuar ishte pajtuar dhe ishte shpërndarë pa ndonjë problem.

Pas rënies në gjurmë nga ana e shërbimit sekret jugosllav të grupeve që ushtroheshin në Shqipëri me Adem Jasharin dhe Zahir Pajazitin pas kthimit në Kosovë, katër djem të rinj nga Llapi me në krye Murat Ajetin, mik shtëpie i M. Ahmetit, për t'i shpëtuar arrestimit, kishin vendosur për të dalë në Shqipëri. Duke mos marrë parasysh fare se çka mund të ndodhte nëse kapen nga milicia, këtë punë të rrezikshme e kishte marrë mbi vete M. Ahmet Berisha dhe një aktivist tjetër, me kerre të veta. Personat në fjalë kishin hipur në kerre të tyre të armatosur ngase kishin vendosur që kurrsesi të mos dorëzoheshin të gjallë në duar të milicisë serbe. Duke udhëtuar për në Gjakovë, në Volljakë afër urës i ndalin milicia, ia kontrollon dokumentet e udhëtimit dhe e pyesin se ku punon? Pasi që u ishte përgjigjur se me profe-

sion është hoxhë dhe dokumentet i kishte pasur në rregull, nuk tentojnë farë për t'i kontrolluar të tjerët duke menduar se janë bashkudhëtarë të thjeshtë, andaj i lejojnë për ta vazhduar rrugën. Kur kishte arritur në fshatin Babaj Bokës, afër kufirit më Shqipërinë, M.Ahmeti, i kishte dorëzuar te një haxhi i njohur, i cili i kishte qitur ilegalisht në Shqipëri.

M.Ahmet Berisha ishte treguar trim i patrembur edhe me rastin e varrimit të veprimtarit të shquar të çështjes shqiptare z. Ahmet Haxhisë, në Lupç. Në këtë varrim madhështor, ku merrnin pjesë njerëz nga mbarë Kosova e më gjerë, përmes mikrofonit e kishte mbajtur një fjalim të rastit duke marrë për moto kaptinën kur'anore "El-Kafirun". Nga përmbajtja e saj nënkuptohet se Muhamedi a.s. është urdhëruar që të refuzojë çdo lloj marrëveshjeje, kompromis dhe lëshimi fetar me kundërshtarët e tij duke iu thënë: "O ju mohues (të së vërtetës) unë nuk e adhuroj atë që e adhuroni ju, as ju nuk e adhuroni atë që e adhuroj unë..., ju keni fenë tuaj, kurse unë kam fenë time".

Në vazhdim duke komentuar këtë kaptinë kishte aluduar në çështjet kombëtare andaj fjalimi i tij kishte marrë karakter politik, sa që shumë kush nga të pranishmit kishin menduar se milicia e cila vëzhgonte ceremoninë e varrimit, do ta arrestonte po sa ta përfundonte fjalimin. Edhe pse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur, atë e kishin thirrur në stacionin e milicisë dhe e kishin marrë në pyetje duke iu kërcënuar me fjalë të ashpra. Mirëpo falë gjendshmërisë së tij i kishte shpëtuar asaj më të keqes.

Në kohën e dëbimit të popullatës gjatë luftës, nga Prishtina M. Ahmeti kishte ndodhur në orar të punës në medrese dhe bashkë me disa nxënës ishte detyruar të udhëtojnë si të gjithë të tjerët në drejtim të Bllacës. Pas kalimit të kufirit ishte vendosur në internatin e medresesë në Shkup, ku qëndroi deri në fund të luftës. Këtë periudhë kohore ai e përjetoi shumë rëndë, sepse tërë familja e tij kishte mbetur në Llap, duke ndërruar vendin prej një fshati në fshatin tjetër për shkak të rrezikshmërisë së madhe. Madje, atëkohë një nip i kishte lindur në malet e Koliqit, mirëpo përkundër kushteve të vështira fatmirësisht si fëmija ashtu nëna e tij kishin shpëtuar gjallë dhe pa pasoja.

Mulla Ahmeti u pensionua në vitin 2003, mirëpo pas shkuarjes në pension ai nuk e ndërpreu aktivitetin e tij andaj me kërkesën e xhematit të Llukës së Epërme të Deçanit e kreu detyrën e imamit për tre vjet. Falë aftësive të tij profesionale dhe punës me vullnet dhe përkushtim të plotë, kudo që shërbeu si imam dhe si edukator në medrese la përshtypje dhe kujtime të mira, andaj

njerëzit e deshën dhe e respektuan pa dallim moshe a profesioni gjatë tërë jetës së tij.

Mulla Ahmet Berisha ishte njeri inteligjent, bujar, trim dhe i sinqertë. Ai kishte gjykim racional, vizion të qartë dhe ishte i frymëzuar me ide të larta patriotike, fetare e kombëtare. Për çështje fetare, ideolog kryesor e kishte profesorin e njohur në medresenë e Sarajevës H. Hysein ef. Gjozën dhe liderin mysliman të Bosnjës, Alia Izetbegoviçin, ndërsa për çështje kombëtare i kishte veprimtarët dhe patriotët e dëshmuar z.Ismail Ajetin (Bushin) dhe Adem Demaçin, me të cilët ka pasur shkuarje-ardhje dhe ndeja të shpeshta.

Qëndrimin e tij të paluhatshëm dhe dashurinë e tij të sinqertë ndaj fesë, kombit dhe atdheut, mulla Ahmeti i dëshmoi në forma të ndryshme, me fjalë dhe me vepra gjatë tërë jetës së tij. Falë aftësive të tij intelektuale dhe oratorisë së dalluar në çdo tubim që merrte pjesë, në xhami qoftë apo vend tjetër publik, në dasmë apo rast vdekjeje, ai për moto të ligjëratës merrte një ajet kur'anor ose një hadith të Muhamedit a.s. e përkthente në shqip dhe në mënyrë bindëse e shpjegonte gjerësisht duke i kombinuar interesat e kësaj bote me të botës tjetër, dhe të fesë me ato të kombit e të atdheut. Gjatë sundimit të sistemit komunist ai ka qenë një anti-titist i përbetuar kurse në emër të çështjes kombëtare ka qenë një pro-enverist i madh. Mirëpo, pas rënies së sistemit diktatorial në Shqipëri dhe zbulimit të krimeve që i kishte bërë Enveri, ai e ndryshoi mendimin ndaj tij në tërësi.

M. Ahmeti e donte shumë vendlindjen e tij Majacin, e donte trevën e Llapit dhe çdo trevë shqiptare por mbi të gjitha e donte trevën e Drenicës, duke thënë se ajo në të gjitha kohërat ka lindur trima, të cilët i kanë paraprirë luftës për çlirimin e atdheut.

Qysh në fillim Mulla Ahmeti ishte mbështetës i luftës së UÇK-së, sepse ishte i bindur se pa luftë liria kurrë nuk mund të fitohet. Me rastin e fillimit të saj më 28 shkurt 1998 në Likoshan, me të dhe me mulla Abdyl Tërdevcin ishim duke shkuar për të pame te Nikajt e Gllanasellës (për Abdullahun që e kishte mbytur mizorisht policia serbe) e pastaj në Drenas të mulla Hajriz Demaku (për një vëlla që i kishte vdekur). Kur arritëm te Ferronikeli, njëri me një xhip të ambulancës duke ardhur në anën e kundërt, na tha që të kthehemi se atje janë duke luftuar. Me këtë rast ne u kthyem në të pame te M. Hajrizi dhe pas shprehjes së ngushëllimeve, prej tyre morëm vesh se në Likoshan kishin filluar luftimet mes UÇK-së dhe forcave policore para disa orëve dhe së krismat e armëve të ndryshme ishin duke u dëgjuar edhe në Drenas. Duke mirëpritur

një ngjarje të tillë paralajmëruese të lirisë, M. Ahmeti u shpreh: "Eu, Drenicë bravo ju qoftë, ia paskit kallë luftën edhe një herë shkaut"! Kur unë thash se ia paskan nisë, por nuk kanë me çka për ta vazhduar, M. Hajrizi tha: "Lufta po i tërhiqte armët dhe njerëzit kah nuk kujtohesh, si magneti hekurin. Unë ketë e kam provuar vetë në luftën e Shaban Polluzhës si ushtar i tij". Një konstatim i tillë u dëshmua më vonë në praktikë gjatë luftës, kur vinin njerëzit dhe armët jo vetëm nga vendet evropiane por edhe nga Amerika dhe Australia. Ai i çmonte lart dhe i donte të gjithë patriotët dhe dëshmorët duke filluar nga Ahmet Delia e Demë Ahmeti e deri te Adem Jashari e Zahir Pajaziti, por mbi të gjithë i donte dy Ademat; Adem Jasharin dhe Adem Demaçin.

"Ahmet ef. Berisha, qysh i ri ishte interesuar për çështje kombëtare dhe qysh atëherë kishte zgjedhur shokët më të mirë, me të cilët bashkëpunonte dhe bashkëvepronte. Ndër shokët më të mirë ishin: Adem Demaçi, Isuf Gërvalla, Dibran Bajraktari, Ismajl Ajeti-Bushi, Ismail Dumoshi, Ilaz Pireva etj. Kur kthehej për pushime nga studimet në Kajro, Ahmet efendi Berisha gjithmonë sillte libra shqip të cilat atje gjendeshin, por në Kosovë nuk guxohej as të përmendeshin. Ndër librat që solli nga Kajro ishin: "Lahuta e Malësisë", "Hasan Prishtina" Shqipëria etnike" etj. Ahmet efendi Berisha ishte përkrahës, organizator dhe pjesëmarrës i shumë proceseve, manifestimeve dhe demonstratave për liri dhe pavarësi. Gjatë pritjes që popullata i bënë legjendës, Adem Demaçit (me rastin e daljes nga burgu) pasi ishin të rrethuar nga forcat policore dhe paramilitare serbe, Ahmet efendi Berisha mori guximin nga të gjithë ne dhe u doli policisë përpara. Ai është aksionist dhe solidar, i cili ka ndihmuar të gjithë aksionet për rregullimin e rrugës së fshatit. Kanalizimin, ndërtimin e shkollës etj. Ka dhënë një kontribut mjaft të madh për pajtimin dhe faljen e gjaqeve dhe ngatërresave" (dr. Fehmi Krasniqi, në veprën e tij: Majaci - Lugina e Kaçandollit me rrethinë: 1912-2000, Prishtinë, 2006)

Mulla Ahmeti u varros me nderime të larta në vendlindjen e tij në Majac, natën e Kurban-Bajramit, ku mori pjesë një numër jashtëzakonisht i madh i farefisit, shokëve, miqve dhe dashamirëve, jo vetëm nga treva e Llapit, por edhe nga treva tjera të Kosovës. Në mesin e tyre pati shumë hoxhollarë, veprimtarë, funksionarë të lartë dhe intelektualë të profileve dhe moshave të ndryshme. Nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mori pjesë myftiu i Kosovës, mr. Naim ef. Tërnava me bashkëpunëtorët e tij, personeli i medresesë, përfaqësues të këshillave të Bashkësisë Islame të Podujevës,

Vushtrrisë, Pejës, Gjakovës, Rahovecit dhe të Lipjanit. Nga veprimtarët e çështjes kombëtare dhe funksionarë morën pjesë: Adem Demaçi, Ilaz Pireva, Fehmi Mujota, Ibrahim Makolli, Behxhet Shala e shumë të tjerë. Namazin e xhenazes së tij ia fali myftiu mr. Naim ef. Tërnava, duan (lutjen) pranë varrit ia këndoi mulla Ferat Gërguri nga Vushtrria, kurse për jetën dhe veprën e tij shkurtimisht foli autori i këtyre rreshtave.

M. Ahmeti la pas vetes familjen e tij shumanëtarëshe: bashkëshorten, gjashtë djem, pesë reja, gashtë nipa dhe katër mbesa. Të gjithë të edukuar në frymën e fesë Islame. Prej tyre dy djem me shkollim të mesëm, katër me fakultet, dy prej të cilëve e kanë të kryer edhe medresenë. Përveç anëtarëve të familjes dhe farefisit, ai la pas vetes edhe një numër të madh të shokëve, miqve dhe dashamirëve kudo që shërbeu si imam dhe si edukator në medrese.

Me Ahmet ef. Berishën më lidhin kujtime të shumta shoqërore nga bankat shkollore në medresenë e Prishtinës dhe atë të Sarajevës. Ato vazhdojnë gjatë shërbimit të tij si imam në Deçan, ku para tij unë kisha shërbyer pesë vjet, gjatë shërbimit të tij si edukator në medrese në Prishtinë dhe pas daljes sonë në pension, e deri në ditën që e përcollëm në botën tjetër.

Para një viti ai ka pasur një operim të rëndë nga tumori në zorrë, pas të cilit shëndeti i tij filloi të përmirësohet në dhe se përveç plogështisë së madhe nuk ndiente ndonjë dhimbje, kështuqë andaj vdekja e tij ishte pak sa e papritur. Lajmi për ndërrimin e jetës të tij më mërziti dhe me pikëlloi shumë. Vdekja e moshatarit dhe e shokut të ngushtë jashtëzakonisht përjetohet rëndë sepse, ta përkujton se ajo që i ka ndodhur atij sot, patjetër do të ndodhë edhe ty sot, apo nesër, t'i përkujton momentet e ndryshme gjatë shoqërimit me të, dhe të bën të kuptosh vlerën që e ka pasur dhe peshën e mungesës së tij.

Megjithatë, nuk na mbetet tjetër përveç se të ngushëllohemi me fjalët përkujtuese kur'anore: "Vërtet, ne jemi të Allahut dhe tek Ai ne do të kthehemi".

Zoti i madhërishëm e mëshiroftë shpirtin e tij, e shpërbleftë dhe na takoftë me të në xhennet.

Hajrullah Hoxha

30-VJETORI I VDEKJES SË MULLA RAMË ef. LLUMNICËS

Mulla Ramë Halim Llumnica u lind në vitin 1907 në Bellopojë të Podujevës, por meqë familja e tij qe shpërngulur në vitin 1920, nga fshati Bellopojë në fshatin Barilevë, Mulla Rama këtu edhe do ta kalojë jetën.

Familja e Mulla Ramës u dëbua me dhunë nga Toplica, pikërisht nga vendi i quajtur Llumnicë. Ai u rrit në një familje të madhe, me traditë fetare e kombëtare. Ishte më i vogli nga vëllezërit e tij, i zgjuar dhe i dalluar. Ata pasi që i panë këto veti të Mulla Ramës, punonin ditë e natë në Mullirin e Pashës në Barilevë, që atij t'ia mundësonin shkollimin.

Mulla Rama shkollimin e filloi në Mejtepin e fshatit Halabak të Llapit, pastaj vazhdoi në Medresenë "Pirinaz" në Prishtinë, te myderrizi i famshëm Hamdi Efendi Ibrahimi, tek i cili e mori ixhazetnamenë. Pas kryerjes së medresesë ai u detyrua nga serbosllavët që të shkonte në kryerjen e shërbimit ushtarak, duke qenë ushtar e kishte zënë Lufta e Dytë Botërore dhe Mulla Rama u zu rob (jesir) nga forcat

Mulla Ramë ef. Llumnica 1907-1982

gjermane. Ai u dërgua në Gjermani dhe u mbajt 4 vjet, duke përjetuar tortura dhe maltretime të ndryshme, familja e tij nuk e dinte që është i gjallë. Pas kthimit në atdhe ai vazhdoi aktivitetin e tij në organizimin dhe zbatimin e jetës fetare në trevat e Llapit e më gjerë.

Mulla Rama ka punuar për 7 vjet në Shajkofc të Podujevës, mirëpo punën e nderpreu në gjysmë, jo pse deshi ai porse ishte i detyruar nga regjimi serboçetnik Në vitin 1956, kur ishte aksioni për mbledhjen e armëve, qe nxierrë me dhunë nga shtëpia, i zbathur në mes të dimrit dhe qe rrethuar e maltretuar në prani të familjes së tij në mënyrën më mizore e barbare.

Pa marrë parasysh kundërshtimin e pushtetit Mulla Rama filloi përsëri detyrën e imamit, me kërkesën e xhematit të Dumnicës së Vushtrrisë, ku punoi për gjatë 20 vjetëve. Ai ishte edhe iniciator për ndërtimin e xhamisë po në këtë fshatë dhe dha kontribut të jashtëzakonshëm në arsimimin dhe emancipimin e fëmijëve të këtij fshati. Është i pakontestueshëm dhe jashtëzakonisht i çmueshëm kontributi i Mulla Ramës, në faljen e gjaqeve dhe ngatërresave të ndryshme, jo vetëm në Dumnicë por edhe në fshatrat përreth e më gjerë.

Për shkak të shërbimit të gjatë të tij në Dumnicë, njerëzit më tepër e quanin mulla Ramë Dumnica, mbiemër i cili i konvenonte më t'iu humbur gjurmët pushtetarëve.

Ai kishte aftësi të shumta profesionale e sidomos në nohjen e gjuhëve si: arabisht, turqisht, gjermanisht dhe serbisht.

Mulla Rama ishte bujar, i afërt me të gjithë, trim dhe i vendosur, sidomos kur ishte në pyetje çështja fetare dhe kombëtare. Ishte njeri serioz si në fjalë ashtu edhe në qëndrim dhe në vepra, ndërsa për nga fizionomia ishte burrë, i pashëm shtatgjatë e vital, shkonte i veshur pedant duke bartur gjithmonë uniformën e hoxhës.

Fjalët e tij janë dëgjuar nga të gjithë si nga të rinjtë ashtu edhe nga të rriturit me respekt dhe vëmendje të madhe.

Populli thoshte kur flet Mulla Ramë Llumnica, fjalët e tij të mbesin gjithmonë në mendje dhe zemër. Edhe sot e kësaj dite përmenden fjalët dhe këshillat e tij duke ia shtuar se kështu ka thënë Mulla Ramë Llumnica.

Mulla Ramë Llumnica ndërroi jetë më 16.11.1982 në Barilevë.

Allahu e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus, hoxhën e nderuar.

P.S. Mulla Ramën personalisht e kam njohur mirë, kurse shënimet biografike për të janë marrë nga djali i vëllait të tij, Enver Llumnica.

Përmbajtja

Qemajl Morina
Shqipëria – 100 vjet pas pavarësisë 5

Mr. Ejup Haziri
Shitblerja në Jurisprudencën Islame 13

Nexhat Ibrahimi
Kompleksiviteti ideologjik i lëvizjeve islame në botën arabo-islame në shekujt XX-XXI 39

Mr. Jahja Hondozi
Kontributi shkencor i prof. dr. Hasan Kaleshit në periodikun shkencor në Kosovë..... 55

Dr. Islam Hasani
Investimet në partneritet sipas parimeve islame..... 73

Abdu-rr-rrahman bedevī* - Filozof 91

Nuruddin Mahmudi - strategu i paprekshëm..... 107

Mr. Qemajl Morina
Kontributi i hoxhë Kadri Prishtinës, në mbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare..... 123

Mr.sc. Rrezehana Hysa
Përpjekja e patriotëve shqiptarë për formimin e shtetit shqiptar dhe çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve 135

Mexhid Yvejsi
40-vjetori i xhamisë, qendresë islame shqiptare-amerikane për shtetet Nju-Jork dhe Nju Xhersi..... 149

Mr. Rexhep Suma
Efekti serioz i medieve mbi strukturën familjare 169

Sedat Islami
Qasjet e mediave ndaj të drejtës fetare islame në periudhën e pasluftës në Kosovë..... 187

Zekeriya Karabell
Në emër të Zotit..... 207

Prof. Dr. Zejnullah Gruda
Krimet njëshekullore ndaj shqiptarëve – krimet gjatë Luftërave Ballkanike..... 241

Shaqir Shala
Xhamia e Gurit në Rogovë të Hasit..... 263

Mr. Muhidin Ahmeti
Kurban-Bajrami më shumë se një festë..... 277

Hajrullah Hoxha
Ndërroi jetë mulla Ahmet ef. Berisha 1938-2012..... 291

Hajrullah Hoxha
30-vjetori i vdekjes së mulla Ramë ef. Llumnicës..... 299

Përmbajtja..... 301